BULETINI EKONOMIK

qershor 2009

Banka e Shqipërisë

Artikujt e paraqitur në këtë botim, nuk shprehin gjithmonë opinionin zyrtar të Bankës së Shqipërisë. Këtyre artikujve lutemi t'u referoheni si mendime personale të autorëve.

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga: Banka e Shqipërisë, sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë.
Tel: 355-4-2222230; 2222152; 2235569.
Faks: 355-4-2223558.
E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

Tirazhi: 600 kopje.

P Ë R M B A J T J A

Deklarata e politikës monetare për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 7

Fjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z.Ardian Fullani
Në konferencën për shtyp me shefin e Misionit të FMN-së për Shqipërinë, z. Gerwin Bell dhe Ministrin e Financave, z. Ridvan Bode
7 prill 2009 68

Fjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z.Ardian Fullani
Në prezantimin e Raportit Vjetor për vitin 2008 përpara Komisionit të Ekonomisë dhe Financave
8 prill 2009 70

Fjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z.Ardian Fullani
Në prezantimin e Raportit Vjetor për vitin 2008 në Kuvendin e Shqipërisë
16 prill 2009 82

Fjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z.Ardian Fullani
Gjatë prezantimit të zhvillimeve ekonomike në Shqipëri dhe sfidave të ardhshme, organizuar nga Citigroup Londër, IFC - International Financial Services dhe Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar
Londër, 18 maj 2009 96

Fjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z.Ardian Fullani
Në takimin Rajonal të Guvernatorëve dhe Bankierëve
Mali i Zi, 20 qershor 2009 102

Artikujt e botuar në Buletinin Ekonomik 2009 109

Artikuj 111

Matja e pritshmërive të inflacionit 111

Kriza financiare dhe vendet e rajonit 130

Banka e Shqipërisë në harkun kohor prill-qershor 2009 139

Kronologji e vendimeve të politikës monetare 144

Ngjarjet juridike, prill - qershor 2009 146

Drejtimi i Bankës së Shqipërisë, 30 qershor 2009 152

Lista e subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë 153

Publikime të botuara nga Banka e Shqipërisë që prej vitit 2008 157

P Ë R M B A J T J A E T A B E L A V E

Deklarata e politikës monetare për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009

Tabelë 1. Disa tregues kryesorë makroekonomikë. 11
Tabelë 2. Disa tregues makroekonomikë për vendet BRIK. 13
Tabelë 3. Tregues ekonomikë për vendet e rajonit. 14
Tabelë 4. Kontributi i kategorive në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje). 21
Tabelë 5. Tregues vjetorë të bilancit të energjisë elektrike (në GWh). 28
Tabelë 6. Tregues të bilancit të pagesave në vite. 29
Tabelë 7. Treguesit fiskalë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit, në krahasim me periudhën 2007-2009. 35
Tabelë 8. Deficiti buxhetor dhe mënyra e financimit të tij, gjatë 6M 1, 2005-2009, në miliardë lekë. 37
Tabelë 9. Tregues të punësimit dhe të papunësisë. 50
Tabelë 10. Normat vjetore të ndryshimit të disa përbërësve të IÇP-së dhe të IÇK-së të kategorisë "ushqime të përpunuara" (në përqindje). 52

Matja e pritshmërive të inflacionit

Tabelë 1. Treguesi RKMG i inflacionit të pritur i llogaritur me metodat probabilitare. 118
Tabelë 2. Frekuenca e përgjigjeve të kategorisë së pyetjes "Si mendoni se do të ndryshojnë çmimet në 3 muajt e ardhshëm? 121

Kriza financiare dhe vendet e rajonit

Tabelë 1. Ndryshimi i PBB-së reale në përqindje vjetore në disa rajone të botës. 125
Tabelë 2. Ndryshimet vjetore të disa treguesve makroekonomikë për vitin 2008. 129

P Ë R M B A J T J A E G R A F I K Ë V E

Deklarata e politikës monetare për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009
Grafik 1. Normat bazë të interesit të disa bankave qendrore. 14
Grafik 2. Normat e liborit usd dhe euro (djathtas) dhe ecuria e kursit euro dollar (majtas). 15
Grafik 3. Ndryshimi vjetor i çmimit të naftës në tregun ndërkombëtar dhe i kursit të këmbimit euro/usd. 16
Grafik 4. Ecuria e çmimeve të lëndëve të para në tregun botëror. 16
Grafik 5. Inflacioni vjetor sipas tremujorëve (në përqindje). 17
Grafik 6. Norma bazë e interesit të Bankës së Shqipërisë. 18
Grafik 7. Diferencat në inflacion për periudhat 2008M3 – 2007M1 (majtas) dhe 2009M5- 2008M3 (djathtas). 19
Grafik 8. Diferencat në normën bazë të interesit për periudhat 2008M3 – 2007 M1 (majtas) dhe 2009M5 - 2008M3 (djathtas). 19
Grafik 9. Bilanci i bankave qendrore (në indeks bazë 2007 M1). 20
Grafik 10. Ecuria e Indeksit të Kushteve Monetare dhe e komponentëve të tij. 20
Grafik 11. Kontributi i kategorive në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje). 21
Grafik 12. Inflacioni vjetor sipas kategorive të mallrave dhe shërbimeve (në përqindje). 23
Grafik 13. Mesatarja e matjeve të inflacionit bazë, jobazë dhe atij total vjetor (në përqindje). 24
Grafik 14. Inflacioni vjetor i mallrave të tregtueshëm dhe të patregtueshëm. 24
Grafik 15. Rritja vjetore e indeksit të shifrës së afarizmit në total (në %) dhe kontributet e sektorëve në rritje (në p.p.), dhe ecuria e TTE. 26
Grafik 16. Ecuria e prodhimit të bujqësisë. Ndryshimi vjetor në përqindje dhe kontributi i nënsektorëve, në pikë përqindje. Ndryshimi vjetor i prodhimit agroindustrial. 26
Grafik 17. Ecuria e indeksit të çmimit të banesave dhe e indeksit të qirasë së banesave. 27
Grafik 18. Raporti i çmimit ndaj qirasë së banesave dhe prirja afatgjatë e tij. 27
Grafik 19. Llogaria korente (majtas) dhe bilanci i pagesave (djathtas) në përqindje ndaj PBB-së. 30
Grafik 20. Vlera e importeve, eksporteve dhe bilanci tregtar (milionë euro). 30
Grafik 21. Ndryshimet vjetore në importin e kategorive mallra kapitalë, të ndërmjetëm dhe konsumi (në për qind). 31
Grafik 22. Vlera e eksporteve, importeve dhe prirja historike (në milionë euro). 31
Grafik 23. Ndryshimi vjetor i vlerës dhe vëllimit të importeve, eksporteve dhe i indeksit të vlerës njësi (në për qind). 31
Grafik 24. Ecuria e PP dhe e KPNj në ekonominë shqiptare. 32
Grafik 25. KPNj në ekonomi të ndryshme. 33
Grafik 26. Llogaria kapitale dhe financiare në përqindje të PBB-së në vite. 34
Grafik 27. Ndryshimet vjetore (në%) të të ardhurave dhe shpenzimeve për 6M I, 2000-2009. 36
Grafik 28. Deficiti buxhetor dhe financimi i tij sipas burimeve kryesore, për 6M I 2000-2009 (miliardë lekë). 36
Grafik 29. Shuma rrëshqitëse e balancës primare, qershor 2000-qershor 2009 (në miliardë lekë). 37
Grafik 30. Ecuria e balancës buxhetore dhe llogarisë korente, mesatare ndaj PBB-së, 2002-2008. 38
Grafik 31. Ecuria e komponentëve të kërkesës për para dhe rritja vjetore e M3. 39
Grafik 32. Rritja vjetore e agregatëve monetarë. 39
Grafik 33. Rritja vjetore e agregatëve monetarë. 40
Grafik 34. Ecuria e depozitave sipas monedhës dhe në terma kohorë (pastruar nga efektet e kursit të këmbimit). 41
Grafik 35. Ecuria e depozitave me afat në lekë dhe valutë sipas kategorive (në miliardë lekë dhe përqindje). 41
Grafik 36. Ecuria e MVN në milionë usd. 42
Grafik 37. Ecuria e ndryshimeve vjetore të MVN në për qind, e ndarë në burime investimesh. 42
Grafik 38. Ecuria e portofolit të kredisë. 43
Grafik 39. Ecuria dhe struktura e kredisë së re, të disbursuar sipas monedhës. 44
Grafik 40. Ecuria e portofolit të kredisë sipas monedhës së indeksimit. 44
Grafik 41. Shpërndarja e portofolit të kredisë sipas grupeve kredimarrëse. 45
Grafik 42. Ecuria e kredisë sipas sektorëve të ekonomisë. 46

Grafik 43. Ecuria e kredisë sipas grupeve dhe qëllimit të përdorimit. 46
Grafik 44. Ndryshimet në standardet e kredisë të aplikuara në kreditë e bizneseve dhe ndikimi i faktorëve të ndryshëm në to (balanca neto), në përqindje. 48
Grafik 45. Ndryshimet në standardet e kredisë të aplikuara në kreditë e individëve për banesa dhe për konsum, dhe ndikimi i faktorëve të ndryshëm (balanca neto), në përqindje. 48
Grafik 46. Ecuria e financimit të deficitit buxhetor dhe struktura e borxhit. 49
Grafik 47. Ecuria e pagës mesatare në disa prej aktiviteteve ekonomike (ndryshime vjetore në për qind). 51
Grafik 48. Ecuria e pagës minimale dhe e pagës mesatare në sektorin e prodhimit e shërbimeve, dhe në atë shtetëror. 51
Grafik 49. Ndryshimi vjetor i indekseve të mallrave përfshirë në IÇP (boshti djathtas) dhe IÇK (boshti majtas). 53
Grafik 50. Ndryshimet vjetore të çmimeve të huaja dhe të çmimeve në vend (grafiku majtas) dhe të çmimeve të huaja dhe në vend të mallrave ushqimorë (grafiku djathtas) dhe kursi i këmbimit. 53
Grafik 51. Ndryshimi vjetor i çmimit të naftës në vend dhe jashtë dhe i kursit të këmbimit lek/usd. 54
Grafik 52. Pritjet e konsumatorëve dhe bankave për inflacionin vjetor dhe inflacioni aktual (në përqindje). 54
Grafik 53. Pritjet e bizneseve për ecurinë e çmimeve të prodhimit pas një tremujori (përqindje neto). 55
Grafik 54. Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë dhe ecuria e normës bazë të interesit. 56
Grafik 55. Normat e interesit në tregun ndërbankar (majtas) dhe vëllimi ditor i huadhënies (djathtas), në miliardë lekë. 57
Grafik 56. Raporti i mbulimit të kërkesës për financimin e deficitit në tregun primar dhe ecuria e yield-it 12-mujor. 58
Grafik 57. Kurba e yield-eve (majtas) dhe yield-et afatgjata të letrave me vlerë në tregun primar (djathtas). 58
Grafik 58. Ecuria e interesave të depozitave 12-mujore dhe normat bazë (majtas) dhe diferenca e normës së interesit për depozitat 12-mujore lek-euro (djathtas). 59
Grafik 59. Ecuria e interesit mesatar të ponderuar për kreditë e reja në lekë. 60
Grafik 60. Interesi mesatar i ponderuar për kreditë e reja në euro, për depozitat në euro dhe interesi euribor 12-mujor. 61
Grafik 61. Normat e ndërmjetësimit në lekë dhe në euro (majtas) dhe diferenca midis interesit mesatar të kredisë së re në lekë dhe atij në euro (djathtas). 61
Grafik 62. Ndryshimet vjetore të lekut në terma nominalë efektivë (NEER) dhe mesatarja rrëshqitëse e tyre. 62
Grafik 63. Ecuria e raportit euro/lek në krahasim me mesataren e rajonit. 62
Grafik 64. Ecuria ditore e raportit euro/lekë dhe usd/lekë. 62
Grafik 65. Luhatshmëria e këmbimit të lekut në tremujorë. 63

Matja e pritshmërive të inflacionit

Grafik 1. Tendencat e përgjigjeve të vrojtimit të IBK lidhur me ndryshimin e pritur të çmimeve. 110
Grafik 2. Metoda e rregulluar e Carlson and Parkin (1975) 111
Grafik 3. Inflacioni i pritur, i llogaritur sipas inflacionit mesatar aktual tremujor dhe shpërndarjet probabilitare përkatëse. 116
Grafik 4. Inflacioni i pritur, i llogaritur sipas inflacionit aktual tremujor dhe shpërndarjet probabilitare përkatëse. 116
Grafik 5. Inflacioni i pritur i periudhës t+1 dhe inflacioni aktual (i thjeshtë apo mesatar). 116
Grafik 6. Inflacioni i pritur i periudhës t sipas shpërndarjes së studentit dhe asaj normale dhe inflacioni aktual i periudhës t (i thjeshtë apo mesatar). 117
Grafik 7. Inflacioni i pritur i periudhës t+1 dhe inflacioni aktual (i thjeshtë apo mesatar). 117

Kriza financiare dhe vendet e rajonit

Grafik 1. Ndryshimi në vlerën e monedhave përkatëse i indeksuar sipas muajit tetor të vitit 2008. 127

DEKLARATA E POLITIKËS MONETARE PËR GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2009

I. FJALA E GUVERNATORIT

Zhvillimet ekonomike të gjashtëmujorit të parë kanë shtruar disa sfida të forta për ekonominë shqiptare. Kriza botërore ka ndikuar ekonominë tonë, duke lëkundur faktorët dhe ekuilibrat të cilët kanë mbështetur rritjen ekonomike, duke testuar mekanizmat e imunitetit dhe të vetërregullimit të ekonomisë, si dhe duke ngritur disa pyetje komplekse për agjentët ekonomikë dhe politikat makroekonomike.

Recesioni ekonomik që ka përfshirë pjesën më të madhe të partnerëve tanë tregtarë është shoqëruar me uljen e shkëmbimeve tregtare dhe të të hyrave valutore. Rritja e pasigurisë në tregjet financiare globale ka ndikuar në lëkundjen e besimit në sistemin financiar, duke ushtruar presion për shtrëngimin e kushteve financiare në Shqipëri. Të dy këta faktorë janë reflektuar në uljen e konsumit, të eksporteve dhe të investimeve, duke sjellë ngadalësimin e aktivitetit ekonomik dhe duke ushtruar presion mbi treguesit fiskalë të të ardhurave buxhetore dhe të deficitit buxhetor. Nga ana tjetër, pakësimi i flukseve hyrëse valutore është shoqëruar me përkeqësimin e treguesve të bilancit të pagesave dhe lindjen e presioneve nënçmuese mbi kursin e këmbimit, duke nënvizuar rolin e qëndrueshmërisë së llogarisë korente në ekuilibrat makroekonomikë dhe financiarë të vendit si dhe nevojën e marrjes së masave për garantimin e saj.

Ambienti ekonomik botëror është karakterizuar nga thellimi i mëtejshëm i krizës ekonomike dhe financiare. Rënia e konsumit dhe e investimeve, në prani të niveleve të larta të borxhit publik e privat si dhe të imbalancave të theksuara makroekonomike, ka bërë që ekonomia botërore të përjetojë rënien më të fortë ekonomike të 50 viteve të fundit. Vendet e zhvilluara, SHBA, Eurozona, Mbretëria e Bashkuar dhe Japonia, kanë ndjekur politika monetare e fiskale lehtësuese, të cilat kanë synuar frenimin e rënies ekonomike dhe përmirësimin e situatës në tregjet financiare dhe të kapitaleve. Nën ndikimin e tyre, të dhënat më të fundit sinjalizojnë për shenja përmirësimi relativ të disa treguesve makroekonomikë. Tensionet e vërejtura në periudhën e mëparshme janë ulur dhe treguesit kryesorë financiarë kanë shenja ripërtëritjeje gjatë muajve të fundit. Ndërkohë, normat e inflacionit botëror kanë ardhur në rënie si pasojë e çmimeve të ulëta të lëndëve të para dhe e shfrytëzimit të ulët të kapaciteteve prodhuese, në kushtet e një kërkese agregate të ulët dhe papunësie në rritje.

Reduktimi i aktivitetit ekonomik në nivel botëror është shoqëruar nga tkurrja e tregtisë botërore, nga shtrëngimi i kushteve financiare dhe nga rënia e

besimit të agjentëve ekonomikë. Ndikimi direkt mbi vendet në zhvillim, si Shqipëria, është rënia e kërkesës për eksportet e tyre, rënia e investimeve të huaja direkte dhe shtrëngimi i kushteve të huamarrjes në tregjet botërore. Kjo ka bërë që këto vende të preken gjithnjë e më shumë nga kriza. Sipas FMN-së, vendet në zhvillim të Evropës Lindore parashikohet të kenë një kontraktim prej rreth 5 për qind gjatë këtij viti.

Në këtë ambient të pafavorshëm, ekonomia shqiptare ka regjistruar një ecuri krahasimisht pozitive. Të dhënat mbi ekonominë reale janë të pakta. Banka e Shqipërisë gjykon se gjashtëmujori i parë i vitit është karakterizuar nga një rritje pozitive ekonomike. Nga ana tjetër, rritja e ulët e kredisë dhe e ofertës monetare, treguesit e përkeqësuar të besimit të biznesit dhe të konsumatorit, ngadalësimi i të ardhurave buxhetore dhe treguesve specifikë të sektorëve të caktuar të ekonomisë, sugjerojnë se ritmi i rritjes ekonomike është zvogëluar. Është ende herët të konkludojmë mbi ecurinë ekonomike gjatë vitit 2009 e në vazhdim. Banka e Shqipërisë gjykon se ekzistojnë premisat për të ruajtur ritmet pozitive të rritjes ekonomike në vend, ndër të cilat stabiliteti makroekonomik dhe ai financiar i vendit mbeten primarë.

Aktiviteti ekonomik në vend është zhvilluar në kushtet e një stabiliteti të kënaqshëm të çmimeve të konsumit. Ai është mbështetur nga tendenca zbutëse e kushteve monetare si dhe nga një politikë fiskale ekspansioniste gjatë kësaj periudhe. Banka e Shqipërisë uli normën bazë të interesit në muajin janar dhe ndërmori operacione injektuese likuiditeti, duke shtuar sasinë e tij në treg. Njëkohësisht, kemi zgjatur horizontin e maturimit të operacioneve injektuese për të zbutur pjerrësinë në rritje të kurbës së normave të interesit si dhe kemi zgjeruar bazën e kolateralit të pranuar për të lehtësuar aksesin e institucioneve financiare në fonde likuide. Këto veprime të Bankës së Shqipërisë kanë ndihmuar në kontrollin e nivelit të normave të interesit. Ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë ka qenë më efektive në kontrollin e normave afatshkurtra të interesit. Ndërkohë që normat afatgjata të interesit të letrave me vlerë të qeverisë dhe të kredive kanë patur tendenca rritëse, si pasojë e kërkesës së qeverisë për financim dhe ndjeshmërisë së rritur të sistemit bankar ndaj treguesve të likuiditetit. Paralelisht me këtë, tendencat nënçmuese të kursit të këmbimit kanë plotësuar kuadrin e kushteve më të lehtësuara monetare, duke favorizuar eksportet dhe përmirësimin e deficitit tregtar. Megjithatë, ashtu siç e kemi theksuar vazhdimisht në deklaratat tona, Banka e Shqipërisë ka qenë e vëmendshme në administrimin e stimulit monetar, duke synuar në rradhë të parë përmbushjen e objektivit të saj për ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, nëpërmjet ruajtjes së ekuilibrave të brendshëm dhe të jashtëm të vendit.

Inflacioni vjetor në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 rezultoi mesatarisht 2.0 për qind, duke shënuar rënie në krahasim me normat e inflacionit të vërejtura gjatë vitit të kaluar por duke qëndruar brenda nivelit të synuar nga Banka e Shqipërisë. Normat e ulëta të inflacionit në gjysmën e parë të këtij viti janë shkaktuar nga dobësimi i presioneve inflacioniste nga ana e kërkesës dhe ofertës, si pasojë e rënies së çmimeve të lëndëve të para në tregun ndërkombëtar dhe ngadalësimit të aktivitetit ekonomik në vend. Stabilizimi i

presioneve inflacioniste ilustrohet qartë nga nivelet e ulëta të inflacionit bazë dhe të atij të mallrave të patregtueshëm gjatë kësaj periudhe, duke u reflektuar edhe në pritje të kontrolluara të agjentëve ekonomikë të tregut. Ndërkohë, pas një periudhe të gjatë disinflacioniste dhe duke konfirmuar parashikimet e Bankës së Shqipërisë, ndryshimi vjetor i çmimeve të konsumit shfaqi prirje të lehtë rritëse, gjatë tremujorit të dytë të vitit 2009. Inflacioni vjetor shënoi normën 2.3 për qind në muajin qershor, duke reflektuar një përcjellje më të plotë të efektit të nënçmimit të kursit të këmbimit mbi çmimet e mallrave të konsumit. Banka e Shqipërisë gjykon se ky faktor mund të luajë një rol më të madh në të ardhmen në përcaktimin e këtyre çmimeve, duke përbërë premisa për goditje afatshkurtra dhe afatmesme mbi nivelin e çmimeve.

Përkundrejt këtyre zhvillimeve, ekonomia shqiptare ka vijuar të karakterizohet nga norma të ulëta kursimi publik dhe privat edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2009, duke u shoqëruar me zgjerimin e mëtejshëm të deficitit të llogarisë korente dhe duke rritur presionet mbi ecurinë e kursit të këmbimit. Rënia e njëkohshme e eksporteve dhe e importeve, respektivisht me 19.6 dhe 6.3 për qind në nivel vjetor, bëri që deficiti tregtar të ngushtohej me 1.3 për qind gjatë pesë muajve të parë të vitit. Megjithatë, ulja e dërgesave të emigrantëve me rreth 8 për qind gjatë tremujorit të parë si dhe përkeqësimi i llogarisë së shërbimeve, bënë që deficiti i llogarisë korente të shënonte një rritje vjetore prej 5 pikësh përqindjeje të PBB-së, gjatë këtij tremujori. Megjithëse ky deficit shkon për të financuar në një masë të madhe mallra importi kapitalë dhe të ndërmjetëm, qëndrueshmëria e tij meriton një vëmendje më të madhe. Veçanërisht shqetësuese është shkalla e ulët e mbulimit të eksporteve ndaj importeve, e cila sinjalizon për probleme strukturore të këtij deficiti si pasojë e konkurrueshmërisë ende të ulët të ekonomisë tonë.

Në këtë drejtim, një vëmendje më e madhe i duhet kushtuar kontrollit të kostove dhe rritjes së produktivitetit në ekonomi, nëpërmjet rritjes së investimeve në edukim dhe tërheqjes e aplikimit të teknologjive më të përparuara në prodhim. Gjithashtu, në një periudhë afatmesme, politikat makroekonomike duhet të jenë të vëmendshme ndaj nivelit të kursimeve publike e private, për të kontrolluar nevojën e përdorimit të burimeve të huaja të financimit.

Politika fiskale gjatë gjysmës së parë të vitit 2009 ka patur një natyrë ekspansioniste, duke u karakterizuar nga një rritje e shpejtë e shpenzimeve dhe e deficitit buxhetor. Të ardhurat buxhetore kanë shënuar një rritje më të moderuar, duke reflektuar pjesërisht edhe efektet e ngadalësimit të aktivitetit ekonomik. Megjithëse mbetet brenda nivelit të planifikuar për gjithë vitin 2009, deficiti buxhetor prej rreth 30 miliardë lekësh përbën një shifër shumë më të madhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në këto kushte, Banka e Shqipërisë do të vlerësonte marrjen e masave për kontrollin brenda niveleve të planifikuara të deficitit buxhetor dhe të huamarrjes publike, duke ndihmuar në ruajtjen e ekuilibrave të brendshëm dhe të jashtëm të ekonomisë. Ruajtja e parametrave të planifikuar buxhetorë do të ketë një ndikim pozitiv në stabilitetin makroekonomik, nëpërmjet kontrollit të stimulit fiskal mbi kërkesën agregate dhe uljes së presionit mbi tregjet monetare.

Kërkesa për mjete monetare ka njohur rritje gjatë muajve të fundit. Rritja e ofertës monetare me rreth 8 për qind, është bazuar në krijimin e parasë në ekonomi nga sektori publik si dhe nga huamarrja e sektorit privat, kryesisht në lekë. Portofoli i kredisë ka njohur një rritje modeste prej 7.5 miliardë lekësh ose rreth 5 herë më pak se në të njëjtën periudhë një vit më parë. Pakësimi i burimit të fondeve të bankave dhe rritja e pasigurisë në vend ndikuan në ngadalësim të dukshëm të ritmeve të rritjes të kredisë. Megjithatë, kreditimi i ekonomisë ka njohur rritje përgjatë muajve të parë të vitit ndërkohë që sistemi bankar ka sinjalizuar mosshtrëngimin e mëtejshëm të kushteve të kredisë gjatë tremujorit të tretë e në vazhdim. Kërkesa për kredi në lekë e sektorit privat është përballur me një gatishmëri në rritje të bankave, në sajë të stabilizimit të situatës së likuiditetit dhe lehtësimit të kushteve monetare në fillim të vitit 2009. Kufizimi i ofertës së parasë në valutë ka rezultuar në kontraktimin e përbërësit valutor të strukturës së parasë edhe në kahun e kërkesës për para, duke sjellë zhvendosjen e strukturës së ofertës monetare drejt lekut.

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009, situata në tregun financiar u ndikua nga rritja e pasigurisë dhe rivlerësimi i primeve të rrezikut që shoqëruan mungesën e likuiditetit si pasojë e rrjedhjeve të depozitave dhe uljes së aktivitetit kreditues. Ndërhyrja e vazhdueshme e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë, e kombinuar me masa që synonin qetësimin e tregut dhe nxitjen e aktivitetit në tregun ndërbankar, si dhe ruajtja e treguesve të shëndoshë të sistemit financiar, kanë bërë që fundi i periudhës të shënojë stabilizim të kushteve të likuiditetit dhe të normave të interesit. Këto të fundit kanë treguar sjellje të ndryshme sipas maturitetit. Interesat afatshkurtër në tregun e parasë kanë pësuar ulje si pasojë e reduktimit të normës bazë të interesit dhe përmirësimit të kushteve të likuiditetit. Interesat afatgjatë janë rritur në kushtet e kërkesës së lartë për fonde afatgjata dhe rritjes së primit të rrezikut. Rritja e interesave në tregun primar është përcjellë tek interesat për kreditë e reja në lekë, për maturitete mbi një vit, e ndikuar edhe nga një prirje e përgjithshme e shtrëngimit të aktivitetit kredidhënës.

Banka e Shqipërisë gjykon se problemet e likuiditetit, të balancave të brendshme dhe të jashtme të ekonomisë dhe ato të shëndetit financiar përbëjnë sfidat direkte mbi stabilitetin makroekonomik dhe ecurinë afatgjatë të ekonomisë shqiptare. Trajtimi i tyre duhet të orientohet në vazhdimësi nga nevoja për respektimin e ekuilibrave të nevojshëm makroekonomikë të vendit. Qëndrueshmëria e nivelit të çmimeve, zbutja e luhatshmërisë së treguesve monetarë, një sistem financiar i shëndetshëm dhe eficient, si dhe bilance të shëndosha të sektorit publik dhe atij privat, ndikojnë në uljen e primeve të rrezikut në ekonomi, në zgjatjen e horizonteve të investimit dhe në shpërndarjen më eficiente të fondeve në ekonomi. Gjithashtu, ato i hapin rrugë tërheqjes së investimeve të huaja dhe ulin koston e huamarrjes në tregjet ndërkombëtare. Në këtë mënyrë, ato japin një kontribut të pazëvendësueshëm në rritjen afatgjatë të vendit.

Nxitja e mëtejshme e kësaj rritjeje kërkon vazhdimin e reformave strukturore të ekonomisë, të cilat nuk duhet të adresojnë vetëm dobësitë e ekonomisë

tonë por edhe të paraprijnë tendencat e ardhshme të zhvillimit. Investimi në infrastrukturë duhet të mbetet një prioritet i përdorimit të fondeve të ekonomisë. Po kështu, zhvillimi e konsolidimi i mëtejshëm i segmenteve të tregut financiar, plotësimi dhe zgjerimi i sistemit të pensioneve në favor të elementeve të iniciativës private, investimi me prioritet në fushën e arsimit dhe të shëndetësisë meritojnë vëmendjen e të gjithë aktorëve ekonomikë. Gjithashtu, ne gjykojmë se ka ardhur koha që sektori privat të reflektojë stadin e ri të zhvillimit të vendit nëpërmjet rritjes dhe fuqizimit të aftësive të tij menaxhuese. Kjo kërkon administrimin më të mirë të rrezikut të biznesit dhe të atij financiar, duke nënkuptuar edhe një bashkëpunim më të ngushtë me agjentët e specializuar të tregut, zgjatjen e horizontit të planeve të biznesit dhe orientimin më të mirë të tyre me realitetin global dhe prioritetet e zhvillimit të vendit.

Në të njëjtën linjë, sistemi financiar duhet t'i përgjigjet me më shumë përkushtim këtyre kërkesave, duke rritur transparencën dhe eficiencën e produkteve të tij. Tashmë që sistemi bankar ka kapërcyer momentet delikate me të cilat u përball në fundin e vitit 2008, ai duhet të rrisë kontributin e tij në financimin e aktivitetit të sektorit privat të ekonomisë. Megjithatë, përfitoj nga ky rast që edhe një herë të theksoj se stabiliteti financiar i sistemit bankar është një objektiv tjetër madhor për të cilin Banka e Shqipërisë mbetet thellësisht e angazhuar. Ky sistem do të jetë subjekt i pandërprerë i mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë dhe analizave "stress – test" të vazhdueshme.

II. ZHVILLIMET NË EKONOMINË E JASHTME

Në gjashtë muajt e parë të vitit 2009, ekonomia botërore ka njohur ngadalësim që ka ardhur nga tkurrja ekonomike e vendeve të zhvilluara dhe nga normat më të ngadalta të rritjes të vendeve në zhvillim. Normat e inflacionit botëror kanë ardhur në rënie, shkaktuar kryesisht nga rritja e kapaciteteve të lira si pasojë e ngadalësimit ekonomik botëror dhe nga efekti statistikor që sjell krahasimi me një bazë më të lartë. Në të njëjtën periudhë vitin e kaluar, çmimet e mallrave, sidomos energjia dhe ushqimet pësuan një rritje të shpejtë.

Tabelë 1. Disa tregues kryesorë makroekonomikë.

	Ndryshimi vjetor i PBB-së	Norma e papunësisë	Inflacioni vjetor
Vendet	T1-09	6M 1-09	6M 1-09
ShBA	-2.5	8.7	-0.6
Eurozonë	-4.8	8.9[1]	0.6
Gjermani	-6.9	7.5[1]	0.5
Greqi	0.3	8.9[2]	1.3
Itali	-6.0	7.4[3]	1.1
Japoni	-8.4	4.7	-0.3[1]

[1] *Mesatare për periudhën janar-maj 2009.*
[2] *Mesatare për periudhën janar-prill 2009.*
[3] *Të dhënat për tremujorin e parë të vitit 2009.*

II.1 RRITJA EKONOMIKE DHE BALANCAT MAKROEKONOMIKE

Në tremujorin e parë të vitit 2009, aktiviteti ekonomik në Eurozonë ka vijuar tendencën rënëse duke u tkurrur me 2.5 për qind krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Shkaku kryesor për këtë tkurrje është rënia e investimeve, të cilat janë zvogëluar me 4.2 për qind krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2008. Rënie kanë shënuar gjithashtu, edhe kërkesa vendase dhe ajo e jashtme që është reflektuar në tkurrjen e eksporteve. Treguesit për tremujorin e dytë të vitit 2009, dëshmojnë për rritje mujore prej 0.2 për qind të indeksit të shitjeve në muajin prill dhe rritje të lehtë të indekseve të besimit në muajin maj. Këto zhvillime lënë të kuptohet se tkurrja ekonomike do të vijojë me ritme më të ulëta. Sipas parashikimeve të Bankës Qendrore Evropiane tkurrja pritet të vazhdojë me terma më të moderuar deri në mesin e vitit 2010, kur mendohet të shfaqen normat e para pozitive të rritjes tremujore.

Sipas të dhënave paraprake, norma vjetore e inflacionit në Eurozonë për muajin qershor 2009 shënoi vlerën -0.1 për qind krahasuar me vlerat 0.6 dhe 0 për qind, për muajt prill dhe maj përkatësisht. Këto vlera të ulëta janë pasojë e efektit statistikor që sjell krahasimi me çmimin e lartë të energjisë në të njëjtën periudhë në vitin 2008.

Aktiviteti ekonomik në SHBA gjatë gjysmës së parë të vitit 2009, ashtu si edhe gjatë fundvitit të kaluar, vazhdoi të jetë i dobët. Kështu, përllogaritjet përfundimtare mbi ecurinë ekonomike gjatë tremujorit të parë të vitit dëshmojnë për një kontraktim të ekonomisë me 5.5 për qind në terma tremujorë. Rënia e PBB-së kryesisht reflektoi rënien e përshpejtuar të eksporteve dhe investimeve agregate. Ndërkohë ecuria pozitive e shpenzimeve për konsum dhe rënia e përshpejtuar e importeve të mallrave e shërbimeve nuk arritën të eklipsojnë këto zhvillime negative[1]. Të dhënat për tremujorin e dytë të vitit paraqesin një përmirësim të lehtë të kushteve ekonomike në vend kryesisht prej sinjaleve pozitive që përcillen nga sektori industrial. Norma e papunësisë u rrit ndjeshëm, në vlerën mesatare 8.7 për qind. Indeksi i çmimeve të konsumit ka regjistruar rënie mesatarisht me 0.4 për qind për periudhën janar-maj të vitit 2009 në terma vjetorë.

Vendet BRIK[2] kanë përjetuar skenarë të ndryshëm të ecurisë ekonomike gjatë gjysmës së parë të vitit në kushtet e situatës jo të favorshme makroekonomike botërore. Në Brazil e Rusi ekonomitë regjistruan kontraktim në terma vjetorë gjatë tremujorit të parë '09. Në të dyja vendet rënia e eksporteve dha kontributin kryesor në rënien e PBB-së.

Në të kundërt, ekonomitë e Indisë dhe Kinës kanë vijuar të rriten me ritme të larta, gjatë tremujorit të parë të vitit. Në Kinë vëllimi i eksporteve ka shënuar ritme të larta rënieje, por rritja e shpenzimeve buxhetore, e investimeve dhe e shpenzimeve për konsum kanë kundërbalancuar këtë zhvillim. Bankat qendrore të Kinës dhe të Rusisë e ulën normën e tyre bazë të interesit. Ndërsa bankat qendrore të Brazilit dhe të Indisë i lanë ato të pandryshuara.

Vendet	Ndryshimi vjetor i PBB-së reale			Inflacioni vjetor
	T1-09	2009[1]	2010[1]	6M 1-09
Brazil	-1.8	-1.3	2.2	5.6
Kinë	6.1	6.5	7.5	-0.9[2]
Indi	6.7	4.5	5.6	9.5[3]
Rusi	-7.0	-6.0	0.5	13.7[2]

Burimi: FMN, OECD, Institutet statistikore përkatëse.

[1] Vlerësime të FMN-së.

[2] Mesatare për periudhën janar-maj 2009.

[3] Mesatare për periudhën janar-prill 2009.

Tabelë 2. Disa tregues makroekonomikë për vendet BRIK.

Situata ekonomike në Itali gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2009 vijoi të jetë e brishtë ndonëse muajt e fundit u shënuan përmirësime në disa tregues ekonomikë. Gjatë kësaj periudhe, kontraktimi i shkëmbimeve tregtare në rang botëror ka dhënë efektin kryesor në përkeqësimin e aktivitetit ekonomik. Kështu, tremujori i parë i këtij viti regjistroi një rënie të PBB-së me 6 për qind në terma vjetorë shkaktuar kryesisht nga rënia e investimeve agregate dhe e eksporteve[3]. Ndërkohë, të dhënat mbi ecurinë gjatë tremujorit të dytë të vitit diktojnë një ulje të ritmeve të kontraktimit të ekonomisë. Norma vjetore e inflacionit për gjashtëmujorin e parë të vitit ishte 1.1 për qind.

Aktiviteti ekonomik në Greqi ka shfaqur shenjat e para të përkeqësimit gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2009. Kështu, ndonëse produkti i brendshëm bruto regjistroi një rritje të lehtë prej 0.3 për qind në terma vjetorë, krahasuar me tremujorin paraardhës u kontraktua me 1.2 për qind. Ndikimin kryesor e dhanë rënia e përshpejtuar e eksporteve dhe investimeve agregate. Ndërkohë që rritja e shpenzimeve për konsum, rritja e shpenzimeve buxhetore dhe rënia e importeve dhanë kontribut pozitiv në llogaritjen e PBB-së. Të dhënat më të fundit mbi ecurinë e treguesve kryesorë makroekonomikë për tremujorin e dytë të vitit dëshmojnë për vijueshmërinë e prirjes rënëse të ekonomisë. Norma e papunësisë shënoi vlerën mesatare 9.3 për katër muajt e parë të vitit. Ndërsa, indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit për gjysmën e parë të vitit u rrit me 1.3 për qind.

Aktiviteti ekonomik në Turqi në tremujorin e parë të vitit 2009 u tkurr me 13.8 për qind krahasuar me tremujorin e parë të vitit të kaluar. Kjo, erdhi si pasojë e rënies së shpejtë të shpenzimeve konsumatore dhe investimeve private, gjë që tejkaloi rritjen e dukshme të investimeve publike. Rënie shënoi edhe aktiviteti tregtar ku importet dhe eksportet u zvogëluan me 32.5 dhe 15 për qind, përkatësisht. Të dhënat për tremujorin e dytë tregojnë për një përmirësim të situatës ekonomike. Prodhimi industrial ka ulur ritmin e rënies dhe indekset e besimit, që në muajin maj, kanë vijuar trendin rritës të filluar gjashtë muaj më parë. Inflacioni në muajin qershor shënoi 5.7 për qind, me një rritje prej 0.1 për qind krahasuar me muajin paraardhës. Ndërsa mesatarja për tremujorin e dytë arrin 5.6 për qind.

Ekonomia e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë në tremujorin e parë të vitit 2009 u tkurr në terma vjetorë me 0.9 për qind. Shkaktarë të rënies së aktivitetit ekonomik janë rënia e vazhduar e prodhimit industrial, e

eksporteve dhe ngadalësimi i shpenzimeve konsumatore që kanë tejkaluar rritjen e investimeve. Rritja e shpenzimeve publike ka krijuar vende pune në administratën publike, që është pasqyruar në një ulje të papunësisë me 1.1 për qind. Norma e inflacionit shënoi vlerën negative prej -1.7 për qind në muajin qershor 2009, krahasuar me të njëjtën periudhë vitin e kaluar.

Sipas përllogaritjeve të FMN-së ekonomia e Kosovës u rrit me 5.4 për qind. Rritja ekonomike e kësaj periudhe u mbështet në burimet financuese nga institucionet ndërkombëtare, në rritjen e shpenzimeve konsumatore si pasojë e rritjes së dërgesave të emigrantëve dhe në dyfishimin e investimeve publike. Normat e inflacionit kanë shënuar vlera negative gjatë vitit 2009, duke vazhduar tendencën në rënie që prej fundvitit të kaluar. Në muajin maj inflacioni mori vlerën vjetore -4.4 për qind.

Tabelë 3. Tregues ekonomikë për vendet e rajonit.

Vendet	Ndryshimi vjetor i PBB-së		Norma vjetore e inflacionit	Norma e papunësisë
	T1:09	2009[1]	6M 1-09	6M 1-09
Itali	-6.0	-4.4	1.1	7.4[3]
Greqi	0.3	-0.2	1.3	8.9[4]
Maqedoni	-0.9	-2.0	0.3	32.7[1]
Serbi	-3.5	-2.0	9.0	15.0[3]
Kroaci	-6.7	-3.5	3.5	14.6[3]
Turqi	-13.8	-5.1	7.3[2]	15.8[4]
Kosovë	:	:	-2.4	:
Shqipëri	:	0.4	2.0	12.7[5]

Burimi: Institutet Statistikore përkatëse, EuroStat, EcoFin, FMN.
[1] Vlerësime të FMN-së.
[2] Të dhënat për tremujorin e parë të vitit 2009.
[3] Mesatare për periudhën janar-maj 2009.
[4] Mesatare për periudhën janar-prill 2009.
[5] Të dhënat për tremujorin e fundit të vitit 2008.

II.2 POLITIKA MONETARE, TREGJET FINANCIARE DHE KURSI I KËMBIMIT

Grafik 1. Normat bazë të interesit të disa bankave qendrore.



Burimi: BQE, FED, Banka e Anglisë, Banka e Japonisë.

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 Banka Qendrore Evropiane ka ulur katër herë normën bazë të interesit duke e çuar atë në vlerën 1 për qind, nga 2.5 për qind që ishte në fillim të vitit. Komiteti i Tregut të Hapur i Rezervës Federale (FED) la të pandryshuar normën e interesit në vlerën 0-0.25 për qind gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2009, duke lënë të kuptohet se norma nuk do të ndryshojë edhe në muajt në vazhdim. Banka e Anglisë ndryshoi tre herë normën bazë të interesit në gjashtë muajt e parë të vitit duke e çuar atë në 0.5 për qind, ndërsa në fillim të vitit ajo shënonte 2 për qind. Banka e Japonisë nuk ndryshoi normën referencë të interesit (norma njëditore për tregun ndërbankar), duke e lënë atë në vlerën 0.1 për qind në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009.

Gjatë pjesës së parë të këtij viti tregjet financiare botërore janë karakterizuar nga ecuri rënëse e normave të interesit dhe normalizim i tensioneve të krijuara nga kriza e financiare. Sinjalet pozitive që vijnë nga të dhënat e fundit tregojnë për një ngadalësim të rënies, të shumë treguesve ekonomikë dhe tregtarë në tregjet botërore. Gjatë këtij gjashtëmujori, normat e interesit libor dhe euribor në tregun e parasë ranë dukshëm, duke përcjellë uljen e normave bazë të BQE dhe SHBA. Normat e interesit euribor me afat 1, 3- dhe 6- mujor në fillim të muajit korrik u ulën mesatarisht me 2.92, 2.96 dhe 2.94 pikë përqindje, në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar ndërsa norma libor me afat 3-mujor u zvogëlua me 1.80 pikë përqindje.

Tregu i obligacioneve në Evropë dhe ShBA gjatë këtyre muajve është karakterizuar nga luhatshmëri e lartë dhe ecuri rritëse e *yield*-eve. Kjo rritje, ka qenë më e theksuar në muajin prill ndërsa periudha e fundit paraqet prirje të lehta rënieje. Në Japoni *yield*-et kanë qenë më të qëndrueshme gjatë kësaj periudhe. Në tregjet e aksioneve indekset kryesore Dow Jones, S&P dhe Nikkei u karakterizuan nga rënie të konsiderueshme dhe luhatshmëri e lartë. Perspektiva më pozitive e treguesve ekonomikë të bizneseve si dhe pritjet e agjentëve të tregut ndikuan në rritjen e vlerave të kuotimit të aksioneve në periudhën e fundit.

Në tregjet valutore monedha euro është karakterizuar nga luhatshmëri e lartë dhe ecuri rritëse, në lidhje me dollarin amerikan. Mbas vlerësimit të lartë në fundin e vitit të kaluar euro ka ndjekur një ecuri rënëse të shoqëruar me paqëndrueshmëri ndaj monedhës amerikane për t'u forcuar sërish në muajt maj dhe qershor. Euro gjithashtu, është vlerësuar në lidhje me grupin e monedhave kryesore. Forcimi i saj ndaj yenit japonez, frangës zvicerane ka kompensuar zhvlerësimin ndaj monedhave të tjera. Ecuria jopozitive e ekonomisë së ShBA si dhe të dhënat negative për treguesit makroekonomikë në Zonën Euro kanë karakterizuar luhatshmërinë dhe vlerësimin e njërës monedhë në favor të tjetrës[4]. Në këta gjashtë muaj mesatarisht euro u zhvlerësua me 5.47 për qind në krahasim me gjashtëmujorin paraardhës. Në

Grafik 2. Normat e liborit usd dhe euro (djathtas) dhe ecuria e kursit euro dollar (majtas).



Burimi: BQE, Reuters.

fillim të korrikut të këtij viti euro vlerësohej me 1.40 dollarë nivel ky i njëjtë me fundin e muajit dhjetor 2008.

II.3 ECURIA E ÇMIMEVE TË NAFTËS DHE TË LËNDËVE TË PARA

Tregu ndërkombëtar i naftës, gjatë gjysmës së parë të vitit, është përballur me efektet e dobësimit të ekonomive të vendeve të industrializuara dhe të disa prej vendeve kryesore në zhvillim. Vlera mesatare e një fuçie naftë ishte 54 për qind më e ulët krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2008. Megjithatë, pas arritjes së pikës më të ulët të çmimit në muajin shkurt të këtij viti, u shfaq një prirje rritëse e naftës për fuçi pavarësisht vlerësimit të dollarit amerikan kundrejt disa prej monedhave kryesore ndërkombëtare[5]. Kërkesa botërore për naftë regjistroi një rënie prej 3.2 për qind në terma vjetorë gjatë kësaj periudhe. Ndikimin kryesor e dha rënia e kërkesës në vendet e OECD dhe disa prej vendeve kryesore në zhvillim. Një vështrim i afërt ndaj ecurisë mujore të këtij tregu dëshmon për një përmirësim të kërkesës në ShBA gjatë periudhës maj-qershor. Oferta për naftë, në anën tjetër, ka shënuar ritme të lehta rritjeje. Organizata për Vendet Eksportuese të Naftës (OPEK) uli kuotat referencë të prodhimit për anëtarët e saj për disa muaj rresht, me qëllim arritjen e një ekuilibri më të lartë të çmimit të naftës. Megjithatë, përmirësimi i kapaciteteve prodhuese dhe rafinuese në rajonet e tjera eksportuese të naftës në botë, ndikoi në ruajtjen e prirjes rritëse të ofertës. Parashikimet për periudhën afatmesme vlerësojnë një rritje të çmimit gjatë gjysmës së dytë të këtij viti.

Grafik 3. Ndryshimi vjetor i çmimit të naftës në tregun ndërkombëtar dhe i kursit të këmbimit euro/usd.



Burimi: Eurostat, Bloomberg.

Indekset kryesore të çmimeve të lëndëve të para të publikuara nga FMN kanë shfaqur një rënie të vlerës së tyre në terma vjetorë. Ndërsa në terma tremujorë vërehet një rritje e çmimeve në tregjet botërore në tremujorin e dytë të vitit[6]. Kështu, Indeksi i Çmimit të Mallrave në gjashtëmujorin e parë të vitit ka shënuar një rënie vjetore prej 42.6 për qind. Ndërsa, tremujori i dytë i këtij viti krahasuar me tremujorin e parë shënon një rritje prej 15.7 për qind. Të njëjtën sjellje ka shfaqur edhe Indeksi i Çmimit të Ushqimeve duke shënuar një rënie vjetore prej 21.7 për qind në gjashtëmujorin e parë. Tremujori i dytë i vitit 2009 krahasuar me tremujorin e parë të këtij viti ka shënuar një rritje prej 10.2 për qind. Edhe Indeksi i Çmimit të Karburanteve ka shënuar një rënie vjetore prej 49.3 për qind në gjashtëmujorin e parë. Në tremujorin e dytë të vitit krahasuar me tremujorin e parë, është rritur me 20.1 për qind.

Grafik 4. Ecuria e çmimeve të lëndëve të para në tregun botëror.



Burimi: FMN.

III. STABILITETI I ÇMIMEVE DHE OBJEKTIVI I BANKËS SË SHQIPËRISË

Objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Ky është kontributi më i madh që banka qendrore mund të japë për të nxitur kursimet, për të tërhequr investime produktive dhe për të mbështetur rritje ekonomike të qëndrueshme. Në përputhje me strategjinë e saj, Banka e Shqipërisë angazhohet në arritjen dhe ruajtjen e inflacionit në terma vjetorë, në nivelin 3.0 për qind me kufi tolerance +/- 1 pikë përqindjeje. Shpallja e objektivit sasior për inflacionin synon ankorimin e pritjeve të agjentëve ekonomikë dhe reflekton njëkohësisht përkushtimin e vazhduar të Bankës së Shqipërisë ndaj objektivit kryesor, pavarësisht lëvizjeve të përkohshme shkaktuar nga faktorë përtej kontrollit të politikës monetare.

Grafik 5. Inflacioni vjetor sipas tremujorëve (në përqindje).



Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Inflacioni vjetor në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 rezultoi mesatarisht 2.0 për qind, rreth 2 pikë përqindje më ulët sesa në gjysmën e parë të vitit 2008. Norma vjetore e inflacionit gjatë kësaj periudhe[7] është luhatur pranë kufirit të poshtëm të intervalit rreth objektivit 3.0 për qind të Bankës së Shqipërisë për inflacionin. Pas një periudhe disinflacioniste (T2:2008 – T1:2009), inflacioni shfaqi prirje të lehtë rritëse gjatë tremujorit të dytë të vitit 2009, duke shënuar normën 2.3 për qind në muajin qershor. Inflacioni mesatar vjetor shënoi 2.4 për qind në këtë muaj.

Normat e ulëta të inflacionit në gjysmën e parë të këtij viti janë shkaktuar nga dobësimi i presioneve inflacioniste si nga ana e kostove dhe nga ana e kërkesës. Rënia e çmimeve të lëndëve të para në tregun ndërkombëtar u reflektua në çmime më të ulëta prodhimi dhe importi. Vlerësimet për ngadalësim të ritmeve të rritjes së kërkesës së brendshme, kushtet më të shtrënguara financiare dhe pritjet për inflacion në rënie, kanë ndikuar sjelljen e inflacionit bazë dhe atij të mallrave të patregtueshëm, të cilët kanë shënuar norma rritjeje më të ulëta që nga muaji qershor i vitit 2008.

Fundi i vitit 2008 dhe fillimi i këtij viti u karakterizuan nga tendenca në rënie e inflacionit, dobësim i ndjeshëm i presioneve inflacioniste, vlerësime për ngadalësim të aktivitetit ekonomik dhe të kërkesës së brendshme, dhe pritjet në rënie për inflacionin e ardhshëm. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë mori vendim të ulë normën bazë të interesit me 50 pikë bazë, në 5.75 për qind në muajin janar 2009.

Në kushtet kur kriza financiare botërore u intensifikua në muajin shtator 2008, Banka e Shqipërisë u angazhua në përdorimin e instrumenteve të tjera të politikës monetare për të zbutur presionet që mund të shkaktoheshin nga mungesa e likuiditetit. Nga tremujori i fundit i vitit 2008, ajo ka injektuar likuiditet me anë të ankandeve të anasjellta të riblerjes, duke ndryshuar

Grafik 6. Norma bazë e interesit të Bankës së Shqipërisë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

formën e këtyre të fundit nga ato me shumë të kufizuar në ato me shumë të pakufizuar dhe normë fikse interesi, interesin bazë. Për të plotësuar kërkesat më afatgjata për likuiditet, krahas operacioneve kryesore me maturim 7-ditor, janë organizuar dhe operacionet me maturim më të gjatë, 3-mujor, si dhe operacione të blerjes me të drejta të plota të letrave me vlerë. Në muajin dhjetor 2008, norma e interesit të kredisë njëditore u ul me 100 pikë bazë, për të lehtësuar aftësinë kredimarrëse të sistemit bankar. Në muajin mars 2009, duke parë përmirësimin e kushteve të likuiditetit dhe për të nxitur aktivitetin e tregut ndërbankar, u vendos moslejimi i përdorimit të depozitës njëditore përkohësisht. Kjo u reflektua në rritje të nivelit të tregtimit në tregun ndërbankar në tremujorin e dytë të vitit. Operacionet në kahun injektues kanë vazhduar, por fundi i kësaj periudhe ka shënuar përmirësimin e gjendjes së likuiditetit dhe stabilitet të normave të interesit në tregun e parasë.

Si rezultat i masave të marra në kohë nga ana e Bankës së Shqipërisë, inflacioni në Shqipëri jo vetëm ka qenë më i ulëti në rajon por dhe brenda intervalit të shpallur rreth objektivit për stabilitetin e çmimeve. Për më tepër, të gjitha masat e marra operacionale dhe rregullative kanë parandaluar efektin zinxhir që përkeqësimi i kushteve financiare në botë të përçohej në sistemin financiar në vend dhe të përkthehej në sektorin real.

Hapësirë informuese 1: Reagimi i bankave qendrore të rajonit ndaj krizës globale.

Kriza financiare në tregjet ndërkombëtare u intensifikua ndjeshëm në tremujorin e tretë të vitit 2008 dhe u përçua dhe në sektorin e ekonomisë reale. Situata ekonomike në botë gjatë thuajse 12 muajve të fundit është karakterizuar nga zhbalancime të treguesve makroekonomikë, rënie e prodhimit, rritje e papunësisë, zhvlerësime të monedhave vendase, shtrëngim i kushteve të kredidhënies dhe të likuiditetit në tregjet e brendshme e të tjera. Përballë kësaj situate, bankat qendrore po përdorin të gjitha instrumentet e mundshme për të stabilizuar sistemin financiar dhe për të nxitur aktivitetin ekonomik.

Zbatimi i politikës monetare mbështetet kryesisht mbi dy instrumente bazë: (i) normën bazë të interesit e cila zakonisht është një normë interesi afatshkurtër dhe (ii) operacionet në tregun e hapur, që përfshijnë kryesisht termat dhe kushtet që sigurohet likuiditet nga ana e bankës qendrore. Në situata të zakonshme operacionet në tregun e hapur hartohen dhe zbatohen në mënyrë që të ndikojnë një normë tregu të paracaktuar nga politika monetare. Ato mund të përdoren pavarësisht nivelit që ka norma bazë e interesit në atë periudhë. Si të tilla ato luajnë një rol mbështetës dhe nuk përmbajnë ndonjë informacion të rëndësishëm për sjelljen e ardhshme të politikës monetare.

Në disa situata të veçanta operacionet në tregun e hapur marrin një rol kryesor dhe përdoren qëllimisht për të ndikuar elementet specifike të mekanizmit të transmetimit. Kjo përqasje komplementare e politikës monetare synon përdorimin e këtij instrumenti, për të përforcuar ndikimin e ndryshimit që norma bazë e interesit ka pasur mbi çmimet e aseteve, të yield-eve dhe të kostove të financimit. Në këto raste operacionet në tregun e hapur rezultojnë në ndryshime thelbësore të bilancit të bankave qendrore dhe zbatimi i politikës monetare me anë të përdorimit të tyre mund të quhet politikë e bilancit.

Grafik 7. Diferencat në inflacion për periudhat 2008M3 – 2007M1 (majtas) dhe 2009M5- 2008M3 (djathtas).



Burimi: Të dhënat janë marrë nga bankat qendrore përkatëse.

Grafik 8. Diferencat në normën bazë të interesit për periudhat 2008M3 – 2007 M1 (majtas) dhe 2009M5 - 2008M3 (djathtas).



Burimi: Të dhënat janë marrë nga bankat qendrore përkatëse.

Përballë krizës globale, autoritetet monetare të vendeve të ndryshme të prekura nga kriza kanë reaguar në mënyrë të ngjashme duke ulur normën bazë të interesit, duke injektuar likuiditet në treg dhe duke krijuar kushte lehtësuese për operacionet e rifinancimit. Madhësia e reagimit nga bankat qendrore ka qenë e ndryshme në varësi të kushteve ekonomike në vend përpara krizës – norma e inflacionit,

Grafik 9. Bilanci i bankave qendrore (në indeks bazë 2007 M1).



Burimi: Të dhënat janë marrë nga bankat qendrore përkatëse.

rritja ekonomike, niveli i papunësisë, madhësia e deficitit korent dhe atij fiskal etj.. Prandaj dhe disa nga këto ekonomi janë më të kushtëzuara në zbatimin e masave të marra për të dalë nga kriza.

III.1 KUSHTET MONETARE

Politika monetare e ndjekur nga Banka e Shqipërisë gjatë muajve të parë të vitit 2009 ka patur natyrë ekspansioniste, sikurse dëshmohet nga Indeksi i Kushteve Monetare. Ulja e normës bazë të interesit në fillim të këtij viti theksoi dhe më shumë prirjen rënëse të këtij indeksi të vërejtur nga tremujori i tretë i vitit 2008.

Grafik 10. Ecuria e Indeksit të Kushteve Monetare[8] dhe e komponentëve të tij.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kushtet monetare lehtësuese reflektojnë ecurinë e kombinuar të dy komponentëve të indeksit, kursit të këmbimit dhe normës bazë të interesit. Në tremujorin e dytë të vitit 2009 ky indeks ka vazhduar tendencën në rënie, i nxitur kryesisht nga nënçmimi i kursit të këmbimit. Ky i fundit është komponenti që zë peshë të rëndësishme në përcaktimin e kushteve monetare në ekonomi të vogla dhe të hapura, siç është edhe rasti i Shqipërisë. Në muajin qershor,

efekti i forcimit sezonal të monedhës vendase është reflektuar dhe në kushtet monetare të këtij muaji, të cilat kanë shënuar një shtrëngim të lehtë.

III.2 ECURIA E ÇMIMEVE TË KATEGORIVE KRYESORE TË SHPORTËS SË MALLRAVE TË KONSUMIT

Ecuria e normës së inflacionit gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2009 reflektoi zbutjen e presioneve inflacioniste me origjinë jashtë dhe brenda vendit. Rënia e çmimeve të mallrave të përdorimit të gjerë (kryesisht mallrave ushqimorë dhe karburanteve) në tregjet ndërkombëtare si dhe konjuktura më e favorshme e çmimeve të mallrave dhe shërbimeve në vend lehtësuan rënien e normës së inflacionit. Në mënyrë të veçantë, shuarja e efektit të rritjes së çmimit të energjisë në muajin mars të këtij viti, bëri që norma e inflacionit të zbresë poshtë kufirit të poshtëm të objektivit të Bankës së Shqipërisë, për t'u rikthyer përsëri mbi këtë nivel në muajt maj e qershor. Vlera e inflacionit për këtë gjashtëmujor u ndikua në mënyrë të rëndësishme nga inflacioni i dy kategorive të mallrave ushqimorë të përdorimit të gjerë dhe ai i mallrave të administruar.

Grafik 11. Kontributi i kategorive në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje).



Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Nga analiza e kontributeve të kategorive përbërëse të shportës së konsumit rezulton një rritje e ndjeshme e kontributit të kategorisë "ushqime të papërpunuara" , ndërkohë që pothuajse të gjitha kategoritë e tjera të shportës shënuan rënie krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë. Kontributi i kategorive të mallrave ushqimorë të përpunuar dhe të papërpunuar përcaktoi në masën 90 për qind, inflacionin mesatar vjetor në gjashtëmujorin e parë të vitit (2%). Në muajin qershor, inflacioni total vjetor (2.3%) u përcaktua pothuajse në masë të plotë nga kontributi i kategorisë "ushqime të papërpunuara" (2.2 pikë përqindjeje).

	T1-08	T2-08	T3-08	T4-08	T1-09	T2-09
Ushqime të përpunuara (pp)	2.5	2.9	2.3	1.7	0.9	0.3
bukë dhe drithëra (pp)	1.4	1.7	1.3	1.0	0.6	0.2
alkol dhe duhan (pp)	0.1	0.1	0.0	0.1	0.1	0.1
Ushqime të papërpunuara (pp)	-0.3	-0.4	-0.9	-0.1	0.6	1.8
fruta* (pp)	0.5	0.3	-0.1	-0.1	0.0	0.3
perime*(pp)	-0.9	-0.2	-1.3	-0.7	-0.3	1.4
Shërbime (pp)	0.3	0.3	0.5	0.5	0.4	0.3
Çmime të administruara (pp)	0.3	0.7	0.8	0.3	0.1	-0.4
lëndë djegëse dhe energji (pp)	0.2	0.6	0.6	0.7	0.4	0.0
Strehim (pp)	0.1	0.1	0.0	0.0	0.1	0.2
Mallra konsumi joushqimorë	0.2	0.3	0.3	0.2	-0.2	-0.2
Mallra konsumi afatgjatë (pp)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1
Indeksi i çmimeve të konsumit (v/v, %)	3.7	4.2	3.0	2.5	1.9	2.1

Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Tabelë 4. Kontributi i kategorive në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje).

Kategoria "ushqime të papërpunuara" kontribuoi mesatarisht me 1.2 pikë përqindjeje në inflacionin vjetor total në periudhën janar - qershor, ndërkohë që ky kontribut ishte negativ gjatë gjithë vitit 2008. Inflacioni vjetor i kësaj kategorie një vit më parë ishte -2.1 për qind, ndërsa këtë vit për gjashtë muajt e parë shënoi vlerën 6.5 për qind. Plotësimi i kërkesës së brendshme për këto produkte është realizuar si nga prodhimi vendas ashtu edhe nga ai i huaj. Inflacioni i lartë në tre muajt e parë të vitit erdhi kryesisht si rezultat i veprimit më të vonuar (për shkak të motit jo të qëndrueshëm) të efektit sezonal të stinës së pranverës dhe futjes së produkteve ushqimore të stinës me çmime më të larta se zakonisht. Në tre muajt e mbetur, çmimet e larta për këtë kategori mallrash u gjeneruan kryesisht nga dobësimi i monedhës vendase kundrejt dy monedhave kryesore, që u përkthye në çmime më të larta importi në terma leku.

Në drejtim të kundërt kanë ecur çmimet e kategorisë "ushqime të përpunuara", inflacioni vjetor i së cilës ka rënë nga 5.3 për qind në muajin janar, në 0.7 për qind në muajin qershor. Kontributi i kësaj kategorie tashmë është stabilizuar në vlera të ulëta pozitive (0.6 pikë përqindjeje në gjashtëmujorin e parë dhe 0.2 pikë përqindjeje në muajin qershor), vlera të cilat nuk regjistroheshin që prej gjysmës së dytë të vitit 2006. Krahas konjukturës globale më të favorshme të çmimeve të mallrave të kësaj kategorie, një ndikim të ndjeshëm në rënien e inflacionit ka dhënë shuarja e efektit të rritjes së çmimit të bukës, në muajin shkurt të vitit 2008.

Inflacioni vjetor i kategorisë "mallra dhe shërbime me çmime të administruara" është luhatur rreth vlerës -3.7 për qind për katër muajt e fundit, duke reflektuar shuarjen e efektit të rritjes së çmimit të energjisë në marsin e vitit 2008. Kontributi i kësaj kategorie gjatë periudhës mars 2008-shkurt 2009 në inflacionin total, rezultoi të jetë mesatarisht 0.7 pikë përqindjeje. Ndërkohë, pas shuarjes së efektit të rritjes së çmimit të energjisë ky kontribut ka ndërruar shenjë (-0.4 pikë përqindjeje) nxitur dhe nga rënia vjetore e tarifave të komunikimit, mesatarisht me 19.4 për qind në tremujorin e fundit.

Inflacioni i kategorisë "mallra konsumi joushqimorë" ndikohet nga ecuria e çmimit të naftës në vend, i cili përcaktohet nga ecuria e çmimit të saj në tregjet ndërkombëtare dhe nga zhvillimet në kursin e këmbimit. Tendenca rënëse në nivel vjetor e çmimit të naftës jashtë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë është reflektuar edhe në çmimet e tregut vendas (inflacioni vjetor ra në shifrat -1.3 për qind në këtë gjashtëmujor). Megjithatë, duke filluar nga muaji mars çmimi i naftës është rritur në terma mujorë duke rikthyer rrezikun e pranisë së presioneve inflacioniste nga rritja e çmimeve të naftës.

Çmimet e kategorive të tjera të inflacionit ("shërbime", "strehim" dhe "mallra konsumi afatgjatë") kanë rezultuar pothuajse të pandryshuara, duke reflektuar një periudhë qetësie si rezultat i ndikimit që kriza botërore ekonomike ka dhënë në koston e jetesës në vend dhe si rrjedhim, dhe në rënien e kërkesës për këto mallra e shërbime.

Rënia e çmimeve në kategorinë "ushqime të përpunuara" dhe atyre me "çmime të administruara" bëri që norma vjetore e inflacionit të vazhdojë të

shënojë vlera shumë më të ulëta se i njëjti gjashtëmujor i një viti më parë. Ndërkohë, rigjallërimi i presioneve inflacioniste kryesisht si rezultat i zhvlerësimit të kursit të këmbimit vlerësohet se do të luajë një rol më përcaktues në ecurinë e çmimeve të konsumit në muajt në vijim.

Grafik 12. Inflacioni vjetor sipas kategorive të mallrave dhe shërbimeve (në përqindje).



Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

III.3 PRIRJET INFLACIONISTE BAZUAR NË MATJE TË TJERA TË INFLACIONIT

Inflacioni bazë[9] vjetor shënoi një rënie graduale gjatë pjesës së parë të vitit 2009, duke arritur vlerën minimale në muajin qershor (1.2 për qind), vlerë kjo e njëjtë me mesataren e këtij treguesi në tetë vitet e fundit. Prirja në rënie e përbërësit bazë të inflacionit, u ndikua ndjeshëm nga frenimi i përgjithshëm i presioneve globale inflacioniste që nga vjeshta e vitit të kaluar. Inflacioni bazë vjetor në terma mesatarë për periudhën janar-qershor të vitit 2009, rezultoi 1.5 për qind ndërkohë që një vit më parë ai ishte rreth 3.0 për qind. Kthimi i vlerave të inflacionit bazë rreth nivelit historik për disa muaj me rradhë, dëshmon për ekuilibrimin e presioneve inflacioniste në ekonominë e vendit. Vlerat e rritura të inflacionit total, kryesisht gjatë dy muajve të fundit, rezultojnë të jenë produkt i ndikimit të faktorëve që nuk janë të lidhur drejtpërdrejt me politikën monetare, të shprehur në treguesin e inflacionit jobazë vjetor[10]. Profili i tij ndryshoi që nga muaji gusht i vitit 2007, si rezultat i zhvillimeve globale në fushën e çmimeve e konsumit.

Grafik 13. Mesatarja e matjeve të inflacionit bazë, jobazë dhe atij total vjetor (në përqindje).



Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Kontributet e inflacioneve sipas sektorëve të mallrave të tregtueshëm dhe të patregueshëm në inflacionin total, rezultuan relativisht të ekuilibruar gjatë pjesës së parë të vitit 2009. Inflacionet vjetore sektoriale në terma mesatarë për këtë periudhë ishin përkatësisht 1.9 dhe 2.2 për qind, duke qëndruar nën vlerat e regjistruara gjatë së njëjtës periudhë të vitit të kaluar.

Prirja në rritje e inflacionit total gjatë tremujorit të dytë të vitit 2009 u ndikua kryesisht nga zhvillimet në sektorin e mallrave të tregtueshëm të mallrave të shportës së IÇK-së. Në muajin qershor inflacioni i këtij sektori arriti në 3 për qind, duke regjistruar vlerën e tij më të lartë të 12 muajve të fundit. Sektori i mallrave të tregtueshëm, u ndikua si nga ecuria relativisht e favorshme e çmimeve në tregjet e huaja dhe në vendet kryesore eksportuese për Shqipërinë, ashtu edhe nga prirja zhvlerësuese e monedhës vendase kundrejt valutave kryesore. Ndërsa faktori i parë vlerësohet të ketë ndikuar në frenimin e presioneve inflacioniste, zhvillimet në kursin e këmbimit, vlerësohet të kenë ndikuar në mënyrë më të plotë në rritjen e çmimeve të mallrave të sektorit të tregtueshëm gjatë muajve të fundit të pjesës së parë të këtij viti. Ndërkohë, shuarjet e efekteve të rritjeve administrative të çmimit të energjisë elektrike (mars '09) dhe të shërbimeve të transportit urban (qershor '09), bënë që prirja e inflacionit të sektorit të patregtueshëm të mallrave dhe të shërbimeve të jetë në rënie të dukshme gjatë periudhës mars-qershor 2009.

Zhvillimet e qëndrueshme në inflacionin bazë dhe në atë të patregtueshëm rreth niveleve të ulëta historike, dëshmojnë për praninë e presioneve të kontrolluara inflacioniste të gjeneruara nga krahu i kërkesës së brendshme gjatë pjesë së parë të vitit 2009. Ndërkohë vendimet e politikës monetare, vlerësohet të kenë ndikuar në barazpeshimin e presioneve të përgjithshme inflacioniste në ekonominë e vendit.

Grafik 14. Inflacioni vjetor i mallrave të tregtueshëm dhe të patregtueshëm.



Burimi: INSTAT, llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

IV. ZHVILLIMET MAKROEKONONOMIKE DHE NDIKIMET NË INFLACION

IV.1 KËRKESA AGREGATE

IV.1.1 Ecuria e prodhimit sipas sektorëve

Të dhëna statistikore apo të tërthorta në dispozicion të Bankës së Shqipërisë, flasin për një ngadalësim të ecurisë së aktivitetit ekonomik në tremujorët e parë dhe të dytë të vitit. Rënia e ritmit të rritjes së kredisë dhe të ofertës monetare, ngadalësimi i eksporteve, i remitancave dhe i të ardhurave fiskale, rritja e ulët e konsumit të energjisë elektrike - veçanërisht nga bizneset, si dhe pasiguria në rritje e reflektuar në tërheqjen e një pjese të depozitave nga sistemi bankar, sugjerojnë një ulje të aktivitetit të përgjithshëm ekonomik në vend. Ky konstatim mbështetet edhe nga rezultatet e vrojtimeve të besimit, të cilat japin sinjale për dobësimin e kërkesës së brendshme dhe ulje të ritmit të aktivitetit prodhues në tremujorin e parë. Bizneset e intervistuara sinjalizojnë për ngadalësim të prodhimit industrial edhe gjatë tremujorit të dytë të vitit të ndikuar nga rënia, si e kërkesës së brendshme ashtu edhe asaj të jashtme. Në të njëjtën kohë, bizneset e industrisë do të vijojnë të pakësojnë inventarët e tyre. Përdorimi i këtyre vrojtimeve si tregues orientues për të ardhmen (*leading indicators*) sugjeron se këto ritme mund të kenë vazhduar dhe në tremujorin e dytë të vitit 2009.

Të dhënat më të fundit të INSTAT mbi zhvillimet në PBB-në tremujore, vlerësojnë se ekonomia e vendit në tremujorin e parë të vitit 2009 ka shënuar ritme vjetore rritjeje në masën rreth 6.0 për qind. Sektorët e shërbimeve dhe të ndërtimit dhanë kontributin më të lartë në zhvillimet pozitive të këtij tremujori. Aktiviteti në sektorin e bujqësisë kontribuoi në mënyrë mjaft modeste në rritjen ekonomike. Industria në tremujorin e parë të vitit në vijim regjistroi një rënie vjetore relativisht të thellë (-13.2 për qind). Megjithatë, duke u nisur nga natyra ende operative e këtyre të dhënave dhe nga periudha e shkurtër e mbuluar prej tyre, Banka e Shqipërisë gjykon se të dhënat për zhvillimet ekonomike në tremujorin e dytë të vitit 2009 mbështetur mbi tregues të ndryshëm makroekonomikë dhe në vlerësimet e agjentëve të tregut, do të jenë përcaktuese në ritmet e ardhshme të aktivitetit ekonomik në vend.

Të dhënat nga vrojtimet në tremujorin e parë, sugjeruan se prodhimi do të vijonte të tkurrej edhe në tremujorin e dytë të vitit 2009. Në tremujorin e parë të vitit 2009, shfrytëzimi i kapaciteteve në ekonomi ka rënë në nivelin më të ulët të regjistruar. Kjo rënie është më e theksuar në sektorin e industrisë (62 për qind krahasuar me 64 për qind shfrytëzimi i kapaciteteve si ekonomi). Të dhënat e Ministrisë së Bujqësisë dëshmojnë për një frenim të rritjes së prodhimit në këtë sektor gjatë vitit 2009.

Grafik 15. Rritja vjetore e indeksit të shifrës së afarizmit në total (në %) dhe kontributet e sektorëve në rritje (në p.p.), dhe ecuria e TTE.



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Prodhimi në sektorin e bujqësisë vlerësohet të jetë në rënie për vitin 2009. Bazuar në të dhënat nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, prodhimi bujqësor do të rritet me 0.5 për qind, 4.5 pikë përqindje më pak se rritja e tij për vitin 2008, e ndikuar kryesisht nga kontributi negativ i prodhimit të pemëtarisë, rritja vjetore e të cilit është -0.6 për qind. Prodhimi agroindustrial, i cili ka qenë në një prirje rënëse duke filluar që nga tremujori i tretë i vitit 2007, ka shënuar rënie me 7 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë.

Çmimet e banesave kanë shënuar rritje gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2009. Rritja vjetore e indeksit të çmimit të banesave me 15.6 për qind në tremujorin e dytë të vitit 2009 konfirmoi kthesën rritëse të nisur që nga tremujori i parë i këtij viti, pas një periudhe njëvjeçare rënëse. Për të bërë

Grafik 16. Ecuria e prodhimit të bujqësisë. Ndryshimi vjetor në përqindje dhe kontributi i nënsektorëve, në pikë përqindje. Ndryshimi vjetor i prodhimit agroindustrial.



Burimi: INSTAT dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

të mundur matjen e rritjes së çmimit për efekt të dinamikës së kërkesës dhe ofertës indeksi i çmimit të banesave është ndërtuar duke zbritur rritjen e çmimit për efekt të ndryshimit të kursit lek/euro, i cili është vlerësuar me 7 për qind në krahasim me tremujorin e dytë të një viti më parë[11]. Bazuar në matje të indeksit duke përjashtuar efektin e ndryshimit vjetor të kursit lek/euro, rritja vjetore e indeksit të çmimit të banesave rezulton vetëm 8 për qind. Në krahasim me tremujorin e parë të vitit 2009, indeksi i çmimit të banesave u rrit me 6 për qind në tremujorin aktual. Duke mbajtur një kurs të pandryshuar të lekut me euron në tremujorin e dytë të vitit 2009, të njëjtë me atë të tremujorit të dytë të vitit 2008, ndryshimi tremujor është -1 për qind.

Grafik 17. Ecuria e indeksit të çmimit të banesave dhe e indeksit të qirasë së banesave.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rritja faktike në indeksin e çmimeve të shitjes në tremujorin e dytë të vitit 2009 është paraprirë nga vlerësime të bizneseve ndërtuese për rritjen e çmimeve të prodhimit, sipas të dhënave cilësore të mbledhura nga vrojtimet e besimit. Në linjë me vlerësimin për rritje të çmimeve të prodhimit gjatë tremujorit të parë të vitit, bizneset presin rritje të çmimeve të prodhimit gjatë tremujorit të dytë të vitit 2009. Pritjet për çmimet në rritje nga ana e bizneseve ndërtuese, shkojnë në një drejtim me parashikimin e bizneseve ndërtuese për pakësim të inventarëve, të cilët ishin rritur shumë në tremujorin e fundit të vitit 2008, duke sugjeruar se oferta në tregun e pasurive të paluajtshme do të mbetet e qëndrueshme. Nga ana tjetër, shtrëngimi i kushteve të kreditimit gjatë vitit 2009, bazuar në vrojtimin e aktivitetit kreditues (shiko hapësirën informuese) sugjeron për një ndrydhje të kërkesës. Dinamika e kërkesës dhe ofertës në tregun e pasurive të paluajtshme, në kushtet e një kërkese më të tërhequr

Grafik 18. Raporti i çmimit ndaj qirasë së banesave dhe prirja afatgjatë e tij.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

dhe të një oferte të qëndrueshme, sugjeron një frenim të rritjes së mëtejshme të çmimeve mbi nivelin aktual.

Indeksi i qirasë së banesave në kryeqytet është rritur me 7.5 për qind në tremujorin e dytë të vitit 2009 (rritja është 5.9 për qind sipas matjeve të indeksit të qirasë duke zbritur efektin e vlerësimit të kursit lek/euro). Në krahasim me tremujorin e kaluar indeksi i qirasë u ul me 14.7 për qind (16 për qind pa efektin e vlerësimit të kursit lek/euro). Ndryshimi me kahe të kundërta i çmimit dhe qirasë së banesave në tremujorin e dytë në krahasim me të parin ka rezultuar në rritje të raportit çmim/qira[12]. Ky raport qëndron sipër prirjes së tij historike në tremujorin aktual, pas një periudhe njëvjeçare në rënie gjatë të cilës ka qenë poshtë mesatares afatgjatë.

Treguesit kryesorë të performancës në sektorin e energjitikës, evidentuan një ecuri pozitive gjatë pesë muajve të parë të vitit 2009. Përmirësimi i mëtejshëm i kushteve hidrike gjatë kësaj periudhe bëri të mundur rritjen vjetore të prodhimit të brendshëm me 53 për qind. Inkurajues është gjithashtu edhe fakti se shpërndarja dhe transmetimi i energjisë së prodhuar ka ardhur në përmirësim, duke vazhduar tendencën në rënie të humbjeve teknike dhe atyre joteknike.

Ndonëse historikisht vendi ka qenë importues neto i energjisë, të dhënat nga KESH raportojnë se gjatë 5-mujorit të parë të këtij viti, bilanci i shkëmbimit për herë të parë ka rezultuar pozitiv. Kështu energjia e eksportuar ka qenë 82.4 GWh më e lartë se niveli i importuar.

Ndërkohë, profili i konsumit të energjisë nuk ka shënuar ndryshime të theksuara në krahasim me vitet e mëparshme. Konsumatorët familjarë mbeten përdoruesit kryesorë të energjisë me 60 për qind të tregut, ndërsa sektori privat dhe ai i institucioneve shtetërore zënë respektivisht 25 dhe 15 për qind të kërkesës. Konsumi i energjisë elektrike vazhdon të ketë të njëjtin sezonalitet si në vitet e mëparshme. Rritja vjetore prej 2 pikë përqindjeje vjen kryesisht si pasojë e rritjes së konsumit familjar dhe atij të pafaturuar. Ndërkohë, konsumi jofamiljar pësoi një rënie prej 5 pikë përqindjeje në terma vjetorë.

Tabelë 5. Tregues vjetorë të bilancit të energjisë elektrike (në GWh).

	5M-07	5M-08	5M-09	Ndryshimi vjetor 5M-09 /5M-08 (në %)
Prodhimi neto	1,307.7	1,685.1	2,584.8	53%
Importi	1,170.1	1,242.8	222.1	-82%
Eksporti	0	0	304.5	100%
Humbjet në shpërndarje	860.6	830.5	1,000.0	20%
Humbje/Prodhim	66%	49%	39%	10.6 (pp)
Kufizimet	390.9	158.0	21.9	-86%
Energjia e konsumuar	2,484.3	2,694.5	2,747.3	2%
Konsumi i faturuar	1,555.3	1,764.6	1,747.3	-1%
Konsumi i pafaturuar	92911	929.9	1,000.0	8%
Konsumi familjar	911.1	1,025.7	1,045.4	2%
Konsumi jofamiljar	644.2	738.8	701.9	-5%

Burimi: KESH dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

IV.1.2 Zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë

Bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi me një pakësim të mjeteve valutore në masën 131 milionë euro, gjatë tremujorit të parë të vitit 2009. Deficiti i llogarisë korente u zgjerua në krahasim me një vit më parë dhe treguesi i tij relativ ndaj PBB-së[13] vlerësohet në 16.6 për qind[14]. Ndërkohë, deficiti i tregtisë në mallra u vlerësua në 29 për qind ndaj PBB-së, rreth 1.5 pikë përqindje më shumë se një vit më parë.

Dërgesat nga emigrantët ranë me 7.7 për qind në terma vjetorë gjatë tremujorit të parë të vitit 2009 dhe financuan 38 për qind të deficitit tregtar në mallra. Ky tremujor karakterizohet dhe nga një rritje vjetore e konsiderueshme e fluksit hyrës të investimeve të huaja direkte (rreth 19 për qind), ndikuar më së shumti prej të ardhurave nga privatizimi. Treguesi i tyre relativ vlerësohet 8.1 për qind e PBB-së, nga 6.2 për qind që vlerësohej një vit më parë. Tremujori i parë i vitit 2009 rezulton me një prurje neto prej 246.6 milionë eurosh në llogarinë kapitale dhe financiare. I vlerësuar në 19.3 për qind e PBB-së, ky tregues u rrit me 8.8 pikë përqindje ndaj një viti më parë.

Tabelë 6. Tregues të bilancit të pagesave në vite.

				Në milionë euro
	T1'06	T1'07	T1'08	T1'09
Llogaria korente	-117.9	-178.0	-267.3	-334.2
Bilanci tregtar	-364.2	-443.0	-527.3	-516.4
-Eksport	144.4	182.0	206.5	176.1
-Import	-508.6	-625.0	-733.9	-692.5
Shërbime (neto)	-25.9	-28.0	-3.3	-26.8
Të ardhura (neto)	48.3	53.0	20.5	-4.4
Transferta korente (neto)	223.9	240.0	242.9	213.4
Llogaria kapitale dhe financiare	117.7	180.9	167.1	246.6
Bilanci i përgjithshëm	16.0	15.0	-27.0	-130.9

				Kumulative në përqindje ndaj PBB-së
	T1'06	T1'07	T1'08	T1'09
Llogaria korente	-9.0	-7.2	-11.6	-16.6
Bilanci tregtar	-22.7	-23.5	-27.6	-29.0
-Eksport	8.1	9.1	10.2	10.6
-Import	-30.8	-32.6	-37.8	-39.6
Shërbime (neto)	-2.1	-0.5	0.5	0.5
Të ardhura (neto)	2.2	2.9	2.3	1.0
Transferta korente (neto)	13.6	13.9	13.2	10.9
Llogaria kapitale dhe financiare	7.2	8.4	10.5	19.3
Bilanci i përgjithshëm	1.9	2.9	1.3	1.0

Burimi: Vlerësime të FMN-së dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Deficiti i llogarisë korente për tremujorin e parë të vitit arriti vlerën kumulative 334.2 milionë euro, duke shënuar një rritje prej 25 për qind në krahasim me të njëjtin tremujor të vitit 2008. Kontributin kryesor në thellimin e deficitit korent e dhanë: ruajtja e nivelit të lartë të deficitit tregtar në 29 për qind ndaj PBB-së, rënia e suficitit të llogarisë së transfertave korente me rreth 12 për qind në nivel vjetor; ndryshimi nga suficit prej 20.5 milionë eurosh në tremujorin e parë të 2008-ës në deficit prej 4.4 milionë eurosh në tremujorin

e parë, të bilancit të llogarisë së të ardhurave; dhe thellimi i ndjeshëm i deficitit të llogarisë së shërbimeve me rreth 27 milionë euro nga 3.4 milionë euro të tremujorit të parë të një viti më parë.

Ndërkohë, deficiti i tregtisë në mallra u tkurr me rreth 2 pikë përqindje në terma vjetorë dhe transaksionet korente ranë me 7.3 për qind për tremujorin e parë të vitit. Shpenzimet korente në pjesën më të madhe shkuan për financimin e importit të mallrave (61%), ndërsa prurjet valutore hynë kryesisht nga eksportet e shërbimeve dhe të mallrave (60%) dhe nga transfertat korente (32%).

Grafik 19. Llogaria korente (majtas) dhe bilanci i pagesave (djathtas) në përqindje ndaj PBB-së.



Burimi: Vlerësime të FMN-së dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Shkëmbimet tregtare[15] të Shqipërisë me botën gjatë pesë muajve të parë të vitit arritën në 1577.7 milionë euro, duke shënuar rënie me rreth 9.1 për qind në nivel vjetor. Si pasojë e rënies së kërkesës së jashtme dhe të brendshme, eksportet dhe importet të shprehura në euro ranë përkatësisht me 19.6 dhe 6.3 për qind në nivel vjetor. Rrjedhimisht, deficiti tregtar u ngushtua me 1.3 për qind mesatarisht për periudhën janar – maj 2009. Raporti i mbulimit eksporte ndaj importeve arriti në 23.4 për qind, 3.8 pikë përqindje më i ulët se ky tregues për të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Grafik 20. Vlera e importeve, eksporteve dhe bilanci tregtar (milionë euro).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë periudhës janar-maj 2009, analiza e importeve sipas përdorimit përfundimtar të tyre, dëshmon për rënie në nivel vjetor në të gjitha kategoritë e mallrave të importuar. Më konkretisht, mallrat kapitalë kanë rënë mesatarisht me rreth 2 për qind; mallrat e ndërmjetëm me rreth 9.5 për qind; dhe ata të konsumit me rreth 1.8 për qind. Rënia në importin e çdo kategorie krahas ngadalësimit të

kredisë për investim, si dhe vlerësimeve pesimiste të bizneseve për prodhimin, kërkesën dhe shitjet, sugjerojnë për tkurrje të kërkesës konsumatore, për ngadalësim të aktivitetit prodhues dhe investues.

Aktualisht importet dhe eksportet janë poshtë prirjes së tyre historike.

Analiza e flukseve të tregtisë së jashtme në vëllime dhe çmime,[16] të disponueshme për tremujorin e parë të vitit 2009, tregon se tendenca në rënie e ndryshimeve vjetore të vlerës së eksporteve dhe importeve, që nga tremujori i tretë i vitit 2008 është shkaktuar si nga rënia e çmimeve, veçanërisht e lëndëve bazë, ashtu dhe nga rënia e vëllimit. Rënia në vëllimin e eksporteve evidenton tkurrjen

Grafik 21. Ndryshimet vjetore në importin e kategorive mallra kapitalë, të ndërmjetëm dhe konsumi (në për qind).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 22. Vlera e eksporteve, importeve dhe prirja historike (në milionë euro).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 23. Ndryshimi vjetor i vlerës dhe vëllimit të importeve, eksporteve dhe i indeksit të vlerës njësi (në për qind).



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe INSTAT.

e kërkesës së jashtme dhe gjithashtu, rëndësinë e aftësisë konkurruese për ekonominë shqiptare (shih hapësirën informuese nr.2). Ndërkohë rënia në vlerën e importeve reflekton rënien e çmimeve të lëndëve bazë ushqimore dhe lëndëve djegëse si dhe rënien e kërkesës së brendshme në vend (shprehur në rënien e vëllimit të importeve).

Shpërndarja gjeografike e shkëmbimeve tregtare tregon për një vijimësi të rëndësisë së partneritetit tregtar me vendet e Bashkimit Evropian. Kështu, vëllimi tregtar me vendet e BE-së zë rreth 64 për qind të shkëmbimeve tregtare në total. Partnerët kryesorë tregtarë vazhdojnë të jenë Italia dhe Greqia. Eksporti me Italinë zuri rreth 60 për qind të totalit ndërsa importi rreth 28 për qind; kurse me Greqinë, eksporti zuri rreth 8 për qind të totalit ndërsa importi rreth 13 për qind. Disa nga partnerët tanë tregtarë me të cilët regjistrohet rritje në vlerën e eksporteve dhe importeve janë: Austria, Gjermania, Kina, Kroacia dhe Spanja (eksport); dhe Gjermania, Greqia, Italia, Kroacia, Zvicra (import).

Hapësirë informuese 2: Duke krahasuar kostot e punës për njësi të prodhimit .

Të dhënat mbi koston e punës për njësi të prodhimit (KPNj) dhe për produktivitetin e punës (PP) lejojnë të kuptohet se si ecuria në tregun e punës dhe e pagave mund të ndikojnë veç të tjerash, në ndryshimin e përparësive krahasuese të një ekonomie ndaj ekonomive të tjera. Në varësi të nivelit të zhvillimit të një vendi, mund të ndiqen strategji të ndryshme për formimin e një profili të caktuar konkurrues të një ekonomie. Frenimi i ritmeve të rritjes së KPNj nëpërmjet një politike joekspansioniste në fushën e pagave, rritja e PP nëpërmjet përmirësimeve teknologjike dhe organizative, si edhe zbatimi i përqasjeve të tjera të ndërmjetme, do të ndihmonin në konsolidimin dhe përmirësimin e aftësive konkurruese të një ekonomie në sektorin e jashtëm.

Grafik 24. Ecuria e PP dhe e KPNj në ekonominë shqiptare.



Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Treguesit e PP dhe KPNj për ekonominë shqiptare janë llogaritur me ndihmën e treguesit të vlerës së shtuar në ekonomi dhe të indekseve të numrit të të punësuarve dhe të fondit të pagave, të marra nga statistikat afatshkurtra (INSTAT). Treguesi i vlerës së shtuar është sezonalisht i rregulluar[17]. Të gjithë treguesit pjesëmarrës në llogaritjen e PP dhe KPNj nuk përfshijnë sektorin e bujqësisë. Indeksi i PP është llogaritur si raport i vlerës së shtuar (të kthyer në indeks) me indeksin e numrit të të punësuarve. Indeksi i KPNj, është llogaritur si raport i indeksit të fondit të pagës me atë të vlerës së shtuar. Ky i fundit, për qëllime krahasimi me ekonomi të tjera, është konvertuar në euro bazuar në kursin nominal të këmbimit lek/euro. Të gjithë treguesit e PP dhe të KPNj rezultojnë si indekse me periudhë bazë T1:2003, për të mundësuar një krahasim më të qartë të prirjeve.

Treguesit e PP dhe të KPNj kanë ndjekur prirje relativisht të ndryshme gjatë periudhës 2003-2008. Luhatshmërinë më të lartë e paraqet treguesi i PP, ndërkohë që KPNj ka ndjekur një ecuri relativisht të qëndrueshme rreth vlerës 100 deri në fund të pjesë së parë të vitit 2006. Pas kësaj periudhe treguesi në fjalë ka shfaqur rritje të

dukshme madje mbi nivelin e PP. Rritjet e KPNj vlerësohet të kenë qenë reflektim i masave administrative për formalizimin e tregut të punës, nëpërmjet vendosjes së pagave referencë për bizneset. Duke filluar që nga tremujori i dytë i vitit 2008, evidentohet një qëndrueshmëri e treguesit të KPNj-së në nivelet e fillimvitit. Përmirësimet në ecurinë tremujore të PP (rritje) mbështesin ngushtimin e hendekut ndërmjet këtyre dy treguesve. Vlerësohet se vijimi i kësaj prirjeje drejt ngushtimit, do të ndihmonte në zbutjen e mëtejshme të presioneve inflacioniste nga krahu i ofertës së brendshme.

Nga një vështrim krahasues i treguesit të KPNj të disa ekonomive, të Shqipërisë dhe të Eurozonës për periudhën T1'03 - T4'08, rezulton se indeksi përkatës për Shqipërinë konvergon më shumë drejt vendeve partnere kryesore tregtare dhe atyre të Eurozonës. Ekonomitë e vendeve baltike paraqiten me humbje progresive të aftësive konkurruese, krahasuar me vendet e tjera të marra në studim. Prirja në rritje të shpejtë e KPNj dëshmon për praninë e goditjeve të forta nga krahu i kostove të punës, kryesisht pas vitit 2006. Profili i KPNj për ekonominë bullgare dhe atë rumune është i ngjashëm me atë të vendeve baltike, por në prirje më të butë rritëse. KPNj për grupin e vendeve të EQJL konvergon në mënyrë thuajse perfekte drejt treguesit për Eurozonën. Kjo ecuri flet për një shkallë të lartë përafrimi ndërmjet tregjeve të punës dhe të prodhimit të mbështetur nga avantazhe mjaft të forta konkurruese të tregjeve të vendeve e EQJL, krahasuar me vendet e tjera. Ekonomia shqiptare, rezulton të ketë një ecuri të ndërmjetme në krahasim me tre grupet e mësipërme.

Grafik 25. KPNj në ekonomi të ndryshme*.



Burimi: OECD (Seasonal adjusted of ULC Index, Bussines Activity, excluding Agriculture); ribazuar me T1:2003; llogaritje të Bankës së Shqipërisë.
*Për grupvendet, KPNj janë llogaritur si mesatare e thjeshtë aritmetike e të dhënave individuale të vendeve. Për T4:08, të dhënat për Bullgarinë nuk janë të disponueshme. EQJL – vende të Evropës Qendrore dhe Juglindore, ku janë përfshirë: Çekia, Sllovakia, Hungaria, Sllovenia. Në vendet baltike janë përfshirë: Lituania, Letonia, Estonia.

Përfundimet e mësipërme janë ekonomikisht të pranueshme, sepse mbështesin procesin dinamik të konvergjencës që karakterizon ekonomitë në zhvillim në ndjekje të ritmeve të ekonomive të zhvilluara. Nga ana tjetër, rezultatet pasqyrojnë shkallën e ulët të efikasitetit të lëvizjes në tregun e punës e në atë të pagave apo edhe të mungesave në kuadrin rregullativ në këto tregje, krahasuar me përvojën e vendeve të zhvilluara.

ECURIA E ZËRAVE TË TJERË TË LLOGARISË KORENTE

Shërbimet regjistrojnë rënie si në kahun e të ardhurave ashtu edhe në atë të shpenzimeve gjatë tremujorit të parë të vitit 2009,[18] duke bërë që kjo llogari të regjistrojë një rezultat negativ prej 26.8 milionë eurosh. Shkëmbimet tregtare në shërbime arritën në 633.2 milionë euro ose 10.5 për qind më të ulëta në terma vjetorë. Zëri "shërbime udhëtimi" regjistron një deficit neto prej 10.3 milionë eurosh dhe zë peshën kryesore si në të ardhurat ashtu dhe në shpenzimet e llogarisë së shërbimeve, me përkatësisht rreth 70 për qind dhe 67 për qind. Hyrjet valutore nga shërbimet e udhëtimit (eksporti) arritën në 211.6 milionë euro ose 4.3 për qind më pak se sa në vitin 2008. Ndërsa, turistët shqiptarë shpenzuan në udhëtimet e tyre jashtë vendit rreth 221.9 milionë euro ose 3.6 për qind më shumë në terma vjetorë.

Bilanci neto i llogarisë së të ardhurave shënon gjithashtu një rezultat negativ prej 4.4 milionë eurosh. Në këtë rezultat, kontribuoi rënia e investimeve neto të portofolit me rreth 3 herë në terma vjetorë ndërkohë që të ardhurat neto nga puna janë rritur me rreth 14 për qind. Transfertat korente neto vlerësohen rreth 12 për qind më të ulëta, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2008[19]. Rreth 196 milionë euro kanë hyrë në formën e dërgesave të emigrantëve. Këto të fundit shënuan një rënie vjetore prej 7.7 për qind dhe financuan 38 për qind të deficitit tregtar në mallra.

LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE

Tremujori i parë i vitit 2009 rezulton me një prurje neto prej 246.6 milionë eurosh në llogarinë kapitale dhe financiare. Rreth 20 milionë euro hynë në formën e transfertave për investime kapitale dhe rreth 227 milionë euro si flukse financiare neto. Flukset hyrëse të kapitalit financuan rreth 74 për qind të deficitit të llogarisë korente dhe raporti i tyre ndaj PBB-së vlerësohet në 19.3 për qind[20].

Llogaria financiare regjistroi një rritje prej 153.5 milionë eurosh në detyrimet financiare të Shqipërisë ndaj botës dhe rënie prej 74 milionë eurosh të mjeteve të rezidentëve jashtë. Kontributin kryesor në fluksin hyrës të llogarisë financiare e dhanë investimet e huaja direkte me 123.6 milionë euro. Këto investime vlerësohen në rreth 8.1 për qind të PBB-së[21] dhe janë kryesisht të ardhura nga privatizimet. Ndërsa, rënia e mjeteve financiare është shkaktuar kryesisht nga rënia e mjeteve në formën e depozitave të sistemit bankar me institucionet financiare jorezidente (rreth 62 milionë euro). Së fundmi, mjetet e rezervës kanë rënë me 130.9 milionë euro. Stoku i rezervës valutore në fund të tremujorit të parë të vitit 2009 arrin në 1,595 milionë euro. Ky stok vlerësohet i mjaftueshëm për mbulimin e 4.7 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.

Grafik 26. Llogaria kapitale dhe financiare në përqindje të PBB-së në vite.



Burimi: Vlerësime të FMN-së dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

IV.1.3 Treguesit fiskalë dhe politika fiskale[22]

Politika fiskale gjatë gjysmës së parë të vitit 2009 ka pasur një karakter më të theksuar ekspansionist në krahasim me vitet kur është shfaqur ky tipar i politikës fiskale. Diferenca midis nivelit të programuar dhe atij të realizuar ka qenë e dukshme në kahun e të ardhurave buxhetore. Ndërkohë që shpenzimet janë realizuar pothuajse në nivelin e planifikuar. Rrjedhimisht, deficiti buxhetor ka tejkaluar planin me 10.6 miliardë lekë, duke arritur nivelin 31.6 miliardë lekë. Në raport ndaj PBB-së[23], deficiti buxhetor vlerësohet në rreth 6.2 për qind.

Tabelë 7. Treguesit fiskalë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit, në krahasim me periudhën 2007-2009.

	Niveli faktik	Ndaj PBB-së[24]	Ndryshim vjetor (në %)		
	6M 1-09	6M 1-09	6M 1-07	6M 1-08	6M 1-09
Të ardhura	144.8	28.5	9.6	16.8	7.2
Tatimet dhe doganat	100.7	19.8	12.6	18.3	4.8
- TVSH	52.1	10.3	21.9	22.3	4.8
- tatim fitimi	9.1	1.8	(7.9)	(6.8)	(7.2)
- akcizat	14.4	2.8	22.2	22.2	(3.6)
Pushteti vendor	6.9	1.4	(7.2)	3.0	26.1
Buxhetet e pavarura	25.5	5.0	(0.0)	18.1	13.7
Të ardhura jotatimore	11.0	2.2	18.9	5.9	4.8
Grante	0.7	0.1	(57.1)	337.8	30.4
Shpenzime	176.3	34.7	10.5	30.3	28.4
Shpenzime korente	129.6	25.5	8.1	14.5	20.2
- personeli	29.6	5.8	1.2	17.2	(1.3)
- interesat	17.4	3.4	(0.9)	24.6	16.0
- sigurimet sociale	44.9	8.8	15.8	8.3	28.3
- pushteti lokal	15.1	3.0	11.9	32.4	44.1
Shpenzime kapitale	46.6	9.2	35.5	149.5	66.5
Balanca buxhetore	(31.6)	(6.2)	0.6	(123.0)	1,254.4

Burimi: Ministria e Financave, FMN (programi PRGF).

Të ardhurat buxhetore gjatë gjysmës së parë të vitit janë realizuar me rreth 144.8 miliardë lekë, duke përmbushur planin me 93 për qind. Në raport ndaj PBB-së, të ardhurat e 6-mujorit të parë të vitit 2009, vlerësohen rreth 28.5 për qind, kundrejt 28 për qind të një viti më parë[25].

Në terma vjetorë të ardhurat buxhetore shënojnë rritje me rreth 7.2 për qind, por në krahasim me vitet e mëparshme ritmi i rritjes së tyre ka ardhur në rënie. Zërat që kanë peshën më të madhe në diferencën e krijuar me planin janë të ardhurat nga TVSH-ja, akcizat dhe pushteti vendor.

Ndonëse norma e tatimit mbi vlerën e shtuar është mbajtur e njëjtë me vitet paraardhëse, të ardhurat e akumuluara nga ky zë gjatë gjysmës së parë të këtij viti, kanë regjistruar një ngadalësim të ndjeshëm në ritmin e rritjes. Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin sikurse dhe në dy vitet paraardhëse, kanë shënuar ritme negative rritjeje gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit. Niveli i planifikuar për këtë periudhë kohore është realizuar në masën 86 për qind. Të ardhurat nga akcizat, ndryshe nga vitet e mëparshme kanë shënuar ritme negative rritjeje. Kjo tkurrje në terma vjetorë e të ardhurave nga akcizat, i dedikohet kryesisht rënies së importeve të mallrave të cilët janë subjekt i akcizës. Të ardhurat nga pushteti vendor, ndonëse kanë shënuar ritëm të lartë rritjeje vjetore, rezultojnë nën planin e hartuar për këtë periudhë me rreth 2.7 miliardë lekë (28%).

Zërat e të ardhurave që kanë përmbushur nivelin e programuar për këtë periudhë janë të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale; të ardhurat jotatimore; si edhe të ardhurat nga taksa doganore. Gjithsesi, ky i fundit është zë që ka pësuar tkurrje në terma vjetorë, si rezultat i marrëveshjeve të ndryshme, palë e të cilave është dhe Shqipëria, që synojnë lëvizjen e lirë të mallrave.

Grafik 27. Ndryshimet vjetore (në%) të të ardhurave dhe shpenzimeve për 6M I, 2000-2009.



Burimi: Ministria e Financave, llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Shpenzimet buxhetore të kryera gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit kapën vlerën 176.3 miliardë lekë, duke përmbushur thuajse plotësisht nivelin e planifikuar për këtë periudhë kohore. Në terma vjetorë, ato u rritën me rreth 28 për qind. Të vlerësuara në raport ndaj PBB-së regjistrojnë nivelin prej 34.7 për qind, kundrejt 28.5 për qind të rezultuara në 6-mujorin e parë të vitit 2008. Ritmet e larta të kryerjes së shpenzimeve buxhetore gjatë kësaj periudhe janë nxitur kryesisht nga shpenzimet kapitale, shpenzimet për sigurimet sociale dhe shpenzimet për personelin. Më konkretisht, shpenzimet kapitale, shpenzimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore, si edhe shpenzimet për personelin kanë kontribuar respektivisht me 7.5; 7.2 dhe 4.8 pikë përqindjeje në rritjen e totalit të shpenzimeve për gjashtëmujorin e parë të vitit.

Një zë tjetër i cili ka spikatur me ritmin e lartë të rritjes (në terma vjetorë), është zëri i shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes, i cili ka shënuar një nivel rreth 33 për qind më të lartë se një vit më parë. Shpenzimet për interesa sikurse dhe të gjithë nënzërat e shpenzimeve, kanë pësuar rritje në terma vjetorë.

DEFICITI BUXHETOR DHE FINANCIMI

Grafik 28. Deficiti buxhetor dhe financimi i tij sipas burimeve kryesore, për 6M I 2000-2009 (miliardë lekë).



Burimi: Ministria e Financave.

Gjashtëmujori i parë i vitit, është karakterizuar përgjithësisht nga një rritje e shpenzimeve në ritme më të larta sesa të ardhurat e për pasojë, deficiti buxhetor është rritur ndjeshëm. Në vlerë nominale deficiti buxhetor ka shënuar një nivel prej 31.6 miliardë lekësh, vlerësuar në rreth 6.2 për qind të PBB-së; kundrejt 0.5 për qind në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Shpërndarja e financimit të deficitit në mënyrë thuajse të barabartë në burime të brendshme dhe të huaja është specifikë e ndryshme nga vitet e mëparshme, ku dallon rëndësia e burimeve të brendshme në financimin e deficitit buxhetor. Financimi i deficitit është mbështetur kryesisht tek të ardhurat nga privatizimet[26] dhe huamarrja e huaj. Pjesa më e madhe e huamarrjes së huaj përfaqëson kredinë sindikale në valutë të huaj të marrë nga bankat rezidente dhe jorezidente në Shqipëri.

	6M I-05	6M I-06	6M I-07	6M I-08	6M I-09
Balanca buxhetore	(9.5)	10.1	10.2	(2.3)	(31.6)
Financim i brendshëm	7.3	(11.1)	(10.4)	1.2	17.0
- privatizime	0.6	2.1	0.0	0.4	20.8
- huamarrje e brendshme	10.5	(10.5)	3.4	11.5	5.0
- të tjera	(3.7)	(2.7)	(13.9)	(9.7)	(8.8)
Financim i huaj	2.1	1.0	0.3	1.1	14.6

Burimi: Ministria e Financave.

Tabelë 8. Deficiti buxhetor dhe mënyra e financimit të tij, gjatë 6M I, 2005-2009, në miliardë lekë.

Politika e huamarrjes së qeverisë ka synuar rritjen e masës së borxhit të brendshëm për të gjitha llojet e letrave me vlerë, sidomos për instrumentet me maturim njëvjeçar dhe më afatgjata se një vit. Megjithatë mungesa e kërkesës së pjesëmarrësve në ankandet e letrave me vlerë[27], sidomos gjatë tremujorit të parë të vitit, ka bërë që stoku i borxhit të brendshëm të rritet vetëm gjatë tremujorit të dytë të vitit. Në total, stoku i borxhit të brendshëm me instrumente financiare, gjatë gjysmës së parë të vitit është rritur me rreth 5 miliardë lekë. Kjo rritje, i atribuohet kryesisht borxhit në letra me vlerë afatgjata. Në fund të qershorit, në vlerë nominale, stoku i borxhit të qeverisë në letra me vlerë shënon një nivel prej rreth 391.9 miliardë lekësh, kundrejt 380.8 miliardë lekësh të rezultuar një vit më parë.

Grafik 29. Shuma rrëshqitëse e balancës primare, qershor 2000-qershor 2009 (në miliardë lekë).



Burimi: Ministria e Financave, llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

DEFICITI PRIMAR

Deficiti primar ka vijuar thellimin e mëtejshëm dhe gjatë tremujorit të dytë të vitit, duke shënuar një nivel prej rreth 55.7 miliardë lekësh, në fund të muajit qershor[28]. Ecuria e deficitit primar, reflekton rritjen e njëkohshme të borxhit të brendshëm dhe atij të huaj gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu, thellimi i diferencës midis rritjes ekonomike dhe normës së interesit për borxhin publik, shkakton rritje të mëtejshme të deficitit primar.

Hapësirë informuese 3: Deficitet binjake.

Hipoteza e deficiteve binjake sugjeron që një deficit i lartë fiskal çon në thellimin e deficitit të llogarisë korente. Kjo hipotezë mund të shihet nga këndvështrimi i hendekut ndërmjet kursimeve dhe investimeve kombëtare: një rritje e deficitit fiskal shkakton një rritje të nevojave për huamarrje të jashtme, e cila çon në thellim të deficitit të llogarisë korente. Argumenti i mësipërm është i qenësishëm në rastin kur kursimet dhe investimet nuk shfaqin korrelacion me njëra tjetrën, që do të thotë se deficiti buxhetor dhe ai i llogarisë korente do të tentojnë të lëvizin në të njëjtin kah (Feldstein and Horioka,1980).

Roli i politikës fiskale në rregullimet e jashtme është evident nga ekuacioni i të ardhurave kombëtare[29]. Politikat fiskale shtrënguese/ekspansioniste përmirësojnë (përkeqësojnë) në mënyrë të drejtpërdrejtë balancën e jashtme. Argumenti sipas të cilit deficiti buxhetor shkakton në të njëjtën kohë deficit të llogarisë korente mbështetet

dhe nga fakti që rritja e deficitit buxhetor shkakton rritje të normave të interesit. Një rritje e normave të interesit tërheq kapitalin e huaj, i cili lidhet drejtpërdrejt me thellim të deficitit të llogarisë korente.

Ndonëse teorikisht, argumentet mbi hipotezën e deficiteve binjake konvergojnë, kërkimet empirike deri tani kanë nxjerrë rezultate mikse. Disa studime, të rishikuara nga Funke dhe Nickel (2006), kanë arritur në përfundimin që deficiti më i lartë fiskal sjell rritjen e deficitit korent; ndërsa të tjerë nuk kanë evidentuar impakt të rëndësishëm.

Teoria e deficiteve binjake nuk u provua në vendet e Bashkimit Evropian. Marrëveshja e Maastricht-it i detyronte ato të shkurtonin deficitet buxhetore përpara lëshimit të monedhës së tyre të përbashkët në vitin 1999. Megjithëse ato ishin të suksesshme në reduktimin gradual të deficitit buxhetor nga 5.4 në 0.8 për qind të PBB-së gjatë periudhës 1995-1999, suficiti i llogarisë korente mbeti thuajse i pandryshuar rreth një mesatareje 0.9 për qind të PBB-së. Në një studim të kryer për vendet e Evropës Juglindore[30], identiteti i deficiteve binjake është vërtetuar vetëm në rastet kur deficiti buxhetor ka qenë i lartë (mbi 3% të PBB-së).

Shqipëria, përkrah vendeve të tjera të Evropës Juglindore, e ka nisur periudhën e tranzicionit me nevoja mjaft të larta për investime. Në kushte të burimeve të kufizuara për financimin e tyre, nevojat më të larta për huamarrje kanë çuar në thellim të deficitit të llogarisë korente. Ndonëse politikat e ndjekura kanë synuar ndër të tjera reduktimin e vulnerabilitetit fiskal, disbalancat e ekonomisë së jashtme janë thelluar sidomos gjatë dy viteve më të fundit. Nga një vështrim krahasues me vendet e rajonit rezulton se thellimi i njëkohshëm i deficitit buxhetor dhe atij të llogarisë korente, sidomos gjatë dy viteve të fundit, e rendit Shqipërinë përkrah vendeve ku kjo hipotezë gjen mbështetje. Vërtetimi i kësaj lidhjeje në periudhën afatgjatë do të kërkonte korrektimin fiskal dhe korrektim të deficitit korent. Ky i fundit do të kishte implikime mbi ecurinë e kursit të këmbimit në periudhën afatshkurtër.

Grafik 30. Ecuria e balancës buxhetore dhe llogarisë korente, mesatare ndaj PBB-së, 2002-2008.



IV.1.4 Zhvillimet monetare

Kërkesa për mjete monetare në muajt e fundit ka njohur rritje pozitive. Rritja e ofertës monetare është bazuar në krijimin e parasë në ekonomi nga sektori publik si dhe nga huamarrja e sektorit privat, kryesisht në lekë. Kërkesa për kredi në lekë e sektorit privat ka gjetur gatishmërinë e bankave, në sajë të stabilizimit të situatës së likuiditetit dhe lehtësimit të kushteve monetare në fillim të vitit 2009. Kufizimi i ofertës së parasë në valutë ka rezultuar në kontraktimin e përbërësit valutor të strukturës së parasë edhe në kahun e kërkesës për para. Në këto kushte, struktura valutore e ofertës monetare është zhvendosur drejt lekut. Megjithatë, ritmet më të ulëta të kërkesës për para kundrejt vitit 2008 janë pasqyruar edhe në ritmet më të ulëta të M3 në terma realë.

Gjashtëmujori i parë i vitit 2009, ka shfaqur një dinamikë ndryshe të krijimit të parasë në ekonomi. Fenomeni i tërheqjes së depozitave që prej tremujorit të fundit të vitit 2008, ka ulur ofertën e parasë në valutë. Efekti i këtij fenomeni në ecurinë e zhvillimeve monetare ka qenë i dyfishtë. Së pari, tërheqja e depozitave ka ulur nivelin e stokut të parasë, që do të reflektohet në ritme më të ulëta vjetore të rritjes së M3 deri në muajin shtator të vitit aktual. Kështu, në fund të muajit maj, niveli i M3 shënoi 816 miliardë lekë kundrejt rreth 820 miliardë lekëve në muajin shtator 2008, para tërheqjes së depozitave. Së dyti, tërheqja e depozitave në valutë ka ngadalësuar ritmet e zgjerimit të parasë duke ndikuar në procesin e krijimit të parasë në valutë. Ngadalësimi i ritmit të kreditimit të sektorit privat në valutë është shoqëruar me ulje të mëtejshme të ritmeve të rritjes së M3. Në terma vjetorë, në muajin maj rritja e M3 rezultoi 7.7 për qind sikurse në fund të vitit 2008, kundrejt 14.9 për qind në muajin shtator të vitit 2008. Megjithatë, stabilizimi i tregut financiar dhe plotësimi i nevojave të sistemit me likuiditet në lekë kanë kontribuar në stabilizimin e ecurisë së stokut të parasë. Përbërësi në lekë i parasë së gjerë, agregati M2, ka shënuar ritme të qëndrueshme të rritjes vjetore në rreth 10 për qind kundrejt rreth 9.6 për qind në muajin shtator të vitit të kaluar.

Grafik 31. Ecuria e komponentëve të kërkesës për para dhe rritja vjetore e M3.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 32. Rritja vjetore e agregatëve monetarë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Prirja afatgjatë e zhvillimeve monetare është ndikuar edhe nga dinamika e zhvillimeve makroekonomike. Në vitet e fundit, sektori i jashtëm i ekonomisë ka qenë një burim i krijimit të parasë në sajë të prurjeve valutore në formën e remitancave, si edhe i furnizimit të kërkesës për kredi në valutë. Zhvillimet më të fundit në ekonomitë e vendeve fqinje kanë prekur ecurinë e remitancave.

Ngadalësimi i ritmit të tyre, në periudhën afatgjatë, tenton të shoqërohet me një ritëm më të ulët të depozitave në valutë kundrejt viteve të tjera. Në këto kushte, plotësimi i kërkesës për para kushtëzohet në burime të brendshme të gjenerimit të kursimeve në ekonomi. Megjithatë, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009, prurjet kapitale të bilancit të pagesave kanë zbutur pjesërisht disbalancën në kërkesën për para, e cila është pasqyruar në ecurinë e agregatëve monetarë.

Dinamika e kërkesës agregate në ekonomi dhe e aktivitetit të sektorit privat në tërësi, është pasqyruar në kërkesën për para në terma realë. Kështu, ndërsa në tremujorin e parë M3 real ka shënuar një rënie të lehtë edhe në sajë të daljes së depozitave, në tremujorin e dytë kërkesa për para ka treguar shenja stabilizimi duke shënuar rritje sezonale prej rreth 9 për qind[31]. Pavarësisht kufizimit të ofertës së parasë në valutë, ritmi i rritjes së M2 ka qëndruar në nivelet e fundvitit 2008.

Grafik 33. Rritja vjetore e agregatëve monetarë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Stoku total i depozitave në fund të muajit maj rezultoi më i ulët në terma relativë kundrejt fundit të vitit 2008. Rrjedhja e depozitave nga sistemi bankar erdhi si pasojë e rritjes së ndjeshmërisë së publikut ndaj sigurisë së kursimeve të tyre, në vijim të zhvillimeve ndërkombëtare në tregjet financiare. Kjo situatë e pafavorshme shfaqi shenjat e para të një përmirësimi të lehtë në dhjetor të vitit 2008. Rrjedhja e depozitave vijoi me ritme më të ngadalësuara gjatë gjysmës së parë të vitit 2009. Në tremujorin e parë të këtij viti stoku total i depozitave u pakësua mesatarisht me 3.6 për qind në terma vjetorë[32]. Raporti i depozitave në total ndaj parasë së gjerë rezultoi në rreth 75 për qind në fund të muajit maj, duke pësuar një rënie me rreth 7 pikë përqindje krahasuar me fundin e muajit shtator 2008.

Grafik 34. Ecuria e depozitave sipas monedhës dhe në terma kohorë (pastruar nga efektet e kursit të këmbimit).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në tremujorin e dytë të këtij viti u vu re një frenim i lehtë i fenomenit të tërheqjes së depozitave. Stoku total i depozitave në muajin prill, pas reduktimit të vazhdueshëm në terma mujorë, pësoi rritje. Kontributin kryesor në këtë rritje e dhanë depozitat e biznesit me afat, kryesisht ato në valutë, të përqendruara në një bankë të vetme të sistemit bankar. Ndërsa depozitat e individëve vazhduan të shfaqin një rënie të lehtë, pavarësisht ngadalësimit të ndjeshëm të ritmit rënës që karakterizoi periudhat e mëparshme. Ecuria mujore e depozitave në muajin pasardhës shfaqi gjithashtu përmirësim. Miratimi i ligjit për sigurimin e depozitave deri në 2.5 milionë lekë në muajin mars, duket të ketë qenë efektiv në menaxhimin e kësaj situate. Stoku total i depozitave në periudhën prill-maj u zgjerua me rreth 11 miliardë lekë pastruar nga efekti i kursit të këmbimit. Depozitat në lekë ishin ato që dominuan rritjen e stokut total, duke shfaqur një rritje prej më shumë se 6.5 miliardë lekësh në vlerë absolute. Ndërsa në

Grafik 35. Ecuria e depozitave me afat në lekë dhe valutë sipas kategorive (në miliardë lekë dhe përqindje).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

terma kohorë depozitat me afat rezultuan me përqendrimin më të madh ndaj totalit të depozitave të sistemit.

ECURIA E KOMPONENTIT VALUTOR

Pakësimi i likuiditetit të bankave veçanërisht në valutë, si pasojë e tërheqjes së depozitave në tremujorin e katërt 2008, është reflektuar në përkeqësimin e pozicionit valutor të sistemit bankar. Ky përkeqësim ka ardhur si rezultat i uljes së mjeteve të investuara jashtë, por dhe rritjes së shpejtë të detyrimeve si pasojë e linjave të kredisë të bankave mëmë në përkrahje të degëve për të kapërcyer situatën e krijuar. Gjithsesi, rritja pozitive e portofolit të kredisë në valutë përkundrejt ritmeve vjetore negative të depozitave në monedhë të huaj, ka disfavorizuar më shumë pozicionin valutor të sistemit deri në muajin mars 2009. Në fund të muajit maj, rikthimi i depozitave në sistem dhe ngadalësimi i dukshëm i kredisë në valutë sollën përmirësimin e këtij pozicioni, i cili megjithatë vazhdon të mbetet negativ.

Grafik 36. Ecuria e MVN në milionë usd.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 37. Ecuria e ndryshimeve vjetore të MVN në për qind, e ndarë në burime investimesh.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

FINANCIMI I SEKTORIT PRIVAT[33]

Në 5 vitet e fundit, sistemi bankar shqiptar ka shfaqur rritje të ndërmjetësimit financiar në vend. Nivelet e larta të rritjes së portofolit të kredisë kanë ndikuar në rritjen e raportit të kredisë ndaj PBB-së, i cili në muajin maj 2009 arriti në 39 për qind. Për pjesën më të madhe të vitit 2008 ritmet e larta të portofolit të kredisë krijuan një hendek[34] (*gap*) pozitiv krahasuar me prirjen historike. Pakësimi i fondeve të bankave (sidomos në valutë) dhe rritja e pasigurisë në vend ndikuan në ngadalësim të dukshëm të ritmeve të rritjes të kredisë. Në muajin maj rritja vjetore reale e kredisë[35] shënoi 19 për qind, në krahasim me 33 për qind në muajin dhjetor 2008. Krahasuar me fundin e vitit 2008, portofoli i kredisë është rritur me 7.5 miliardë lekë ose rreth 5 herë më pak se në të njëjtën periudhë një vit më parë. Në këtë ecuri mendohet të kenë ndikuar vështirësitë e bankave për gjenerimin e likuiditeteve të nevojshme për kredidhënie, rritja e kredive me probleme si dhe efekti i sektorit fiskal, i cili gjatë kësaj periudhe është karakterizuar nga një kërkesë e lartë për financim, si pasojë e rritjes së dukshme të shpenzimeve fiskale. Ndërkohë, rritja vjetore nominale e portofolit të kredisë arriti në 27 për qind[36]. Ngadalësimi i kredisë në terma nominalë shfaqet më i moderuar se norma reale, për shkak të ndikimit pozitiv që ka dhënë në portofol zhvlerësimi i lekut ndaj valutave kryesore krahasuar me një vit më parë.

Grafik 38. Ecuria e portofolit të kredisë*.



*Seritë e kredisë janë të pastruara sezonalisht dhe nga lëvizjet e kursit. Grafiku djathtas paraqet diferencën e shprehur në për qind të kredisë faktike ndaj prirjes historike, të gjeneruar nga filtri i HP.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ngadalësimi i ritmeve të rritjes së portofolit të kredisë pasqyron kryesisht tkurrjen e ofertës për kredi nga bankat, të cilat për më shumë se 6 muaj aplikojnë shtrëngim të kushteve të kredidhënies. Shtrëngimi i kritereve në kreditim ka ndikuar në zvogëlimin e kërkesës për kredi. Ndërkohë tkurrja e kërkesës pasqyron gjithashtu ngadalësimin e aktivitetit ekonomik në muajt e parë të 2009-ës, si dhe pasiguritë e agjentëve për të ndërmarrë investime apo për të financuar me kredi konsumin e tyre. Po kështu gjatë kësaj periudhe, kredia e re e disbursuar shfaqet në nivele më të ulëta se një vit më parë duke

regjistruar ndryshim vjetor negativ. Rënia më e theksuar është vërejtur në 2 muajt e parë të vitit 2009. Duke filluar nga muaji mars vihet re një përmirësim i situatës. Zhvillimet më pozitive të muajve të fundit janë në linjë me ecurinë sezonale të kredisë në këtë periudhë që përputhet me sezonalitetin e aktivitetit ekonomik në vend. Po kështu rezultatet e vrojtimit të kredisë për tremujorin e dytë të vitit 2009, tregojnë se kushtet e kredidhënies kanë mbetur kryesisht të pandryshuara me një tendencë relative lehtësuese.

Grafik 39. Ecuria dhe struktura e kredisë së re, të disbursuar sipas monedhës.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në zhvillimet e portofolit të kredisë sipas monedhave vihet re një frenim i ndjeshëm i ritmeve të rritjes vjetore të kredisë në valutë, e cila në muajin maj arriti në 13 për qind. Ndërkohë kreditimi në lekë ka ruajtur ritmet e rritjes së pjesës së dytë të vitit 2008, me një rritje vjetore prej 33 për qind.

Grafik 40. Ecuria e portofolit të kredisë sipas monedhës së indeksimit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Vështirësitë për gjenerimin e likuiditetit të nevojshëm në valutë së bashku me perceptimin për një rrezik më të lartë për këtë portofol[37], kanë diktuar këtë sjellje të bankave. Nga ana tjetër shkalla më e ulët e ndërmjetësimit në monedhën vendase, si dhe politika akomoduese e Bankës së Shqipërisë kanë krijuar hapësirat e nevojshme për kreditimin e ekonomisë në lekë. Në muajin maj, raporti i kredisë në lekë ndaj totalit të portofolit arriti në 31 për qind përkundrejt 27 për qind që shënonte një vit më parë.

Portofoli i kredisë për biznese dominon portofolin e kredisë të sistemit bankar, me 66 për qind të tij. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009, ndryshimet vjetore të këtij portofoli, kanë ardhur në rënie, duke arritur në 19 për qind. Gjithsesi ngadalësimi i ritmeve të kredisë për biznese është më i ulët krahasuar me kredidhënien për individë. Sikurse vihet re edhe nga vrojtimi i kredisë, bankat janë treguar më konservatore në kreditë me pakicë. Për pjesën më të madhe të periudhës bankat kanë kredituar bizneset për të mbështetur nevojat e tyre për likuiditet. Kredia për likuiditet shënoi rritje vjetore me 37 për qind përkundrejt rritjes vjetore prej 20 për qind të kredisë për investime.

Grafik 41. Shpërndarja e portofolit të kredisë sipas grupeve kredimarrëse.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kredia për sektorët e ekonomisë, në gjashtë muajt e fundit dëshmon ngadalësim të dukshëm të kredidhënies për sektorët e ndërtimit dhe të industrisë përpunuese. Ndërkohë që sektorët e tjerë kanë ruajtur pothuajse të njëjtin ritëm si më parë. Në muajin maj, portofoli i kredisë për tregtinë arriti në 38 për qind, sektori i ndërtimit 21 për qind dhe kredia për industrinë përfaqësonte 26 për qind të portofolit të kredisë së bizneseve. Krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë, portofoli i kredisë për industrinë në tërësi ka paraqitur përmirësim të dukshëm me rreth 3 pikë përqindje. Rritja e kredisë për sektorin e prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë ka kompensuar tkurrjen e kreditimit në nënsektorë të tjerë. Ecuria e portofolit të kredisë sipas nënsektorëve pasqyron rënie të peshës së kredisë për industrinë përpunuese dhe rritje të kredisë për sektorin e prodhimit të energjisë. Vetë bankat shprehen

se gjatë vitit të fundit ato kanë preferuar të kreditojnë bizneset, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në sektorët e ekonomisë të lidhur me mallrat e konsumit bazë. Industria përpunuese reflekton ngadalësim të ritmeve të rritjes si rezultat i përfshirjes në këtë nënsektor, të bizneseve që janë të lidhura me eksporte ose furnizojnë me lëndë të para industrinë e ndërtimit. Përkeqësimi i termave të tregtisë ndërkombëtare[38] si dhe pasiguria e krijuar për zhvillimet në tregun e pasurive të paluajtshme, kanë bërë që shumë prej bankave të kufizojnë ndjeshëm kredidhënien për bizneset e këtij nënsektori.

Grafik 42. Ecuria e kredisë sipas sektorëve të ekonomisë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Portofoli i kredisë për individët gjatë vitit 2009 është karakterizuar nga ngadalësimi i njëtrajtshëm i ritmeve të rritjes vjetore, në 14 për qind. Kjo ecuri reflekton tkurrjen e ndjeshme të kredisë për pasuri të paluajtshme. Gjatë 5 muajve të parë teprica e kredisë për individë është rritur vetëm me 1.5 miliardë lekë, krahasuar me 12 miliardë lekë që u rrit një vit më parë. Norma vjetore

Grafik 43. Ecuria e kredisë sipas grupeve dhe qëllimit të përdorimit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

e rritjes së portofolit të kredisë për banesa është tkurrur dukshëm duke arritur në 13.4 për qind, e njëjtë me kredinë për konsum. Ky ngadalësim i kredisë për banesa ka qenë në përgjigje të politikave më konservative të bankave për këtë produkt, por edhe të një kërkese më të pakët. Politikat e ndjekura nga bankat tregtare për shtrëngimin e kritereve të kreditimit vihen re kryesisht në rritjen e raportit të mbulimit me kolateral të kredisë, në rritjen e nivelit të mbulimit të kështit të kredisë me të ardhura personale, me përzgjedhjen e cilësisë së kolateralit si dhe reduktimin në disa prej bankave, të afatit të maturimit të kredisë. Kërkesa për këtë produkt është ndikuar jo vetëm nga pasiguria për ecurinë e qëndrueshme të të ardhurave dhe vendit të punës, por edhe nga pritshmëritë për një reduktim të çmimit të banesave.

Ngadalësim të ritmeve të rritjes ka pasqyruar edhe kredia konsumatore. Gjithsesi, sikurse vihet re edhe në vrojtimet për aktivitetin kreditues, kjo kredi ka shfaqur shtrëngim më të lartë të kushteve të kreditimit nga sistemi bankar që në fillim të vitit 2008. Në maj të 2009-ës, kredia konsumatore përbënte 24 për qind të portofolit të kredisë për individë ose rreth 6 pikë përqindje më e ulët se niveli më i lartë historik, në korrik të 2007-ës. Krahasuar me një vit më parë struktura e portofolit të kredisë për individë sipas qëllimit të përdorimit ka mbetur e pandryshuar.

Hapësirë informuese 4: Rezultatet e vrojtimit të aktivitetit kreditues për tremujorin e dytë 2009.

Në këtë hapësirë informuese përmblidhen rezultatet nga vrojtimi i aktivitetit kreditues të zhvilluar me ekspertë të kredisë pranë bankave gjatë muajit korrik 2009. Vrojtimi i referohet ndryshimeve të ndodhura në aktivitetin kreditues gjatë tremujorit të dytë të vitit 2009 dhe pritjeve të bankave për tremujorin e tretë të vitit. Nga rezultatet e këtij vrojtimi, përqindja neto e bankave që kanë raportuar për shtrëngim të standardeve të kredidhënies, megjithëse ende në nivele të larta, është zvogëluar krahasuar me tremujorin e parë. Faktorët kryesorë nxitës të politikës shtrënguese të bankave vijojnë të jenë vlerësimi i tyre për situatën makroekonomike, problemet specifike të sektorit ku operojnë bizneset si dhe gjendja financiare e individëve. Lidhur me kërkesën neto për kredi (përqindja neto e bankave që kanë raportuar se kërkesa është rritur), megjithëse mbetet në nivele negative ka regjistruar një kthesë drejt rritjes në tremujorin e dytë të vitit 2009, ndërsa kërkesa e korporatave ka shënuar për herë të parë vlerë pozitive.

Pritjet e bankave për tremujorin e tretë të vitit 2009 çojnë drejt një zbutjeje të mëtejshme të shtrëngimit të standardeve për të dyja kategoritë e biznesit si dhe për kredinë dhënë individëve. Për sa i përket kërkesës për kredi, bankat vlerësojnë se ajo do të vijojë prirjen rritëse si nga individët ashtu edhe nga korporatat dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme.

Kredia për bizneset. Në tremujorin e dytë të vitit 2009 shtrëngimi i standardeve të kredisë akorduar bizneseve është zbutur në krahasim me tremujorin e kaluar. Balanca neto e cila vijon të jetë në kahun shtrëngues është rritur në -23.4 për qind në krahasim me -66.3 për qind në vrojtimin e kaluar. Balanca negative reflekton kryesisht bankat që kanë zgjedhur alternativën e përgjigjes "standardet janë shtrënguar disi" pasi asnjë bankë nuk ka zgjedhur "standardet janë shtrënguar shumë".

Grafik 44. Ndryshimet në standardet e kredisë të aplikuara në kreditë e bizneseve dhe ndikimi i faktorëve të ndryshëm në to (balanca neto[1]), në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.
Shënim 1. Balanca pozitive tregon për lehtësim të standardeve ose që faktori ka ndikuar në lehtësimin e standardeve të kredidhënies; ndërsa balanca negative tregon për shtrëngim të standardeve ose që faktori ka ndikuar në shtrëngimin e standardeve të kredidhënies.

Grafik 45. Ndryshimet në standardet e kredisë të aplikuara në kreditë e individëve për banesa dhe për konsum, dhe ndikimi i faktorëve të ndryshëm (balanca neto*), në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.
*) Shih shënimin 1.

Faktorët kryesorë që kanë kontribuar në shtrëngimin e standardeve në tremujorin e dytë të vitit 2009 vijojnë të jenë problemet specifike të sektorit ku operon biznesi, situata makroekonomike në vend dhe ecuria e kredive me probleme. Megjithatë, gjatë vrojtimit të rradhës ndikimi i këtyre faktorëve është zbutur disi krahasuar me gjysmën e dytë të vitit 2008 dhe tremujorin e parë të vitit 2009 (grafiku 1). Politika shtrënguese e bankave gjatë tremujorit të dytë është realizuar kryesisht nëpërmjet rritjes së marzhit mesatar për kreditë që bankat vlerësojnë si më me rrezik dhe rritjes së kërkesës për kolateral në raport me madhësinë e kredisë.

Kërkesa neto e bizneseve për kredi, sipas vlerësimeve të ekspertëve të bankave, është rritur disi në krahasim me tremujorin e kaluar, megjithëse kërkesa e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme mbetet në nivele negative. Faktorët kryesorë që kanë nxitur kërkesën e bizneseve për kredi, sipas opinionit të ekspertëve të bankave, kanë qenë nevoja për financimin e kapitalit qarkullues, pakësimi i përdorimit të burimeve alternative të financimit si dhe vendime të Bankës së Shqipërisë. Sipas qëllimit të përdorimit të kredisë, kërkesa neto për kredi për investim ka njohur rritje ndërsa kërkesa për kapital qarkullues është paraqitur pozitive.

Bankat presin zbutje të mëtejshme të standardeve për akordimin e kredisë për bizneset në tremujorin e tretë të vitit 2009. Pritjet për kërkesën tregojnë për një kthesë pozitive të saj në tremujorin e ardhshëm. Balanca e pritjeve është pozitive si për kërkesën nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme ashtu edhe nga korporatat.

Kredia për individë. Standardet e kredidhënies për individët në tremujorin e dytë të vitit 2009 kanë qenë të shtrënguara, megjithëse më të zbutura në krahasim me nivelin e lartë të shënuar në tremujorin e parë: përqindja neto e bankave që shprehën lehtësim është rritur, balanca neto regjistron -21.6 për qind nga -44.3 për qind në tremujorin e parë të vitit. Gjatë tremujorit aktual standardet kanë qenë disi më të shtrënguara për kredinë konsumatore se sa për kredinë për blerje banese. Faktori kryesor që ka përcaktuar shkallën e shtrëngimit të standardeve në tremujorin e dytë të vitit 2009 është gjendja e kredive me probleme, balanca neto e së cilës shënon -45.2 për qind krahasuar me -29.8 për qind tremujorin e kaluar.

Përveç gjendjes së kredive me probleme, ndikimin më të madh në shtrëngimin e standardeve të bankës vijojnë ta japin gjendja financiare e individëve si dhe zhvillimet në tregun e pasurive të paluajtshme.

Kërkesa e individëve për kredi sipas opinioneve të ekspertëve të bankave ka shënuar një rritje të lehtë krahasuar me rënien në tremujorin e kaluar. Kërkesa për kredi për konsum paraqitet më e ulët se sa ajo për blerje banese.

Për tremujorin e tretë të vitit 2009 bankat nuk parashikojnë shtrëngim të mëtejshëm të standardeve të kredidhënies për individët. Pritjet e ekspertëve të bankave tregojnë për një kërkesë pozitive gjatë tremujorit të tretë të vitit.

Aktiviteti kreditues sipas monedhës. Bankat presin rritje të aktivitetit kreditues në lekë në tremujorin e tretë të vitit 2009 dhe rënie të aktivitetit kreditues në monedhë të huaj. Kjo prirje është vënë re që prej gjysmës së dytë të vitit 2008. Bankat presin rritje të normës së interesit të kredive në valutë për kreditë që do të akordohen në tremujorin e tretë të vitit 2009. Përqindja neto e bankave që presin rritje të normës së interesit për kreditë në valutë është 12.3 për qind në krahasim me përqindjen e bankave që presin rritje të normës së interesit të kredisë në lekë, e cila është 4.7 për qind.

Ekspertët e bankave kanë vlerësuar gjithashtu edhe faktorët që nxisin bizneset dhe konsumatorët të kërkojnë kredi në valutë. Faktori kryesor për nxitjen e kërkesës së bizneseve edhe gjatë tremujorit të dytë ka qenë diferenca në normat e interesit dhe burimi i të ardhurave në valutë. Ndërsa për kërkesën e individëve vijon të mbetet faktor kryesor nxitës për kredinë në valutë diferenca në normat e interesit si dhe çmimet e mallrave të blerë, të shprehura në monedhë të huaj.

FINANCIMI I SEKTORIT FISKAL

Përmirësimi i situatës së likuiditetit në përgjigje të zhvillimeve pozitive në depozita si dhe prezencës së vazhdueshme të Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë, ka rritur pjesëmarrjen e bankave në tregun primar të letrave me vlerë qeveritare. Ndërkohë që zgjerimi i mëtejshëm i deficitit buxhetor të qeverisë në muajin maj ka mbajtur të lartë kërkesën për fonde. Gjithsesi, arkëtimi i të ardhurave nga disa privatizime ka ndihmuar në uljen e presioneve në likuiditet në tregun e parasë. Rezultantja e kësaj tabloje ka ndikuar në stabilitetin e normave të interesit në tregun e letrave me vlerë gjatë këtyre muajve.

Grafik 46. Ecuria e financimit të deficitit buxhetor dhe struktura e borxhit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në muajin maj 2009, portofoli i letrave me vlerë qeveritare të sistemit bankar u rrit me rreth 8.3 miliardë lekë. Kjo u ndikua kryesisht nga rritja mujore e investimeve në letra me vlerë afatgjata prej 5.2 miliardë lekësh dhe në ato 1-vjeçare me rreth 3.1 miliardë lekë. Përgjatë muajve të parë të vitit 2009 ka vijuar tendenca për zhvendosjen e portofolit të letrave me vlerë nga afatshkurtra deri në 1 vit; në afatgjata dhe kryesisht 5-vjeçare. Krahasuar me fundin e dhjetorit portofoli i bonove të thesarit të bankave është reduktuar me 5.4 miliardë lekë. Ndërkohë që vihet re rritje prej 7.5 miliardë lekësh në investimet në obligacionet 5-vjeçare.

Gjatë 5 muajve të parë të vitit 2009, vihet re një pjesëmarrje më e madhe e individëve në financimin e nevojave të qeverisë. Në këtë periudhë portofoli i individëve në tregun primar është rritur me rreth 5 miliardë lekë, duke financuar rreth 11 për qind të borxhit të brendshëm të qeverisë. Një pjesë (rreth 1/5) e kursimeve të tërhequra nga bankat gjatë tremujorit të katërt të vitit 2008, mendohet të jetë kanalizuar pjesërisht në tregun e letrave me vlerë të qeverisë.

IV.2 ECURIA NË TREGUN E PUNËS DHE ECURIA E PAGAVE

TREGU I PUNËS

Norma e papunësisë në tremujorin e fundit të vitit 2008 regjistroi nivelin 12.68 për qind, ndërkohë që një tremujor më parë ishte 12.62 për qind. Rritja e normës së papunësisë u shkaktua kryesisht nga rritja e numrit të të papunëve të regjistruar, krahasuar me tremujorin e tretë 2008. Sipas të dhënave për tremujorin e parë të vitit 2009[39], vihet re një rënie e treguesit të punësimit në total dhe rënie e numrit të të papunëve krahasuar me tremujorin e mëparshëm.

Tabelë 9. Tregues të punësimit dhe të papunësisë.

	T 1-08		T 2-08		T 3-08		T 4-08		T 1-09	
	Sektori		Sektori		Sektori		Sektori		Sektori	
	Shtetëror	Privat	Shtetëror	Privat	Shtetëror	Privat	Shtetëror	Privat	Shtetëror	Privat
Të punësuarit	165,427	230,548	165,266	230,777	164,019	234,795	164,052	238,975	163,767	237,379
Numri i të papunëve[40]		140,008		139,985		140,140		141,700		141,382
Norma e papunësisë		13.04		12.97194786		12.62		12.68		

Burimi: Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

ECURIA E PAGAVE

Ritmet vjetore të ndryshimit të pagës mesatare në sektorin shtetëror dhe në ndërmarrjet ekonomike në tremujorin e fundit të vitit 2008, janë luhatur mesatarisht rreth vlerës 7 për qind. Në terma tremujorë është regjistruar një rritje e pagës mesatare për të dy sektorët, privat dhe shtetëror.

Miratimi dhe hyrja në fuqi e vendimit të qeverisë për rritjen e pagave që prej datës 1 maj të vitit 2009 vlerësohet të ketë dhënë efekt në rritjen e pagës mesatare, fillimisht në sektorin shtetëror[41]. Rritja e pagës bazë minimale mujore[42] për punonjësit në shkallë vendi në nivelin e 18,000 lekëve, rreth 13

Grafik 47. Ecuria e pagës mesatare në disa prej aktiviteteve ekonomike (ndryshime vjetore në për qind).



Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

për qind më e lartë në bazë vjetore dhe rreth 6 për qind në bazë tremujore, pritet të ndikojë në ecurinë e pagave në sektorin privat në tremujorët pasues të vitit 2009.

Grafik 48. Ecuria e pagës minimale dhe e pagës mesatare në sektorin e prodhimit e shërbimeve, dhe në atë shtetëror.



Burimi: INSTAT, Konjuktura tregues kryesorë ekonomikë tetor-dhjetor 2008 dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

IV.3 ÇMIMET E PRODHIMIT DHE TË IMPORTIT

Zhvillimet në çmimet e importit dhe të prodhimit në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 u ndikuan kryesisht nga konjuktura e favorshme në tregjet ndërkombëtare për çmimet e lëndëve të para. Rritja vjetore e çmimeve të importit ra nga niveli mesatar 3.7 për qind në vitin 2008 në 1.1 për qind në gjashtëmujorin e parë 2009. Ndërsa çmimet e prodhimit nga 6.5 për qind në -1.2 për qind në tremujorin e parë 2009. Presionet inflacioniste të gjeneruara nga çmimet e importit dhe të prodhimit mbi nivelin e përgjithshëm të çmimeve të konsumit kanë ardhur në rënie, por nënçmimi i monedhës vendase ndaj dollarit amerikan dhe monedhës evropiane vlerësohet se ka dhënë ndikim inflacionist në ecurinë e inflacionit të importuar.

Tremujori i parë i vitit 2009 dëshmoi për një rënie të çmimeve të prodhimit me -1.2 për qind në krahasim me tremujorin e parë të vitit të kaluar. Tendenca rënëse e këtyre çmimeve që në mesin e vitit 2008 është shkaktuar kryesisht nga klima e favorshme ekonomike në konjukturat ndërkombëtare.

Analiza mbi ecurinë e kostove sipas ndarjes sektoriale tregon për norma gjithmonë e më të ulëta rritjeje të çmimeve të prodhimit, në sektorët kryesorë të prodhimit në vend. Industria përpunuese, e cila është edhe kategoria me mbulimin më të madh në shportën e IÇP-së, shënoi një rritje të lehtë vjetore prej 0.6 për qind. Nëngrupi kryesor në këtë kategori "industria ushqimore", regjistroi për të dytin tremujor rradhazi një normë negative ndryshimi vjetor - 5.4 për qind. Rënia e çmimeve të prodhimit në këtë industri ka lehtësuar rënien e çmimeve të konsumit të kategorisë "ushqime të përpunuara". Kosto e prodhimit në kategorinë "industria nxjerrëse" ka shënuar një moderim të ritmeve të rritjes. Në tremujorin e parë të vitit rritja vjetore e çmimeve të prodhimit në këtë industri ishte 5 pikë përqindjeje më e ulët sesa rritja mesatare vjetore prej 7 për qind në vitin 2008. Rënia e kërkesës dhe e çmimeve për produktet në këtë industri në tregjet ndërkombëtare dhe natyra rieksportuese e firmave vendase që operojnë në këtë industri, vlerësohen të kenë qenë shkaktarët kryesorë në uljen e ritmeve të rritjes.

Tabelë 10. Normat vjetore të ndryshimit të disa përbërësve të IÇP-së dhe të IÇK-së të kategorisë "ushqime të përpunuara" (në përqindje).

	IÇP	IÇP Industria përpunuese gjithsej	IÇP Industria ushqimore	IÇK- Kategoria "ushqime të përpunuara"	IÇP Industria nxjerrëse
T4:06/T4:05	-0.7	1.5	1.4	2.4	8.3
T1:07/T1:06	2.1	14.4	2.5	3.2	8.1
T2:07/T2:06	3.3	7.3	11.3	2.9	2.8
T3:07/T3:06	3.6	6.3	14.7	7.3	4.7
T4:07/T4:06	7.5	10.2	18.6	10.8	4.5
T1:08/T1:07	7.4	6.8	20.5	11.2	5.6
T2:08/T2:07	7.4	6.9	14.6	12.9	2.9
T3:08/T3:07	7.1	6.1	7.0	10	9.7
T4:08/T4:07	4.2	1.8	-1.1	7.1	9.2
T1:09/T1:08	-1.2	0.6	-5.4	3.6	2.3

Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Indeksi i çmimeve të prodhimit për eksport[43] ra me 2 për qind në tremujorin e parë të këtij viti. Rritja mesatare vjetore e këtij indeksi ishte 9.3 për qind gjatë vitit 2008. Dega kryesore industriale "industria përpunuese" regjistroi një rritje vjetore prej 2.5 për qind gjatë këtij tremujori. Dobësimi i kërkesës botërore duket të ketë ushtruar presion mbi kompanitë eksportuese vendase që pranojnë një marzh më të ulët fitimi, duke ulur çmimet e produkteve të tyre për eksport.

Rënie ka shënuar dhe indeksi i çmimeve të prodhimit për tregun vendas. Kostot e prodhimit në vend ranë me 0.1 për qind në tremujorin e parë të vitit, në krahasim me rritjen mesatare vjetore prej 5.1 për qind gjatë vitit 2008. Kontributin kryesor e dha rënia e kostove të prodhimit në industrinë ushqimore me 4.7 për qind në terma vjetorë. Tendenca në rënie e çmimeve

të prodhimit për tregun vendas është reflektuar dhe në normat e ulëta të rritjes së çmimeve të konsumit në vend, në tremujorin e parë.

Çmimet e huaja kanë ndjekur një spirale rënëse që prej tremujorit të tretë të vitit 2008. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009, indeksi i çmimeve të huaja të konsumit[44] u rrit mesatarisht me 1.1 për qind në nivel vjetor, 2.6 pikë përqindje më pak në krahasim me mesataren e vitit të kaluar. Çmimet e konsumit në Itali dhe Greqi regjistruan në muajin qershor rritjen vjetore më të ulët të dhjetë viteve të fundit, përkatësisht me nga 0.5 për qind. Rënia e çmimeve të konsumit në këto vende është shkaktuar nga rënia e çmimeve të lëndëve bazë si dhe ngadalësimi i rritjes ekonomike në to.

Grafik 49. Ndryshimi vjetor i indekseve të mallrave përfshirë në IÇP (boshti djathtas) dhe IÇK (boshti majtas).



Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Pavarësisht niveleve të ulëta të çmimeve të huaja, inflacioni i importuar ka ardhur në rritje si pasojë e nënçmimit të lekut në muajt e fundit. Leku është nënçmuar në nivel vjetor mesatarisht me 21.3 dhe 5.5 për qind ndaj dollarit dhe euros, në gjashtëmujorin e parë të vitit. Kështu, megjithë rënien më të theksuar të çmimeve të huaja në tremujorin e dytë të vitit, inflacioni vjetor në vend ka ndjekur një tendencë rritëse për këtë periudhë nga 1.9, në mars në 2.3 për qind, në qershor. Rritja e inflacionit total në këtë tremujor është shkaktuar kryesisht nga rritja e inflacionit të mallrave të tregtueshëm, ndërsa inflacioni i mallrave të patregtueshëm ka ruajtur ritmet e rritjeve të muajve të mëparshëm.

Çmimet e huaja gjejnë reflektim të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm në zhvillimet e çmimeve të mallrave ushqimorë në vend. Inflacioni vjetor mesatar i grupit "ushqime dhe pije joalkolike" si në vend dhe jashtë (Itali dhe Greqi)

Grafik 50. Ndryshimet vjetore të çmimeve të huaja dhe të çmimeve në vend (grafiku majtas) dhe të çmimeve të huaja dhe në vend të mallrave ushqimorë (grafiku djathtas) dhe kursi i këmbimit.



Burimi: Llogaritje të Bankës së Shqipërisë dhe Instituti Statistikor Itali dhe Greqi.

është rritur përkatësisht me 3.5 për qind në tremujorin e parë të vitit. Në tremujorin e dytë rritja mesatare vjetore e çmimeve ushqimore në vend (5.0%) është dy herë më e madhe sesa, duke evidentuar rolin e kursit të këmbimit, në rritjen e inflacionit të çmimeve të ushqimeve në vend.

Çmimet e importit vijuan të ndikohen nga luhatjet e çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare Tregu vendas i naftës, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit, ka rezultuar gjithnjë e më i integruar me tregun ndërkombëtar të tij duke pasqyruar luhatjet në çmim pa kohëvonesën njëmujore, që e karakterizonte atë gjatë vitit 2008. Çmimi mesatar për fuçi në tregun me pakicë për këtë periudhë ishte 104 lekë për litër. Kjo vlerë është përafërsisht 26 për qind më e ulët se e të njëjtës periudhë në vitin paraardhës. Pas rënies të fortë të çmimit të naftës në muajin shkurt të këtij viti, periudha paraardhëse ka shfaqur një prirje rritëse në terma mujorë, që kulmoi në muajin qershor. Kjo ecuri është në linjë me zhvillimet në tregun ndërkombëtar të naftës, të cilat janë përcjellë në masë të madhe në ecurinë e çmimit në tregun vendas, në kushtet e nënçmimit të monedhës vendase kundrejt dollarit amerikan.

Grafik 51. Ndryshimi vjetor i çmimit të naftës në vend dhe jashtë dhe i kursit të këmbimit lek/usd.



Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, EIA.

Indekset e grupeve dhe nëngrupeve në shportën e IÇK-së të cilat varen drejtpërsëdrejti ose në mënyrë të tërthortë prej luhatjeve të çmimit të naftës në treg, kanë ndjekur dinamikën e ndryshimeve të këtij produkti në nivel vjetor dhe mujor. Çmimet e nëngrupit "shërbime ndaj mjeteve personale të transportit", kanë regjistruar rënie vjetore mesatarisht me 12.3 për qind dhe rritje në nivel mujor. Në të kundërt, indeksi i nëngrupit "shërbim transporti" ka shfaqur prirje rritëse, kryesisht si pasojë e rritjes së çmimeve në shërbimin e transportit urban vitin e kaluar. Në muajin qershor këto çmime erdhën në rënie si pasojë e efektit statistikor.

Grafik 52. Pritjet e konsumatorëve dhe bankave për inflacionin vjetor dhe inflacioni aktual (në përqindje).



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

IV.4 PRITJET PËR ECURINË E ÇMIMEVE NË EKONOMI

Pritjet për inflacionin[45] në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme kanë vazhduar rënien dhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2009. Megjithatë, ato qëndrojnë mesatarisht brenda intervalit 2 – 4 për qind të objektivit të Bankës së Shqipërisë për stabilitetin e çmimeve. Pritjet e konsumatorëve për inflacionin vjetor pas një viti qëndrojnë në nivele më të ulëta në krahasim me pritjet e agjentëve të tjerë të ekonomisë (biznese dhe bankat). Inflacioni vjetor i pritur pas një viti nga konsumatorët[46] është +1.1 për qind, krahasuar me 2.6 për qind të pritur nga ekspertët e bankave dhe nga bizneset.

Çmimet e pritura të prodhimit në nivel ekonomie, pasi u rritën ndjeshëm në tremujorin e dytë të vitit 2008, kanë shfaqur një prirje në rënie deri në tremujorin e parë të këtij viti, duke u rritur lehtë në tremujorin e dytë (grafiku 2). Megjithatë, ato qëndrojnë poshtë mesatares së tyre historike.

Sipas vlerësimeve të bizneseve të sektorit të industrisë pritet që çmimet e prodhimit të vazhdojnë rënien dhe gjatë tremujorit të dytë të vitit, madje balanca e pritjeve merr vlera negative. Balanca e pritjeve për çmimet e prodhimit në këtë sektor qëndron 6.5 pikë përqindje më poshtë prirjes historike. Në kontrast, bizneset e sektorëve të ndërtimit dhe të shërbimeve kanë vlerësuar në rritje çmimet e tyre të prodhimit për tremujorin e dytë. Bizneset në sektorin e shërbimeve janë më optimiste duke pritur rritjen e çmimeve të prodhimit mbi mesataren historike. Ndërsa bizneset në sektorin e ndërtimit, megjithëse presin rritje të çmimeve të tyre të prodhimit vlerësojnë se ato do të qëndrojnë poshtë mesatares së tyre historike.

Grafik 53. Pritjet e bizneseve për ecurinë e çmimeve të prodhimit pas një tremujori (përqindje neto).



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

V. TREGJET FINANCIARE, NORMAT E INTERESIT DHE KURSI I KËMBIMIT

Përbërësit e kushteve monetare, normat e interesit dhe kursi i këmbimit, janë ndikuar nga pasiguria në tregun financiar që shoqëroi theksimin e mungesës së likuiditetit në gjashtëmujorin e parë. Normat afatshkurtra të interesit në

tregun e parasë janë ulur si pasojë e efektit pozitiv që ka dhënë ndërhyrja e bankës qendrore në plotësimin e likuiditetit dhe sinjalizimi lehtësues i politikës monetare, ndërkohë që ato afatgjata janë rritur si pasojë e rivlerësimit të rrezikut. Në të njëjtën kohë, kursi i këmbimit ka shfaqur luhatshmëri të theksuar gjatë kësaj periudhe në një prirje nënçmuese.

OPERACIONET NË TREG TË HAPUR

Nevoja për likuiditet, si pasojë e rrjedhjes së depozitave që karakterizoi sistemin bankar në tremujorin e fundit të vitit të kaluar ka vazhduar dhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2009. Situata e krijuar nxiti presione për rritje të normave të interesit në tregun e parasë, reflektuar në rritjen e primit të rrezikut për normat më afatgjata. Për të kontrolluar këto presione, për të nxitur aktivitetin huadhënës në tregun e parasë dhe për të qetësuar pjesëmarrësit në treg, Banka e Shqipërisë ka ndërhyrë duke injektuar likuiditet të përkohshëm e pa kufizim nëpërmjet operacioneve në treg të hapur. Në muajin nëntor 2008, forma e ankandit të marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes ndryshoi nga ajo me shumë të kufizuar në atë me shumë të pakufizuar dhe interes fiks, normën bazë. Krahas këtij instrumenti kryesor, me qëllim krijimin e kushteve të favorshme për të nxitur aktivitetin huadhënës të bankave, Banka e Shqipërisë i është drejtuar përdorimit në sasi të konsiderueshme të marrëveshjes së anasjelltë të riblerjes me afat tremujor. Në fund të gjashtëmujorit, huadhënia ndaj sistemit bankar me anë të operacioneve në treg të hapur llogaritet rreth 31 miliardë lekë, nga 15 miliardë lekë në tetor. Ulja e normës bazë nga 6.25 për qind në 5.75 për qind në fund të muajit janar, kur në të njëjtën kohë ishte ngushtuar dhe korridori për lehtësinë e kreditimit nga banka qendrore (dhjetor 2008) i shërbeu uljes së kostos së financimit të sistemit bankar. Duhet nënvizuar se këto masa u morën në kushtet kur presionet inflacioniste ishin në kahun rënës, duke mos rrezikuar arritjen e objektivave kryesorë të Bankës së Shqipërisë.

Grafik 54. Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë dhe ecuria e normës bazë të interesit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Përmirësimi i situatës së likuiditetit, ndihmuar dhe nga frenimi i rrjedhjes së depozitave në muajt e fundit është përçuar në rritjen e aktivitetit kreditues në tregun e parasë. Luhatja e normave të interesit është zbutur, ndërkohë që ulja e normës bazë prej 50 pikësh në fund të muajit janar, është përcjellë në mënyrë të plotë në tregun ndërbankar. Në vijim, masa e marrë nga Banka e Shqipërisë për mospërdorimin e depozitës njëditore pranë saj nga institutet kredituese në muajin mars, duket se është reflektuar në rritje të vëllimit të shkëmbyer dhe ulje të normave të interesit në tregun ndërbankar.

TREGU I PARASË

Normat e interesit në tregun ndërbankar ranë në tremujorin e parë të vitit në përgjigje të lehtësimit të kushteve monetare dhe uljes së tensionit për

likuiditet pas ndërhyrjeve me operacione në treg të hapur. Në këtë periudhë ato janë luhatur pranë normës bazë të interesit. Tremujori i dytë evidentoi stabilizimin e kushteve të likuiditetit dhe rritjen e sigurisë në treg ndikuar edhe nga shenjat e para të rikthimit të depozitave në sistem. Vëllimi i tregtimit në tregun ndërbankar ka shënuar rritje në këtë periudhë, pas vlerave të ulëta që arriti në dy muajt e parë të vitit. Mungesa e përkohshme e alternativës së shfrytëzimit të lehtësisë së depozitës njëditore duket se ka qenë faktor tjetër nxitës për tregtimin e fondeve në tregun ndërbankar, duke pasqyruar sjellje më eficiente të agjentëve në këtë treg. Shpërndarja e likuiditetit në sistem ka qenë më e njëtrajtshme duke u përcjellë në zbutjen e luhatshmërisë së normave të interesit.

Grafik 55. Normat e interesit në tregun ndërbankar (majtas) dhe vëllimi ditor i huadhënies (djathtas, në miliardë lekë).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Huadhënia mesatare ditore është rritur me 0.6 miliardë lekë në tremujorin e dytë, nga 1.8 miliardë lekë në tremujorin e parë dhe 1.5 miliardë lekë në tremujorin e fundit të vitit të kaluar. Bankat vazhdojnë të preferojnë transaksionet ditore, ndërkohë që dhe ato javore kanë paraqitur rritje të moderuar gjatë këtyre muajve të fundit. Në terma mesatarë, interesi njëditor në këta muaj u ul në 5.08 për qind nga 5.42 për qind në tremujorin e parë dhe 6.33 për qind në tre muajt e fundit të vitit të kaluar. Në muajt shtator e tetor, interesi njëditor kaloi mbi normën bazë të interesit, ndërkohë që gjatë gjithë këtij viti ai ka qëndruar poshtë këtij niveli. Interesi për transaksionet 7-ditore është luhatur fare pranë normës së marrëveshjeve të riblerjes me të njëjtin maturitet, duke shënuar mesatarisht 5.74 për qind ose 94 pikë përqindjeje më pak se tremujori i katërt 2008.

Në tregun primar, *yield*-et e letrave me vlerë të qeverisë kanë ndjekur ecuri rritëse. Kjo tendencë ka nisur që prej fundit të vitit të kaluar dhe është theksuar edhe në periudhën në vazhdim. Në muajt e parë të këtij viti, rritja e *yield*-eve duket të ketë reflektuar disi pjesëmarrjen e ulët të bankave në

ankandet e letrave me vlerë të qeverisë. Ndonëse në periudhën në vazhdim kjo pjesëmarrje është rritur dukshëm, ajo gjithsesi nuk ka ndikuar në zbutjen e presioneve rritëse. Rritja e *yield*-ve për të gjitha maturitetet në një kohë që norma bazë është ulur me 50 pikë bazë dhe pjesëmarrja ka qenë e lartë, tregon për rritjen e perceptimit të rrezikut nga ana e bankave në një kohë që dhe rritja e emetimeve duket të ketë ndikuar në këtë kah.

Grafik 56. Raporti i mbulimit të kërkesës për financimin e deficitit në tregun primar dhe ecuria e *yield*-it 12-mujor.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rritja më e theksuar në *yield*-et e bonove të thesarit është vërejtur për maturitetin 12-mujor, duke u përcjellë më pas dhe në *yield*-et e obligacioneve të parametruara me këtë tregues. Në fund të këtij gjashtëmujori interesi i bonove 12-mujore arriti vlerën 9.24 për qind ose 0.48 pikë përqindjeje më lart se fundi i muajit dhjetor. Në nivel mesatar gjashtëmujor, *yield*-i i bonove njëvjeçare është 0.93 pikë përqindjeje më i lartë sesa një vit më parë. Të njëjtën

Grafik 57. Kurba e *yield*-eve (majtas) dhe *yield*-et afatgjata të letrave me vlerë në tregun primar (djathtas).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

ecuri kanë ndjekur dhe *yield*-et për maturitetet e tjera, 6- dhe 3-mujore, por në masë më të përmbajtur. *Yield*-i për afatin 6-mujor shënoi 7.67 për qind në fund të majit ose 0.22 pikë përqindje më lart se fundi i muajit dhjetor. Ndërsa *yield*-i i bonove 3-mujore ka qëndruar afërsisht në të njëjtin nivel.

Tregu primar i obligacioneve ka evidentuar të njëjtën prirje me atë të bonove të thesarit. *Yield*-et e obligacioneve janë rritur kryesisht të ndikuara nga rritja e vlerësimit të rrezikut nga ana e bankave, në një kohë që pjesëmarrja në ankande ka qenë në nivele të kënaqshme gjatë muajve të fundit.[47] Në muajin qershor, *yield*-i i obligacioneve 2-vjeçare shënoi 9.45 për qind dhe ai i obligacioneve 5-vjeçare (me interes të ndryshueshëm) 10.92 për qind. Këto nivele tregojnë një rritje prej rreth 50 dhe 75 pikë bazë nga ato të fundit të gjashtëmujorit të kaluar. Rritja e *yield*-eve të këtyre instrumenteve ka reflektuar rritjen e *yield*-it të bonove 12-mujore si dhe të marzhit të pranuar. Në ankandin e organizuar në prill, *yield*-i i obligacioneve 3-vjeçare u rrit me 0.63 pikë përqindjeje, duke shënuar 9.61 për qind.

NORMAT E INTERESIT PËR DEPOZITAT DHE KREDITË E REJA

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 normat e interesit për të dyja monedhat kryesore, lekë dhe euro kanë qenë relativisht të larta (krahasuar me kahun e sinjalizuar të politikës monetare). Këto norma kanë reflektuar mungesën për likuiditet dhe rritjen e primit të rrezikut.

Norma mesatare e interesave për depozitat e reja me afat në lekë gjatë pesë muajve të parë të vitit 2009 është mesatarisht 5.36 për qind, 16 pikë përqindjeje më poshtë nga tremujori i fundit i vitit 2008. Tendenca në rënie e normave të interesit të depozitave në lekë pas muajit janar të vitit 2009, ka reflektuar pjesërisht përfundimin e ofertave të fillimvitit dhe uljen e normës bazë të interesit. Kjo prirje duket se ka ndryshuar drejtimin duke u rritur në fillim të sezonit veror, në 5.45 për qind në muajin maj.

Grafik 58. Ecuria e interesave të depozitave 12-mujore dhe normat bazë (majtas) dhe diferenca e normës së interesit për depozitat 12-mujore lek-euro (djathtas).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Interesat për depozitat me afat në euro, në përgjithësi, kanë ndjekur të njëjtën lëvizje si ato në monedhën vendase, duke u kushtëzuar nga gjendja e likuiditetit dhe rivlerësimi i rreziqeve në tregun e brendshëm, sesa nga orientimi i normave përkatëse të interesit në tregun ndërkombëtar. Norma mesatare e interesit për depozitat me afat në euro ka vazhduar të ruajë vlera të larta pavarësisht reduktimit të normës bazë nga BQE me 1.50 pikë përqindjeje, nga muaji dhjetor 2008 (në nivelin 2.50%) deri në maj 2009 (në nivelin 1.00%) dhe uljes së interesave në euro në tregun ndërkombëtar. Norma mesatare e interesave për depozitat e reja në euro në të njëjtën periudhë është ulur me 0.55 pikë përqindjeje, në 2.58 për qind. Reduktimi është bërë më së tepërmi për afatet e shkurtra, ndërkohë që interesat për depozitat njëvjeçare kanë shfaqur rritje në muajin maj, duke ruajtur marzhe të larta në vend me qëllim tërheqjen e valutës nga prurjet sezonale verore.

Diferenca e normës së interesit për depozitat 12-mujore në lekë me ato në euro ka qëndruar në të njëjtin nivel me atë të fillimvitit, si pasojë e politikave pothuajse të njëjta të aplikuara për të dyja monedhat paralelisht.

Në pesë muajt e parë të vitit 2009 është regjistruar një prirje shtrënguese për kreditim, për të dyja monedhat, nga sistemi bankar e reflektuar edhe në rritje të normave të interesit për kreditë e reja. Diferencat e këtyre me normat të cilave ato u referohen, janë zgjeruar si pasojë e rritjes së rrezikut të perceptuar nga bankat dhe/ose ruajtjes së *spread*-eve me interesat e depozitave respektive.

Interesi mesatar i ponderuar për kreditë e reja në lekë është rritur mesatarisht me 0.96 pikë përqindjeje në pesë muajt e parë të vitit 2009, në 13.81 për qind, krahasuar me vitin 2008. Krahas rritjes së normave referencë me të cilat këto kredi janë të indeksuara (kryesisht *yield*-e të bonove të thesarit), ecuria e tyre pasqyron edhe tendencën e shtrëngimit të kushteve të kredidhënies gjatë kësaj periudhe. Sipas afateve të maturimit vihet re se rritja e normës mesatare të ponderuar të interesit pasqyron rritjen e normës së interesit për kreditë afatmesme në monedhën vendase. Kjo tendencë është në përputhje me preferencën e bankave për të shtrënguar më tepër kreditë afatgjata dhe ato për investime, në përgjigje të një perceptimi të tyre për rritjen e pasigurisë në vend. Në të kundërt, interesat për afatin e shkurtër (0-6 muaj) kanë shfaqur prirje rënëse dhe janë akorduar kryesisht për nevojat me likuiditet qarkullues të bizneseve në këtë periudhë.

Grafik 59. Ecuria e interesit mesatar të ponderuar për kreditë e reja në lekë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Norma mesatare e interesit për kreditë në euro ka treguar rënie në këtë periudhë, por jo me të njëjtin ritëm me normat referencë në tregun ndërkombëtar (zakonisht euribor dhe libor në euro). Ato janë përcaktuar nga ruajtja e *spread*-eve të larta me normat e depozitave në të njëjtën monedhë dhe perceptimi i përgjithshëm

për monitorimin më të rreptë të kredidhënies në valutë. Norma mesatare e kredisë në euro ka rezultuar 7.74 për qind në periudhën janar-maj ose 0.45 pikë përqindjeje më poshtë se viti i kaluar. Ndërkohë, gjatë kësaj periudhe, norma e euriborit në tregjet ndërkombëtare është ulur me 2.79 pikë përqindjeje. Lëvizja e kundërt e interesave të kredisë në lekë dhe atyre në euro ka sjellë rritjen e diferencës midis këtyre monedhave. Në këtë kontekst, shtrëngimi i kritereve të tjera, përveç çmimit, ka luajtur rol në rënien e kredidhënies në valutë dhe uljen e kërkesës për të. Diferenca midis interesit të kredisë së re në lekë dhe asaj në euro është rreth 6.07 pikë përqindjeje në pjesën e parë të vitit duke shënuar një zgjerim prej 1.40 pikë përqindjeje në krahasim me vitin 2008.

Kostoja e ndërmjetësimit (*spread*-i kredi/depozita) ka ruajtur nivel të lartë gjatë vitit 2009 për të dyja monedhat. Kjo diferencë, pas prirjes rritëse të janarit, ka rezultuar mesatarisht më e lartë se ajo e vitit 2008. Ky tregues në maj rezultoi 8.26 për qind për lekun dhe 5.22 për qind për euron.

Grafik 60. Interesi mesatar i ponderuar për kreditë e reja në euro, për depozitat në euro dhe interesi euribor 12-mujor.



Burimi: Banka e Shqipërisë, Reuters.

Grafik 61. Normat e ndërmjetësimit në lekë dhe në euro (majtas) dhe diferenca midis interesit mesatar të kredisë së re në lekë dhe atij në euro (djathtas).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

KURSI I KËMBIMIT

Ecuria e lekut kundrejt shportës së valutave kryesore, në terma mesatarë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2009, ka vijuar në të njëjtën linjë nënçmuese të vërejtur që nga tetori i vitit të kaluar kur, për herë të parë zhvillimet e krizës në tregjet financiare ndërkombëtare dhanë goditjen e tyre në tregun e brendshëm valutor. Në terma vjetorë, gjatë kësaj periudhe ndryshimet e indeksit NEER janë luhatur rreth intervalit -4.2 për qind deri në

Grafik 62. Ndryshimet vjetore të lekut në terma nominalë efektivë (NEER)[48] dhe mesatarja rrëshqitëse e tyre.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 63. Ecuria e raportit euro/lek në krahasim me mesataren e rajonit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 64. Ecuria ditore e raportit euro/lekë dhe usd/lekë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

-10.2 për qind (në terma mesatarë 7.95 për qind). Pavarësisht nënçmimit të përshkallëzuar të indeksit NEER, gjatë muajit qershor, i cili përkon me fillimin e sezonit turistik dhe me hyrjen në tregun valutor të një pjese të fondeve të kontraktuara nga tregjet ndërkombëtare, ritmi i rënies është paraqitur disi më i moderuar. Kjo mbështetet dhe nga ndryshimi pozitiv (1.14 për qind) që ka shënuar ky tregues në terma mujorë.

Nga një këndvështrim rajonal, analiza e raportit euro/monedhë vendase tregon për një rikthim të tendencës në kahun nënçmues, fakt ky që nuk duket se është vërejtur ende në vend pavarësisht se në terma marxhinalë leku paraqitet i mirëpozicionuar.

Në vija të përgjithshme, faktorët që duket se kanë ndikuar ecurinë e kursit të këmbimit gjatë gjysmës së parë të vitit janë të lidhur me krizën globale dhe impaktin e saj në tregun vendas. Si të tillë mund të përmendim prurjet e reduktuara valutore nga emigrantët, rënien e eksporteve, reduktimin e kredisë në valutë dhe lëkundjen e besimit të agjentëve ekonomikë. Krahas këtyre faktorëve, duket se në zhbalancimin e raportit ofertë-kërkesë është bashkëngjitur dhe efekti sezonal, që karakterizon rritjen e kërkesës për valutë në muajt e parë të çdo viti.

Në tregun e brendshëm valutor, leku është nënçmuar kundrejt dy monedhave kryesore në gjashtëmujorin e parë të vitit. Ecuria e monedhës vendase në raport me dollarin amerikan ka shënuar një nënçmim prej 21.3 për qind në terma vjetorë dhe 11.6 për qind në krahasim me gjashtëmujorin e fundit të vitit 2008. Ecuria e lekut kundrejt monedhës së gjelbër ka reflektuar tërësisht zhvillimet e raportit euro/dollar në tregjet ndërkombëtare. Kjo vërtetohet dhe nga luhatshmëria relativisht e moderuar e raportit usd/lekë gjatë periudhës në fjalë, në krahasim me tremujorin e fundit të vitit 2008, kur dollari pësoi goditjen më të fortë si pasojë e krizës financiare.

Gjithashtu, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit, në terma mesatarë monedha vendase ndaj euros ka pasqyruar një nënçmim prej 5.54 për qind, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar dhe 5.79 për qind krahasuar me gjashtëmujorin e dytë

të vitit 2008. Ndonëse në tre muajt e parë të vitit euro dukej të fitonte pikë kundrejt lekut me një ritëm të përshkallëzuar, kjo tendencë është frenuar në muajt prill dhe qershor, në favor të monedhës vendase, duke paraqitur një mbiçmim të lehtë prej 0.16 dhe 0.57 për qind, përkatësisht. Forcimi i lekut në këto dy momente ka ardhur kryesisht si rrjedhojë ofertës sezonale. Nga analizimi i dinamikës së raportit në fjalë vihet re se luhatshmëria ka rezultuar e theksuar gjatë tremujorit të parë të vitit në krahasim me të gjithë tremujorët e vitit të kaluar. Ndërkohë që në tremujorin e dytë ky tregues ka pasqyruar një rënie të moderuar duke pasqyruar pjesërisht praninë e autoriteteve monetare në treg.

Grafik 65. Luhatshmëria e këmbimit të lekut në tremujorë[49].



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Nënçmimi i kursit nominal efektiv (NEER) të lekut si dhe rritja më e shpejtë e çmimeve në vend në krahasim me çmimet e huaja, rezultuan në një nënçmim të kursit real efektiv (REER) me 6.64 për qind në nivel vjetor për gjashtë muajt e parë të vitit 2009. Në periudhën afatmesme - afatgjatë, kursi real efektiv i këmbimit të lekut përcaktohet nga faktorët themelorë ekonomikë si bilanci i pagesave, pozicioni konkurrues i mallrave vendas dhe diferenca e normave të interesit. Nga analiza e bërë mbi ecurinë e bilancit të pagesave duket se gjatë periudhës janar–prill 2009, bilanci tregtar ka pasqyruar një tkurrje të moderuar, çka mund të ketë pasqyruar në një masë reduktimin e remitancave dhe rënien e ritmit të kredisë. Megjithatë, tendenca rritëse që pasqyron kostoja për njësi pune gjatë dy viteve të fundit, mund të përbëjë premisë për zgjerimin e deficitit tregtar dhe rritje të kërkesës për valutë. Në të njëjtën linjë, ecuria e llogarisë korente gjatë tremujorit të parë tregoi se ecuria e këtij zëri të bilancit do të varet në një masë të madhe nga kohëzgjatja e rimëkëmbjes së ekonomive ku vendi ynë ka emigracion (sezonal dhe të përkohshëm) si dhe nga ecuria dhe pesha[50] e zërave të llogarisë kapitale dhe financiare, që financojnë llogarinë korente. Nga ana tjetër, përmirësimi i mëtejshëm i situatës së likuiditetit në treg do të krijojë kushte për një përçim më eficient të politikave monetare duke reflektuar në treg zgjerimin e ndjeshëm të normave bazë, që do të mbështesin ecurinë pozitive të kursit.

VI. ZHVILLIMET E PRITSHME EKONOMIKE DHE MONETARE GJATË VITIT 2009-2010.

Ekonomia shqiptare ka përjetuar dukshëm ndikimin e zhvillimeve makroekonomike botërore, krahas ndryshimeve në faktorët e brendshëm. Rënia e ritmeve të rritjes ekonomike në ekonominë botërore dhe në veçanti recesioni në shumë prej vendeve të Eurozonës, është përcjellë në ngadalësimin e treguesve të aktivitetit të ekonomisë shqiptare. Rënia e kërkesës agregate në vendet partnere në tregti, ulja e punësimit dhe ulja e ritmit të qarkullimit të kapitalit të huaj privat midis vendeve, kanë dhënë efektin e tyre nëpërmjet treguesve të sektorit të jashtëm të ekonomisë. Paralelisht me këtë, fenomeni i tërheqjes së depozitave nga sistemi bankar, tkurrja e ofertës monetare dhe rritja e pasigurisë në treg kanë kontribuar në ngadalësimin e kërkesës në ekonomi. Në tërësi, aktiviteti ekonomik është përballur me burime financuese më të pakta, duke u përkthyer në ngadalësim të kërkesës agregate.

Rënia ekonomike dhe ulja e kërkesës agregate në ekonomitë partnere në tregti kanë prekur ecurinë e eksporteve dhe rrjedhimisht, nxitjen e kërkesës në ekonominë shqiptare. Gjatë viteve të fundit, eksportet kanë njohur një tendencë rritëse duke arritur në rreth 30 për qind të PBB-së në vitin 2008. Të dhënat për llogarinë korente në tremujorin e parë të këtij viti tregojnë një rënie të tyre kundrejt tremujorit të parë të vitit 2008. Në përgjithësi, konfirmimi i tendencës rënëse të eksporteve gjatë vitit 2009, mund të kontribuonte në kahun rënës të ecurisë së kërkesës agregate në ekonomi.

Ecuria e mëtejshme e aktivitetit ekonomik mbart një pasiguri shtesë në terma të financimit të rritjes ekonomike në periudhën afatgjatë. Përtej faktorëve të rritjes së produktivitetit dhe zhvillimit teknologjik, remitancat kanë qenë një nga burimet më të qëndrueshme të rritjes ekonomike në vitet e fundit. Në terma të PBB-së, remitancat janë luhatur në rreth 10-15 për qind. Megjithatë, në tre vitet e fundit, ato kanë ndjekur një prirje të qartë rënëse nga 14.6 për qind të PBB-së në vitin 2005, në rreth 10.6 për qind në vitin 2008. Në terma vjetorë, në vitin 2008, remitancat shënuan një rënie prej rreth 6 për qind kundrejt vitit 2007, ndërsa për tremujorin e parë të vitit 2009 rënia vjetore ishte 7.7 për qind. Vazhdimësia e tendencës rënëse të remitancave vështirëson financimin e konsumit në ekonomi dhe rrit koston oportune të investimeve. Në mungesë të balancimit të këtij faktori, kryesisht nëpërmjet rritjes së produktivitetit dhe të investimeve të huaja direkte, rritja ekonomike do të tentojë të ngadalësohet.

Zhvillimet në tregjet kapitale ndërkombëtare dhe pasiguria e iniciativës sipërmarrëse pritet të veprojnë në ecurinë e ekonomisë reale në vend. Në prani të situatës së vështirë për likuiditet në tregjet e huaja dhe të rrezikut në rritje, lëvizshmëria e investimeve të huaja direkte dhe atyre kapitale nga jashtë kërkon norma më të larta kthimi. Për një ekonomi në zhvillim, kjo pasiguri e aksesit në tregjet kapitale të huaja përkthehet në vështirësi më të mëdha për ruajtjen e niveleve të mëparshme të investimeve. Prurjet financiare, në formën e investimeve të huaja direkte dhe kapitale, kanë financuar një pjesë në rritje të kërkesës në ekonomi. Kështu, në vitin 2008 niveli i tyre arriti në rreth 17 për qind në terma të PBB-së, përkundrejt 9 për qind në vitin 2007

dhe mesatarisht 5 për qind në vitet e mëparshme. Në kushtet e ngadalësimit të burimeve alternative të financimit, ruajtja e këtij niveli të prurjeve financiare përbën një sfidë për realizimin e një rritjeje ekonomike në nivelet e viteve të mëparshme.

Zhvillimet aktuale financiare dhe ato makroekonomike vështirësojnë gjetjen e burimeve të brendshme për financimin e ritmeve ekonomike. Së fundi, tërheqja e depozitave e vërejtur në sistemin bankar në tremujorin e fundit të vitit 2008 dhe në fillim të vitit aktual, ka tkurrur ofertën monetare dhe ka ngadalësuar procesin e ndërmjetësimit financiar. Ndërhyrjet në tregjet e parasë për plotësimin e nevojave për likuiditet në lekë dhe qetësimi i situatës financiare, kanë plotësuar kërkesën për mjete monetare në lekë.

Gjithashtu, përtej faktorëve të importuar nga zhvillimet botërore, në prani të përkeqësimit të termave të tregtisë, ekonomia pritet të përballet me nevoja në rritje të kërkesës për para. Përmirësimi i termave të tregtisë përbën një alternativë balancuese për ruajtjen e ritmeve ekonomike në periudhën afatgjatë dhe të ekuilibrit makroekonomik. Gjendja ende e pazhvilluar e tregjeve kapitale në vend nuk e ndihmon vetëkorrektimin e termave të tregtisë dhe të ekonomisë në tërësi.

Në këto kushte, hartimi dhe zbatimi i politikave makroekonomike duhet të përqendrohen në mbështetjen e stabilitetit të ekonomisë në periudhën afatmesme dhe atë afatgjatë. Hartimi i koordinuar i tyre do të synonte kontrollin e kërkesës agregate dhe rritjen e normës së kursimeve në përputhje me një nivel të qëndrueshëm afatgjatë të mbështetjes së investimeve dhe të rritjes ekonomike.

SHËNIME

[1] Eksportet dhe investimet agregate ranë me përkatësisht 30.6 dhe 48.9 për qind në terma tremujorë. Gjithashtu, importet ranë me 36.4 për qind ndërsa shpenzimet për konsum u rritën me 1.4 për qind të dyja në terma tremujorë.

[2] Vendet janë Brazili, Rusia, India dhe Kina.

[3] Rënia e këtyre dy kategorive ishte përkatësisht 12.6 dhe 21.7 për qind.

[4] Në këtë kontekst euro dhe dollari amerikan.

[5] Dollari amerikan u vlerësua me mesatarisht 13 për qind kundrejt monedhës së përbashkët evropiane, përgjatë gjashtë muajve të parë të vitit në terma vjetorë.

[6] Efekt i bazës së lartë krahasuese, duke qenë se çmimet e mallrave pësuan një rritje të konsiderueshme në gjysmën e parë të vitit 2008.

[7] Shpërndarja e inflacionit sipas muajve 2.1,1.8,1.6,1.9,2.1,2.3 (%).

[8] Në rastin e Shqipërisë, Indeksi i Kushteve Monetare (IKM) është një mesatare e peshuar e ndryshimeve të normës bazë të interesit dhe të kursit nominal efektiv të këmbimit (NEER), kundrejt vlerave përkatëse të tyre në një periudhë bazë. Duke nisur nga tremujori i dytë 2009, periudha bazë është muaji dhjetor 2005. Raporti i IKM në rastin e Shqipërisë është 1.82:1, çka nënkupton se efekti i një mbiçmimi në nivelin 1.82 për qind të NEER në kërkesën agregate, do të mund të neutralizohej nga një ulje e normës bazë të interesit me 1.0 pikë përqindjeje. Indeksi monitorohet për të parë kahun e kushteve monetare dhe jo si objektiv operacional.

[9] Mesatarja e dy matjeve (me përjashtim të përhershëm dhe me mesatare të reduktuar).

[10] Në muajin qershor dhe në tremujorin e dytë të vitit 2009 ai rezultoi përkatësisht rreth 6 dhe 3.7 për qind.

[11] Metodologjia e llogaritjes së indeksit të çmimeve të shitjes së banesave bazohet në supozimin se çmimi i njoftuar nga shitësi i banesave është çmimi i realizuar i transaksionit. Pjesa më e madhe e çmimeve të njoftuara për shitje banese është e shprehur në monedhën evropiane. Gjatë llogaritjes së indeksit për tremujorin e dytë u ndoqën dy metoda llogaritëse. Sipas metodës së parë, çmimet e vendosura në euro u shprehën në lekë me kursin korent të këmbimit. Dhe sipas metodës së dytë, çmimet e banesave të vendosura në euro u shprehën në lekë duke përdorur kursin lek/euro të një viti më parë, me supozimin se shitësi i banesës në vendosjen e çmimit në euro nuk ka mbajtur parasysh efektin e zhvlerësimit të lekut. Theksojmë se vrojtimi mbulon vetëm qytetin e Tiranës.

[12] Raporti çmim shitje ndaj qirasë së banesës është një nga treguesit më të thjeshtë që përdoren për të vlerësuar nëse banesat janë të mbiçmuara, duke krahasuar vlerat korente të raportit me vlerat historike të tij.

[13] Si PBB nominale për vitin 2009, llogaritjet janë bërë me vlerësimin e FMN-së për PBB-në nominale: 1,129,000 milionë lekë (rishikimi i 6-të i marrëveshjes PRGF). Shpërndarja e PBB-së sipas tremujorëve është bërë duke ruajtur peshat sipas tremujorëve përkatës të vitit 2008.

[14] Vlerat në përqindje ndaj PBB-së do të llogariten si raporte të të dhënave kumulative për periudhën T2'08- T1'09 ndaj PBB-së.

[15] Të dhënat mbi ecurinë e tregtisë së jashtme gjatë muajit maj '09 janë në nivel operativ. Banka e Shqipërisë rezervon të drejtën e rishikimit të tyre, çka nënkupton se mund të pasqyrohen ndryshime në këto vlera në një kohë të dytë.

[16] Indekset e vlerës njësi për importet dhe eksportet, INSTAT.

[17] Treguesit e tjerë nuk kanë një profil sezonal, ndaj janë marrë si seri origjinale.

[18] Krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2008, të ardhurat ranë me 13.9 për qind ndërsa shpenzimet me 7.1 për qind.

[19] Këto transferta arritën në 213.4 milionë euro gjatë T1'09 krahasuar me vlerën prej 242.9 milionë eurosh që shënonin një vit më parë.

[20] Treguesi relativ i tyre gjatë tremujorit të parë të vitit 2008 vlerësohet në 10.5 për qind. Vlera e raportit të mësipërm i referohet të dhënave kumulative për periudhën T2'08- T1'09.

[21] IHD brenda vendit shënojnë një rritje prej 1.9 pikë përqindjeje krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2008.

[22] Të dhënat për treguesit buxhetorë janë paraprake dhe mund të jenë objekt rishikimi.

[23] PBB-ja 6-mujore sipas parashikimeve të FMN.

[24] Vlerat janë përftuar si raport i realizimit 6-mujor të çdo treguesi, ndaj PBB-së 6-mujore të

publikuar nga FMN në programin e PRGF.

[25] Raportet janë ndërtuar sipas realizimit 6-mujor të secilit vit, ndaj PBB-së 6-mujore të vitit përkatës.

[26] Përfshihen një pjesë e të ardhurave nga privatizimi i ARMO-s, OSSH-së dhe privatizimi i një pjese të aksioneve të AMC-së, të cilat në total shënojnë një nivel prej 20.8 miliardë lekësh.

[27] Raporti bid/cover ka qenë nën 1 për tremujorin e parë të vitit, ndërkohë që me rritjen e kërkesës nga ana e bankave të nivelit të dytë për instrumentet e emetuara nga qeveria, ky raport ka rezultuar mbi 1 përgjatë tremujorit të dytë të vitit.

[28] Kjo shifër i referohet shumës rrëshqitëse të deficitit primar, për periudhën korrik '08- qershor '09.

[29] Y = GNP = Cd + Id+ Gd + EX ; ku C d: konsumi i brendshëm; Id: investimet e brendshme; Gd: shpenzimet qeveritare; EX: Eksporte – Importe.

[30] Bullgari, Rumani, Kroaci, Mal i Zi, Serbi, Maqedoni, Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë.

[31] Rritja sezonale mat rritjen tremujore të treguesit monetar të përshtatur në terma vjetorë.

[32] Pastruar nga efektet e kursit të këmbimit.

[33] Analiza e portofolit të kredisë është bazuar në serinë e pastruar nga efektet e kursit, me përjashtim të rasteve ku është e specifikuar ndryshe.

[34] Diferenca e tepricës faktike të kredisë ndaj nivelit ekuilibër.

[35] Seria e kredisë e pastruar sezonalisht dhe nga luhatjet e kursit të këmbimit.

[36] Krahasuar me 35% në muajin dhjetor 2008.

[37] Kryesisht si pasojë e zhvlerësimit të monedhës vendase ndaj valutave kryesore.

[38] Ulja e kërkesës nga jashtë, politikat proteksioniste të shumë prej vendeve në përgjigje të krizës financiare globale etj..

[39] Burimi: Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, maj 2009.

[40] Në fundin e secilit tremujor.

[41] Vendimi për rritjen e pagave përfshin rritjen e pagës për punonjësit e sektorit buxhetor.

[42] Vendimi i Këshillit të Ministrave në lidhje me pagën minimale i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2009.

[43] Indeksi i çmimeve të eksportit analizon ecurinë e çmimeve të prodhimit të mallrave që janë ekskluzivisht për qëllim eksportimi.

[44] Llogaritur si mesatare e ponderuar e indeksit të çmimeve të konsumit në Itali dhe Greqi.

[45] Treguesit e pritjeve të inflacionit dhe çmimeve të prodhimit që përdoren nga Banka e Shqipërisë maten duke u bazuar në informacionin e nxjerrë nga vrojtimet e organizuara pranë bizneseve, konsumatorëve dhe bankave.

[46] Pritjet e inflacionit të konsumatorëve llogariten në Bankën e Shqipërisë nëpërmjet procesit të kuantifikimit të pritjeve cilësore. Përgjigjet cilësore të marra nga vrojtimi i besimit të konsumatorit përkthehen në matje sasiore të pritshmërive të inflacionit duke përdorur metodën probabilitare të rregulluar.

[47] Raporti bid/cover në ankandet e obligacioneve ka qenë mesatarisht mbi 1.

[48] NEER – kursi nominal efektiv i këmbimit, i llogaritur kundrejt dy monedhave sipas një peshe të përafërt që zënë në tregtinë me jashtë, euro (80 për qind) dhe usd (20 për qind). Një rritje e NEER do të thotë mbiçmim i lekut.

[49] Llogaritur si mesatare tremujore e luhatshmërisë së kursit të këmbimit. Luhatshmëria e kursit të këmbimit është matur nga treguesi i devijimit standard.

[50] Një financim i llogarisë korente nëpërmjet investimeve të huaja direkte do të ndihmonte në qëndrueshmërinë e kursit të këmbimit.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z.ARDIAN FULLANI

Në konferencën për shtyp me shefin e Misionit të FMN-së për Shqipërinë, z. Gerwin Bell dhe Ministrin e Financave, z. Ridvan Bode
7 prill 2009

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, është shprehur në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe transparente për rreziqet me të cilat mund të përballet qëndrueshmëria e stabilitetit financiar të vendit gjatë këtij viti. Në dokumentin e saj më të fundit "Deklarata e Stabilitetit Financiar për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2008", në përmbushje dhe të detyrimit që rrjedh nga ligji "Mbi Bankën e Shqipërisë", është bërë një renditje e qartë e këtyre rreziqeve, të cilat përfitoj nga rasti që t'i përmend edhe një herë publikisht:

- Së pari, ngadalësimi i ritmit të rritjes ekonomike në vitin 2009, e bën të vështirë realizimin e treguesve të politikës fiskale në përputhje me parashikimet e fundit të vitit 2008. Zhvillimet në tregtinë e jashtme do të ndikojnë në rënien e grumbullimit të të ardhurave buxhetore, ndërkohë që shtrëngimi i kushteve financiare në ekonomi ndikon negativisht mundësitë e sektorit bankar për të financuar deficitin buxhetor. Për këtë arsye, në mënyrë që të realizohet objektivi për nivelin e deficitit buxhetor, është i domosdoshëm rialokimi i shpenzimeve publike sipas rëndësisë, në masën e nevojshme dhe përgjatë gjithë vitit financiar. Në terma praktikë, kjo do të thotë që aty ku është e mundur, të bëhen të gjitha përpjekjet për të ruajtur burimet e të ardhurave, për të gjetur burime alternative financimi, për të shtyrë në kohë shpenzimet jo urgjente, për të ripërcaktuar shpenzimet e planifikuara për këtë vit dhe që janë ende të pakontraktuara ose të pakryera.

- Së dyti, zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë, kryesisht në formën e ngadalësimit të eksporteve, rënies së dërgesave të emigrantëve dhe rritjes së importeve, ndikuan mbi ekuilibrin e tregut të brendshëm valutor, duke ushtruar presion mbi kursin e këmbimit të monedhës kombëtare në fillim të këtij viti. Kursi fleksibël i këmbimit është një instrument korrektues, i cili automatikisht ndihmon në eliminimin e zhbalancimeve në sektorin e jashtëm të ekonomisë. Megjithatë, në një periudhë më afatshkurtër, lëvizjet e shpejta dhe të pakontrolluara të kursit të këmbimit, ndikojnë negativisht në psikologjinë e publikut dhe fshehin brenda tyre veprime spekulative të subjekteve të ndryshme. Në këtë mënyrë, krijohen premisa për efekte zinxhir, me pasoja negative në besimin e operatorëve ndaj monedhës vendase dhe në aftësinë e huamarrësve në valutë për të shlyer në kohë borxhin e tyre. Rënia e pritshme e ritmit të rritjes ekonomike gjatë vitit 2009, do të reflektojë rënien e kërkesës së brendshme dhe si rrjedhojë, mund të shoqërohet me rënie të pjesës së saj që drejtohet për mallra të huaj. Si rezultat, vëllimi i tregtisë në përgjithësi mund të shënojë rënie, duke realizuar një korrektim të nevojshëm të deficitit në llogarinë korente të ekonomisë

së vendit, si edhe duke i vendosur faktorët e kërkesë/ofertës për valutë të ekonomisë tonë, në një ekuilibër më të qëndrueshëm.

- Së treti, është e domosdoshme të rivendosen ritme të qëndrueshme të rritjes së depozitave të publikut në sektorin bankar. Vetëm në këtë mënyrë, do të mundësohet mbulimi me produkte bankare i një klientele në rritje dhe me kosto më të leverdisshme. Unë përsëris se gjendja e sektorit bankar, për sa i takon treguesve të likuiditetit dhe kapitalizimit të veprimtarisë është e mirë dhe mbikëqyrja e tij e vazhdueshme është përparësi e Bankës së Shqipërisë. Ne besojmë që vendimi i fundit i Kuvendit të Shqipërisë, i cili miratoi rritjen e vlerës së plotë të garantimit të depozitave në 2.5 milionë lekë, do të ndikojë në kthimin më të shpejtë të depozitave të tërhequra në sistemin bankar. Niveli aktual i sigurimit të depozitave, i ngjashëm me atë të vendeve evropiane, garanton plotësisht dhe përgjithmonë kursimet e shumicës dërrmuese të familjeve shqiptare. Tashmë nuk ka arsye objektive që njerëzit të shqetësohen për sigurinë e kursimeve të tyre në banka. Çdo hezitim për të vendosur kursimet në banka, rrit në mënyrë të panevojshme vlerën e të ardhurave të munguara për shkak të mospërfitimit të interesave dhe të shërbimeve të tjera bankare. Theksoj që sektori bankar shqiptar është vendi më i mirë ku familjet tona duhet të vendosin dhe të rrisin vlerën e kursimeve te tyre.

- Së katërti, rikthimi i depozitave në sistem është i domosdoshëm për të mundësuar edhe një ecuri financiare më të mirë nga ana e sektorit bankar, në terma të shëndetit financiar. Gjatë vitit në vazhdim, veprimtaria bankare pritet të jetë më pak fitimprurëse, si rezultat i rënies së kredisë dhe kostove në rritje për shtimin e depozitave dhe të fondeve rezervë për shkak të cilësisë së kredisë. E rëndësishme është që sektori bankar shqiptar, pas disa viteve të një fitimi të kënaqshëm e ka përdorur atë, në pjesën dërrmuese, për të fuqizuar kapitalin e sektorit bankar. Gjithashtu, nëpërmjet një akti të veçantë rregullativ, Banka e Shqipërisë i ka kërkuar sektorit bankar të mos shpërndajë fitimin e vitit 2008, në formën e dividentit. Në këtë mënyrë, kapitalizimi i veprimtarisë bankare forcohet më tej, duke ofruar një garanci më shumë për shëndetin financiar të sektorit bankar në vijim. Kohët e fundit, Banka e Shqipërisë është duke kryer testime të njëpasnjëshme, për të gjetur reagimin e sistemit bankar në qoftë se ai do të përballej me rrethana nga më pesimistet. Analizat e përftuara nga stress-test-et e shumta që janë bërë si në rang sistemi, ashtu dhe në mënyrë individuale për çdo bankë më vete, tregojnë se sistemi në tërësi dhe asnjë nga bankat me rëndësi sistemike në veçanti, nuk janë të prekura në nivelin e likuiditetit dhe të kapitalizimit. Pavarësisht zgjerimit të spektrit të rreziqeve dhe një viti më të vështirë për zgjerimin e veprimtarisë bankare, sistemi financiar dhe sektori bankar do të mbeten të qëndrueshëm.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z.ARDIAN FULLANI

Në prezantimin e Raportit Vjetor për vitin 2008 përpara Komisionit të Ekonomisë dhe Financave
8 prill 2009

I nderuar z. Kryetar i Komisionit,
Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Është kënaqësi për mua të ndodhem përsëri këtu mes jush në këtë takim të përvitshëm. Banka e Shqipërisë e sheh këtë forum jo thjesht si një përmbushje e detyrimit të saj ligjor, por edhe si një mundësi për rritjen e transparencës dhe të përgjegjshmërisë së saj.

Në vijim të fjalës time, do të paraqes një analizë të ecurisë së ekonomisë shqiptare gjatë vitit që lamë pas si dhe një përmbledhje të punës së Bankës së Shqipërisë për përmbushjen e misionit të saj ligjor dhe të angazhimeve të tjera të saj, në funksion të forcimit të sigurisë dhe të rritjes së eficiencës së sistemit bankar shqiptar. Gjithashtu, duke përfituar nga mundësia e këtij komunikimi publik, dëshiroj të ndaj me ju pikëpamjen tonë në lidhje me sfidat me të cilat përballet ekonomia shqiptare dhe rrugët e duhura për zgjidhjen e tyre. Banka e Shqipërisë gjykon se trajtimi i këtyre sfidave duhet të vihet në krye të vëmendjes dhe të listës së përparësive të politikave ekonomike.

Duke paraprirë konkluzionet e analizave të Bankës së Shqipërisë, dëshiroj të theksoj që në fillim se aktiviteti ekonomik në vend është zhvilluar mbi baza të shëndetshme. Ekonomia shqiptare plotëson një sërë premisash për të patur një rritje ekonomike të qëndrueshme dhe afatgjatë, primare ndër të cilat është stabiliteti makroekonomik i vendit. Megjithatë, në kushtet e sfidave aktuale me të cilat përballet ekonomia shqiptare, këto baza duhet të ruhen dhe të forcohen më tej, nëpërmjet hartimit të politikave të duhura ekonomike nga autoritetet përkatëse dhe nëpërmjet rishikimit të planeve të zhvillimit nga të gjithë agjentët ekonomikë.

1. ECURIA E EKONOMISË SHQIPTARE GJATË VITIT 2008

Më lejoni në vijim që, në mënyrë të përmbledhur, të bëj një analizë retrospektive të ecurisë së ekonomisë shqiptare gjatë vitit 2008.

KONTEKSTI GLOBAL

Ekonomia botërore shënoi një përkeqësim të vazhdueshëm gjatë harkut kohor të vitit 2008. Rritja ekonomike në shkallë botërore arriti në 3.4 për qind gjatë vitit 2008, përkundrejt rritjes mesatare prej 5 për qind gjatë periudhës katërvjeçare paraardhëse.

Zhvillimi më i spikatur i vitit 2008 ishte tronditja që pësuan tregjet financiare dhe përhapja e saj në ekonominë reale. Natyra komplekse e instrumenteve financiare derivative, të përdorura në një masë të gjerë gjatë viteve të fundit, rriti pasigurinë në vlerësimin e ekspozimit të institucioneve individuale ndaj instrumenteve financiare të cilësuara si toksike. Kjo pasiguri u shndërrua në mungesë besimi dhe në ndërprerjen e funksionimit të tregut financiar, duke penguar funksionimin normal të sistemit të kreditit në ekonomi. Në këto rrethana, ekonomia reale u ndikua menjëherë nga mungesa e financimit të konsumit dhe të kredive, duke i çuar vendet e zhvilluara në recesion. Presionet e larta inflacioniste të gjashtëmujorit të parë të vitit, të kushtëzuara nga rritja e fortë ekonomike dhe të reflektuara në çmime të larta të naftës dhe të lëndëve të para, u zbutën ndjeshëm gjatë gjashtëmujorit të dytë. Tregjet monetare dhe financiare janë karakterizuar nga luhatje të mëdha. Rivlerësimi i rrezikut në tregjet financiare u shoqërua me rënie të çmimeve të letrave me vlerë. Gjithashtu, normat e interesit, kurset e këmbimit, çmimet e aksioneve dhe vëllimet e tregtimit janë luhatur dukshëm, në varësi të lajmeve të tregut dhe rrezikut të perceptuar të situatës.

RRITJA EKONOMIKE

Në këtë sfond të trazuar botëror, ekonomia shqiptare ka patur një ecuri zhvillimi krahasimisht pozitive. Në pritje të konfirmimeve nga statistikat zyrtare, Banka e Shqipërisë gjykon se ekonomia e vendit është rritur në linjë me parashikimet e fillimvitit. Kjo rritje ka reflektuar zhvillimin dinamik të disa sektorëve të ekonomisë, të mbështetur nga rritja e konsumit dhe e investimeve në ekonomi, si dhe përmirësimet e vazhdueshme strukturore dhe infrastrukturore të ekonomisë.

Rritja ekonomike në vend është mbështetur kryesisht në rritjen e shpejtë të kërkesës së brendshme, e cila mbetet edhe gjeneratori kryesor i rritjes ekonomike. Konsumi, investimet dhe shpenzimet qeveritare kanë shënuar rritje gjatë vitit 2008. Kërkesa e jashtme në formën e eksporteve, ka shënuar rritje të shpejtë gjatë viteve të fundit, por ajo mbetet ende në nivele të ulta për të mbështetur rritjen ekonomike të vendit. Aktiviteti ekonomik në vend është financuar kryesisht nga burime të brendshme. Në sajë të likuiditetit të tij të lartë gjatë vitit 2008, sistemi bankar shqiptar ka mundur t`i përgjigjet kërkesës për fonde të ekonomisë me rritje të ndërmjetësimit financiar. Gjatë vitit 2008, portofoli i kredisë bankare u rrit me 7.3 pikë përqindjeje të PBB-së.

Aktiviteti ekonomik në vend ka patur dy tablo të ndryshme gjatë vitit 2008, të kushtëzuara këto dukshëm nga zhvillimet në tregjet ndërkombëtare.

Statistikat zyrtare dëshmojnë për rritje të ndjeshme të vëllimit të aktivitetit ekonomik gjatë nëntëmujorit të parë, i shprehur ky në rritjen e shifrës së afarizmit, në rritjen e nivelit të kredisë, të të ardhurave buxhetore dhe të vëllimit të tregtisë me jashtë. Shifra e afarizmit në vëllim, e cila është një përafrues i nivelit të vlerës së shtuar në ekonomi, është rritur mesatarisht me 17 për qind gjatë nëntë muajve të parë të vitit. Normat më të larta të rritjes vjetore janë shënuar në degën e ndërtimit dhe në atë të tregtisë, ndërkohë që dega

e industrisë dhe ajo e transportit e komunikacionit paraqesin një ngadalësim të ritmit të rritjes krahasuar me një vit më parë. Tremujori i fundit pasqyroi një tablo cilësisht të ndryshme të zhvillimeve ekonomike. Nën ndikimin e krizës financiare dhe ekonomike botërore, aktiviteti ekonomik në vend ka shfaqur shenja ngadalësimi ndërsa treguesit monetarë kanë patur luhatje të dukshme. Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik të vendit gjatë tremujorit të katërt, u sinjalizua nga një sërë treguesish të tërthortë si: përkeqësimi i treguesit të tendencave ekonomike, i rezultuar nga përpunimi i opinioneve të bizneseve dhe të konsumatorëve mbi gjendjen aktuale të ekonomisë dhe pritjet e tyre për të ardhmen; rënia e remitancave dhe ngadalësimi i eksporteve gjatë gjysmës së dytë të vitit si dhe frenimi i aktivitetit kreditues gjatë tremujorit të fundit.

INFLACIONI I ÇMIMEVE TË KONSUMIT

Edhe gjatë vitit 2008, Banka e Shqipërisë ka përmbushur objektivin e saj ligjor për ruajtjen stabilitetit të çmimeve në ekonomi. Inflacioni i çmimeve të konsumit është luhatur brenda nivelit të synuar nga Banka e Shqipërisë. Norma mesatare e inflacionit vjetor shënoi vlerën 3.4 për qind gjatë vitit 2008, duke qenë mjaft afër objektivit të Bankës së Shqipërisë prej 3 për qind dhe brenda intervalit tonë të tolerancës prej 2-4 për qind. Niveli i kontrolluar i inflacionit reflekton kushtet e përshtatshme monetare dhe politikën e drejtë monetare të Bankës së Shqipërisë. Kjo e fundit ka bërë të mundur balancimin e faktorëve të kërkesës dhe të ofertës si dhe ka mundësuar ankorimin e pritjeve inflacioniste rreth objektivit të Bankës së Shqipërisë.

Sjellja e inflacionit nuk ka qenë e njëtrajtshme gjatë vitit 2008. Kërkesa e lartë e brendshme dhe goditjet e ekonomisë globale në formën e çmimeve të larta të mallrave bazë, u reflektuan në presione të larta inflacioniste gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit. Inflacioni vjetor kulmoi në vlerën 4.6 për qind në muajin maj, vlerë e cila shënon edhe nivelin më të lartë të inflacionit gjatë 5 viteve të fundit. Këto presione u reflektuan qartë edhe në rritjen e inflacionit bazë dhe të inflacionit të mallrave të patregtueshëm , të cilët janë edhe tregues sintetikë të balancave inflacioniste në ekonomi. Qetësimi i goditjeve të ofertës dhe ngadalësimi i kërkesës së brendshme gjatë tremujorit të fundit u shoqëruan me uljen progresive të vlerës së inflacionit, deri në nivelin 2.2 për qind në muajin dhjetor. Kjo rënie reflektoi një balancim më të mirë të kërkesës dhe të ofertës së brendshme, si dhe vlera më të ulta të inflacionit të importuar.

BILANCI I PAGESAVE DHE SEKTORI I JASHTËM I EKONOMISË

Viti 2008 u karakterizua nga një rritje e ndjeshme e shkëmbimeve ekonomike e tregtare me jashtë. Kërkesa e brendshme është reflektuar në rritjen e deficitit tregtar dhe të deficitit të llogarisë korente gjatë vitit 2008. Deficiti i llogarisë korente arriti në 14.9 për qind të PBB-së, i ndikuar kryesisht nga rritja e shpejtë e importeve dhe nga ngadalësimi i remitancave përgjatë pjesës së dytë të vitit, si pasojë e forcimit të efekteve të krizës ekonomike në ekonomitë e vendeve fqinje. Deficiti tregtar arriti vlerën e 2.4 miliardë eurove, duke qenë rreth 13.1 për qind më i lartë se në vitin 2007. Megjithatë, flukset

hyrëse valutore të llogarisë kapitale kanë qenë të mjaftueshme për ta mbyllur në terma pozitivë bilancin e pagesave gjatë vitit 2008. Rezervat valutore të Bankës së Shqipërisë janë rritur me rreth 192 milionë euro ose me 0.9 pikë përqindjeje të PBB-së.

Në terma makroekonomikë, deficiti i lartë i llogarisë tregtare sinjalizon për nivele të larta konsumi dhe investimesh në ekonomi, të cilat janë financuar nga kursimet e huaja në formën e hyrjeve të kapitalit. Në një analizë më afatgjatë, deficiti i llogarisë korente të Shqipërisë është një fenomen i natyrshëm, në përputhje me nivelin e zhvillimit të vendit. Veçanërisht pozitiv është fakti që pjesa më e madhe e importeve të vendit përfaqësohet nga importet e makinerive dhe pajisjeve, si dhe importi i mallrave të ndërmjetëm në aspektin e konsumit. Megjithatë, rritja e deficitit të llogarisë korente është një zhvillim që duhet monitoruar në vazhdimësi, pasi burimet e financimit të tij nuk janë gjithnjë të qëndrueshme dhe korrektimet e duhura për përputhjen e deficitit korent me fondet e disponueshme për financimin e tij janë shpesh të vështira. Politikat makroekonomike duhet të jenë të kujdesshme për të siguruar qëndrueshmërinë afatgjatë të bilancit të pagesave, si një nga aspektet kryesore të stabilitetit makroekonomik të vendit dhe një nga kushtëzuesit kryesorë të rritjes afatgjatë të vendit.

POLITIKA FISKALE DHE TREGUESIT FISKALË

Politika fiskale është një nga instrumentet kryesore për nxitjen dhe kontrollin e aktivitetit ekonomik. Në sajë të peshës së tij, sektori publik është një gjenerues i rëndësishëm i aktivitetit ekonomik dhe një përcaktues i kushteve financiare të ekonomisë, normave të interesit, të kursit të këmbimit dhe të likuiditetit të saj.

Politika fiskale ka patur një karakter më ekspansionist gjatë vitit 2008. Ky karakter është reflektuar në zgjerimin e deficitit buxhetor dhe të borxhit publik gjatë vitit 2008.

Deficiti buxhetor për vitin 2008, vlerësohet të ketë arritur në 5.7 për qind të PBB-së, duke u thelluar me rreth 2.2 pikë përqindjeje në terma vjetorë. Niveli i borxhit publik shënoi rritje gjatë vitit 2008, duke arritur në 55.6 për qind të PBB-së nga 52.2 për qind një vit më parë. Të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore u rritën përkatësisht me 15.3 për qind dhe 22.6 për qind gjatë vitit 2008, duke u vlerësuar në 27.3 për qind dhe 32.9 për qind e PBB-së.

Përmirësimi i administrimit të borxhit publik në drejtim të zgjatjes së afatit të maturimit dhe të diversifikimit të burimeve të financimit është zhvillim pozitiv që ka ndihmuar rifinancimin e borxhit dhe kontrollin e impaktit të kostos së tij në treguesit e buxhetit. Megjithatë, Banka e Shqipërisë gjykon se politika fiskale nuk duhet ta shkëpusë fokusin nga ruajtja e qëndrueshmërisë afatgjatë të treguesve fiskalë dhe minimizimi i impaktit të tyre në tregjet financiare. Ulja e deficitit buxhetor gjatë vitit 2009 dhe angazhimi për reduktimin e borxhit publik në horizontin afatgjatë, duhet të jenë prioritete konstante të organeve fiskale. Paralelisht me këtë, Banka e Shqipërisë gjykon se duhen bërë më

shumë përpjekje për përmirësimin e strukturës së shpenzimeve, në funksion të uljes së peshës së shpenzimeve korente dhe rritjes së investimeve kapitale.

ZHVILLIMET MONETARE

Si pasojë e ngadalësimit të vënë re gjatë tremujorit të fundit, ritmi i ekspansionit monetar shënoi nivele më të reduktuara në krahasim me vitin paraardhës. Ritmi mesatar i rritjes vjetore të M3 shënoi vlerën 12.3 për qind, përkundrejt vlerës 15.8 për qind të shënuar gjatë vitit 2007. Rritja e mjeteve monetare të ekonomisë i detyrohet kryesisht rritjes së kredisë së sistemit bankar. Shkalla e ndërmjetësimit financiar në ekonomi është rritur më tej gjatë vitit 2008. Raporti i depozitave në sistemin bankar ndaj PBB-së u rrit në 80 për qind gjatë vitit 2008, krahasuar me nivelin 78 për qind të shënuar gjatë vitit 2007. Ndërkohë që raporti i kredisë ndaj PBB-së u rrit në 37 për qind të PBB-së, duke shënuar një rritje vjetore prej 7.3 pikësh përqindjeje.

Ecuria e depozitave është karakterizuar nga luhatje të theksuara sezonale. Niveli i depozitave ka shënuar ritme të larta rritjeje kryesisht gjatë muajve të verës dhe një ngadalësim të dukshëm gjatë tremujorit të fundit. Në anën e aktivit, portofoli i kredisë së sistemit bankar për ekonominë është rritur me rreth 35 për qind gjatë vitit 2008. Zhvillimet në strukturën valutore të kredisë gjatë vitit 2008, treguan një zhvendosje të lehtë të portofolit të kredisë drejt asaj në valutë. Kjo preferencë për kredi në valutë, është mbështetur nga interesa më të ulët të ofruar për kredinë në valutë. Ky konstatim do të ishte i saktë në prani të një kursi këmbimi të qëndrueshëm.

Ai është i gabuar në kushtet e Shqipërisë, ku kursi i këmbimit është fleksibël dhe mundësia e lëvizjeve nënçmuese të tij nuk mund dhe nuk duhet të përjashtohet. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë konstaton se klientët e bankave tregtare vazhdojnë të mos faktorizojnë sa duhet rrezikun e kursit të këmbimit kur zgjedhin të marrin një kredi në valutë.

Ritmi i rritjes së kredisë ka ardhur në rënie gjatë vitit, duke reflektuar si shtrëngimin e standardeve të kredidhënies në përgjigje të masave rregulluese të marra nga Banka e Shqipërisë, ashtu edhe shtrëngimin e kushteve të likuiditetit në sistem. Vështirësitë e bankave për gjenerimin e mjaftueshëm të likuiditeteve si dhe një politikë më e kujdesshme e tyre drejt kreditimit, u reflektuan në ngadalësimin e rritjes së kredisë për ekonominë dhe të financimit të sektorit fiskal.

TREGJET FINANCIARE

Tregjet financiare shqiptare kanë reflektuar jo vetëm ecurinë e zhvillimeve ekonomike në vend, por edhe zhvillimet e vrullshme në tregjet financiare ndërkombëtare. Në këto kushte, ato janë karakterizuar nga një luhatshmëri më e lartë e treguesve të tyre, likuiditetit, normave të interesit, vëllimit të tregtimit dhe kursit të këmbimit, por duke mbetur gjithsesi brenda parametrave normalë të operimit.

Në një vështrim të përgjithshëm normat e interesave për depozitat kanë treguar prirje rritëse, si për monedhën vendase ashtu dhe për ato në euro. Në të kundërt, interesat e kredive kanë shfaqur prirje rënëse gjatë vitit 2008, duke sjellë edhe uljen e kostos së ndërmjetësimit të sistemit bankar. Në veçanti, pozitive është evidenca e fundit për rritjen e vëmendjes drejt kreditimit në lekë dhe rritjen e konkurrencës nëpërmjet normave të interesit në këtë treg.

Në plotësim të objektivit të saj për stabilitetin e çmimeve, Banka e Shqipërisë ka shpallur dhe ndjek një regjim fleksibël të kursit të këmbimit. Ky regjim nënkupton që vlera e kursit të këmbimit përcaktohet lirisht në treg, duke reflektuar balancën e forcave të kërkesës dhe të ofertës për valutë në të. Në pjesën më të madhe të vitit, kursi i këmbimit të lekut kundrejt valutave ka qenë i qëndrueshëm, ndërkohë që ai ka filluar një nënçmim të lehtë në fund të periudhës. Ecuria pozitive e monedhës vendase gjatë vitit 2008 është mbështetur nga një sërë faktorësh si: stabiliteti makroekonomik i vendit, rezultantja pozitive e bilancit të pagesave, ankorimi i inflacionit pranë objektivit të Bankës së Shqipërisë dhe përafrimi i këtij indikatori me atë të Eurozonës, si dhe diferenca pozitive e normave të interesit.

SISTEMI BANKAR

Viti 2008 u karakterizua nga zhvillime intensive në sistemin bankar shqiptar. Aktiviteti bankar njohu rritje të mëtejshme gjatë vitit, si në aspektin sasior të mbulimit gjeografik të vendit dhe të shkallës së ndërmjetësimit, ashtu edhe në treguesit cilësorë të gamës së shërbimeve të ofruara dhe të kostos së ndërmjetësimit. Ndërkohë, tërheqja e depozitave gjatë tremujorit të fundit testoi ndjeshëm qëndrueshmërinë e sistemit. Zhvillimet e kësaj periudhe dëshmuan se sistemi bankar shqiptar e kaloi me sukses provën e tij të parë të qëndrueshmërisë.

Ky sistem, vijon të jetë i angazhuar kryesisht në aktivitetin e grumbullimit të depozitave dhe rritjes së kredidhënies. Megjithëse me ritme më të moderuara, aktivet dhe burimet e sistemit u rritën më tej gjatë vitit 2008. Analiza e treguesve të sistemit tregon për një nivel në rritje të rrezikut dhe zvogëlim të kapacitetit të tij financiar përgjatë vitit. Performanca e sistemit bankar për vitin 2008 ka shënuar rënie, vlerësuar në këndvështrimin e ecurisë së rezultatit neto. Kjo ka reflektuar si rritjen e konkurrencës në sistem, ashtu edhe rritjen e shpejtë të shpenzimeve për provigjone, veçanërisht në gjysmën e dytë të vitit. Gjithsesi, luhatshmëria dhe performanca jo e mirë e disa prej treguesve kryesorë, nuk ka vënë në rrezik nivelin e kapitalit rregullator të nevojshëm për mbulimin e rreziqeve të marra nga sistemi bankar. Niveli i treguesve të sipërpërmendur nuk konsiderohet të jetë kritik, por dinamika dhe intensiteti i zhvillimeve kërkojnë monitorim më të kujdesshëm edhe në vijimësi.

2. AKTIVITETI I BANKËS SË SHQIPËRISË GJATË VITIT 2008

Si autoriteti monetar i vendit, Banka e Shqipërisë ka si mision të saj garantimin e stabilitetit të çmimeve në ekonomi. Në përmbushje të këtij misioni, ajo harton dhe zbaton në mënyrë të pavarur politikën monetare si dhe

monitoron dhe rregullon aktivitetin e tregjeve financiare në përgjithësi dhe atë të sistemit bankar në veçanti. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë është një aktor i rëndësishëm dhe aktiv në përpjekjet e vendit për integrimin evropian. Më lejoni në vijim të bëj një pasqyrë të shkurtër të punës së Bankës së Shqipërisë përgjatë vitit 2008.

POLITIKA DHE OPERACIONET MONETARE TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë hartohet dhe zbatohet ekskluzivisht në funksion të përmbushjes së objektivit tonë kryesor, arritjes dhe ruajtjes së stabilitetit të çmimeve.

Presionet inflacioniste të pranishme gjatë gjashtëmujorit të parë dhe lëkundja e besimit në agjentët diktuan ndjekjen e një politike monetare të kujdesshme gjatë vitit 2008. Norma bazë e interesit është mbajtur e pandryshuar gjatë gjithë periudhës, duke synuar balancimin më të mirë të raporteve të kërkesës dhe të ofertës si dhe duke kontribuar në kontrollin e pritjeve inflacioniste në ekonomi. Së bashku me forcimin e disa masave të mbikëqyrjes bankare në drejtim të administrimit të rrezikut të kredive, kjo politikë ka ndikuar në një rritje më të balancuar të kredisë dhe ka përcjellë stimujt e duhur për konsum e kursime.

Kriza ndërkombëtare e besimit në fillim të tremujorit të katërt të vitit 2008, nxiti tërheqjen e një pjese të depozitave nga bankat e nivelit të dytë në Shqipëri e për rrjedhojë, theksoi mungesën e likuiditetit në sistemin bankar. Kjo gjë u reflektua në rritjen e normave të interesit dhe ngadalësimin e aktivitetit të bankave në tregun e parasë. Banka e Shqipërisë ka ndërhyrë në tregjet monetare nëpërmjet injektimit të likuiditetit, për të mbuluar nevojat e sistemit bankar me likuiditet.

Dinamika e ngjarjeve të vitit 2008 kërkoi përdorimin e të gjitha instrumenteve të tregut të hapur dhe modifikimin e disave prej tyre. Banka e Shqipërisë ka injektuar likuiditet me afate maturimi javore, mujore dhe tremujore. Ajo ka rritur bazën e letrave me vlerë të cilat mund të përdoren si kolateral si dhe ka ulur tavanin e korridorit të normave të interesit të operacioneve të saj. Gjithashtu, në përgjigje të furnizimit më të mirë të tregut me likuiditet, ne kemi ndryshuar tipin e ankandit kryesor të injektimit, nga ankand me shumë fikse në ankand me çmim fiks. Banka e Shqipërisë iu ka krijuar më shumë fleksibilitet bankave në administrimin e likuiditetit afatshkurtër, nëpërmjet rritjes së sasisë së përdorimit ditor të rezervës së detyruar. Të gjitha këto veprime, i kanë shërbyer qetësimit të situatës së likuiditetit dhe minimizimit të impaktit të saj në rritjen e normave të interesit. Ato kanë penguar gjithashtu kontraktimin e bilanceve të bankave tregtare dhe janë reflektuar në zgjerimin e bilancit të Bankës së Shqipërisë.

MBIKËQYRJA DHE RREGULLIMI BANKAR

Viti 2008 përkon me një kujdes në rritje të politikave mbikëqyrëse të Bankës së Shqipërisë. Miratimi i ligjit të ri për sistemin bankar, i dha rrugë miratimit të një pakete të gjerë masash, ku mund të veçoj:

- Në përputhje me ligjin e ri u miratuan kritere të reja për llogaritjen, mbikëqyrjen dhe raportimin e ekspozimeve të mëdha të bankës ndaj bankave mëmë dhe subjekteve të lidhura me të, me qëllim administrimin e rrezikut që rrjedh nga ekspozimi i përqendruar ndaj tyre;
- Për t'i shërbyer një administrimi më efektiv, u hartua një rregullore e re për forcimin e kontrollit të brendshëm në bankat dhe degët e bankave të huaja;
- Bazuar në problematikat e mëparshme një rëndësi e veçantë iu kushtua dhe transparencës për produktet dhe shërbimet bankare e financiare. Ky është një drejtim tjetër ku ndërhymë gjatë vitit 2008. Kërkesat e reja standardizojnë mënyrën dhe formën e dhënies së informacionit për klientët për produktet dhe shërbimet bankare të ofruara;
- Pjesë e paketës së re ishte dhe standardizimi i informacionit të detyrueshëm që bankat dhe degët e bankave të huaja duhet të bëjnë publik, në lidhje me veprimtarinë kryesore të bankës, organizimin dhe drejtimin e saj, në lidhje me ecurinë financiare, në lidhje me gjendjen financiare, në lidhje me administrimin e rrezikut si dhe politikat kontabël;
- Për të diversifikuar më mirë rrezikun që rrjedh nga përqendrimi në investimet e bankave në tregjet financiare ndërkombëtare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, bëri disa modifikime të rregullores për administrimin e rrezikut, duke vendosur kufij më prudencialë të treguesve të ekspozimeve të mëdha dhe në teknikat e llogaritjes dhe njohjes së kolateralit;
- Banka e Shqipërisë ka ndaluar kreditimin e ekonomisë me "para ekzotike", të cilat nënkuptojnë fonde me kosto shumë të lirë, të gatshme për të depërtuar edhe në ekonominë tonë. Më lejoni të kujtoj se në grackën e këtyre fondeve kanë rënë shumë prej ekonomive në zhvillim, të cilat sot po vuajnë seriozisht nga largimi i këtyre fondeve.

Në funksion të rritjes së transparencës, këto masa u diskutuan paraprakisht edhe me sistemin bankar nëpërmjet një forumi të hapur, të mbajtur me përfaqësues të sistemit. Zhvillimet e tregjeve financiare gjatë vitit 2008 evidentuan drejtësinë e masave të marra nga Banka e Shqipërisë. Aksionet e Bankës së Shqipërisë për absorbimin me sa më pak kosto të efekteve të krizës mbarëbotërore janë shtrirë edhe gjatë muajve të parë të vitit 2009.

NISMAT LIGJORE DHE RREGULLATIVE

Gjatë vitit 2008, me miratimin e ligjit për kontratën e riblerjes së titujve, u finalizuan përpjekjet e Bankës së Shqipërisë për të krijuar infrastrukturën e duhur ligjore për zhvillimin e tregut të marrëveshjeve të riblerjes ndërmjet bankave tregtare, duke krijuar mundësinë e përdorimit të këtyre marrëveshjeve si instrumente fleksibël për të siguruar dhe investuar likuiditete në tregun ndërbankar, në funksion edhe të rritjes së efektivitetit të transmetimit të politikës monetare.

Një përmirësim tjetër i rëndësishëm i kuadrit ligjor në fuqi gjatë vitit 2008 ka qenë dhe miratimi i disa amendamenteve në Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, të cilat priten të kenë efekte pozitive në drejtim të

lehtësimit dhe shkurtimit të afateve kohore të procedurave për ekzekutimin e kolateralit të kredive të dhëna nga bankat dhe degët e bankave të huaja.

Gjithashtu, në funksion të përmirësimit të kuadrit rregullator ekzistues në fushën e mbikëqyrjes bankare, me qëllim përshtatjen e tij me kërkesat e ligjit të ri "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" (i cili hyri në fuqi në 01.06.2007) dhe me *Acquis Communautaire* në këtë fushë, në përputhje me angazhimet e ndërmarra në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, gjatë vitit që shkoi Banka e Shqipërisë miratoi disa rregullore lidhur me sistemin e kontrollit të brendshëm dhe transparencën e bankave ndaj publikut, të cilat pritet të kenë impakte pozitive për sa i përket drejtimit, administrimit dhe qeverisjes së përgjegjshme të bankave.

INTEGRIMI EVROPIAN

Në kuadër të integrimit evropian, Banka e Shqipërisë i ka kushtuar vëmendje të madhe përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga MSA për Bankën e Shqipërisë, të cilat lidhen me përmbushjen e kriterit ekonomik të Kopenhagenit për anëtarësim në BE, garantimin e së drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime financiare për bankat dhe institucionet e tjera financiare komunitare, liberalizimin e lëvizjeve të kapitalit dhe pagesave rrjedhëse ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së si dhe përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë komunitar (*Acquis Communautaire*) në këto fusha.

Gjatë vitit 2008, Banka e Shqipërisë ka mbajtur kontakte të rregullta me Ministrinë e Integrimit Evropian dhe ka përcjellë pranë saj raportet mujore të progresit, të cilat pasqyrojnë progresin e arritur në drejtim të realizimit të masave ligjore dhe aktiviteteve zbatuese, në përputhje me afatet e parashikuara në Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së si dhe një përshkrim të shkallës së përputhshmërisë me *acquis*-in të akteve juridike të miratuara nga ana e Bankës së Shqipërisë.

Në kuadër të Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së 2007-2012, Banka e Shqipërisë vijoi punën për nismat ligjore dhe veprimtaritë zbatuese që duhet të ndërmerren nga ana e saj. Kështu, në përputhje me ligjin "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" i cili hyri në fuqi në muajin qershor të vitit 2007, është rishikuar kuadri rregullator i mbikëqyrjes bankare, sidomos në fushën e drejtimit, transparencës dhe kontrollit të brendshëm të bankave.

TRANSPARENCA E BANKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN

Një rëndësi të veçantë në veprimtarinë e përditshme të Bankës së Shqipërisë ka zënë edhe komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun, pasi ajo beson se një komunikim i hapur dhe transparent me publikun ndihmon në rritjen e besueshmërisë dhe të efektivitetit të vendimmarrjes së saj. Banka e Shqipërisë ka zhvilluar një sërë aktivitetesh dhe takimesh me aktorët e sistemit bankar dhe financiar, përfaqësues të ndryshëm të medias dhe akademikë, leksione në klasat e shkollave të mesme dhe auditorët e universiteteve, takime rajonale që kanë mbledhur në një tryezë të përbashkët diskutimi përfaqësuesit e sistemit bankar, të pushtetit vendor, biznesit dhe publikut.

Banka e Shqipërisë ka punuar në dy drejtime kryesore: në përsosjen e transparencës dhe komunikimit me publikun të vendimmarrjes së saj dhe së dyti; në drejtim të rritjes së transparencës të sistemit bankar. Gjatë vitit 2008 Banka e Shqipërisë është përpjekur të rrisë transparencën në lidhje me vendimmarrjen dhe efektet e saj në ekonomi duke shtuar jo vetëm kontaktet fizike dhe rritur numrin e publikimeve, por gjithashtu duke investuar në edukimin e publikut për të rritur kulturën ekonomike në përgjithësi dhe atë financiare në veçanti. Kjo ka synuar të sigurojë përputhshmërinë e vendimmarrjes racionale në nivel mikro me vendimmarrjen e Bankës së Shqipërisë.

Vetëm gjatë vitit 2008:

- janë publikuar mbi 4500 faqe në gjuhën shqipe dhe mbi 2100 faqe në gjuhën angleze;
- janë shpërndarë rreth 80.000 broshura edukative;
- janë zhvilluar seminare të trajnimit për rreth 100 mësues të lëndës së ekonomisë;
- janë zhvilluar takime me rreth 2000 nxënës të shkollave e mesme;
- është zhvilluar konkursi "Vlera e Vërtetë e Parasë" në Tiranë e Vlorë;
- janë organizuar 44 konferenca, seminare, takime diskutimi, forume dhe tryeza pune;
- janë organizuar 5 seminare trainuese me gazetarët e fushës së ekonomisë të medias së shkruar dhe vizive.

Gjithashtu është rritur "Transparenca e Vendimmarrjes" përmes dhënies së sinjaleve mbi tendencat e ardhshme të vendimeve të politikës monetare, duke krijuar një model komunikimi standard që lejon publikun të perceptojë kahun e vendimeve të ardhme të politikës monetare.

"Transparenca e Zhvillimeve Ekonomike" është rritur përmes publikimit të tendencave të pritshmërive inflacioniste të gjeneruara nga parashikimet dhe analizat e bazuara në modelet empirike të Bankës së Shqipërisë si dhe zgjatja e periudhës parashikuese nga 12 në 24 muajt e ardhshëm. Gjithashtu, është shumë e rëndësishme të përmendet se në kuadrin e transparencës së sistemit bankar janë përgatitur një sërë masash rregullative që kanë synuar rritjen e transparencës ndaj klientit dhe si rrjedhojë, mbrojtjen e konsumatorit.

REZULTATI FINANCIAR

Banka e Shqipërisë ka zhvilluar aktivitetin e saj ekonomik dhe financiar në përputhje me ligjet në fuqi. Bilancet e saj janë monitoruar në vazhdimësi dhe janë audituar nga KPMG, e cila ka certifikuar vërtetësinë e tyre në përputhje me politikat kontabile të përshtatura nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

Gjatë vitit 2008, aktivet e bilancit të Bankës së Shqipërisë janë rritur me 60.1 miliardë lekë ose rreth 23 për qind. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së rezervës valutore të Bankës së Shqipërisë dhe të operacioneve të saj për injektim likuiditeti në lekë. Gjatë vitit 2008, Banka e Shqipërisë ka patur një fitim neto prej rreth 9.3 miliardë lekësh.

3 SFIDAT E TË SOTMES DHE TË SË ARDHMES

Ashtu siç e theksova në shumë momente të fjalës time, ekonomia shqiptare po vihet gjithnjë e më shumë nën ndikimin e krizës botërore. Pasiguria që përcolli tronditja e sistemit financiar botëror u reflektua në tërheqjen e një pjese të depozitave nga sistemi, duke sjellë probleme likuiditeti në të dhe tendenca për rritjen e normave të interesit. Kjo situatë ka ndikuar në mënyrë të natyrshme në uljen e mundësisë dhe gatishmërisë së sistemit për të kredituar ekonominë.

Nga ana tjetër, zhvillimet e ekonomisë globale sugjerojnë se ekonomia shqiptare duhet të përballohet me një reduktim të nivelit të remitancave dhe të hyrjeve kapitale gjatë vitit 2009. Këto zhvillime përbëjnë një reduktim të mëtejshëm të mundësive të financimit të aktivitetit ekonomik si dhe dëmtojnë balancat e kërkesës dhe ofertës për valutë. Ato janë shoqëruar me lindjen e presioneve nënçmuese ndaj kursit të këmbimit, ashtu si dhe në ekonomitë e shumë vendeve të tjera të Evropës Lindore. Në vetvete, ky nënçmim përbën një sjellje korrektuese, në kushtet e regjimit fleksibël të kursit të këmbimit që aplikohet në Shqipëri.

Në optikën e Bankës së Shqipërisë, problemi kryesor me të cilin do të përballet ekonomia shqiptare gjatë vitit në vijim është mungesa e likuiditetit dhe, i lidhur me të, shtrëngimi i kushteve të financimit të aktivitetit. Ashtu siç e kemi theksuar edhe në dalje tona të tjera publike, ky kufizim duhet të njihet dhe të faktorizohet në planet e biznesit të të gjithë agjentëve ekonomikë. Ekonomia shqiptare do të përfitojë më pak kredi gjatë vitit 2009. Kjo mungesë likuiditeti kufizon edhe hapësirat që ka politika fiskale dhe monetare për reagim. Në këto rrethana, ajo që kërkohet është një eficiencë më e madhe e përdorimit të fondeve të sistemit bankar, nëpërmjet renditjes prioritare të shpenzimeve në funksion të impaktit që kanë mbi rritjen ekonomike.

Për më tepër, Banka e Shqipërisë gjykon se sjellja e deficitit të llogarisë korente duhet të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme. Barazimi i këtij deficiti me hyrjet e reduktuara të llogarisë kapitale, duhet të jetë një prioritet tjetër i zhvillimit të politikave ekonomike. Sikurse e theksova dhe më parë, ky moment kushtëzon ndjeshëm ekuilibrat makroekonomikë dhe financiarë të vendit. Për këtë arsye, ai do të jetë në vëmendjen e vazhdueshme të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë.

I nderuar z. Kryetar i Komisionit,
Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Problemet aktuale me të cilat përballet ekonomia shqiptare nuk kanë origjinuar në Shqipëri; për këtë arsye, zgjidhja e tyre do të varet në një masë të madhe nga përmirësimi i aktivitetit ekonomik në nivel botëror.

Stabiliteti makroekonomik i vendit ka amortizuar ndikimin e krizës ekonomike e financiare globale në aktivitetin ekonomik në vend. Ky stabilitet

i shprehur në: inflacion të ulët të çmimeve të konsumit; qëndrueshmëri të bilancit të pagesave dhe të borxhit publik; bilance të shëndosha të agjentëve ekonomikë; luhatje të ulta të tregut financiar; dhe besim të publikut në institucionet financiare, është një kapital i madh i ekonomisë shqiptare. Ai është përftuar me punë dhe sakrifica gjatë viteve të shkuara, prandaj Banka e Shqipërisë gjykon se vëmendja jonë nuk duhet të shkëputet nga ruajtja dhe konsolidimi i mëtejshëm i tij edhe në këto momente sfide për të gjithë ne. Dinamizmi i sektorit privat të ekonomisë shqiptare kërkon kushte afatgjata të favorshme ekonomike dhe financiare, si dhe struktura transparente tregjesh konkurrenciale, për të çliruar në mënyrë të plotë potencialin e tij.

Vetëm vendet të cilat kanë ditur të ngrihen dhe t`i përgjigjen këtyre goditjeve, kanë mundur të rriten e të begatojnë në një periudhë afatgjatë. Përvetësimi i këtij mësimi kërkon një renditje të qartë të prioriteteve të zhvillimit, ndarjen e interesit afatgjatë të zhvillimit të vendit nga synimet afatshkurtra si dhe vullnetin politik për realizimin e tyre.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z.ARDIAN FULLANI

Në prezantimin e Raportit Vjetor për vitin 2008 në Kuvendin e Shqipërisë
16 prill 2009

E nderuar zonja Kryetare!
Të nderuar deputetë!

Në zbatim të detyrimit ligjor është një nder dhe privilegj i veçantë që të prezantoj para jush raportin e Bankës së Shqipërisë për aktivitetin e ushtruar prej saj në vitin 2008. Përfitoj nga ky rast që të shpreh falenderimet e mija në lidhje me mbështetjen dhe mirëkuptimin që Kuvendi i Shqipërisë i ka dhënë institucionit që unë drejtoj.

Viti 2008 na përballi me një situatë komplekse në rrafshin global. Veçanërisht duke filluar nga muaji shtator, një varg ngjarjesh të pajetuara më parë tronditën infrastrukturën financiare të SHBA-ve. Integrimi i madh i tregut financiar kishte mundësuar shpërndarjen e produkteve të infektuara në të gjithë botën e zhvilluar, përfshirë dhe ekonomitë në rritje të Azisë. Shumë shpejt, ekonomia botërore u gjend në një konfuzion të përgjithshëm si pasojë e të cilit besimi i publikut mbi sistemin financiar u dëmtua rëndë. Çmimet në të gjitha bursat kryesore filluan të binin me shpejtësi, ndërkohë që bankat më të mëdha raportonin humbje të konsiderueshme.

Shumë institucione financiare me histori shekullore u rrënuan, duke i detyruar autoritetet të ndërmarrin një sërë veprimesh shpëtimi. Qeveritë dhe bankat qendrore të vendeve të zhvilluara, përfshirë dhe organizmat ndërkombëtarë të specializuar, adoptuan një sërë masash emergjente. Me qëllim kthimin e besimit publik tek sistemi bankar, përveç injektimit të likuiditetit u gjykua i arsyeshëm edhe injektimi i kapitaleve apo blerja e aktiveve të infektuara nëpërmjet fondeve publike.

Globalizimi i krizës dëmtoi rëndë tregtinë botërore duke u përhapur me shpejtësi edhe në vendet në zhvillim dhe në ato me të ardhura të ulëta.

Vendet në zhvillim po përjetojnë një përkeqësim të kushteve financiare, shtrëngim të kreditimit, presione mbi kursin e këmbimit si dhe njëkohësisht rënie të konsiderueshme të kërkesës për degë mjaft të rëndësishme të aktivitetit ekonomik. Në fund të vitit 2008 dhe në fillim të 2009-ës, disa prej vendeve në zhvillim, anëtare të reja të Bashkimit Evropian, pësuan goditje të rënda. Hungaria, Rumania, Bullgaria, vendet Baltike, përfshirë dhe shtete të tjera si Ukraina, Serbia, Bjellorusia e ndonjë tjetër, të ballafaquara me një krizë të përgjithshme të bilancit të pagesave iu drejtuan Fondit Monetar Ndërkombëtar për ndihmë të menjëhershme.

Fundi i vitit 2008 dhe muaji janar i 2009-ës konfirmuan përfundimisht

kontraktimin e aktivitetit ekonomik në ekonomitë e SHBA, Gjermanisë, Italisë, Britanisë dhe të Japonisë. Tregjet ndërkombëtare vazhdojnë të luhaten ndjeshëm duke shtuar pasigurinë dhe paqartësinë midis pjesëmarrësve në to. E ardhmja mbetet ende me shumë pikëpyetje pavarësisht përpjekjeve të shumta në rrafshin global. Një përpjekje e tillë ishte dhe takimi i Londrës ku udhëheqësit e 20 vendeve më të zhvilluara vendosën të krijojnë një fond prej 1,1 trilionë dollarësh amerikanë për të stimuluar aktivitetin ekonomik në rang botëror, përfshirë dhe ndihmën për vendet e varfra nëpërmjet forcimit të rolit të Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Situata që përshkrova më sipër të lë të kuptosh presionin e madh që gjeneron ekonomia botërore në përgjithësi dhe ajo e vendeve partnere në veçanti, mbi ekonominë ende të brishtë, të vendit tonë. Në daljet e mija në publik, në deklaratat për shtyp të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë si dhe në dokumentet e tjera zyrtare të institucionit, në vazhdimësi është folur për zhvillimet ndërkombëtare dhe ndërlikimet që ato mund të shkaktojnë në aktivitetin e ekonomisë tonë.

Në përgjithësi, ekonomia shqiptare ka treguar një shkallë të lartë rezistence ndaj fenomeneve që karakterizuan zhvillimet globale në tremujorin e fundit të vitit 2008. Imunitet të lartë tregoi edhe sistemi bankar shqiptar, i cili nuk manifestoi shenja paniku dhe konfuzioni. Disa ekspertë e kanë vlerësuar Shqipërinë si vend me fat, ndërkohë që disa të tjerë e kanë gjetur shkakun tek një integrim i vogël i ekonomisë shqiptare me ekonominë globale.

Banka e Shqipërisë mendon se arsyeja kryesore ka të bëjë me vëmendjen e madhe që i kemi kushtuar këto vitet e fundit stabilitetit financiar të sistemit bankar. Ekonomia shqiptare është e integruar po aq sa janë të integruara edhe ekonomitë e tjera të Ballkanit, disa prej të cilave tashmë janë dorëzuar. Më lejoni ta shtjelloj pak më tej këtë konstatim.

Sistemi bankar shqiptar mund të konsiderohet si zgjatim i sistemit bankar të vendeve më të zhvilluara evropiane. Rreth 80 për qind e aktiveve të sistemit i përket grupeve bankare që i kanë selitë qendrore në vendet e Eurozonës, për më tepër të shtrira në të gjithë rajonin tonë e më gjerë.

Shtrirja e grupeve bankare të njëjta në shumë vende bëri që politikat e kreditimit, të grumbullimit të depozitave, të ishin të ngjashme për të gjitha këto vende. Për rrjedhim, ekspozimi ndaj rreziqeve që imponin këto politika ishte i njëjtë si për Shqipërinë, ashtu dhe për Bullgarinë, Rumaninë apo Serbinë. Në këtë këndvështrim, mund të thuhet se integrimi financiar i vendit ka qenë i njëjtë me vendet e tjera të rajonit përsa i përket numrit të operatorëve, llojit të tyre dhe produkteve që ato ofronin.

Ashtu si shumica e vendeve të tjera edhe Shqipëria pati gradimin e rradhës kur në vitin 2006 një nga agjencitë e njohura e vlerësoi Shqipërinë me notën B1, vlerësim i cili ishte i njëjtë edhe për vitin 2008. Një vlerësim i ngjashëm ka qenë edhe për vendet e tjera të rajonit, duke bërë që perceptimi i rrezikut të vendit nga ana e investitorëve të huaj të ishte pak a shumë i njëjtë.

Kjo konfirmohet edhe nga blerja e borxhit të brendshëm prej institucioneve të huaja financiare. Në shtesë, dëshiroj të theksoj se edhe veprimet në llogarinë kapitale veçanërisht nga këndvështrimi i investitorëve të huaj janë tërësisht të liberalizuara, duke mos krijuar pengesa për hyrjen dhe daljen e kapitaleve.

Rritja e transaksioneve me jashtë është një tjetër tregues rreth shkallës së hapjes së vendit ndaj pjesës tjetër të botës. Eksportet dhe importet kanë regjistruar ritme të larta nga njëri vit në tjetrin duke bërë që aktiviteti tregtar i vendit të rritet ndjeshëm. Rreth 80 për qind e këtij aktiviteti tregtar zhvillohet me vendet e Eurozonës, ku si partnerë kryesorë spikasin Italia me Greqinë. Thellimi i fortë i deficitit tregtar nga njëri vit në tjetrin ishte një shenjë tipike e të ashtuquajturit proces i përafrimit të shpejtë.

Ky fenomen ka qenë karakteristika kryesore e zhvillimit të të gjitha vendeve të Evropës Lindore që u anëtarësuan vitet e fundit në BE, përfshirë dhe shumicën e vendeve të Ballkanit Jugperëndimor, ku bën pjesë edhe vendi ynë.

Argumentet që parashtrova më sipër besoj se janë të mjaftueshme për të kuptuar se nuk kemi qenë as me fat dhe as të pazhvilluar apo në periferi të zhvillimeve globale. Ajo që ka dalluar sistemin financiar shqiptar nga një sërë sistemesh të vendeve të rajonit kanë qenë treguesit e tij të performancës dhe të shëndetit, të cilët i detyrohen në një masë të madhe punës dhe masave të Bankës së Shqipërisë. Politikat dhe vendimet që kemi miratuar këto vitet e fundit kanë marrë formën e platformave të ndryshme për të administruar me kujdes situatat me të cilat jemi përballur në rrjedhën e kohës.

Në vlerësimin tim dëshiroj të theksoj se vendimet e marra, që nga viti 2006 deri në muajin gusht 2008, në fushën e politikës monetare dhe në atë të mbikëqyrjes bankare kanë krijuar platformën e imunitetit. Vendimet e adoptuara në vjeshtën e vitit 2008 e deri në ditët e sotme përbëjnë platformën e absorbimit të efekteve të krizës. Njëkohësisht Banka e Shqipërisë po punon intensivisht edhe për platformën e tretë: Platformën e rigjallërimit.

Më lejoni të nderuar deputetë të ndalem shkurtimisht në secilën prej tre platformave që përmenda më sipër.

PLATFORMA E IMUNITETIT

Në një kontekst të përgjithshëm vlerësoj se imuniteti i ekonomisë tonë ka të bëjë me kursimet e mëdha të shqiptarëve, të materializuara në formën e depozitave dhe në vendosmërinë e Bankës së Shqipërisë për të ndaluar në mënyrë administrative penetrimin e disa produkteve, të cilat në vende të tjera kanë rezultuar fatale.

Në një këndvështrim më analitik po ndalem në aksionet tona në të kaluarën, të cilat i vlerësoj si terapinë imunizuese ndaj zhvillimeve aktuale.

Së pari, dëshiroj të sjell në vëmendjen tuaj vendimet e politikës monetare në periudhën korrik 2006 – nëntor 2007, gjatë së cilës norma bazë e interesit u rrit pesë herë duke arritur nivelin 6.25 për qind. Ky nivel mbeti i pandryshuar edhe gjatë vitit 2008. Motivimi ynë kryesor, ishte i lidhur me mbinxehjen e ekonomisë që kryesisht pasqyronte rritjen e madhe të kërkesës së brendshme si rezultat i ekspansionit të kredisë për ekonominë. Sot, Banka e Shqipërisë vlerëson se shtrëngimi i politikës monetare ka qenë një amortizues efektiv në kontrollin e kërkesës së brendshme në ekonomi, duke ndikuar drejtpërdrejt në kanalin e kredisë për ekonominë.

Në përgjithësi, Banka e Shqipërisë vlerëson se ambienti i përgjithshëm makroekonomik ka qenë i shëndetshëm këto katër vitet e fundit, përfshirë edhe vitin 2008. Duke bërë një analizë të përmbledhur të këtyre zhvillimeve, edhe pse jemi ende në pritje të konfirmimeve nga statistikat zyrtare, Banka e Shqipërisë gjykon se ekonomia e vendit është rritur në linjë me parashikimet e fillimvitit.

Kjo rritje ka reflektuar zhvillimin dinamik të disa sektorëve të ekonomisë, të mbështetur nga rritja e konsumit dhe e investimeve në ekonomi si dhe përmirësimet e vazhdueshme strukturore dhe infrastrukturore të ekonomisë.

Rritja ekonomike në vend është mbështetur kryesisht në rritjen e shpejtë të kërkesës së brendshme, e cila mbetet edhe gjeneratori kryesor i rritjes ekonomike. Konsumi, investimet dhe shpenzimet qeveritare kanë shënuar rritje gjatë vitit 2008. Kërkesa e jashtme në formën e eksporteve, ka shënuar rritje të shpejtë gjatë viteve të fundit, por ajo mbetet ende në nivele të ulta për të mbështetur rritjen ekonomike të vendit. Aktiviteti ekonomik në vend është financuar kryesisht nga burime të brendshme. Në sajë të likuiditetit të tij të lartë gjatë vitit 2008, sistemi bankar shqiptar ka mundur t`i përgjigjet kërkesës për fonde të ekonomisë me rritje të ndërmjetësimit financiar. Gjatë vitit 2008, portofoli i kredisë bankare u rrit me 7.3 pikë përqindjeje të PBB-së.

Banka e Shqipërisë ka përmbushur objektivin e saj ligjor për ruajtjen stabilitetit të çmimeve në ekonomi. Norma mesatare e inflacionit vjetor shënoi vlerën 3.4 për qind gjatë vitit 2008, duke qenë mjaft afër objektivit të Bankës së Shqipërisë prej 3 për qind dhe brenda intervalit tonë të tolerancës prej 2-4 për qind. Niveli i kontrolluar i inflacionit reflekton kushtet e përshtatshme monetare dhe politikën e drejtë monetare të Bankës së Shqipërisë. Kjo e fundit ka bërë të mundur balancimin e faktorëve të kërkesës dhe të ofertës si dhe ka mundësuar ankorimin e pritjeve inflacioniste rreth objektivit të Bankës së Shqipërisë.

Politika fiskale ka patur një karakter më ekspansionist gjatë vitit 2008. Deficiti buxhetor për vitin 2008, vlerësohet të ketë arritur në 5.7 për qind të PBB-së, duke u thelluar me rreth 2.2 pikë përqindjeje në terma vjetorë. Niveli i borxhit publik shënoi rritje gjatë vitit 2008, duke arritur në 55.6 për qind të PBB-së nga 52.2 për qind një vit më parë. Përmirësimi i administrimit të borxhit publik në drejtim të zgjatjes së afatit të maturimit dhe të diversifikimit të burimeve të financimit është zhvillim pozitiv që ka ndihmuar rifinancimin e borxhit dhe kontrollin e impaktit të kostos së tij në treguesit e buxhetit.

Viti 2008 u karakterizua nga një rritje e ndjeshme e shkëmbimeve ekonomike e tregtare me jashtë. Kërkesa e brendshme është reflektuar në rritjen e deficitit tregtar dhe të deficitit të llogarisë korente gjatë vitit 2008. Deficiti i llogarisë korente arriti në 14.9 për qind të PBB-së, i ndikuar kryesisht nga rritja e shpejtë e importeve dhe nga ngadalësimi i remitancave përgjatë pjesës së dytë të vitit. Megjithatë, flukset hyrëse valutore të llogarisë kapitale kanë qenë të mjaftueshme për ta mbyllur në terma pozitivë bilancin e pagesave gjatë vitit 2008. Rezervat valutore të Bankës së Shqipërisë janë rritur me rreth 192 milionë euro ose me 0.9 pikë përqindjeje të PBB-së.

Si pasojë e ngadalësimit të vënë re gjatë tremujorit të fundit, zgjerimi monetar paraqitet më i moderuar në krahasim me vitin paraardhës. Ritmi mesatar i rritjes vjetore të agregatit monetar M3 shënoi vlerën 12.3 për qind, përkundrejt vlerës 15.8 për qind të shënuar gjatë vitit 2007. Rritja e mjeteve monetare të ekonomisë i detyrohet kryesisht rritjes së kredisë së sistemit bankar. Shkalla e ndërmjetësimit financiar në ekonomi është rritur më tej gjatë vitit 2008.

Raporti i depozitave në sistemin bankar ndaj PBB-së u rrit në 80 për qind gjatë vitit 2008, krahasuar me nivelin 78 për qind të shënuar gjatë vitit 2007. Ecuria e depozitave është karakterizuar nga luhatje të theksuara sezonale. Niveli i depozitave ka shënuar ritme të larta rritjeje kryesisht gjatë muajve të verës dhe një ngadalësim të dukshëm gjatë tremujorit të fundit. Në anën e aktivit, portofoli i kredisë së sistemit bankar për ekonominë është rritur me rreth 35 për qind gjatë vitit 2008. Zhvillimet në strukturën valutore të kredisë gjatë vitit 2008, treguan një zhvendosje të lehtë të portofolit të kredisë drejt asaj në valutë. Ritmi i rritjes së kredisë ka ardhur në rënie gjatë vitit, duke reflektuar si shtrëngimin e standardeve të kredidhënies në përgjigje të masave rregulluese të marra nga Banka e Shqipërisë, ashtu edhe shtrëngimin e kushteve të likuiditetit në sistem.

Tregjet financiare në Shqipëri, përveç zhvillimeve ekonomike në vend, kanë reflektuar edhe zhvillimet e vrullshme në tregjet financiare ndërkombëtare. Në këto kushte, ato janë karakterizuar nga një luhatshmëri më e lartë e treguesve të tyre, likuiditetit, normave të interesit, vëllimit të tregtimit dhe kursit të këmbimit, por duke mbetur gjithsesi brenda parametrave normalë të operimit.

Në një vështrim të përgjithshëm normat e interesave për depozitat kanë treguar prirje rritëse, si për monedhën vendase ashtu dhe për atë në euro. Në të kundërt, interesat e kredive kanë shfaqur prirje rënëse gjatë vitit 2008, duke sjellë edhe uljen e kostos së ndërmjetësimit të sistemit bankar. Në veçanti, pozitive është evidenca e fundit për rritjen e vëmendjes drejt kreditimit në lekë dhe rritjen e konkurrencës nëpërmjet normave të interesit në këtë treg.

Në pjesën më të madhe të vitit, kursi i këmbimit të lekut kundrejt valutave ka qenë i qëndrueshëm, ndërkohë që ai ka filluar një nënçmim të lehtë në fund të periudhës. Kjo ecuri është rezultante e natyrshme e stabilitetit makroekonomik

të vendit, bilancit pozitiv të pagesave, ankorimit të inflacionit pranë objektivit të Bankës së Shqipërisë, përafrimit të këtij indikatori me atë të Eurozonës si dhe diferencës pozitive të normave të interesit.

Së dyti, do të evidentoja periudhën relativisht të gjatë të konsolidimit të vazhdueshëm të sistemit bankar, ku karakteristikë ka qenë shëndoshja e vazhdueshme financiare e tij. Viti 2008 u karakterizua nga zhvillime intensive në sistemin bankar shqiptar. Aktiviteti bankar njohu rritje të mëtejshme gjatë vitit, si në aspektin sasior të mbulimit gjeografik të vendit dhe të shkallës së ndërmjetësimit, ashtu edhe në treguesit cilësorë të gamës së shërbimeve të ofruara dhe të kostos së ndërmjetësimit. Ndërkohë, tërheqja e depozitave gjatë tremujorit të fundit testoi ndjeshëm qëndrueshmërinë e sistemit. Zhvillimet e kësaj periudhe dëshmuan se sistemi bankar shqiptar e kaloi me sukses provën e tij të parë të qëndrueshmërisë.

Megjithëse me ritme më të moderuara, aktivet dhe burimet e sistemit u rritën më tej gjatë vitit 2008. Analiza e treguesve të sistemit dëshmon për një nivel në rritje të rrezikut dhe zvogëlim të kapacitetit të tij financiar përgjatë vitit. Performanca e sistemit bankar për vitin 2008 ka shënuar rënie, vlerësuar në këndvështrimin e ecurisë së rezultatit neto. Kjo ka reflektuar si rritjen e konkurrencës në sistem, ashtu edhe rritjen e shpejtë të shpenzimeve për provigjone, veçanërisht në gjysmën e dytë të vitit.

Gjithsesi, luhatshmëria dhe performanca jo e mirë e disa prej treguesve kryesorë, nuk kanë vënë në rrezik nivelin e kapitalit rregullator të nevojshëm për mbulimin e rreziqeve të marra nga sistemi bankar. Niveli i treguesve të sipërpërmendur nuk konsiderohet të jetë kritik, por dinamika dhe intensiteti i zhvillimeve kërkojnë monitorim më të kujdesshëm edhe në vijimësi.

Së treti, do të doja të vija theksin në sensibilitetin e treguar dhe në rregullimet e bëra në fushën e mbikëqyrjes bankare gjatë kësaj periudhe. Në vitin 2006, për herë të parë konferenca vjetore e Bankës së Shqipërisë iu kushtua tërësisht problemeve të stabilitetit financiar parë nga një këndvështrim rajonal. Së bashku me të gjithë guvernatorët e rajonit u arrit në konstatimin se një numër i vogël bankash po zgjeroheshin me shpejtësi në të gjithë rajonin edhe pse korniza që rregullonte kuadrin mbikëqyrës midis bankave në vendin e origjinës me bankat e tyre bija, nuk ishte ende e plotësuar.

Në 1 qershor 2007 hyri në fuqi ligji "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i cili paraqet fazën e parë të përfarimit të legjislacionit shqiptar me *Acquis Communautaire* në përputhje me angazhimet e ndërmarra në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit. Ligji parashikon parime dhe rregulla më të qartë për administrimin e rreziqeve me të cilat mund të përballen bankat gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, duke synuar mbrojtjen e depozituesve, të investitorëve si dhe ruajtjen e stabilitetit të sistemit bankar.

Në datën 31 dhjetor 2007, krijohet Regjistri i Kredive, një zhvillim i rëndësishëm infrastrukturor.

Nëpërmjet tij u krijua një instrument shtesë dhe mjaft i dobishëm për të thelluar më tej analizën në drejtim të: cilësisë së portofolit, evidentimit të përqendrimeve të kredisë sipas bankave dhe subjekteve kredimarrëse, vlerësimit të detajuar të ekspozimit të bankave dhe të subjekteve kredimarrëse ndaj financimit sipas monedhave, vlerësimit të detajuar të llojit të kolateraleve dhe të garancive të përdorura si dhe evidentimit të lidhjeve që ekzistojnë midis subjekteve të ndryshme kredimarrëse.

Për herë të parë në Raportin Vjetor të Bankës së Shqipërisë për aktivitetin e ushtruar prej saj në vitin 2007, citohet se "Banka e Shqipërisë vlerëson që situata e vështirë që po kalojnë tregjet ndërkombëtare financiare, përfaqëson një element të ri rreziku për sistemin financiar shqiptar. Megjithatë, për aq kohë sa ajo nuk shndërrohet në një krizë financiare globale me pasoja në ekonominë reale botërore dhe veçanërisht atë evropiane, do të jetë relativisht e pandjeshme për tregun e brendshëm.".

Nisur nga ky shqetësim në pranverën e vitit 2008 në një ballafaqim të hapur me sistemin bankar u hodh për diskutim një paketë përmirësimesh rregullative, me orientim të përgjithshëm adoptimin e politikave më konservatore në disa drejtime kryesore të administrimit të përditshëm të biznesit bankar. E gjithë nevoja për ndryshim buronte nga zbatimi i ligjit të ri "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", nga ecuria e kredisë për ekonominë, veçanërisht asaj në valutë si dhe nga zhvillimet e verifikuara në tregjet financiare ndërkombëtare në mesin e vitit 2007 dhe në tremujorin e parë të vitit 2008.

Lançimi i kësaj nisme në muajin prill i la vendin një debati të hapur mes nesh dhe bankave të sistemit. Asimilimi i mirë nga ana e sistemit bankar, i këtyre ndryshimeve u gjykua jashtëzakonisht i rëndësishëm. Ky proces konsultimesh u finalizua me miratimin e kësaj pakete nga ana e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, në muajin gusht 2008.

Më konkretisht u miratuan disa ndryshime në rregulloret ekzistuese:

- "Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e degëve të bankave të huaja".
- "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit".
- "Për administrimin e rrezikut të kredisë".

Si dhe njëkohësisht u miratuan rregulloret e reja:

- "Për kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat dhe degët e bankave të huaja".
- "Për disa kritere bazë për qeverisjen e bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe administratorët e tyre".
- "Për sistemin e kontrollit të brendshëm në banka dhe degët e bankave të huaja".
- "Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare".

PO SI DO TË PËRKTHEHEJ NË TERMA MË TË THJESHTË KJO TERAPI?

- Në përputhje me ligjin e ri "Për bankat në Republikën e Shqipërisë"u përcaktuan limite të reja sasiore për llogaritjen, mbikëqyrjen dhe raportimin e ekspozimeve të mëdha të bankës ndaj bankave mëmë dhe subjekteve të lidhura me të. Në mënyrë më të thjeshtë bankat që operojnë në Shqipëri, me qëllim minimizimin e rrezikut që rrjedh nga ekspozimi i përqendruar ndaj selive të tyre qendrore ose bankave mëmë siç quhen ndryshe, nuk mund të kapërcejnë një kufi të caktuar të fondit të themelimit.
- Duke marrë shkas nga situata ndërkombëtare, për të diversifikuar më mirë rrezikun që rrjedh nga përqendrimi në investimet e bankave në tregjet financiare ndërkombëtare, u vendosën kufij më të ulët për ekspozimet e mëdha të bankave. Përmirësime iu bënë si teknikave të llogaritjes së këtyre ekspozimeve ashtu dhe klasifikimit të aktiveve financiare që do të shërbejnë kolateral.
- Për t'i shërbyer një administrimi më efektiv të aktivitetit bankar, u përgatit infrastruktura ligjore për një kontroll të brendshëm aktiv dhe të përgjegjshëm në bankat dhe degët e bankave të huaja që operojnë në Shqipëri. Në këtë akt, kontrolli i brendshëm konsiderohet si pjesë integrale e qeverisjes së bankave. Për këtë arsye, në rregullore sanksionohen parimet bazë për një kontroll të pavarur, të paanshëm dhe të përgjegjshëm. Kontrolli i brendshëm duhet të mbulojë çdo qelizë të bankës në mënyrë që të kthehet në një parandalues i mbarsjes dhe zhvillimit të fenomeneve të padëshiruara.
- Qeverisja e përgjegjshme është një nga parimet bazë të zhvillimit të qëndrueshëm të një biznesi. Kjo bëhet më e domosdoshme në rastin e institucioneve financiare, suksesi i të cilave përpos të gjithave varet nga besimi që publiku ka tek ato. Për këtë qëllim, Banka e Shqipërisë e vlerëson thelbësore cilësinë e burimeve njerëzore, duke nënkuptuar rekrutimin e profesionistëve në vendimmarrje dhe administrimin e rrezikut. Përqendrimi *de facto* i vendimmarrjes në duar të pakta, është një praktikë e dëmshme. Akti i ri përcakton përgjegjësitë dhe detyrat e strukturave drejtuese të institucioneve bankare. Janë këto struktura që përgjigjen dhe garantojnë funksionimin e sigurtë dhe të shëndoshë të institucioneve që drejtojnë.
- Bazuar në problematikat e mëparshme një rëndësi e veçantë iu kushtua dhe transparencës për produktet dhe shërbimet bankare e financiare. Kërkesat e reja ligjore sdandardizojnë mënyrën dhe formën e dhënies së informacionit për klientët, për produktet dhe shërbimet bankare të ofruara. Theks i veçantë i është vënë publikimit të detyrueshëm të normave efektive të interesit të depozitave dhe kredive. Nëpërmjet këtij informacioni klientët e bankës mund të njihen me metodën e llogaritjes së normës efektive të interesit për kreditë, elementet e kontratës së kredisë dhe depozitave, me marketingun e produkteve dhe shërbimeve, ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave të klientit, trajtimin e ankesave të këtij të fundit si dhe krijimin e strukturave të

veçanta lidhur me këto ankesa.

- Pjesë e paketës së re ishte dhe standardizimi i informacionit të detyrueshëm që bankat dhe degët e bankave të huaja duhet të bëjnë publik, në lidhje me veprimtarinë kryesore të bankës, organizimin dhe drejtimin e saj, në lidhje me ecurinë financiare, në lidhje me gjendjen financiare, në lidhje me administrimin e rrezikut si dhe me politikat kontabël.

Së katërti, dëshiroj të sjell në vëmendjen tuaj se miratimi i një akti rregullativ nuk nënkupton automatikisht zbatim të tij në praktikë. Për këtë qëllim, burimet njerëzore të specializuara të Bankës së Shqipërisë, përfshirë dhe drejtuesit e saj kanë qenë në kontakte të vazhdueshme me drejtuesit e sistemit bankar, me këshillat mbikëqyrës të bankave, me drejtuesit e lartë të selive qendrore si dhe me drejtues të institucioneve mbikëqyrëse në vendet ku e kanë origjinën bankat mëma.

Që prej një periudhe 3 – 4-vjeçare janë ndërtuar ura komunikimi me autoritetet përkatëse të çdo vendi të rajonit, me synimin për të kuptuar:

- përmasat e sistemit tonë në raport me atë të vendeve fqinje;
- operatorët që mbizotërojnë tregjet dhe mbulimin gjeografik;
- produktet që ofrohen, nivelin e shërbimit dhe politikat e komisionimit;
- politikat monetare dhe skemat e mbikëqyrjes;
- marrëdhëniet me autoritetet mbikëqyrëse të bankave mëma;
- statusin e marrëdhënieve dhe perspektivat e bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare.

Në përfundim të gjithë këtij procesi të pandërprerë bashkëpunimi dhe investigimi kemi arritur në përfundime, të cilat shpesh herë na kanë vënë në pozita të ballafaqimit me ide dhe praktika të kundërta nga ato tonat.

Fryt i këtij procesi ishte këmbëngulja jonë për të ndaluar në mënyrë administrative kreditimin e ekonomisë me të ashtuquajturat "para ekzotike".

Vitet e fundit u bë i modës kreditimi në monedhën zvicerane apo atë japoneze, fonde të cilat për kohën përfaqësonin kredi me kosto shumë të lirë, të gatshme për të depërtuar edhe në ekonominë tonë. Për aq kohë sa kjo veprimtari gjykohej me rrezik të lartë, në kushtet kur përfituesit e kredisë apo bankat nuk krijonin mbrojtjen e duhur, u pa e arsyeshme të bllokohej administrativisht akordimi i kredive nga ana e sistemit bankar për klientët, në këto dy lloj monedhash. Mendoj se kështu kemi kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe në frenimin e hyrjeve valutore afatshkurtra të kapitalit nga bankat mëmë tek bankat bija, në formën e linjave të kredisë.

Më lejoni të kujtoj se në grackën e këtyre fondeve kanë rënë shumë prej ekonomive në zhvillim, të cilat sot po vuajnë seriozisht nga nevoja për të rifinancuar borxhet në këto monedha.

PLATFORMA E ABSORBIMIT TË KRIZËS

Shpërthimi i krizës financiare në vjeshtën e vitit 2008 e përhapur në shumë vende të botës si krizë besimi, pati ndikimin e saj edhe në sistemin bankar shqiptar. I ballafaquar me një hezitim të arsyeshëm të individëve, sistemi bankar u përball me një rrjedhje depozitash përgjatë gjithë periudhës tetor – dhjetor 2008. Megjithatë, kapitalizimi shumë i mirë dhe situata e kënaqshme e likuiditetit mundësuan përballimin e kësaj situate.

Aktualisht, ekonomia shqiptare po vihet gjithnjë e më shumë nën presionin e krizës botërore.

Pasiguria që përcolli tronditja e sistemit financiar botëror siç shpjegova më sipër u reflektua në tërheqjen e një pjese të depozitave nga sistemi, duke sjellë probleme të likuiditetit dhe tendenca për rritjen e normave të interesit. Kjo situatë ka ndikuar në mënyrë të natyrshme në uljen e mundësisë dhe gatishmërisë së sistemit për të kredituar ekonominë.

Nga ana tjetër, zhvillimet e ekonomisë globale sugjerojnë se ekonomia shqiptare do të përballet me një reduktim të prurjeve valutore gjatë vitit 2009. Këto zhvillime përbëjnë një reduktim të mëtejshëm të mundësive të financimit të aktivitetit ekonomik si dhe dëmtojnë balancat e kërkesës dhe ofertës për valutë. Ato janë shoqëruar me lindjen e presioneve nënçmuese ndaj kursit të këmbimit, ashtu si dhe në ekonomitë e shumë vendeve të tjera të Evropës Lindore. Në vetvete, ky nënçmim, në kushtet e regjimit fleksibël të kursit të këmbimit që zbatohet në Shqipëri përbën një sjellje korrektuese në drejtim të konsumit, kursimeve dhe investimeve në nivel mikro dhe makroekonomik.

Në optikën e Bankës së Shqipërisë, problemi kryesor me të cilin do të përballet ekonomia shqiptare gjatë vitit në vijim është mungesa e likuiditetit dhe i lidhur me të, shtrëngimi i kushteve të financimit të aktivitetit. Ashtu siç e kemi theksuar edhe në dalje tona të tjera publike, ky kufizim duhet të njihet dhe të faktorizohet në planet e biznesit të të gjithë agjentëve ekonomikë. Ekonomia shqiptare do të përfitojë më pak kredi gjatë vitit 2009. Kjo mungesë likuiditeti kufizon edhe hapësirat që ka politika fiskale dhe ajo monetare për veprim.

Në këto rrethana, ajo që kërkohet është një eficiencë më e madhe e përdorimit të fondeve të sistemit bankar, nëpërmjet renditjes prioritare të shpenzimeve në funksion të impaktit që kanë mbi rritjen ekonomike.

Për më tepër, Banka e Shqipërisë gjykon se sjellja e deficitit të llogarisë korente duhet të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme.

Barazimi i këtij deficiti me hyrjet e reduktuara të llogarisë kapitale, duhet të jetë një prioritet tjetër i zhvillimit të politikave ekonomike. Sikurse e theksova dhe më parë, ky moment kushtëzon ndjeshëm ekuilibrat makroekonomikë dhe financiarë të vendit. Për këtë arsye, ai do të jetë në vëmendjen e vazhdueshme të analizës së Bankës së Shqipërisë.

Duke kuptuar drejt rolin e saj si një institucion që administron tregun e parasë, situatën e likuiditetit, stabilitetin e sistemit bankar dhe funksionin e saj si financuese e burimit të fundit, Banka e Shqipërisë që në ditët e para të tetorit 2008 bëri publik qëndrimin e saj se do të furnizonte sistemin bankar në mënyrë të pandërprerë me likuiditetin e nevojshëm.

Me kalimin e kohës, duke ndjekur situatën hap pas hapi, Banka e Shqipërisë modifikoi kuadrin e saj operacional për të përmbushur më mirë nevojat e tregut për likuiditet. Fillimisht ne kemi ndryshuar tipin e ankandit kryesor të injektimit, nga ankand me shumë fikse në ankand me çmim fiks, që do të thotë furnizim i tregut me likuiditet në sasinë që bankat e gjykojnë vetë të arsyeshme dhe e gjithë kjo, kundrejt çmimit fiks të përqindjes bazë të interesit.

Në shtesë, Banka e Shqipërisë bëri dhe disa modifikime të rëndësishme rregullative. Më konkretisht:

- U zgjerua baza e letrave me vlerë që shërbejnë si kolateral për marrëveshjet e anasjellta të riblerjes, duke shtuar edhe obligacionet e emetuara nga qeveria, me maturim të mbetur jo më shumë se 365 ditë.
- U rrit hapësira e përdorimit të rezervës së detyruar nga 20 për qind në 40 për qind në ditë.
- U ul diferenca midis normës bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë dhe kredisë njëditore, nga 175 pikë bazë në vetëm 75 pikë.
- Nëpërmjet një akti të veçantë rregullativ, Banka e Shqipërisë i ka kërkuar sektorit bankar të mos shpërndajë fitimin e vitit 2008, në formën e dividentit. Në këtë mënyrë kapitalizimi i veprimtarisë bankare forcohet më tej, duke ofruar një garanci më shumë për shëndetin financiar të sektorit bankar, në vijim.

Vendimet e mësipërme, i kanë shërbyer qetësimit të situatës së likuiditetit dhe janë në sintoni me reagimin operacional të zbatuar nga BQE në përgjigje të krizës.

Monitorimi i kujdesshëm i situatës imponoi krijimin e një grupi të posaçëm të tipit *task force,* përgjegjësi kryesore e të cilit është ndjekja ditore e situatës për çdo bankë të veçantë. Konkluzioni ynë i drejtpërdrejtë ishte se treguesit e agreguar jo domosdoshmërisht tregojnë të vërtetën. Shprehja interesante se "djalli qëndron në detaje" e bëri të domosdoshme që në vazhdimësi analiza duhet të zbriste në nivel mikro, në çdo qelizë të sistemit, në çdo tregues të veçantë tij dhe akoma më tej për çdo bankë më vete.

Banka e Shqipërisë ka kryer testime të njëpasnjëshme, për të gjetur reagimin e sistemit bankar në qoftë se ai do të përballej me rrethana nga më ekstremet. Analizat e përftuara nga *stress-test* e shumta në rang sistemi ashtu dhe në mënyrë individuale për çdo bankë më vete, tregojnë se sistemi në tërësi dhe asnjë nga bankat me rëndësi sistemike në veçanti, nuk janë të prekura në nivelin e likuiditetit dhe të kapitalizimit. Pavarësisht zgjerimit të spektrit të rreziqeve dhe një viti më të vështirë për zgjerimin e

veprimtarisë bankare, sistemi financiar dhe sektori bankar do të mbeten të qëndrueshëm.

Ne besojmë që vendimi i fundit i Kuvendit të Shqipërisë i cili miratoi rritjen e vlerës së plotë të garantimit të depozitave në 2.5 milionë lekë, krijon të gjitha kushtet dhe eliminon barrierat psikologjike për kthimin më të shpejtë të depozitave të tërhequra në sistemin bankar. Niveli aktual i sigurimit të depozitave, i ngjashëm me atë të vendeve evropiane, garanton plotësisht dhe përgjithmonë kursimet e shumicës dërrmuese të familjeve shqiptare. Tashmë nuk ka arsye objektive që njerëzit të shqetësohen për sigurinë e kursimeve të tyre në banka. Çdo hezitim për të vendosur kursimet në banka, rrit në mënyrë të panevojshme vlerën e të ardhurave të munguara për shkak të mospërfitimit të interesave dhe të shërbimeve të tjera bankare.

PLATFORMA E RIGJALLËRIMIT

Problemet aktuale me të cilat përballet ekonomia shqiptare nuk kanë origjinuar në Shqipëri; për këtë arsye, zgjidhja e tyre do të varet në një masë të madhe nga përmirësimi i aktivitetit ekonomik në nivel botëror.

Strategjia e ardhme e zhvillimit duhet të vazhdojë të mbështetet në elementet fondamentale që shtjellova në platformën e parë. Stabiliteti makroekonomik do të mbetet një parakusht themelor për një rritje të qëndrueshme afatgjatë. Mbështetur në mësimet e deritanishme të krizës botërore, Banka e Shqipërisë gjykon jetike hedhjen e vështrimit përtej të sotmes dhe thellimin e mëtejshëm të reformave strukturore. Kjo përbën dhe kushtin kryesor për konvergimin e qëndrueshëm të vendit me standardet e Bashkimit Evropian.

Duke vlerësuar kompleksitetin e sfidave me të cilat do të përballemi në vazhdim, ne gjykojmë si themelor rishikimin e të gjitha politikave aktuale makroekonomike dhe financiare me qëllim përshtatjen e tyre me kushtet e reja. Në të ardhmen, duhen krijuar mekanizma të qartë për koordinimin e politikave makroekonomike dhe programeve të zhvillimit të vendit. Banka e Shqipërisë gjykon se një hap në drejtimin e duhur do të ishte adoptimi i një rregulli fiskal sasior transparent, i cili do të shërbente si një kushtëzues i politikave fiskale në horizontin afatmesëm dhe afatgjatë.

Shtrëngimi i kushteve financiare në ekonomi, pamjaftueshmëria e burimeve të brendshme dhe problemet e tregut financiar ndërkombëtar, e bëjnë të nevojshme gjetjen e burimeve të huaja të financimit. Për këtë qëllim, duhet vlerësuar çdo opsion i mundshëm, përfshirë dhe programet e mbështetjes nga institucionet ndërkombëtare të specializuara. Banka e Shqipërisë gjykon se Shqipëria duhet të përfitojë medoemos nga fondi ndërkombëtar i krijuar nga mbledhja e njëzet vendeve më të zhvilluara, pasi ajo i plotëson të gjitha kushtet.

Në emër të institucionit që unë drejtoj do të doja të siguroja Kuvendin e Shqipërisë, sistemin bankar, të gjithë aktorët e tjerë të interesuar se Banka e

Shqipërisë do të plotësojë nevojat e sistemit bankar me likuiditet. Nga ana tjetër, ne do të këmbëngulim që sistemi bankar në politikat që aplikon në lidhje me tregun e parasë dhe portofolin e investimeve të jetë më i pavarur nga selitë qendrore. Banka e Shqipërisë do të intensifikojë komunikimin me selitë qendrore të bankave për të mbështetur financiarisht bijat e tyre që operojnë në Shqipëri.

Bankat që operojnë në Shqipëri janë licencuar dhe administrojnë kursimet e qytetarëve shqiptarë. Rrjedhimisht, obligimi themelor i çdo sistemi bankar është ndërmjetësimi financiar në vendin ku ai operon. Për këtë arsye, ne do të këmbëngulim që kreditimi i ekonomisë të ringjallet duke sjellë në vëmendjen e sistemit degët e veçanta të prodhimit që justifikojnë mbështetjen financiare të tij.

Sistemi bankar duhet të jetë më aktiv për rifitimin e besimit të publikut, nëpërmjet një komunikimi në rritje dhe prezantimit të produkteve të reja që adresojnë hezitimin e publikut.

Komuniteti i biznesit duhet të hapet më shumë ndaj sistemit bankar. Sinqeriteti i rritur dhe domosdoshmëria për të qenë më vizionar në përcaktimin e planeve të ardhshme të biznesit, janë dy kushte të rëndësishme për ristabilizimin e kredisë në parametra të dëshiruar.

Një apel do t'ju drejtoja edhe individëve, qytetarëve të thjeshtë. Mënyra se si ju silleni çdo ditë përcakton edhe dinamikën e efekteve të krizës. Individët duhet t'i kthehen bankave. Nëse sjellja juaj do të jetë racionale, atëherë dhe ndikimi i krizës do të jetë periferik. Nëse në sjelljen tuaj të përditshme zë vend pseudofilozofia mikroproteksioniste e shfaqur në formën e panikut, mungesës së besimit, largimit të depozitave nga bankat atëherë edhe mundësia për t'u prekur nga kriza financiare rritet më shumë. Për më tepër, mundësia për t'u shndërruar në një krizë të ekonomisë reale rritet. Sistemi financiar është e vetmja "makineri" e specializuar që zotëron informacionin, njohuritë dhe burimet njerëzore për të bërë shpërndarjen optimale të burimeve financiare në ekonomi. Për më tepër, sistemi bankar është një segment i rregulluar dhe i mbikëqyrur nga Banka e Shqipërisë, autoriteti që si objektiv të vetëm ka ruajtjen e ekuilibrave makroekonomikë e financiarë të vendit. Për këtë qëllim besoj se sot është koha që të reagojmë me logjikë dhe me sens të theksuar patriotizmi.

Falenderoj mediat për mbulimin e kujdesshëm që i kanë bërë ngjarjeve të muajve të fundit dhe i ftoj ato që të vazhdojnë me pasqyrimin me vërtetësi të zhvillimeve në të ardhmen.

Përfitoj nga ky rast, t'i drejtohem klasës politike me një thirrje për rritjen e vëmendjes ndaj sfidave me të cilat përballet vendi. Arritja e një mirëkuptimi politik në trajtimin e tyre do të reduktonte në kohë dhe në intensitet efektet negative në ekonomi. Këtë detyrim e kemi jo vetëm ndaj vetes por edhe ndaj brezave të ardhshëm, të cilët meritojnë një ambient më të përshtatshëm biznesi, stabilitet makroekomik, sistem financiar të shëndoshë dhe perspektivë të qartë konvergjence me Eurozonën.

Kriza globale, tashmë na i ka dhënë mësimet e para. Ajo na mëson që na nevojitet më shumë disiplinë, më shumë komunikim, më shumë koordinim, më shumë transparencë dhe më shumë kulturë.

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Stabiliteti makroekonomik i vendit ka amortizuar ndikimin e krizës ekonomike e financiare globale në aktivitetin ekonomik në vend. Ky stabilitet i shprehur në: inflacion të ulët të çmimeve të konsumit; qëndrueshmëri të bilancit të pagesave dhe të borxhit publik; bilance të shëndosha të agjentëve ekonomikë; luhatje të ulta të tregut financiar; dhe besim të publikut në institucionet financiare, është një kapital i madh i ekonomisë shqiptare. Ai është përftuar me punë dhe sakrifica gjatë viteve të shkuara, prandaj Banka e Shqipërisë gjykon se vëmendja jonë nuk duhet të shkëputet nga ruajtja dhe konsolidimi i mëtejshëm i tij edhe në këto momente sfide për të gjithë ne.

Dinamizmi i sektorit privat të ekonomisë shqiptare kërkon kushte afatgjata të favorshme ekonomike dhe financiare, si dhe struktura transparente tregjesh konkurrenciale, për të çliruar në mënyrë të plotë potencialin e tij. Vetëm vendet të cilat kanë ditur të ngrihen dhe t`i përgjigjen këtyre goditjeve, kanë mundur të rriten e të begatojnë në një periudhë afatgjatë. Përvetësimi i këtij mësimi kërkon një renditje të qartë të prioriteteve të zhvillimit, ndarjen e interesit afatgjatë të zhvillimit të vendit nga synimet afatshkurtra si dhe vullnetin politik për realizimin e tyre. Përballja energjike me efektet e krizës do të thotë dalje më e shpejtë prej saj dhe më me pak pasoja. Kjo do t'i japë vendit avantazhe krahasuese në raport me ekonomitë e rajonit, në realizimin e ambicieve për integrim dhe konvergjencë të shpejtë me familjen evropiane.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z.ARDIAN FULLANI

Gjatë prezantimit të zhvillimeve ekonomike në Shqipëri dhe sfidave të ardhshme, organizuar nga Citigroup Londër, IFC - International Financial Services dhe Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar.
Londër, 18 maj 2009

Të nderuar zonja dhe zotërinj!

Më lejoni të filloj duke falenderuar Ambasadën e Shqipërisë këtu në Londër për organizimin e këtij takimi. Është një kënaqësi për mua që t'ju ofroj një panoramë të shkurtër mbi tendencat dhe zhvillimet më të fundit në ekonominë shqiptare. Takime të këtij lloji janë mjaft të rëndësishme për ballafaqimin e mundësive që ofron një vend me ekonomi në zhvillim, me dëshirën e vendeve të zhvilluara për kthim më të lartë.

Progresi ynë makroekonomik gjatë viteve të fundit, sistemi i shëndoshë bankar dhe angazhimi ynë për rritjen e eficiencës së tij janë pikat e forta me të cilat unë vij sot përpara jush. Gjendja e shëndoshë dhe e qëndrueshme ekonomike dhe financiare është arritur përmes zbatimit të një politike monetare moderne dhe vizionare, dhe si rezultat i një politike të përgjegjshme fiskale.

Suksesi makroekonomik dëshmon për aftësinë e autoriteteve shqiptare për identifikimin në kohën e duhur të prioriteteve, si dhe për zbatimin e reformave të shëndosha ekonomike dhe shoqërore. Si rezultat, për herë të parë në vitin 2007, Shqipëria pati gradimin e saj të pavarur lidhur me profilin e rrezikut të saj. Agjencia Moody e vlerësoi Shqipërinë me B+, vlerësim i cili ishte i njëjtë edhe për vitin 2008.

Në dy vitet e fundit, vendi ynë ka bërë mjaft progres në drejtim të klimës së biznesit, fakt i cili mbështetet nga mjaft të dhëna. Do të doja të përmendja këtu anketën e Bankës Botërore "Cost of Doing Business" ("Të bësh biznes"), e cila e ka ngjitur Shqipërinë nga vendi i 135-të në atë të 86-të.

Për herë të parë në fund të vitit 2007, borxhi publik i Shqipërisë në monedhën vendase u tregtua në tregjet financiare ndërkombëtare.

Gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka bërë mjaft përmirësime në drejtim të administrimit fiskal dhe monetar të vendit. Zbatimi i taksës së sheshtë prej 10 për qind u pasua nga një rritje e konsiderueshme në mbledhjen e taksave.

Përmirësimet e fundit në legjislacion kanë kontribuar në krijimin e një klime më të favorshme biznesi. Disa nga zhvillimet më kryesore mund të përmenden: sistemi i thjeshtuar i vendosjes së taksave, procedurat më të lehta dhe më pak të kushtueshme të tyre; infrastruktura më e mirë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve lidhur me to; prezantimi i procedurave elektronike për taksat, si dhe ulja e kontributit për sigurimin shoqëror.

Vlen të përmendet gjithashtu, projektligji për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative në Republikën e Shqipërisë, i cili është në fazë diskutimi. Ky ligj do të krijojë gjykata administrative, të cilat do të kenë mjaft kompetenca për të gjykuar mbi vendimet e marra nga autoritetet fiskale shqiptare.

Procesi i integrimit ka bërë hapa përpara me dy ngjarje mjaft të rëndësishme. Në fillim të muajit prill të këtij viti, në Samitin e Strasburgut, Shqipëria u bë anëtare e NATO-s, ndërkohë që vetëm pak javë më vonë, vendi ynë i paraqiti Presidencës Çeke aplikimin zyrtar për statusin e kandidatit në Bashkimin Evropian.

Falë pozicionit të saj gjeografik mjaft strategjik, Shqipëria është shndërruar kohët e fundit në një faktor mjaft të rëndësishëm ekonomik, politik dhe stabilizues për rajonin. E karakterizuar nga këto elemente të rëndësishme gjeopolitike, Shqipëria bëhet urë lidhëse për Evropën Juglindore.

Gjatë dekadës së fundit, vendi ynë është karakterizuar nga një rritje ekonomike e lartë dhe joinflacioniste, e mbështetur nga kërkesa e brendshme dhe e nxitur nga rritja e aktivitetit kreditues.

Në përgjithësi, Shqipëria ka arritur të mbajë çmimet nën kontroll, pa cënuar rritjen apo stabilitetin financiar të vendit. Gjatë viteve të fundit, vendi ynë ka regjistruar një rritje ekonomike vjetore prej 6 për qind. Aktiviteti ekonomik është rritur në mënyrë të mjaftueshme për të përballuar rritjen e shpejtë të kërkesës, duke kontribuar në mbajtjen e çmimeve nën kontroll dhe në ankorimin e pritjeve inflacioniste rreth objektivit të Bankës së Shqipërisë për inflacionin. Objektivi ynë për ruajtjen e nivelit të inflacionit total në 3 për qind ± 1 pikë përqindjeje është arritur në mënyrë të suksesshme.

Në fund të vitit 2008, inflacioni total i çmimeve të konsumit u luhat në rreth 3 për qind. Pavarësisht zhvlerësimit të moderuar të kursit të këmbimit gjatë muajve të parë të vitit 2009, presionet inflacioniste janë ulur në përgjigje të zhvillimeve të fundit në tregjet ndërkombëtare dhe tkurrjes ekonomike në partnerët tanë kryesorë tregtarë, si dhe të ngadalësimit të aktivitetit ekonomik në vend. Megjithatë, vlerësimet tona tregojnë se inflacioni për 12 muajt në vijim do të mbetet brenda intervalit të tolerancës.

Vendi ynë është karakterizuar nga një konsolidim i vazhdueshëm fiskal gjatë viteve të fundit. Prania e FMN-së ka përfaqësuar një ankorë të rëndësishme të jashtme, duke nxitur kështu disiplinën fiskale. Megjithatë, për shkak të projekteve aktuale ambicioze për përmirësimin e infrastrukturës rrugore, shpenzimet kapitale kanë pësuar rritje, duke kontribuar kështu në zgjerimin e deficitit fiskal në vitin 2008.

Projektet e mëdha infrastrukturore janë financuar ndërmjet të tjerash, nga të ardhurat e realizuara nga privatizimi i sektorëve institucionalë. Një gjë e tillë, ka kontribuar në ruajtjen e masës së borxhit publik të qeverisë në masën 55 për qind të PBB-së, masë kjo e pranueshme duke marrë parasysh Kriteret e Mastrihtit.

Kursi i këmbimit të monedhës vendase, lekut, është vendosur lirisht në tregun valutor. Banka e Shqipërisë beson se një regjim i lirë i kursit të këmbimit është një element i rëndësishëm në procesin e korrektimit të zhbalancimeve të mundshme makroekonomike.

Monedha vendase ka ruajtur nivele të qëndrueshme duke filluar nga vitet 2000. Gjithashtu, leku ka shfaqur një tendencë të lehtë dhe të vazhdueshme vlerësimi, si rezultat i rritjes së produktivitetit dhe shtimit të qëndrueshëm të të ardhurave nga emigrantët. Duke filluar nga viti 1998, luhatshmëria e kursit të këmbimit ka pësuar rënie të vazhdueshme.

Megjithatë, tendencat e fundit të zhvillimit, kryesisht në sektorin e jashtëm (rënia e të ardhurave nga emigrantët dhe zgjerimi i përkohshëm i deficitit të llogarisë korente), kanë kontribuar në zhvlerësimin e lekut. Deri në fund të muajit prill 2009, kursi nominal efektiv i këmbimit pësoi një rënie prej rreth 6 për qind. Pavarësisht kësaj, ky zhvlerësim mbetet në nivele të moderuara, krahasuar me përvojën e vendeve të tjera të Evropës Qendrore dhe Juglindore.

Të dhënat mbi bilancin e pagesave dëshmojnë për rritjen e besimit në ekonominë shqiptare, e reflektuar kryesisht në shtimin e investimeve të huaja direkte, të cilat në vitin 2008 arritën në 6 për qind të PBB-së.

Kuadri aktual i politikës monetare mund të konsiderohet si një regjim i nënkuptuar i inflacionit të shënjestruar, i administruar përmes përdorimit të instrumenteve indirekte të politikës monetare. Sinjalet e politikës monetare përçohen përmes vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë mbi normën bazë të marrëveshjeve njëjavore të riblerjes, si dhe përmes komunikimit të vazhdueshëm.

Burimet natyrore të vendit tonë, si dhe forca e lirë por e kualifikuar e punës, vijojnë të jenë elemente tërheqëse për të gjithë sipërmarrësit evropianë, të cilët dëshirojnë të eksplorojnë përparësitë që ofron globalizimi. Baza e eksporteve varion nga produktet bujqësore, deri tek ato minerale. Shqipëria ofron mjaft mundësi investimi në miniera, bujqësi, energji, infrastrukturë dhe turizëm. Industria e përpunimit të ushqimit po përjeton një zhvillim të kënaqshëm, duke krijuar njëkohësisht mjaft hapësira për rritje të aktivitetit. Ndërkohë që mundësitë në sektorin e energjisë variojnë nga ndërtimi i burimeve të reja, deri tek përmirësimi i rrjetit të shpërndarjes.

Fokusi strategjik i Shqipërisë drejt përmirësimit të infrastrukturës së transportit kërkon një pjesëmarrje më të madhe të sektorit publik dhe atij privat në ndërtimin e rrugëve dhe porteve të reja. Siç e përmenda dhe më lart, vendi ynë ofron mundësi të jashtëzakonshme për investime në turizmin bregdetar, alpin, historik dhe kulturor, si rezultat i pozicionit të saj të favorshëm në Mesdhe, trashëgimisë së pasur etnografike, si dhe klimës së ndryshueshme dhe gjeologjisë së saj.

Kultura e biznesit gëzon aftësi të mëdha përshtatëse. Gjuha angleze njihet mjaft mirë nga brezi i ri. Shqiptarët e konsiderojnë investimin në arsimimin

e tyre si mjaft të rëndësishëm, ndërkohë që një numër i konsiderueshëm profesionistësh të rinj janë arsimuar në Mbretërinë e Bashkuar dhe në universitete të tjera evropiane. Me arsimimin e tyre, ata kanë zhvilluar zakone perëndimore pune dhe përfaqësojnë faktorë të vlefshëm dhe ndihmues për zgjerimin e biznesit tuaj në rajonin e Ballkanit.

Jo pa qëllim e përmenda rajonin pak më lart. Shqipëria nuk është më një ishull i izoluar dhe i vetmuar i eksperimenteve të çuditshme ekonomike. Gjatë dy dekadave të fundit, ajo është transformuar në një treg të lirë, fleksibël, konkurrues dhe të hapur ndaj zhvillimeve moderne të globalizimit. Vendi ynë ka mësuar të pozicionohet siç duhet dhe të përfitojë nga zhvillimet ndërkombëtare në rajon. Gjeografikisht, Shqipëria gjendet në një pozicion kyç, që lidh lindjen me perëndimin.

Për sa i përket sistemit financiar, objektivi ynë është që të ruajmë një sistem të shëndoshë, likuid dhe fitimprurës. Në fund të vitit 2008, sistemi bankar shqiptar përbëhej nga 16 banka tregtare. Privatizimi i sistemit bankar përfundoi pesë vite më parë me privatizimin e Bankës së Kursimeve nga Banka Raiffeisen. Pas kësaj, në vitin 2004, përqindja e bankave private u rrit në 100 për qind, ku më shumë se 90 për qind e kapitalit aksioner është i huaj.

Gjatë viteve të fundit, kredia për sektorin privat dhe për individët është rritur në mënyrë të ndjeshme. Pa dyshim, kreditimi ka qenë një faktor mbështetës për rritjen ekonomike dhe investimet në vend.

Sektori bankar qëndron në pararojë të investimeve të huaja direkte dhe të procesit të integrimit të vendit. Ai përfaqëson një nga mundësitë më të suksesshme për investim në Shqipëri, duke përfituar mjaft nga prania e disa prej grupeve më të mëdha financiare në Evropë. Referenca ime për integrimin nuk i referohet vetëm pranisë së kapitalit të huaj, por edhe kapacitetit të sistemit bankar për të ndërmjetësuar dhe plotësuar iniciativat dhe investimet evropiane në ekonominë shqiptare. Këto banka gëzojnë reputacionin, aftësinë dhe infrastrukturën e nevojshme për të shërbyer si partnere për investitorët e huaj.

Sistemi bankar është i nevojshëm, por jo një kusht i mjaftueshëm për të nxitur mirëqenien ekonomike dhe për të realizuar shpërndarjen e burimeve për përdoruesit më të mirë të mundshëm.

Shpërndarja e tregut financiar në Shqipëri anon nga bankat universale tregtare. Lloje të tjera si fonde të përbashkëta, kompani investimi me rrezik të lartë, fonde pensioni dhe banka investimi nuk ekzistojnë.

Banka e Shqipërisë dhe autoritetet e tjera financiare të tregut po inkurajojnë krijimin e stimujve të duhur për promovimin e investimeve në këto segmente. Ne besojmë, se sistemi ynë financiar nuk i ka shfrytëzuar ende të gjitha mundësitë e tij. Duke përfituar nga ky takim, do të doja të ftoja të gjitha kompanitë britanike që ta përfshijnë Shqipërinë në hartën e tyre të investimit.

Të nderuar zonja dhe zotërinj!

Zhvillimet globale kanë dominuar axhendën e vendimmarrësve në mbarë botën. Deri tani, ekonomia shqiptare ka shfaqur rezistencë të admirueshme ndaj këtyre zhvillimeve. Stabiliteti makroekonomik dhe ai financiar janë arritur dhe sistemi bankar mbetet likuid.

Megjithatë, efektet e krizës financiare ndërkombëtare u shfaqën në ekonominë shqiptare duke filluar nga tremujori i fundit i vitit 2008. Pasoja e parë ishte tërheqja e depozitave, duke reflektuar rënien e besimit të publikut në sistemin bankar. Shkaqet kryesore që nxitën tërheqjen e depozitave në mesin e muajit tetor të vitit 2008, mendohen të jenë njohja e kufizuar e problemeve reale, e përforcuar prej njoftimeve nga të afërmit emigrantë në Itali dhe Greqi, të cilat nxitën panik në publik.

Një pasojë tjetër e dukshme lidhet me uljen e flukseve valutore hyrëse, në formën e të ardhurave nga emigrantët dhe të eksporteve të mallrave dhe shërbimeve, të cilat shtrënguan gjendjen e përgjithshme financiare në ekonomi, duke ushtruar presion mbi kursin e këmbimit.

Në këtë pikë, Banka e Shqipërisë filloi të bëjë vlerësimin e situatës, me qëllim përgatitjen për efektet e raundit të dytë, të cilat do të vinin si pasojë e shtrëngimit të gjendjes së likuiditetit dhe të situatës botërore, e cila tashmë përballej me një recesion ekonomik. Banka e Shqipërisë i ka komunikuar shqetësimet e saj lidhur me ndikimin e tërthortë të krizës financiare, duke renditur efektet e mundshme të raundit të dytë që do të ushtrojnë presione më të forta gjatë vitit 2009:

- Ne presim, që shtrëngimi i situatës së likuiditetit të ngadalësojë rritjen e kreditimit dhe rritjen ekonomike.
- Ngadalësimi i pritur i eksporteve tona dhe ulja e çmimeve të mallrave do të çojnë në rritjen e deficitit tregtar. Gjithashtu, reduktimi i mëtejshëm i të ardhurave nga emigrantët do të kontribuojë në rritjen e deficitit të llogarisë korente.
- Megjithatë, ne besojmë se regjimi i kursit të lirë të këmbimit do të jetë një instrument efektiv për rregullimin e konsumit dhe për pasojë, të importeve.
- Banka e Shqipërisë nuk do të ndërhyjë për fiksimin e ndonjë çmimi në treg. Ashtu si përherë, ajo do të përpiqet që të shmangë çdo çrregullim të theksuar në treg.
- Deficiti fiskal pritet të rritet, si rezultat i një ndikimi të pritur negativ të aktivitetit ekonomik mbi të ardhurat buxhetore dhe financimit të tyre, për shkak të shtrëngimit të situatës së likuiditetit në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Analizat tona tregojnë se aktiviteti ekonomik do të ngadalësohet në mënyrë të ndjeshme. Megjithatë, ai do të mbetet në nivele pozitive.
- Analizat stress-test tregojnë se cilësia e portofolit të kredisë pritet të përkeqësohet më tej, si rezultat i ngadalësimit të aktivitetit ekonomik, zhvlerësimit të kursit të këmbimit, si dhe i efektit statistikor të rritjes më

të ulët të kreditimit. Megjithatë, cilësia e këtij portofoli do të mbetet brenda kufijve të pranueshëm dhe nuk pritet që të kërcënojë ndjeshëm stabilitetin financiar të vendit.

Gjithashtu, objektivi afatshkurtër i Bankës së Shqipërisë u zhvendos drejt ruajtjes së stabilitetit dhe minimizimit të efekteve të raundit të dytë, duke mbajtur në vëmendje të vazhdueshme zhvillimet në inflacion, i cili është zhvendosur në kahun rënës.

Të nderuar pjesëmarrës,

Viti me të cilin përballemi do të jetë i vështirë. Përpara nesh gjenden mjaft sfida. Kombinimi i krizës financiare me recesionin ekonomik botëror është një rast i paprecendentë. Vendi im, Shqipëria, është gjithashtu pjesë e kësaj tabloje globale. Deri tani, ne kemi arritur të ruajmë si stabilitetin ekonomik, ashtu dhe atë financiar. Ne mbetemi të angazhuar për ruajtjen e mëtejshme të këtyre arritjeve.

Duke ju falenderuar për vëmendjen tuaj, mbetem i hapur ndaj çdo pyetjeje.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z.ARDIAN FULLANI

Në takimin Rajonal të Guvernatorëve dhe Bankierëve
Mali i Zi, 20 qershor 2009

Të nderuar Guvernatorë,
Të nderuar pjesëmarrës,

Më lejoni të filloj duke falenderuar organizatorët e këtij takimi, që synon promovimin e një diskutimi të përbashkët lidhur me statusin e sektorëve tanë financiarë dhe me masat e nevojshme për t'u ndërmarrë, me qëllim mbështetjen dhe ruajtjen e rezistencës së tyre ndaj efekteve negative të kësaj krize globale të papërjetuar më parë. Në fakt, ajo çfarë nisi si një krizë financiare në SHBA është shndërruar në një krizë ekonomike, me pasoja të thella mbi sektorët realë të ekonomisë botërore. Do ta nis diskutimin tim duke përshkruar së pari, zhvillimet kryesore makroekonomike në Shqipëri dhe karakteristikat e sistemit tonë financiar, i cili gëzon tipare të njëjta me ato të vendeve të tjera në rajon. Më pas, do të vijoj me disa masa të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, me qëllim zbutjen e ndikimit të krizës financiare ndërkombëtare mbi sektorin tonë bankar dhe mbi ekonominë shqiptare. Në fund, do ta mbyll duke përmendur disa opinione lidhur me politikat e ardhshme, të cilat i konsideroj të rëndësishme për konsolidimin e mjedisit ekonomik dhe të stabilitetit financiar në Shqipëri dhe në rajon.

EKONOMIA SHQIPTARE ËSHTË RRITUR ME RITME TË QËNDRUESHME GJATË DEKADËS SË FUNDIT.

Ekonomia shqiptare ka shënuar ritme të qëndrueshme rritjeje gjatë dekadës së fundit, duke regjistruar një normë mesatare rritjeje prej rreth 6 për qind, në terma vjetorë. Ajo ka përfituar mjaft nga reformat ekonomike, të cilat kanë ofruar mundësi zhvillimi për sektorin privat shqiptar, kanë mbështetur zhvillimin e tregjeve, kanë nxitur konkurrencën si dhe kanë krijuar fleksibilitet në tregun e punës, duke rritur kështu të ardhurat e individëve. Të mbështetura nga një program asistence i FMN-së, si politika fiskale ashtu dhe ajo monetare kanë qenë të kujdesshme në dhënien e stimujve të nevojshëm për rritjen ekonomike, duke qenë konsistente dhe të disiplinuara në arritjen e objektivave të tyre të konsolidimit fiskal dhe të krijimit të një mjedisi me inflacion të ulët. Kjo ecuri pozitive dhe e qëndrueshme ekonomike është mbështetur nga një kurs këmbimi fleksibël, i cili ka kontribuar në mbështetjen dhe ruajtjen e një rritjeje të ekuilibruar, duke ruajtur në të njëjtën kohë, stimujt e duhur për ndërveprim ndërmjet palëve vendase dhe të huaja.

ASHTU SI DHE NË VENDET E TJERA TË RAJONIT, SEKTORI BANKAR MBIZOTËRON SISTEMIN FINANCIAR NË SHQIPËRI.

Aktivet e sektorit bankar llogariten në rreth 95 për qind të totalit të aktiveve të sektorit financiar në Shqipëri ose rreth 80 për qind të PBB-së. Sektori bankar numëron 16 banka me rreth 500 degë, të gjitha private dhe ku mbizotëron kapitali i huaj. Me kalimin e kohës, ky sektor ka rritur numrin e degëve, ka përmirësuar produktet e tij për publikun dhe ka rritur rolin e tij ndërmjetësues. Njëkohësisht, hyrja në Shqipëri e grupeve të mirënjohura bankare evropiane nga Greqia, Austria, Italia dhe Franca është shoqëruar me konsolidimin e industrisë bankare. Treguesit e performancës financiare kanë qenë mjaft të kënaqshëm. Veçanërisht në tre vitet e fundit, sektori bankar ka prezantuar një infrastrukturë moderne për kryerjen e pagesave si dhe produkte, të cilat mundësojnë rritjen e përdorimit të mjeteve elektronike të pagesave dhe të internet banking. Sektori bankar ka qenë një kontribues i rëndësishëm në rritjen ekonomike, duke ruajtur në të njëjtën kohë zhvillimin e qëndrueshëm të biznesit dhe treguesit e shëndetit financiar.

Pavarësisht ecurisë së qëndrueshme gjatë viteve të fundit, Banka e Shqipërisë, në rolin e saj si autoritet monetar dhe si mbikëqyrësi ekskluziv i sektorit bankar, ka qenë vigjilente në identifikimin e fushave të veprimtarisë bankare, që kërkojnë më tepër vëmendje nga kjo industri.

Ne vazhdimisht, kemi shprehur shqetësimin tonë lidhur me rritjen e shpejtë të kredidhënies, rritja vjetore e së cilës ka arritur deri në 8-9 pikë përqindjeje të PBB-së. Ne ishim të vetëdijshëm për rrezikun që një zgjerim i tillë mund t'i sillte cilësisë së kredisë, ndonëse rritja e kësaj të fundit nuk pritej të kishte ndikim mbi cilësinë. Përbërja e portofolit të kredisë, i cili dominohet nga kreditë në monedhën euro, ka përbërë gjithmonë një aspekt shqetësues. Pavarësisht nga fakti se ky pozicion mbështetet nga një prezencë e fuqishme në bilancet e bankave të detyrimeve në monedhë të huaj, nga një mjedis përgjithësisht mbështetës i kursit të këmbimit dhe i normave të interesit dhe nga lidhje mjaft të ngushta ekonomike me vendet e Eurozonës - si për shembull, Italia dhe Greqia, Banka e Shqipërisë ka qenë konsistente në qëndrimin e saj për paraqitjen graduale të disa masave rregullative, të cilat do të zbusnin rritjen e shpejtë të kredidhënies, do t'i nxisnin bankat të kreditonin më tepër në monedhën vendase, si dhe do të rrisnin transparencën ndaj klientit lidhur me produktet dhe shërbimet bankare.

NDIKIMI I KRIZËS MBI EKONOMINË DHE SEKTORIN FINANCIAR SHQIPTAR ËSHTË RRITUR DHE…

Ndikimi i krizës financiare ndërkombëtare filloi të ndihet mbi sektorin financiar në Shqipëri në tremujorin e fundit të vitit 2008. Zhvillimi kryesor lidhej me rritjen e ndjeshmërisë së publikut ndaj kursimeve të tyre, të vendosura në sektorin bankar. Njerëzit filluan t'i tërhiqnin depozitat, pavarësisht nga monedha e këtyre kursimeve. Në fillim, nuk ushtrohej asnjë

presion mbi kursin e këmbimit, por ai erdhi në rritje në momentin kur u vu re një kontraktim i fluksit hyrës në valutë, për shkak të rënies së eksporteve dhe të remitancave. Cilësia e portofolit të kredisë filloi të përkeqësohet dhe në fund të muajit prill 2009, kreditë me probleme arritën në 8 për qind të totalit të tepricës së kredisë. Ne presim, që kjo shifër të rritet edhe më tej, duke qenë se të dhëna nga ekonomia dhe nga vrojtimet lidhur me pritshmëritë e bizneseve, si dhe një ngadalësim i theksuar i kredidhënies, të çojnë në përfundimin se rritja ekonomike në vitin 2009 do të jetë shumë më e ulët, sesa në vitin paraardhës. Për shkak të rënies së marzhit të të ardhurave nga interesi dhe rritjes së provigjoneve, disa banka kanë filluar të akumulojnë rezultate financiare negative.

Në një këndvështrim më pozitiv, pothuajse të gjitha bankat kanë mbështetur kredidhënien në monedhën vendase. Në të njëjtën kohë, sektori bankar mbetet i mirëkapitalizuar dhe likuid. Në muajin mars 2009, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit ishte 17.1 për qind, krahasuar me nivelin minimal të kërkuar prej 12 për qind. Raporti i aktiveve likuide ndaj totalit të aktiveve përllogaritet në rreth 42 për qind.

Mjaftueshmëria e kapitalit të sektorit bankar është e mjaftueshme për të mbuluar aktivitetin bankar në rast të një skenari tejet negativ, i cili kombinon mungesën e një rritjeje ekonomike, një zhvlerësim më të lartë të kursit të këmbimit dhe një përqindje më të lartë të kredive me probleme. Do të doja të përmendja gjithashtu, se aksionerët e bankave u janë përgjigjur thirrjeve tona për injektim kapitali në mënyrë të shpejtë dhe të mjaftueshme. Ne gjithashtu, jemi në kontakt të vazhdueshëm me përfaqësuesit e bankave, me qëllim identifikimin e nevojave të tjera në këtë drejtim.

...JANË NDËRMARRË MASA, ME QËLLIM PËRBALLIMIN E KËTIJ MJEDISI NË NDRYSHIM.

Duke filluar nga tremujori i fundit i vitit 2008, Banka e Shqipërisë ka intensifikuar punën e saj në drejtime të ndryshme, me qëllim monitorimin e kujdesshëm të zhvillimeve dhe parandalimin e situatave negative, në rast se një gjë e tillë është e mundur. Për këtë arsye ne:

- kemi forcuar kontaktet dypalëshe dhe shumëpalëshe me përfaqësuesit e bankave, duke iu kërkuar atyre më tepër vigjilencë për shkak të situatës aktuale në tregun botëror;
- kemi rritur kontaktet me institucionet e tjera vendore, të cilat rregullojnë dhe monitorojnë tregjet financiare, në veçanti me Autoritetin Mbikëqyrës Financiar, i cili mbikëqyr sektorin e sigurimeve;
- kemi rritur numrin e publikimeve, duke përfshirë Raportin e Stabilitetit Financiar për vitin 2007 (shtator 2008) dhe Deklaratën mbi Stabilitetin Financiar (tetor 2008, prill 2009), të cilat përpiqen që të analizojnë elementet e krizës dhe efektet e saj të mundshme mbi sektorin bankar dhe ekonominë shqiptare;
- kemi rritur prezencën tonë në media, duke dhënë shpjegime mbi krizën,

duke qartësuar pozicionin e sektorit tonë bankar kundrejt efekteve të mundshme të krizës, si dhe duke ruajtur besimin e publikut në sektorin bankar;

- kemi ndryshuar dhe përmirësuar kuadrin e raportimit të bankave, në drejtim të kohës dhe cilësisë së të dhënave, në veçanti lidhur me ekspozimin e tyre ndaj tregjeve financiare (dhe bankave mëmë), detyrimet e tyre (depozitat dhe ekspozimin ndaj linjave të kredisë) ndaj bankave mëmë, si dhe lidhur me zhvillimet në portofolin e tyre të kredisë. Këto të dhëna po monitorohen nga afër;
- kemi intensifikuar mbikëqyrjen në vend të bankave, me qëllim monitorimin nga afër të procesit të administrimit të rrezikut dhe të mënyrës se si bankat reagojnë ndaj zhvillimeve të reja;
- kemi përmirësuar analizat tona stress-test, në drejtim të paraqitjes së supozimeve më konservatore dhe teknike, të cilat mundësojnë kombinimin e skenarëve negativë të mundshëm;
- kemi filluar të përdorim transaksionet e marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes me maturim njëjavor me çmim fiks (shumë të papërcaktuar) dhe transaksionet e marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes me maturim më të gjatë, si dhe kemi zgjeruar listën e instrumenteve që mund të përdoren si kolateral në këto transaksione, për t'iu përshtatur sa më mirë nevojave të bankave për likuiditet;
- kemi dyfishuar hapësirën e përdorimit të rezervës së detyruar, me qëllim që bankat të përdorin më shumë nga rezerva e tyre në bankën qendrore, në rast se kanë nevojë për të brenda periudhës të mbajtjes;
- kemi përgatitur dhe dërguar për miratim në Parlament ndryshime për legjislacionin mbi sigurimin e depozitave. Miratimi i këtyre ndryshimeve iu ka mundësuar depozitorëve tanë një rritje të konsiderueshme dhe të përhershme të shumës maksimale të depozitave të tyre, e cila sigurohet plotësisht;
- kemi ulur normën e interesit në janar të vitit 2009 me 50 pikë bazë, duke e çuar atë në 5.75 për qind, me qëllim uljen e presioneve inflacioniste. Që atëherë, diskutimet janë përqendruar rreth zhvillimeve të kursit të këmbimit dhe ndikimit potencial në presionet inflacioniste dhe stabilitetin financiar.

Ndërkohë, në drejtim të përmirësimit të diskutimeve të brendshme dhe vendimmarrjes, ne jemi duke rishikuar planet tona të mbështetjes, për të vlerësuar mundësinë për veprime të reja, në rast se përballemi me skenarë të përkeqësuar.

TASHMË ËSHTË KOHA TË PREZANTOJMË POLITIKA QË DO TË PËRMIRËSOJNË MJEDISIN EKONOMIK DHE STABILITETIN FINANCIAR NË RAJONIN TONË …

Në nivel global, tashmë është bërë e qartë se kriza e kohëve të fundit ishte pasojë e stimujve të gabuar që mbështetën zhvillimin e çekuilibruar të aktivitetit financiar dhe perceptimin e gabuar të vlerësimit, kuotimit dhe administrimit

të rrezikut. Institucionet mbikëqyrëse, ndonjëherë të zëna në grackë në situata strukturash të ndërlikuara, në pamjaftueshmëri burimesh e pamundësi për të ndjekur dhe kuptuar novatorët financiarë të tregut dhe vendndodhjen e rrezikut, nuk ishin në gjendje ta rregullonin situatën në kohën e duhur. Nevoja për të rikthyer dhe ruajtur stabilitetin financiar gjatë kësaj krize të paprecedentë, kërkon marrjen e masave të jashtëzakonshme, të koordinuara dhe të menjëhershme nga autoritetet publike, në fushën monetare dhe atë fiskale. Bankat qendrore kanë hequr çdo kufizim dhe kanë ndërmarrë masa jokonvencionale për të pajisur tregjet financiare me likuiditet. Qeveritë kanë treguar një angazhim shumë të madh për të ulur rrezikun sistemik, duke mbrojtur institucionet e rëndësishme financiare, duke dhënë garanci për kredidhënien ndërbankare dhe duke rritur nivelin e garancive të depozitave për publikun etj..

Kriza po iu jep autoriteteve publike dhe tregjeve kudo në botë mundësinë më të mirë për të identifikuar mangësitë dhe për t'i korrigjuar ato, me qëllim shmangien e një krize të tillë në të ardhmen. Kjo detyrë kërkon masa të fuqishme dhe vizionare, të cilat në periudhë afatmesme do të mundësojnë forcimin e arkitekturës mbikëqyrëse në nivele të ndryshme, por do të krijojnë gjithashtu kushtet fiskale dhe financiare për të shmangur çrregullimet në aktivitetin financiar, jo vetëm në industrinë financiare por edhe në bilancin e individëve dhe të bizneseve. Këto masa do të kërkojnë një bashkërendim dhe përgjegjësi të lartë të autoriteteve publike në nivel kombëtar, si dhe angazhimin për të ndërmarrë hapa të nevojshëm, për reformimin dhe përmirësimin e superstrukturës mbikëqyrëse në nivel rajonal, evropian dhe global. Në nivel evropian, masa të tilla do të mbështeten nga gjetjet dhe rekomandimet e "De Larosiere Report", por sigurisht zbatimi i tyre nuk do të jetë i lehtë. Meqenëse pritet të jetë një model më i centralizuar për banka sistemike në nivel global dhe deri - diku një model më i decentralizuar për institucione financiare më të vogla, shpresojmë që autoritetet mbikëqyrëse në vendet e vogla të kenë një pozicion më të përcaktuar, që do t'iu lejonte përgjegjësi më të qarta dhe një zë më të fuqishëm në komunikim me mbikëqyrësit e vendeve-mëmë.

Pak a shumë, të gjitha vendet e rajonit tonë i kanë rezistuar ndikimit fillestar të drejtpërdrejtë të krizës ndërkombëtare, duke gëzuar një mbrojtje natyrale nga tregjet financiare më pak të zhvilluara dhe të integruara dhe një nivel shumë më të ulët borxhi nga individë dhe biznese, krahasuar me vendet e zhvilluara. Megjithatë, tashmë është e qartë se në kohën e integrimit të vazhdueshëm financiar dhe globalizimit ekonomik, kjo nuk mund të mjaftojë për të kompensuar rreziqet potenciale, që rrjedhin nga rritja ekonomike më pak e diversifikuar, mbështetja e tepërt mbi remitancat, kultura e pamjaftueshme në drejtim të menaxhimit të rrezikut në institucione financiare dhe agjentë të tjerë ekonomikë – në veçanti për rrezikun e kursit të këmbimit dhe të likuiditetit, si dhe hapësira shumë e kufizuar e autoriteteve publike për të prezantuar masa financiare të njëjta me ato të vendeve të zhvilluara. Kështu, masat e politikave duhet të marrin parasysh këto apo të tjera mangësi, me qëllim që të gjejnë zgjidhjen e duhur brenda një periudhe afatmesme. Këto masa duhet të pasqyrojnë preferencën për metoda parandaluese.

...DHE NË SHQIPËRI

Banka e Shqipërisë ka shprehur shqetësimin e saj mbi ndikimin e krizës financiare ndërkombëtare, veçanërisht në lidhje me ecurinë e ekonomisë shqiptare.

Rreziqet ndaj rritjes ekonomike janë rritur dhe lidhen veçanërisht me një rënie të mëtejshme të kredisë të sektorit bankar, rritjen e deficitit tregtar (për shkak të perceptimit në rënie të pasurisë dhe rritjes së papunësisë në vendet e zhvilluara). Besojmë se, aktualisht ka më shumë nevojë për një politikë monetare të matur dhe politikë fiskale të përgjegjshme.

Lidhur me sektorin financiar, besojmë se edhe ai ka nevojë për vendosjen e rregullave të caktuar, që në të ardhmen do të mbështesin një zhvillim më të sigurt dhe më të ekuilibruar të industrisë financiare në përgjithësi dhe të sektorit bankar në veçanti.

Së pari, lidhur me masat e përgjithshme, do të mbështesja çdo masë të tillë që do të kontribuonte në: krijimin e një kuadri të fortë ligjor për titujt dhe të drejtat e pronësisë në Shqipëri, të cilat nga ana e tyre do të ndihmonin në zhvillimin e tregut të mjeteve jofinanciare dhe në rritjen e transparencës për çmimet dhe së fundi, do të forconin procesin e vlerësimit të rrezikut.

Së dyti, duhet të bëhen përpjekje për të zhvilluar tregun financiar jobankar dhe tregun e kapitalit në përgjithësi. Kjo do të ndihmojë për mbështetjen e zhvillimit ekonomik të vendit dhe të agjentëve të ndryshëm në ekonomi, rritjen e mundësive për të financuar nevojat në mënyrë më konkurruese e më të diversifikuar (duke përmirësuar kështu aftësitë e tyre për administrimin e rreziqeve) dhe zbutjen e presioneve që vijnë nga sektori bankar.

Së treti, autoritetet publike në vend (autoritetet mbikëqyrëse dhe qeveria) duhet të kenë plane të shëndosha për ngjarjet e paparashikuara për menaxhimin e ndonjë krize të mundshme financiare. Ngjarjet e kohëve të fundit në vendet e tjera kanë dëshmuar rëndësinë e ekzistencës të një plani veprimesh të koordinuar mirë, të diskutuar, të pranuar dhe të testuar paraprakisht. Së katërti, kur bëhet fjalë për kuadrin mbikëqyrës dhe rregullator të sektorit bankar, jam në favor të ndryshimeve të nevojshme, për ta bërë atë më pak prociklik. Në rastin e Shqipërisë – ku nivelet minimale të kapitalit të kërkuar janë tashmë të larta, unë do të isha në favor të futjes së një modeli provigjonimi dinamik, të përshtatur me strukturën e biznesit dhe me nivelin e sofistikimit teknik të sektorit bankar. Madje, në një pozicion më të përgjithshëm, do të mbështesja rishikimin e kuadrit rregullator drejt qartësisë dhe thjeshtësisë, ndonëse kjo mund të interpretohet sikur po mbështes më shumë një metodë të mbikëqyrjes të bazuar në rregulla.

Mendoj se një kuadër rregullator është vërtet i efektshëm dhe i suksesshëm, kur ndërthur thjeshtësinë dhe transparencën e metodës së bazuar në rregulla me karakteristikat elastike dhe vizionare të një metode të bazuar në parime. Në çdo rast, besoj se kjo gjë është e domosdoshme, për t'i bërë bankat të

përgjegjshme, për të bindur mbikëqyrësin për karakteristikat e rrezikut dhe të kthimit të produkteve të ndryshme të reja, para se ato të kapërcejnë një kufi të caktuar në madhësi dhe ekspozim. Kjo arrihet nëse kuadri mbikëqyrës është gjithmonë i ndërtuar me fokus kryesor në vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut në drejtime të ndryshme të veprimtarisë bankare. Së pesti, kur bëhet fjalë për të zgjedhur ndërmjet huadhënies në monedhën vendase apo në atë të huaj, duhet të mbahen parasysh shumë gjykime lidhur me natyrën e rrjedhjes së monedhës në vend, problemet në mekanizmin e transmetimit të politikës monetare, natyrën e regjimit të kursit të këmbimit, përbërjen e monedhës së mjeteve dhe detyrimeve të sektorit bankar etj.. Në këtë drejtim, ne duhet të mbështesim një rol më të fuqishëm të monedhës vendase në kredidhënien bankare, duke e bërë kredidhënien në valutë më të kushtueshme për bankat, nëse ajo nuk mbështetet nga kursimet me pakicë në valutë. Kështu, mbështetja e tepërt e bankave në burime financiare me shumicë në valutë për të mbështetur kredidhënien e shpejtë, duhet të trajtohet dhe menaxhohet në kohën e duhur.

E gjej këtë takim shumë të dobishëm për të diskutuar rreth këtyre çështjeve dhe rreth çështjeve të tjera që ju keni përcaktuar. Besoj se qëllimi përfundimtar duhet të jetë krijimi i një bashkëpunimi real dhe të efektshëm, që do të mbështesë një metodë të koordinuar, atje ku është e mundshme.

Faleminderit për vëmendjen!

ARTIKUJT E BOTUAR NË BULETININ EKONOMIK 2009

PËRCAKTUESIT E MARZHIT NETO TË INTERESAVE NË SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR

Mars 2009

Irini Kalluci

Ky material trajton marzhin neto të interesave si një matës i eficiencës së bankave që operojnë në sistemin bankar shqiptar dhe fokusi kryesor është në identifikimin e faktorëve që ndikojnë në masën e këtij treguesi. Marzhi neto i interesave mund të llogaritet si raport i të ardhurave neto nga interesat me totalin e aktiveve apo me aktivet që sjellin të ardhura. Megjithatë, një reduktim i këtij treguesi jo në të gjitha rastet sinjalizon përmirësim eficience. Në këto kushte, studimi i faktorëve që mund të shkaktojnë ndryshime në kostot e ndërmjetësimit, përbën një fushë interesante dhe gjerësisht të trajtuar nga literatura e huaj. Sistemi bankar është elementi më i rëndësishëm i sistemit financiar shqiptar, aktivet e të cilit zënë rreth 97 për qind të aktiveve të të gjithë sistemit financiar. Për rastin e Shqipërisë, bankat funksionojnë si aktorët kryesorë në kanalizimin e fondeve nga huadhënësit te huamarrësit, prandaj është e rëndësishme që roli ndërmjetësues i tyre të sigurojë një mirëqenie më të lartë për shoqërinë, mundësisht me kosto sa më të ulëta. Në këtë kontekst mori fillesën edhe ky studim, duke synuar që nëpërmjet tij të identifikohen faktorët që ndikojnë marzhin neto të interesave për sistemin bankar shqiptar dhe duke shpresuar që do të kontribuojë në literaturën e shkruar rreth kësaj çështjeje, meqenëse një studim i tillë realizohet për herë të parë për rastin e Shqipërisë. Grupe të ndryshme interesi, por sidomos politikëbërësit janë të interesuar në ngritjen dhe funksionimin e sistemeve bankare që gëzojnë stabilitet dhe eficiencë. Stabiliteti kërkon kthime të mjaftueshme, ndërsa eficienca ekonomike kërkon marzhe në nivele të pranueshme, të aplikuara nga bankat. Rezultatet e marra nga analiza e faktorëve që ndikojnë marzhin neto të interesave, mund të jenë të dobishme për hartimin e masave specifike të politikave ekonomike.

REZERVA VALUTORE NË SHQIPËRI: MATJA DHE NIVELI NJË ANALIZË KRAHASUESE ME VENDET E RAJONIT

Olta Manjani

Ky material synon të paraqesë një përshkrim të përgjithshëm të treguesve për mbajtjen e rezervës valutore nga autoriteti monetar. Strategjia e Bankës së Shqipërisë për administrimin e rezervës valutore parashikon rritjen e vazhdueshme të saj në përputhje me tiparet kryesore të ekonomisë: deficit i lartë dhe në rritje i llogarisë korente, rritje e shpejtë e borxhit të jashtëm afatshkurtër si dhe zhvendosje e theksuar e parasë së gjerë drejt përbërësit të

saj valutor. Në këto kushte, aplikimi i kritereve të mjaftueshmërisë për matjen e rezervës valutore duhet të mbajë parasysh kritere të tilla si mbulimi me rezervë në vlerë i 3 - 4 muajve importe mallrash dhe shërbimesh, mbulimi me rezervë në vlerë i një ose mbi një vit i borxhit të jashtëm afatshkurtër apo mbulimi me rezervë nga 5 deri në 20 për qind të sasisë së parasë së gjerë. Zbatimi i këtyre kritereve, përveçse shërben për t'u paraprirë faktorëve potencialë të rrezikut që mund të cënojnë ekonominë shqiptare gëzon një shkallë të lartë kredibiliteti dhe siguron një bazë të mirë krahasuese midis vendeve të ndryshme.

ARTIKUJ

"Ju mund të mashtroni një pjesë të njerëzve gjithmonë dhe të gjithë njerëzit disa herë, por ju nuk mund të mashtroni të gjithë njerëzit, për të gjithë kohën."

Abraham Lincoln

MATJA E PRITSHMËRIVE TË INFLACIONIT*

ABSTRAKT

Në këtë material jemi përpjekur që të zbatojmë disa teknika të kuantifikimit të përgjigjeve të mbledhura nëpërmjet vrojtimit të besimit të konsumatorit, që kryhet nga Banka e Shqipërisë. Në të njëjtën kohë bëhen disa përpjekje për të kuptuar më mirë natyrën e pritjeve të konsumatorëve shqiptarë, të cilat rezultojnë të jenë të një natyre adoptive. Kështu, nëse norma e inflacionit rritet, konsumatorët presin një rritje edhe më të madhe të inflacionit për periudhën në vazhdim.

1. HYRJE

Objektivi kryesor i shumë bankave qendrore është ruajtja e stabilitetit të çmimeve dhe për këtë arsye ekziston një literaturë e gjerë mbi faktorët që ndikojnë në inflacion. Analiza e rolit që kanë pritjet e konsumatorëve në procesin e formimit të çmimeve ka marrë një rëndësi të veçantë në këtë kontekst. Teoria e pritjeve racionale daton që në fillim të viteve gjashtëdhjetë, ku John F. Muth (1960) formuloi për herë të parë në mënyrë të saktë hipotezën mbi pritjet racionale dhe përdori termin e pritjeve për të përshkruar shumë situata ekonomike në të cilat rezultati varet nga ajo çka njerëzit presin që të ndodhë, kjo e parë në një treg të vetëm i cili ishte në gjendje të pjesshme ekuilibri. Por teoria e pritjeve racionale të konsumatorëve arriti të fitojë rëndësi vetëm pas disa dekadash kur fituesi i çmimit Nobel në vitin 1995, Robert Lucas, e zgjeroi këtë hipotezë në modele makroekonomike dhe në analizën e politikave ekonomike. Tashmë ka një konsensus të gjerë midis ekonomistëve se agjentët ekonomikë nuk bëjnë gabime të vazhdueshme në kohë gjatë procesit të parashikimit. Supozohet se njerëzit janë në gjendje që të dallojnë apo zbulojnë modele në gabimet e shkuara të parashikimit dhe ta bazojnë sjelljen e tyre në parashikimin "më të mirë të mundshëm" të kushteve ekonomike (Bullard 1991). Pranimi i këtij supozimi nga një spektër i gjerë studiuesish ka qenë çelësi i suksesit të teorisë së pritjeve racionale.

Proceset e formimit të pritjeve dhe arritjes së rezultateve kanë varësi të ndërsjellë. Gjatë procesit të formimit të pritjeve, agjentët përpiqen të parashikojnë se çfarë do të ndodhë dhe janë të nxitur të përdorin rregulla, që funksionojnë mirë pasi nëse arrijnë në parashikime të sakta kanë "fitime"

të larta. Nga saktësia e parashikimit përfiton si një individ që do të tregtojë në bursë ashtu edhe dikush që merr në konsideratë të blejë një makinë të re. Kur njerëzit duhet të parashikojnë në mënyrë të vazhdueshme çmimin e një produkti apo të një shporte produktesh, kanë tendencën të përshtatin rregullat e parashikimit, me qëllim që të mënjanojnë gabimet e mundshme. Pra, ka një qarkullim të vazhdueshëm midis rezultateve të kaluara dhe pritjeve aktuale.

Rëndësia e inflacionit të pritshëm – inflacioni që bazohet në pritjet e konsumatorëve, rezulton nga fakti që ai ndikon në sjelljen e agjentëve ekonomikë, përsa i përket vendimeve që ata marrin për konsum, kursim apo investim (Lyziak 2003). Inflacioni i pritshëm mund të shërbejë edhe si një tregues domethënës i inflacionit në të ardhmen. Matja sasiore e tij mund të përdoret si një variabël në analizat parashikuese të inflacionit, pasi pritjet e inflacionit ndikojnë vendimet për caktimin e çmimeve dhe të pagave (Forsells dhe Kenny, 2002). Në të njëjtën kohë, krahasimi (ose devijimi) i pritshmërive mbi inflacionin që manifeston publiku me objektin e inflacionit të bankës qendrore, shërben si mjet kontrolli për kredibilitetin e autoritetit monetar (Berk 2000).

Inflacioni i pritshëm luan një rol të rëndësishëm në përcaktimin e çmimeve dhe të pagave. Kështu, duke ndikuar normën reale të interesit, ndryshimet në inflacionin e pritur ndikojnë kërkesën agregate që sjell ndryshimin e çmimeve. Nga ana tjetër, pritshmëria për një inflacion në rritje nga ana e punonjësve do të sjellë një kërkesë për paga më të larta, e cila do të detyrojë firmat që të përshtatin çmimet e shitjes për të përballuar rritjen e kostos.



Materiali është i organizuar si vijon: seksioni 2 trajton rëndësinë e pritjeve në procesin e kontrollit të inflacionit dhe mënyrën e matjes së tyre. Seksioni 3 vijon me metodologjinë e konvertimit të të dhënave nga cilësore në sasiore, duke përdorur disa lloje funksionesh të metodës së kuantifikimi probabilitar si dhe trajtohen testet e treguesit të inflacionit të pritur, për të arritur në konkluzione në lidhje me natyrën e pritjeve të konsumatorëve. Në seksionin që vijon, zbatohet metodologjia dhe testet në rastin e Shqipërisë. Materiali mbyllet me disa konkluzione paraprake.

2. KONSIDERATA TEORIKE

2.1 PRITJET E INFLACIONIT DHE POLITIKA MONETARE

Banka e Shqipërisë, prej disa kohësh, ka hartuar një plan veprimi i cili synon të rrisë eficiencën e kanalit të komunikimit me publikun. Objektivi i rritjes së eficiencës së komunikimit është arritja e një shkalle më të lartë transparence dhe llogaridhënieje ndaj publikut, të cilat në vetvete shërbejnë për të rritur besueshmërinë e tij për veprimet e ndërmarra nga autoriteti monetar. Komunikimi është një aspekt shumë i rëndësishëm i transmetimit të vendimeve të politikës monetare. Transparenca e politikës monetare dhe besueshmëria e bankës qendrore, në mënyrë të veçantë kur zbatohet regjim i shënjestrimit direkt të inflacionit, përbëjnë parakushtet për arritjen e objektivit të stabilitetit të çmimeve (Lyziak 2003).

Duke parë rëndësinë që kanë pritjet e publikut në arritjen e objektivit të inflacionit, bankat qendrore janë të interesuara të monitorojnë sjelljen e pritjeve të inflacionit dhe të kuptojnë procesin e formimit të pritjeve të publikut. Nëpërmjet dy shembujve të thjeshtë mund të nxjerrim në pah se sa e rëndësishme është të kemi një matje të besueshme të inflacionit të pritur. Së pari, në kushtet që pritjet shërbejnë si parashikues të inflacionit në të ardhmen, treguesit e pritjeve përfaqësojnë një variabël të rëndësishëm informacioni në një analizë afatgjatë të zhvillimit të çmimeve. Së dyti, nëse punonjësit mendojnë se çmimet do të rriten ata do të kërkojnë paga më të larta, dhe nëse kjo është edhe pritja e përgjithshme e ekonomisë, atëherë firmat / punëdhënësit do të synojnë të rrisin pagat pasi kanë mundësinë që t'i transferojnë ndryshimet e kostove në çmime më të larta (skema 1).



2.2 FORMIM I PRITJEVE DHE METODAT E VLERËSIMIT TË PRITJEVE

Argumentuam se pritjet e inflacionit mund të jenë shumë të dobishme në vlerësimin e besueshmërisë së politikës monetare dhe gjykimet mbi racionalitetin empirik të tyre po bëhen gjithmonë e më të vlefshme në procesin e drejtimit të politikës monetare. Për të vlerësuar dhe kontrolluar karakteristikat empirike të pritjeve të inflacionit është e rëndësishme gjetja e metodologjive, të cilat mund të mbledhin nga publiku pritjet dhe t'i transformojnë ato në seri kohore. Ky proces shpesh është cilësuar i vështirë, për shkak të gabimeve që shoqërojnë procedurat e agregimit apo gjenerimit të tyre.

Figurë 1. Formimi i pritshmërive të inflacionit.



Diagrama e mësipërme paraqet formimin e perceptimeve të inflacionit përgjatë periudhave 12-mujore, duke shfrytëzuar njohuritë mbi inflacionin e publikuar. Seria e pritjeve të inflacionit përbëhet nga vlerat e inflacionit të pritur π^e për periudhën pasardhëse, ndërkohë që agjentët kanë informacion mbi inflacionin aktual të publikuar π^a. Është e nevojshme gjithashtu të dallojmë midis inflacionit aktual π^a dhe atij aktual të perceptuar π^p. Perceptimi i publikut për inflacionin në kohën *t* mund të mos jetë i barabartë me normën e publikuar aktuale.

Nëse si bazë referimi marrim një moment të caktuar kohe *t*, atëherë, duke disponuar informacion për inflacionin aktual π_t^a agjentët formojnë pritjet e tyre të inflacionit π_{t+12}^e për periudhën pasardhëse, në këtë rast 12-mujore. Zgjedhja e gjatësisë së periudhës në përgjithësi kushtëzohet nga motivimi për të bërë pritjet të krahasueshme me objektivat vjetorë të kontrollit të inflacionit. Megjithatë, në vazhdim do të shohim se në rastin e Shqipërisë pritjet janë analizuar për periudhën tremujore dhe jo atë njëvjeçare, dhe se avantazhet e zgjedhjes së njërës ndaj tjetrës mbeten të diskutueshme, në mungesë të të dhënave njëvjeçare të mjaftueshme për të bërë krahasime[1].

Përgjigjet e konsumatorëve do të kuantifikohen me qëllim që të përftohet seria e pritjeve, e cila shprehet në formën [π_t^e, π_{t+12}^e, π_{t+24}^e...].

Në literaturë evidentohen tre metoda të cilat bëjnë të mundur mbledhjen e informacionit mbi pritjet e publikut për inflacionin.

Një mënyrë është ajo e ndërtimit të modeleve ekonomike, që përcaktojnë inflacionin në varësi të disa variablave, ndër të cilët përfshihen edhe pritjet e inflacionit. Për vlerësimin e ekuacioneve, pritjet përafrohen me vlerat *e kaluara* apo *të vonuara* të inflacionit, sipas supozimeve paraprake për mënyrën e formimit të tyre. Në disa raste, në model përdoren pritje të gjeneruara nga kuantifikimi i të dhënave të vrojtimeve[2]. Vlerësimi i ekuacioneve jep informacion mbi mënyrën e formimit të pritjeve, nëse janë të drejtuara në të ardhmen dhe në përgjithësi shkallën e tyre të racionalitetit. Megjithatë, analiza e pritjeve të inflacionit në këtë rast është indirekte dhe e kushtëzuar nga zgjedhja e modelit të sjelljes[3].

Një mënyrë tjetër e përhapur për matjen e pritjeve është duke përdorur çmimet e instrumenteve financiare. Një mënyrë zbatimi e kësaj metode do të ishte duke vrojtuar ecurinë e çmimit të instrumenteve të borxhit nominal dhe atyre të indeksuara me të njëjtat karakteristika në lidhje më rrezikun, likuiditetin dhe maturitetin. Pritjet e përftuara sipas kësaj metode kanë një shkallë të lartë saktësie (Berk 2000). Megjithatë, ka disa vështirësi të lidhura me zbatimin praktik të kësaj metode. Numri i kufizuar i instrumenteve të indeksuara të borxhit bën të nevojshëm ngritjen e një sërë supozimesh të cilat ndikojnë (negativisht) në cilësinë e serisë kohore të përftuar, të pritjeve mbi inflacionin. Gjithashtu, një mangësi tjetër e përdorimit të instrumenteve financiare lidhet me tendencën që kanë tregjet financiare për të reaguar më shumë se duhet ndaj informacionit të ri, duke shkaktuar kështu situata paniku apo spekulative, të cilat sërish ndikojnë në uljen e cilësisë informative të vlerësimeve të përftuara me këtë mënyrë (Mylonas dhe Schich 1999).

Mënyra më e përdorur e matjes së pritjeve, tek e cila do të përqendrohemi në vazhdim, mbështetet tek vrojtimi. Kjo metodë është gjerësisht e përdorur nga shumë banka qendrore dhe ka disa avantazhe kundrejt metodave të tjera. Veçanërisht, mund të përmendim mundësinë për modelimin e pritjeve dhe thjeshtësinë e matjes. Gjithashtu, sipas kësaj metode nuk është e nevojshme që të ngrihen supozime shtesë, të cilat mund të ndikojnë në saktësinë e treguesit. Megjithatë, shpesh është e vështirë të marrësh opinionin e vërtetë të intervistuarit, për shkak se nuk ekziston një nxitje për të raportuar ose edhe kur i intervistuari shpreh opinionin e vërtetë mbi pritjet, nuk ekziston një nxitje për të vepruar sipas këtij opinioni si në rastin e tregut financiar, për shkak të sjelljeve jo gjithmonë racionale. Ndërkohë ekzistojnë edhe gabime të lidhura me zgjedhjen e të intervistuarve apo me mënyrën e hartimit të pyetësorëve, gabime të cilat janë të vështira për t'u kuantifikuar.

Matja e pritshmërive të inflacionit nga vrojtimet është një metodë gjerësisht e përdorur, por të vendosësh nëse këto pritshmëri janë përfaqësuese të mira të besimit të vërtetë të publikut kjo është një pikë e diskutueshme. Megjithatë,

për qëllimin e këtij propozimi do të mbështetemi tek vrojtimi i besimit të konsumatorit. Për të konvertuar përgjigjet cilësore në tregues sasiorë të pritshmërive, do të përdoret metoda probabilitare e rregulluar, e ideuar nga Carlson dhe Parkin (1975),

3. METODOLOGJIA

3.1 LLOGARITJA E NORMËS SË PRITUR TË INFLACIONIT NËPËRMJET VROJTIMIT TË BESIMIT TË KONSUMATORIT

Për llogaritjen e pritshmërive për inflacionin janë shfrytëzuar të dhënat cilësore që vijnë nga vrojtimi i besimit të konsumatorit. Në këtë vrojtim mblidhet informacion nga rreth 1200 konsumatorë çdo tre muaj. Pyetjet e vrojtimit për pritshmëritë për inflacionin janë të ndërtuara në mënyrë të tillë që konsumatori nuk përcakton një vlerë numerike, por vetëm tregon drejtimin e pritur dhe ritmin e ndryshimit të çmimeve, duke e krahasuar këtë parashikim me ritmin e ndryshimit të çmimeve të periudhës tremujore kur kryhet vrojtimi. Ata i përgjigjen pyetjes së mëposhtme: *"Si mendoni se do të ndryshojnë çmimet në 3 muajt e ardhshëm (muajt përkatës)?: 1) do të rriten me ritëm të lartë, 2) do të rriten me të njëjtin ritëm, 3) do të rriten me ritëm më të ulët, 4) nuk do të ndryshojnë, 5) do të ulen pak"*. Përqindjet e çdo kategorie të kësaj pyetjeje, për të pesëmbëdhjetë vrojtimet e kryera deri më tani, jepen në grafikun 1:

Grafik 1. Tendencat e përgjigjeve të vrojtimit të IBK lidhur me ndryshimin e pritur të çmimeve.



Burimi: Vrojtimi i besimit të konsumatorit.

Nga grafiku, vihet re se tendenca sezonale rënëse e çmimeve në muajit e verës (kemi rritje të përqindjes së përgjigjes "do të ulen pak") është perceptuar edhe nga ana e konsumatorëve, ashtu si dhe rritja e tyre pas përfundimit të këtij sezoni.

3.2 TEKNIKA E KUANTIFIKIMIT - METODAT PROBABILITARE

Metoda probabilitare sasiore për të llogaritur pritshmëritë për inflacionin u përdor për herë të parë nga Theil (1952). Kjo metodë ofronte një alternativë kundrejt metodës tjetër të thjeshtë "të balancës", e cila përcaktonte si vlerë për pritshmëritë diferencën e përqindjes së konsumatorëve që prisnin rritje të çmimeve me përqindjen e atyre që prisnin ulje të tyre.

Për të përdorur këtë metodë janë të nevojshme dy supozime. Së pari, për çdo individ supozohet se ekziston një funksion probabiliteti në lidhje me ndryshimin e çmimeve të pritura dhe së dyti, supozohet se nëse çmimi i pritur ndryshon brenda një intervali të caktuar (-s,+s), individi përgjigjet që çmimi i

pritur nuk do të ndryshojë. Ky interval quhet ndryshe "intervali i ndjeshmërisë" ose "intervali i indiferencës".

Në këtë material funksioni i probalitetit i përdorur për të përshkruar përgjigjen e konsumatorit mbi çmimet e pritura është ai normal, duke qenë se në rastin e vrojtimit tonë, plotësohet kushti për këtë shpërndarje, pra që numri i individëve që përgjigjen të jetë i madh (rreth 1200 konsumatorë).

Për matjen e pritshmërive për inflacionin shënojmë me:

a - përqindjen e individëve të cilët presin që çmimet të rriten me ritëm të lartë.
b - përqindjen e individëve të cilët presin që çmimet të rriten me të njëjtin ritëm.
c - përqindjen e individëve të cilët presin që çmimet të rriten me ritëm të ulët.
d - përqindjen e individëve të cilët presin që çmimet të mos ndryshojnë.
e - përqindjen e individëve të cilët presin që çmimet të ulen lehtë.
Π^{e}_{+3} - normën e pritur të ndryshimit të çmimeve gjatë tremujorit paraardhës, e supozuar me një shpërndarje normale (m, σ^2).
Π_0 - normën aktuale të ndryshimit të çmimeve gjatë tremujorit paraardhës.
f - funksionin e densitetit të normës së pritur të inflacionit.
F - funksionin e shpërndarjes kumulative të normës së pritur të inflacionit.
Nz - funksionin e shpërndarjes kumulative normale të standardizuar.

Në grafikun 2 paraqitet metoda e rregulluar e Carlson and Parkin (1975), e zbatuar me rezultatet e vrojtimit të besimit konsumator.

Pas kryerjes së disa transformimeve algjebrike dhe përdorimit të funksionit të shpërndarjes kumulative normale të standardizuar përfitojmë këtë rezultante për normën e pritur të inflacionit:

$$m = \Pi_0(C+D)/\ C+D-(A+B)$$

$$\sigma = -2\Pi_0\ /\ C+D-(A+B)$$

ku $A= Nz^{-1}(1-a)$; $B= Nz^{-1}(1-a-b)$; $C= Nz^{-1}(1-a-b-c)$; $D= Nz^{-1}(1-a-b-c-d)$; $E= Nz^{-1}(e)$.

Grafik 2. Metoda e rregulluar e Carlson and Parkin (1975).



Burimi: Carlson and Parkin.

dhe m - është norma mesatare e pritur e inflacionit.

Kategoritë e përgjigjes mbi ndryshimet e çmimeve në të ardhmen në rastin e Shqipërisë paraqiten në tabelën 1 të shtojcës statistikore.

3.3 FUNKSIONET E SHPËRNDARJES

Zgjedha e funksionit të shpërndarjes nuk është një proces i lehtë. Carlson dhe Parkin (1975) propozojnë të përdoret shpërndarja normale duke e justifikuar këtë supozim nëpërmjet teoremës së limitit qendror. Shumë studime empirike ndjekin këtë sugjerim për lehtësi, pasi shpërndarja normale është lehtësisht dhe gjerësisht e përdorshme.

3.3.1 Duke supozuar shpërndarjen normale kemi:

Forma e përgjithshme:

$$
\begin{aligned}
{}_te_{t+1} &= \Phi^{-1}({}_tE_{t+1}) \\
{}_td_{t+1} &= \Phi^{-1}({}_tE_{t+1} + {}_tD_{t+1}) \\
{}_tc_{t+1} &= \Phi^{-1}({}_tE_{t+1} + {}_tD_{t+1} + {}_tC_{t+1}) \\
{}_tb_{t+1} &= \Phi^{-1}({}_tE_{t+1} + {}_tD_{t+1} + {}_tC_{t+1} + {}_tB_{T+1})
\end{aligned}
$$

Ku Φ është funksioni i shpërndarjes standard normale kumulative.

Pavarësisht avantazheve që ofron shpërndarja normale ajo mund të mos përshtatet me gjetjet empirike. Ka arsye teorike dhe empirike për të mos pranuar supozimet e bëra në rastin e shpërndarjes normale. Një deviacion i vërejtur nga Carlson (1975) dhe Lahiri dhe Teigland (1987) ndërsa analizonin parashikimin e inflacionit po kështu dhe nga Vining dhe Elwertowski (1976), për ndryshimet e çmimeve aktuale është gjetja që *peakedness* (kulmimi) i cili nuk i përshtatet shpërndarjes normale. Për këtë arsye, kemi aplikuar shpërndarjet logistic dhe simetrike e studentit (central t) të cilat janë më *peaked* se shpërndarja normale.

3.3.2 Funksioni i *shpërndarjes logjistike* përcaktohet si:

Forma e përgjithshme:

$$
H(x_{t+1} / \Omega_t) = \frac{1}{1 + e^{\frac{-x_{t+1} - {}_tm_{t+1}}{\beta_t}}}
$$

Ku β_t - është parametri i shkallës dhe ${}_t\sigma_{t+1} = \frac{\Pi}{\sqrt{3}}\beta_t$. Mesatarja llogaritet si në rastin e shpërndarjes normale dhe deviacioni standard sipas[5]:

$$
{}_t\sigma_{t+1} = -m_t \cdot \frac{2\Pi}{\sqrt{3}} \cdot {}_tq_{t+1}
$$

Si rrjedhim:

$$
\begin{aligned}
{}_te_{t+1} &= ln\,({}_tE_{t+1} / 1 - {}_tE_{t+1}) \\
{}_td_{t+1} &= ln\,[({}_tE_{t+1} + {}_tD_{t+1}) / (1 - ({}_tE_{t+1} + {}_tD_{t+1})] \\
{}_tc_{t+1} &= ln\,({}_tE_{t+1} + {}_tD_{t+1} + {}_tC_{t+1}) / [1 - ({}_tE_{t+1} + {}_tD_{t+1} + {}_tC_{t+1})] \\
{}_tb_{t+1} &= ln\,\{({}_tE_{t+1} + {}_tD_{t+1} + {}_tC_{t+1} + {}_tB_{t+1}) / [1 - ({}_tE_{t+1} + {}_tD_{t+1} + {}_tC_{t+1} + {}_tB_{t+1})]\}.
\end{aligned}
$$

3.3.3 Shpërndarja simetrike e studentit përcaktohet si:

Forma e përgjithshme:

$$T_c = \frac{Y_1}{\sqrt{Y_2/n}}$$

Ku Y_1 ndjek shpërndarjen probabilitare normale dhe Y_2 është i shpërndarë në mënyrë të pavarur si $\aleph^2$me *n* shkallë lirie.

Varianca e shpërndarjes së studentit (central t) jepet nga $\frac{n}{n-2}, n > 2$.

Praetz (1972) tregon se për të modeluar më mirë shpërndarjen e ndryshimeve në çmimet e aksioneve përdoret një shpërndarje central t, e shkallëzuar me deviacionin standard.

Si rrjedhojë, variabli i standardizuar është shkallëzuar me $\theta^1 = \sqrt{\frac{n}{n-2}}$ dhe ekuacionet janë:

$$_t e'_{t+1} = \theta^{(1)}\ _t e'_{t+1} = T_C^{-1}\ (_t E_{t+1})$$
$$_t d'_{t+1} = \theta^{(1)}\ _t d'_{t+1} = T_C^{-1}\ (_t E_{t+1} +_t D_{t+1})]$$
$$_t c'_{t+1} = \theta^{(1)}\ _t c'_{t+1} = T_C^{-1}\ (_t E_{t+1} +_t D_{t+1} +_t C_{t+1})$$
$$_t b'_{t+1} = \theta^{(1)}\ _t b_{t+1} = T_C^{-1}\ (_t E_{t+1} +_t D_{t+1} +_t C_{t+1} +_t B_{t+1})$$

Ku:

$$_t m_{t+1} = m'_t \cdot (_t e'_{t+1} +_t d'_{t+1})\ _t q'_{t+1}$$
$$_t \sigma_{t+1} = -m'_t\ 2\theta^{(1)}\ _t q'_{t+1}$$

Ku $_t q'^{-1}_{t+1} =_t e'_{t+1} +_t d'_{t+1} -_t c'_{t+1} -_t d'_{t+1}$

Shpërndarja uniforme



Në këtë rast lidhjet e mëposhtme duhet të kihen në konsideratë:

$a = 1/2q \cdot (m + q - \pi_0 - s)$

$b = s/q$

$c = 1/2q \cdot (\pi_0 - s - t)$

$d = t/q$

$e = 1/2q \cdot (- t - m - q)$

Ku grupi i këtyre variablave të varur përcaktohet nga *m* (mesatarja e pritur e ndryshimit të çmimeve), *q* (gjysma e diferencës midis minimumit dhe maksimumit të inflacionit të pritur) dhe *s* e *t* janë intervalet e ndjeshmërisë. Ka gjashtë variabla shpjegues a, b, c, d, e (të cilët janë fraksione të përgjigjeve për pyetjet përkatëse) dhe π_0 (norma aktuale e inflacionit). Zgjidhja e ekuacioneve mund të shprehet si:

$$s = \frac{b \cdot \pi_0}{2c + b + d}$$

$$q = \frac{\pi_0}{2c + b + d}$$

$$t = \frac{d \cdot \pi_0}{2c + b + d}$$

$$m = \frac{\pi_0 - (1 - d - 2e)}{2c + b + d}$$

Ku ekuacioni i fundit përcakton normën e pritur të inflacionit sipas kësaj shpërndarjeje.

3.4 TESTIME BAZË PËR RACIONALITETIN

Metodat e matjes së inflacionit të pritur, të përshkruara në seksionin e mësipërm ndihmojnë për të përfituar një informacion të dobishëm për zhvillimet e ardhshme të çmimeve të konsumit krahasuar me disa metoda të thjeshta, të bazuara në balancën e përgjigjeve të konsumatorëve. Në këtë seksion, bëhet një përpjekje për t'i testuar treguesit e inflacionit të pritur me qëllim që të arrihet në konkluzione në lidhje me natyrën e pritjeve të konsumatorit shqiptar.

Matja e pritjeve përfshin pothuajse gjithmonë testime të mëtejshme mbi natyrën dhe veçoritë, të cilat përgjithësisht lidhen me shkallën e racionalitetit të pritshmërive. Kjo sepse natyra e pritjeve ndikon në mënyrën e reagimit të agjentëve ndaj veprimeve të institucionit politikëbërës, në rastin tonë të Bankës

së Shqipërisë. Racionaliteti i pritjeve është një koncept i lidhur me mënyrën e formimit të tyre. Në rastin e hipotezës së pritjeve racionale supozohet që agjentët marrin në konsideratë gjithë informacionin e disponueshëm për të bërë parashikime të pazhvendosura *(unbiased)*. Ndërsa në rastin e hipotezës së pritjeve adoptive, agjentët ekonomikë mbështeten vetëm në informacionin e kaluar të variablit.

Ekzistojnë interpretime të ndryshme lidhur me vetitë e serive të pritjeve që i bëjnë ato racionale ose jo, megjithatë testimet kryesore përfshijnë ato për zhvendosje (bias), rishikim periodik të gabimeve të parashikimit dhe eficiencën makroekonomike.

Kështu, testimi për zhvendosje (*bias*) na ndihmon të përcaktojmë nëse në periudhën afatgjatë, publiku e parashikon (mesatarisht) në mënyrë të saktë normën e inflacionit apo nëse kjo normë nënçmohet/mbiçmohet në mënyrë sistematike. Ky testim bazohet mbi ekuacionin:

$$\pi_t = \alpha + \beta\pi_t^e + \varepsilon_t$$

dhe nëse hipoteza $H_0:(\alpha, \beta) = (0,1)$ nuk mund të hidhet poshtë, atëherë mund të themi që pritjet janë të pazhvendosura në kuptimin statistikor (Shih: Forsells & Kenny 2002, Lyziak 2003).

Në përgjithësi, rezultatet e testit tregojnë se treguesi i inflacionit të pritur nga ana e konsumatorit është një vlerë e parashikuar jo e mirë për inflacionin 3 muaj më tej. Në terma statistikorë, për të gjithë periudhën e vrojtuar (tremujori i tretë 2003 -tremujori i katërt 2006) hipoteza zero hidhet poshtë në të shumtën e rasteve.

Seria e shkurtër e të dhënave të vrojtimit të besimit të konsumatorit[6] ndikon në mënyrë të rëndësishme në rezultatin e mësipërm. Gjatësia e serisë së pritshmërive të inflacionit është e pamjaftueshme për kryerjen e testimeve të mëtejshme[7] për të zbuluar vetitë dinamike të pritjeve të cilat ofrojnë më tepër informacion se testimet e mësipërme, në lidhje me mënyrën e evoluimit të këtyre pritjeve në kohë.

4. ZBATIMI I METODAVE PROBABILITARE PËR RASTIN E SHQIPËRISË

Në grafikët e mëposhtëm paraqitet norma e pritur e inflacionit tremujor, e llogaritur sipas funksioneve përkatëse të shpërndarjeve probabilitare. Në grafikun e parë, në llogaritjen e inflacionit të pritur është marrë për bazë norma mesatare e inflacionit e tremujorit të fundit. Ndërsa në grafikun e dytë, për llogaritjen e inflacionit të pritur është përdorur norma tremujore e inflacionit. Periudha kohore e të dhënave përfshin tremujorin e dytë të vitit 2003 deri në tremujorin e parë të vitit 2009. Informacioni i paraqitur në grafikët 1,2 dhe 4 është i tillë që norma aktuale mesatare apo ajo e thjeshtë tremujore e inflacionit, vihet në të njëjtën periudhë me normën

Grafik 3. Inflacioni i pritur, i llogaritur sipas inflacionit mesatar aktual tremujor dhe shpërndarjet probabilitare përkatëse.



Burimi: Llogaritje të autorëve.

Grafik 4. Inflacioni i pritur, i llogaritur sipas inflacionit aktual tremujor dhe shpërndarjet probabilitare përkatëse.



Burimi: Llogaritje të autorëve.

mesatare apo të thjeshtë të inflacionit të pritur, por të parashikuar një periudhë më parë.

Nga grafikët duket se norma e parashikuar e inflacionit për shpërndarjet normale, logjistike dhe atë uniforme ndjek normën aktuale të inflacionit si atë tremujore ashtu dhe atë mesatare tremujore me një vonesë prej një periudhe kohore. Kjo duket dhe më qartë në grafikun 3 ku norma aktuale e inflacionit vihet në grafik në të njëjtën periudhë kohore me normën e pritur të inflacionit, për periudhën *t+1* të parashikuar në periudhën *t*. Kështu, nëse inflacioni aktual rritet dhe për periudhën në vazhdim pritshmëritë janë për një rritje më të madhe të inflacionit dhe anasjelltas. Funksioni i shpërndarjes normale ka një zhvendosje më të madhe në krahasim me dy funksionet e tjera nga inflacioni aktual, e cila vjen duke u ngushtuar me kalimin e kohës. Kjo mund të shpjegohet me edukimin e publikut apo dhe me familjarizimin e të intervistuarve me pyetësorin e konsumatorit.

Grafiku i funksionit të shpërndarjes së studentit paraqitet i përmbysur në krahasim me tre grafikët e funksioneve të tjera të shpërndarjeve probabilitare. Kështu, pikat më të larta të inflacionit të parashikuar nëpërmjet funksionit të shpërndarjes së studentit i korrespondojnë pikave më të ulëta të inflacionit të parashikuar sipas shpërndarjes normale dhe anasjelltas.

Grafik 5 Inflacioni i pritur i periudhës t+1 dhe inflacioni aktual (i thjeshtë apo mesatar).



Burimi: Llogaritje të autorëve.

Grafik 6. Inflacioni i pritur i periudhës t sipas shpërndarjes së studentit dhe asaj normale dhe inflacioni aktual i periudhës t (i thjeshtë apo mesatar).



Burimi: Llogaritje të autorëve.

Nëse shohim grafikun në të cilin norma aktuale e inflacionit vihet në grafik me normën e pritur të inflacionit të periudhës *t+1*, vihet re që ai është i përmbysur në krahasim me atë e inflacionit aktual mesatar apo të thjeshtë.

Grafik 7. Inflacioni i pritur i periudhës t+1 dhe inflacioni aktual (i thjeshtë apo mesatar).



Burimi: Llogaritje të autorëve.

Përfundimet e mësipërme gjejnë mbështetje dhe në rezultatet e ekuacioneve statistikore të aplikuara për secilin rast të funksionit të shpërndarjes probabilitare (shih rezultatet në aneks) si dhe në llogaritjet e gabimit të parashikimit. Nga aplikimi i ekuacioneve duket që lidhja midis inflacionit aktual dhe atij të pritur është më e fortë në rastin kur inflacioni i periudhës *t* vihet në regresion me inflacionin e pritur të periudhës *t+1*. Po kështu nga rezultatet e ekuacioneve, konkretisht koeficentin R^2 dhe rezultatet e matjes së Rrënjën Katrore të Mesatares së Gabimit konstatojmë që konsumatorët e intervistuar i formojnë pritjet e tyre për inflacionin tremujor të periudhës *t*, duke u nisur nga inflacioni mesatar i tremujorit të mëparshëm *(t-1)*[8]. Sjellja adoptive e konsumatorëve

reflektohet dhe në rezultatet e testit të matjes së racionalitetit të pritjeve ku H:(α, β) = (0,1) hidhet poshtë.

4.1 VLERËSIMI I GABIMIT TË PARASHIKIMIT

Për të matur cilësinë e parashikimeve të inflacionit dhe për të krahasuar mënyrat e ndryshme të aplikuara për llogaritjen e pritshmërive të inflacionit kemi përdorur metodën e Rrënjës Katrore të Mesatares së Gabimit (RKMG). RKMG llogaritet sipas formulës:

$$RKMG = \{\sum_{t=1}^{T}(F_t - A_t)^2\}^{\frac{1}{2}}$$

Ku T - është numri i parashikimeve të inflacionit, F- është inflacioni i pritur (ose i parashikuar) dhe A- inflacioni aktual.

Llogaritjet e këtij treguesi statistikor bazuar në të dhënat e vrojtimeve paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabelë 1. Treguesi RKMG i inflacionit të pritur i llogaritur me metodat probabilitare.

RKMG		
Funksioni shpërndarjes	Sipas inflacionit mesatar tremujor	Sipas inflacionit tremujor
Logjistike	9.5	12.9
Normale	33.1	38.3
t-student e centruar	13.9	10.3
Uniforme	9.3	12.7

Burimi: Llogaritje të autorëve.

Rezultatet tregojnë se inflacioni mesatar tremujor është një vlerë që merret në konsideratë më shumë nga ana e konsumatorëve kur ata formojnë pritjet për tremujorin pasardhës për treguesin e inflacionit. Ndërkohë, vlera e treguesit sugjeron se vlerat më të afërta për pritjet e konsumatorit për periudhën afatshkurtër modelohen më mirë duke aplikuar metodën probabilitare që merr për bazë funksionet e shpërndarjes logjistike apo atë uniforme. Ky fakt evidentohet qartë edhe nga grafiku 2 i këtij studimi.

5. PËRFUNDIME

Në këtë material për të llogaritur inflacionin e pritur janë përdorur të dhënat cilësore tremujore të marra nga vrojtimi i indeksit të besimit të konsumatorit (të BSH) për periudhën shtator 2003- mars 2009. Në mungesë të një serie të konsiderueshme[9] të të dhënave me bazë vjetore, pritshmëritë e inflacionit janë llogaritur me bazë tremujore. Për të transformuar të dhënat e pyetësorit nga cilësore në sasiore është aplikuar metoda probabilitare. Ndërsa për të eliminuar rastet e zhvendosjeve (shtrembërimeve dhe kulmimeve) nga normalja janë aplikuar funksione të ndryshme të shpërndarjeve probabilitare.

Nga testet e aplikuara rezulton se konsumatorët nisen nga një mesatare e normave të inflacionit të tre muajve të fundit në momentin që duhet të bëjnë

një parashikim të inflacionit për tremujorin në vazhdim. Kështu, nëse norma mesatare e inflacionit rritet, të intervistuarit presin një rritje edhe më të madhe të inflacionit për periudhën në vazhdim dhe anasjelltas. Në këtë mënyrë sjellja e konsumatorëve shqiptarë duket të jetë një sjellje adoptive që mbështetet në informacionin e kaluar të variablit.

Megjithatë, kjo çështje mbetet për t'u shqyrtuar në vazhdimësi pasi përmirësimi në perceptimin e konsumatorëve mbi treguesit makroekonomikë, në rastin konkret inflacionin dhe zgjatja e bazës së të dhënave, do të çonin në përmirësim të parashikimit. Kështu përdorimi i serive më të gjata kohore dhe sidomos krijimi i serisë për pritshmëritë vjetore të inflacionit, mendojmë që do të jenë mjete të rëndësishme në përmirësimin e vlerësimit dhe të parashikimit të pritshmërive të inflacionit nga vrojtimi i besimit të konsumatorit.

LITERATURA

Berk, J.M ,2000, "Consumers' inflation expectations and monetary policy in Europe", Monetary and Economic Policy Department, De Nederlandsche Bank, seria MEB.

Bullard J, 1991, "Learning, rational expectations and policy: A summary of recent research", Review of Federal Reserve Bank of St. Lous, botimi i janarit, faqe 50-60.

Estrella A, J. C. Fuhrer, 1998, "Dynamic inconsistencies: Counterfactual implications of a class of rational expectations models", Federal Reserve Bank of Boston, WP 98-5.

Foresells, M and G. Kenny, 2002, "The rationality of consumers' inflation expectations: Survey-based evidence for the Euro Area", European Central Bank, Working paper series No. 163.

Hoxholli, R., G. Hashorva, 2006, "Propozim për përfshirjen e pritshmërive të inflacionit në parashikimin e inflacionit", material i brendshëm, Banka e Shqipërisë.

Maestre, R, 2007, "Are Survey –Based inflation expectations in the Euro Area informative?", European Central Bank, Ëorking paper series No. 721.

Nasto R., 2005, "Matja e pritjeve të inflacionit", material i brendshëm, Banka e Shqipërisë.

Nielsen, H, 2003, "Inflation expectations in the EU- Results from survey data", Institute fur Statistik und Okonometrie,

Lyziak, T, 2003, "Consumer inflation expectations in Poland", European Central Bank, Working paper series No. 287.

Roberts, J. M.,1997, "Is Inflation Sticky?" Journal of Monetary Economics, 39, fq. 173 -196.

6. SHTOJCË STATISTIKORE

Tabelë 2. Frekuenca e përgjigjeve të kategorisë së pyetjes "Si mendoni se do të ndryshojnë çmimet në 3 muajt e ardhshëm?

	T2/03	T3/03	T4/03	T1/04	T2/04	T3/04	T4/04	T1/05	T2/05	T3/05	T4/05	T1/06	T2/06
a	11.2	19.5	18.0	17.2	2.0	21.8	19.3	10.3	3.2	10.9	8.3	12.5	9.1
b	28.5	37.6	35.4	32.8	19.0	27.0	37.3	32.2	14.2	29.4	25.1	29.7	30.7
c	24.0	22.8	25.0	21.0	23.6	28.2	22.3	30.6	22.0	31.8	24.9	22.5	26.1
d	22.0	17.8	19.8	25.1	30.5	21.2	18.6	22.3	33.9	23.3	34.1	22.5	20.7
e	14.3	2.4	1.8	3.9	24.9	1.8	2.5	4.5	26.7	4.6	7.7	12.8	13.4

T3/06	T4/06	T1/07	T2/07	T3/07	T4/07	T1/08	T2/08	T3/08	T4/08	T1/09
11.4	8.7	11.1	6.5	20.5	14.0	13.4	8.1	13.2	12.9	9.2
35.9	28.5	23.7	23.5	43.7	35.7	38.0	33.2	37.0	32.1	29.9
24.9	26.5	27.1	26.4	21.1	23.8	23.0	27.8	27.9	24.7	28.7
23.9	28.7	26.7	28.4	10.3	21.0	21.2	21.0	15.8	19.8	20.4
4.0	7.6	11.5	15.2	4.4	5.5	4.4	9.9	6.1	10.5	12.0

a - përqindja e individëve të cilët presin që çmimet të rriten me ritëm të lartë.
b - përqindja e individëve të cilët presin që çmimet të rriten me të njëjtin ritëm.
c - përqindja e individëve të cilët presin që çmimet të rriten me ritëm të ulët.
d - përqindja e individëve të cilët presin që çmimet të mos ndryshojnë.
e - përqindja e individëve të cilët presin që çmimet të ulen lehtë.

Figurë 1: Metodat e llogaritjes së inflacionit të pritur.

$\pi_t = \alpha + \beta\pi_t^e + \varepsilon_t$ ku π_t^e - është inflacioni i pritur i periudhës *t* i parashikuar në periudhën *t-1*.

	α	β	R^2	X^2 for H
central limit t	0.79 (1.43)	-0.01 (0.05)	0.00	31.91 [0.000]
Logistic	0.86 (1.42)	-0.09 (0.19)	0.00	5.85* [0.053]
Normal	0.79 (1.44)	0.01 (0.12)	0.00	278 [0.00]
Uniform	0.84 (1.41)	-0.07 (0.15)	0.00	5.34* [0.069]

$\pi_t = \alpha + \beta\pi_t^e + \varepsilon_t$ ku π_t^e - është inflacioni i pritur mesatar i periudhës *t* i parashikuar në periudhën *t-1*.

	α	β	R^2	X^2 for H
Central limit t	0.69 (1.32)	-0.01 (0.04)	0.00	26.19 [0.000]
Logistic	0.74 (1.41)	-0.11 (0.26)	0.01	7.01* [0.03]
Normal	0.68 (1.31)	0.01 (0.11)	0.00	204 [0.00]
Uniform	0.73 (1.4)	-0.11 (0.23)	0.00	6.24* [0.044]

$\pi_t = \alpha + \beta\pi_t^e + \varepsilon_t$ ku π_t^e - është inflacioni i pritur i periudhës *t+1*.

	α	β	R^2	X^2 for H
Central limit t	-0.02 (0.45)	0.43 (61.73)	0.9966	7308 [0.000]
Logistic	-0.39 (1.59)	1.61 (8.68)	0.85	10.74 [0.00]
Normal	0.16 (3.18)	0.23 (42.65)	0.9929	21372 [0.00]
Uniform	-0.36 (1.66)	1.71 (10.04)	0.885	17.34 [0.00]

$\pi_t = \alpha + \beta\pi_t^e + \varepsilon_t$ ku π_t^e - është inflacioni i pritur mesatar i periudhës *t+1*.

	α	β	R^2	X^2 for H
Central limit t	0.012 (0.25)	-0.81 (36.79)	0.990	7401.77 [0.000]
Logistic	0.01 (0.12)	1.47 (15.08)	0.946	25.8 [0.000]
Normal	0.03 (0.63)	0.25 (43.56)	0.992	19209.34 [0.000]
Uniform	(0.03) (0.24)	1.58 (17.21)	0.96	43.3 [0.000]

SHËNIME

* Gent Hashorva, kryespecialist, Departamenti i Politikës Monetare, Elona Bollano, specialiste, Departamenti i Politikës Monetare, Elvana Troqe, specialiste, Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë.

Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorëve dhe nuk shprehin domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.

[1] Seria e të dhënave për inflacionin e pritur në terma vjetorë është ende e shkurtër për të nxjerrë përfundime statistikisht të rëndësishme.

[2] Shih psh. Roberts (1997).

[3] Estrella dhe Fuhrer (1998) bëjnë një kritikë të modeleve të cilat supozojnë pritje tërësisht racionale.

[4] Në versionin tonë është zëvendësuar norma e pritur për inflacionin 12-mujor me normën e pritur për inflacionin 3-mujor, për shkak të natyrës së pyetjes në vrojtimin tonë mbi besimin konsumator.

[5] Ku Π nuk është inflacioni por numri 3.14.

[6] Seria ku maten vlerat e inflacionit të pritur ka vetëm 24 terma.

[7] Këto testime nënkuptojnë nga njëra anë, testimin e konceptit të rishikimit periodik të parashikimeve nga agjentët, përfshi edhe gabimet e tyre, nën dritën e informacioneve më të reja apo parimin e testimit të eficiencës makroekonomike për të testuar racionalitetin e pritjeve.

[8] Kjo mënyrë sjelljeje njihet me termin adoptive, ndërsa e anasjellta e saj si racionale.

[9] Në pyetësor, pyetja mbi çmimet vjetore është aplikuar për herë të parë në muajin mars të vitit 2005.

KRIZA FINANCIARE DHE VENDET E RAJONIT*

Sistemi financiar e ekonomik botëror u përfshi në një turbullirë gjatë vitit 2008, e cila kushtëzuar nga shkalla e globalizimit dhe integrimit financiar aktual dha efektin e saj në mënyra të ndryshme, në shumicën e vendeve në botë. Faza e parë e kësaj krize përfshiu tregjet financiare në vendet më të zhvilluara të rruzullit. Ndërsa faza e dytë dha ndikimin e saj në treguesit e ekonomisë reale, si në vendet e zhvilluara ashtu edhe në vendet në zhvillim apo në vendet e varfra. Qëllimi i këtij artikulli nuk është të analizojë imtësisht origjinën apo pasojat e kësaj krize por të paraqesë një retrospektivë të evoluimit të krizës prej vendeve të zhvilluara në vendet në zhvillim ku në fokus janë disa prej vendeve të Evropës Qendrore, disa prej vendeve të rajonit dhe Shqipëria. Në këtë kontekst, interes i veçantë i kushtohet mënyrës së reflektimit të krizës në treguesit realë të këtyre ekonomive si dhe lëvizjet fiskale, monetare apo operacionale të institucioneve përkatëse sipas profilit ekonomik të secilit vend.

Evoluimi në një fazë tjetër gjithëpërfshirëse i turbullirave financiare konsiderohet të ketë ndodhur me falimentimin e "Lehman Brothers", një prej bankave më të mëdha në tregun amerikan në muajin shtator të vitit 2008, dhe me ndërhyrjen e Qeverisë Amerikane në kapitalet e mjaft prej institucioneve financiare të vendit. Pasiguria që mbizotëroi gjatë kësaj periudhe u transformua në humbje besimi të agjentëve kryesorë të tregut ndaj homologëve të tyre dhe ndryshoi perceptimin e agjentëve të tregut mbi gjendjen e tyre reale financiare. Rreziku i transformimit në një krizë që prek të tërë sistemin, kërkoi ndërhyrjen e koordinuar dhe të bashkërenduar të bankave qendrore dhe qeverive të disa vendeve të zhvilluara. Në origjinë ishte kriza e kredive për shtëpi në Amerikë, e cila u thellua dhe u përcoll fillimisht në tregun vendas, për t'u transmetuar më pas drejt tregjeve kryesore botërore. Efektet e politikës së zbutjes të kushteve monetare që bankat kryesore qendrore zbatuan për të stabilizuar sistemin janë kompensuar nga rritja e *spread*-it të kredive dhe nga rënia e çmimeve të aksioneve. Që prej fillimit të saj, kriza ka ndikuar në rritjen e kostos së financimit dhe shtrëngimin e shkëmbimeve në tregjet financiare. Problemet me likuiditetin në tregun bankar u thelluan duke goditur institucionet që financoheshin kryesisht në tregun monetar. Gjatë kësaj krize, sistemi financiar u dobësua nga humbjet e mëdha që bankat regjistruan në bilancet e tyre. Përqindja e kredive me probleme në portofolet e bankave shënoi rritje. Përparimi i krizës goditi vlerën e mjeteve të institucioneve financiare, duke ulur likuiditetin dhe kapitalin e tyre. Ndryshimi i strukturës kohore dhe cilësore që kishte ndodhur në bilancet e bankave gjatë viteve të fundit, ndihmoi në përhapjen dhe transmetimin e pasojave në sektorë jetikë të ekonomisë. Në tregjet e aksioneve, vlera e titujve shënoi rënie të konsiderueshme duke përkeqësuar thithjen e kapitaleve të reja për biznesin. Prirja drejt zvoglimit të financimit të investimeve me rritjen e

borxhit të bankave me anë të shitjes së mjeteve dha ndikim në uljen e vlerës së tyre si dhe të gatishmërisë për të dhënë kredi. Oferta e kredisë në nivel të përgjithshëm u zvogëlua dhe kostoja e saj shënoi rritje si pasojë e rritjes së rrezikut të kreditimit. Humbja e besimit u reflektua te konsumatorët që përpara një situate të tensionuar financiare filluan të jepnin shenja frenimi në konsum dhe ulje të kërkesës për kredi të reja.

Pasojat e turbullirave financiare u përçuan me një kohëvonesë të shkurtër edhe në ekonominë reale. Ekonomitë e industrializuara u përballën me goditje me ndikim negativ si nga kahu i kërkesës, ashtu edhe nga ai i ofertës. Rënia e vazhdueshme e vlerës së mjeteve financiare dhe e çmimit të banesave ndikoi në fuqinë blerëse dhe investuese të familjeve. Dy kanalet kryesore të prekura janë, kanali i pasurisë dhe kanali i kredive. I pari, kushtëzon drejtpërsëdrejti fuqinë blerëse të individëve e familjarëve; ndërsa i dyti, ul vlerën e kolateralit në procesin e kredimarrjes. Për pasojë, shpenzimet për konsum, të cilat kanë dhe peshën kryesore në llogaritjen e PBB-së në këto vende, shfaqën tendenca rënëse. Investimet, në formën e makinerive apo godinave, përballur me kushtet e shtrënguara të kredisë, përftuan gjithashtu prirje rënëse. Treguesit për prodhimin industrial dhe për aktivitetin në industrinë përpunuese pasqyrojnë tkurrje për muajt në vazhdim. Situata e rënduar ekonomike krijon pasiguri në ecurinë e tregut dhe, duke u shoqëruar me presionet në kapacitetin e prodhimit, detyron firmat të ulin numrin e të punësuarve. Vendet e zhvilluara si SHBA, vendet e BE-së dhe Japonia kanë njohur dobësim të kushteve të tregut të punës gjatë vitit 2008 dhe gjysmës së parë të vitit 2009[1]. Së bashku, efekti i dobësimit të kërkesës dhe të ofertës, ndikon në uljen e ritmeve të rritjes ekonomike dhe të parashikimeve për të për periudhën afatshkurtër në vendet e zhvilluara. Sipas parashikimeve më të fundit rritja ekonomike botërore pritet të ketë ritme më të moderuara në vitin 2009:

Tabelë 1. Ndryshimi i PBB-së reale në përqindje vjetore në disa rajone të botës.

	Rritja reale e PBB-së			
	2006	2007	2008*	2009*
Ekonomitë e industrializuara	3	2.7	0.9	-3.8
Vendet në zhvillim në Azi	9.8	10.6	7.7	4.8
Amerika e Jugut dhe Meksika	5.7	5.7	4.2	-1.6
Vendet në zhvillim në Evropë	6.6	5.4	2.9	-3.7
Lindja e Mesme	5.7	6.3	5.9	2.5

**Vlerësime.*
Burimi: FMN World Economic Outlook, Prill 2009.

Rënia e ritmit të rritjes ekonomike në vendet në zhvillim paraqiti një shkallë të njëtrajtshme me atë të vendeve të industrializuara, por me madhësi më të moderuar. Krahasuar me krizat e kaluara financiare, treguesit bazë ekonomikë të vendeve në zhvillim janë më të shëndoshë dhe për pasojë, goditjet ndaj ekonomisë kanë qenë më të zbutura. Megjithatë, shkalla e rrezikut varet ndjeshëm nga karakteri makroekonomik përkatës i secilit vend. Shtetet që përballen me mundësinë e një rreziku më të lartë karakterizohen nga: deficit i lartë i llogarisë korente, borxh i brendshëm e i jashtëm në valutë dhe zgjerim me ritme të përshpejtuara të kredisë konsumatore në nivele që cënojnë stabilitetin financiar. Ndërsa vendet kryesisht eksportuese të lëndëve të para apo të naftës, megjithë rënien e çmimeve në tregjet ndërkombëtare dhe dobësimin

e kërkesës në ekonomitë e zhvilluara, mbeten më pak të prekura. Investitorët e huaj, kryesisht në disa prej vendeve aziatike por edhe në vendet e tjera në zhvillim, janë tërhequr nga tregjet vendase duke krijuar një fluks dalës kapital e financiar[2]. Gjithashtu, vështirësia për të siguruar kredi të reja dhe hezitimi i investitorëve të huaj për të rrezikuar në tregjet e vendeve në zhvillim, ka ulur investimet direkte hyrëse. Për rrjedhojë, pas një periudhe kohore ku treguesit financiarë dhe ekonomikë nuk patën ndryshime të theksuara strukturore, gjatë muajve të fundit të vitit 2008, në vendet e Evropës Qendrore dhe në vendet e rajonit u shfaqën problemet e para, të ndërlidhura me rënien e aktivitetit ekonomik botëror. Karakteri ekonomik i secilit vend ishte faktor përcaktues në formën e përcjelljes së efekteve të krizës ku vendet me tregje financiare krahasimisht të zhvilluara rezultuan më të prekura. Ndërkohë, vendet nën regjimin e bordit të monedhës apo kursit të fiksuar të këmbimit përjetuan kufizime në gamën e politikave stabilizuese.

- HUNGARIA

Në Hungari, zhvillimet më negative në ekonominë vendase u ndjenë në formën e përkeqësimit të disponueshmërisë së likuiditetit në tregun e parasë në të gjitha valutat, në zhvlerësimin e monedhës vendase, në rënien e zgjerimit të kredisë, në rrjedhjen e depozitave, në rritjen e normave të interesit të kredisë, në rritjen e *yield*-eve të letrave me vlerë të qeverisë si dhe në formën e ikjes së kapitaleve të huaja, si rezultat i gradimit negativ që shoqëritë audituese botërore i bënë ekonomisë hungareze. Në përpjekje për të rikthyer qetësinë në tregje dhe për të përmirësuar treguesit monetarë, aktiviteti i Bankës Qendrore të Hungarisë u fokusua në sigurimin e likuiditetit në valutën vendase dhe të huaj (kryesisht euro), në mbrojtjen e zhvlerësimit të monedhës vendase si dhe në ndjekjen e një politike të kujdesshme për mbajtjen nën kontroll të inflacionit. Në këtë kuadër u përdorën instrumente të reja për të furnizuar tregun me likuiditet si linjat e kredisë speciale 2-javore dhe 6-mujore, me frekuencë javore të ofruara me normë të ndryshueshme me kolateral; ankande më të shumta për blerje të letrave me vlerë të qeverisë; ngushtime të korridorit të normave të interesit për lehtësitë e përhershme; zgjerim i mjeteve të pranuara si kolateral si edhe zvogëlimi i përqindjes së rezervës së detyruar të mbajtur pranë Bankës Qendrore të Hungarisë. Gjithashtu, Hungaria rriti normën e depozitave të sigurura duke iu afruar niveleve të shumë vendeve të zhvilluara. Hungarisë iu miratua aplikimi për kredi financiare prej Fondit Monetar Ndërkombëtar, gjatë muajve të fundit të vitit 2008.

- POLONIA

Zhvillime të ngjashme u vërejtën edhe në ekonominë e Polonisë. Kështu, inflacioni në Poloni rreth fundit të vitit arriti vlerën 3.3 për qind, që është nën kufirin e sipërm të nivelit të shënjestruar nga Banka Kombëtare e Polonisë. Në tremujorët e tretë dhe të katërt të vitit 2008, pati një zhvlerësim të monedhës vendase kundrejt euros dhe dollarit amerikan. Megjithatë, zhvlerësimi i monedhës si pasojë e daljes së kapitalit të huaj ishte një problem i hasur në

të gjitha vendet e rajonit, që adoptonin një kurs të lirë këmbimi. Një fenomen tjetër i vërejtur në ekonominë polake ishte shtrëngimi i kritereve për kredidhënie nga mungesa e likuiditetit në treg. Kjo rrezikoi të shkaktonte rritje të normave të interesit të depozitave, që mund të sillte probleme financiare në bilancet e bankave të nivelit të dytë. Për t'i bërë ballë kësaj situate, Banka Kombëtare e Polonisë uli normën e interesit me 0.25 pikë përqindje, në nëntor 2008 dhe mars 2009; dhe me 0.75 pikë përqindje në dhjetor 2008 dhe janar 2009. Krahas kësaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Autoritetin Mbikëqyrës Financiar, banka ndërmori një paketë masash, e quajtur "Paketa e Besimit" për të rregulluar tregun ndërbankar. Masat e marra që synonin rritjen e likuiditetit ishin marrëveshjet e riblerjes me afat maturimi tremujor, pajisja e bankave me valutë të huaj (swap) dhe modifikimi i kuadrit operacional të kredisë lombard, duke zgjeruar gamën e mjeteve që mund të shërbejnë si kolateral. Ndër mjetet që u përfshinë ishin bonot e bashkive, bonot e korporatave të lëshuara në vend, bonot e mbështetura nga shteti dhe bonot e Bankës Evropiane për Investim. Masa të tjera të marra nga banka qendrore ishin vijimi i emetimit të letrave me vlerë me afat maturimi shtatëditor si mjeti kryesor për të thithur likuiditetin e tepërt të tregut si edhe në qoftë se do të ishte e nevojshme, shtimi i frekuencës së operacioneve të tregut të hapur, për të patur një përgjigje të shpejtë për ndryshimin e likuiditetit dhe për të stabilizuar normën e interesit të depozitave njëditore. Në maj të këtij viti, Polonisë iu miratua një ndihmë financiare prej 20 miliardë dollarësh amerikanë prej Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Grafik 1. Ndryshimi në vlerën e monedhave përkatëse i indeksuar sipas muajit tetor të vitit 2008*.



*Rritja në grafik pasqyron zhvlerësim të monedhës.
Burimi: Bankat qendrore përkatëse.

- RUMANIA

Një tjetër vend i cili vuajti efektet e krizës ndërkombëtare financiare është edhe Rumania. Rënia e përshpejtuar e transfertave të individëve në formën e remitancave, rënia e besimit të agjentëve ekonomikë, zhvlerësimi i monedhës vendase, shtrëngimi i kushteve të likuiditetit dhe pamundësia prej qeverisë për të marrë kredi në tregjet ndërkombëtare, për të shtuar investimet publike në vend ishin vetëm disa nga trajtat përcaktuese të ekonomisë. Kështu, për të zvogëluar rrezikun e bankave të nivelit të dytë në dhënien e kredive të reja për banesa, Banka Qendrore e Rumanisë miratoi një rregullore të re, për të përforcuar kornizën rregullatore në fuqi mbi administrimin e rrezikut. Gjithashtu, Banka Qendrore e Rumanisë vendosi të ulë normën e rezervës së detyruar për pasivet në valutë me maturitet mbi dy vjet në 0 për qind prej 40 për qind. Norma bazë e interesit u la e pandryshuar gjatë mbledhjeve të Bordit të Bankës Qendrore të Rumanisë këtë vit. Në muajin mars të këtij viti, Rumania aplikoi për ndihmë financiare në disa prej institucioneve kryesore ndërkombëtare si FMN, Banka Botërore por edhe në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

- KROACIA

Gjatë fundvitit 2008, Kroacia, ndikuar nga integrimi gjithnjë e më i avancuar ekonomik rajonal, shfaqi shenjat e para të prekjes së ekonomisë vendase. Rënia e kërkesës së jashtme dhe asaj të brendshme, u pasqyrua në rënien e të ardhurave buxhetore duke detyruar autoritetet qeverisëse të ndryshojnë nivelin e shpenzimeve në buxhetin e rishikuar së fundmi. Niveli i lartë i borxhit të jashtëm të Kroacisë dhe pamundësia për të siguruar fonde në organizmat ndërkombëtarë, rezultuan të ishin disa faktorë të tjerë të cilët krijuan presione në ekonomi. Kredia për individët dhe bizneset e vogla shënoi rënie të konsiderueshme, ndërkohë që interesat për këto të fundit u rritën ndjeshëm. Banka Qendrore e Kroacisë ka furnizuar rregullisht tregun me sasi të konsiderueshme të monedhës së përbashkët evropiane, me qëllim plotësimin e kërkesës së bankave të nivelit të dytë në kushtet e rritjes së normës së interesit në tregun ndërbankar si dhe parandalimin e dobësimit të monedhës vendase. Njëkohësisht, në përgjigje të tërheqjes së depozitave në muajin tetor të vitit 2008 dhe rënies së besimit të individëve në sistemin bankar, Banka Qendrore e Kroacisë në bashkëpunim me qeverinë vendase, katërfishoi normën e sigurimit të depozitave[3]. Ajo eleminoi rezervën e detyruar për fondet e siguruara në valutë të huaj për bankat e nivelit të dytë, duke ndihmuar në akordimin e këtyre fondeve prej bankave mëmë. Masa të tjera ishin ulja e rezervës së detyruar nga 17 për qind në 14 për qind; ulja e raportit të detyrueshëm të likuiditetit në valutë të huaj nga 32 për qind në 20 për qind si dhe lehtësimi i kanaleve të akordimit të kredive emergjente, adresuar bankave të nivelit të dytë.

- SERBIA

Zhvillime të njëtrajtshme kanë karakterizuar edhe ekonominë e Serbisë. Rënia e investimeve të huaja direkte dhe oferta e dobët e valutës në treg ndikuan në nënvlerësimin e përshpejtuar të monedhës vendase kundrejt monedhës së përbashkët evropiane. Treguesit monetarë shënuan një kontraktim në terma vjetorë ndërkohë që ekonomia u përball me rënie të importeve dhe eksporteve. Flukset hyrëse të kapitalit të huaj u zvogëluan duke krijuar vështirësi në financimin e aktivitetit bankar dhe ekonomik. Fenomeni i tërheqjes së depozitave në valutë shtoi presionin për likuiditetin duke kërkuar ndërhyrje të menjëhershme të autoritetit qendror. Norma bazë e inflacionit pasqyroi prirje rritëse të cilat, gjatë tremujorit të fundit të vitit 2008, çuan në tejkalimin e objektivit të bankës qendrore. Në mënyrë që të përmirësonte likuiditetin në valutë të bankave të nivelit të dytë, Banka Qendrore e Serbisë uli normën e rezervës së detyruar si dhe vendosi ta eleminojë atë për financimet e reja që bankat do të merrnin gjatë 2009-ës në tregjet e huaja. Norma e depozitave të siguruara u rrit gjatë kësaj periudhe. Për të përmbushur objektivin e inflacionit, Banka Qendrore e Serbisë uli normën bazë të interesit në muajin janar të vitit 2009, ndërsa bankat e nivelit të dytë vendosën t'i ofrojnë mundësinë kredimarrësve të konvertojnë kreditë e tyre në valutë, në kredi të denominuara në monedhën vendase. Në muajin maj të këtij viti, Serbisë iu miratua një ndihmë financiare prej 4 miliardë dollarësh amerikanë prej Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Vendet	Prodhimi i brendshëm bruto		Eksportet agregate		Investimet e huaja direkte (për qind ndaj PBB-së)	
	H:1	H:2	H:1	H:2	H:1	H:2
Kroaci	3.9	0.9	7.0	2.1	8.1	6.5
Maqedoni	6.0	3.8	12.1	4.9	6.7	7.0
Serbi	7.3	3.9	40.3	11.6	9.0	3.9
Turqi	4.3	-2.9	20.8	10.4	2.2	2.1
Mali i Zi	8.1	8.1	-17.2	-23.0	17.7	16.9

Burimi: Komisioni Evropian, institucionet statistikore përkatëse.

Tabelë 2. Ndryshimet vjetore të disa treguesve makroekonomikë për vitin 2008.

- TURQI

Tremujori i tretë i vitit 2008 shënoi kthesën në ecurinë e treguesve makroekonomikë në Turqi. Kërkesa për eksportet turke, në linjë me dobësimin e kërkesës në vendet e zhvilluara, përftoi një prirje të theksuar rënëse duke ushtruar presione negative mbi shpenzimet për konsum dhe investimet agregate. Qeveria Turke shtoi shpenzimet dhe investimet e saj publike, me qëllim rimëkëmbjen e kërkesës agregate në ekonomi, por në kurriz të thellimit të mëtejshëm të deficitit buxhetor. Deficiti i llogarisë korente shënoi një përmirësim të ndjeshëm, si pasojë e kontraktimit vjetor të vëllimit të importeve me afërsisht 44 për qind gjatë muajve të parë të vitit 2009. Në kushtet e rënies së presioneve dhe pritjeve inflacioniste, si dhe ngadalësimit të ekonomisë vendase, Banka Qendrore e Turqisë uli normën bazë të interesit me 750 pikë bazë, që prej muajit nëntor të vitit të kaluar. Gjithashtu, Banka Qendrore e Turqisë ndërmori masa të vazhdueshme për të shmangur luhatshmërinë e normave të interesit në tregun ndërbankar, duke rritur frekuencën e operacioneve të tregut të hapur. Megjithëse, regjimi i kursit të këmbimit në Turqi është i luhatshëm, zhvlerësimi i monedhës vendase me 35 për qind që prej mesit të vitit 2008, detyroi Bankën Qendrore të Turqisë të jetë më aktive në mbështetje të monedhës turke në tregun valutor. Ndërkohë, meqënëse eksportet zënë një pjesë të konsiderueshme të PBB-së vendase dhe industri të tjera prodhuese varen direkt prej ecurisë së tyre, Banka Qendrore e Turqisë vendosi të rrisë nivelin e kredisë së alokuar prej saj enkas për kompanitë me karakter eksportues[4].

- MALI I ZI

Mali i Zi është karakterizuar nga rritje ekonomike e shpejtë në tre vitet e fundit. Rritja ekonomike është mbështetur në investimet dhe flukset e kapitaleve të huaja, rritje të turizmit dhe industrisë së ndërtimit si dhe privatizime të suksesshme. Gjysma e dytë e vitit 2008 ishte edhe periudha e cila përkoi me përballjen e Malit të Zi me problemet e lidhura ngushtë me dobësimin ekonomik dhe me përcjelljen e tij në sektorët strategjikë të ekonomisë. Gjatë kësaj periudhe u vu re rritje e treguesit për kredi të këqija, rënie e investimeve të huaja në sektorët e ndërtimit dhe të pasurive të paluajtshme si dhe dobësim i kërkesës së brendshme në kushtet kur bankat, kryesisht të huaja, hasën vështirësi në sigurimin e kapitaleve. Rezerva ndërkombëtare u zvoglua ndjeshëm në muajt e fundit. Gjithashtu, fenomeni i tërheqjes së depozitave

përkeqësoi më tej gjendjen delikate të bilanceve të bankave, duke paraqitur një rrezik të mundshëm në sistem. Banka Qendrore e Malit të Zi adoptoi një sërë masash urgjente, me qëllim kthimin e besimit në institucionet financiare si dhe përmirësimin e treguesve të mjaftueshmërisë së kapitalit. Në mënyrë të veçantë u rrit baza dhe norma e rezervës së detyruar si dhe u zgjerua periudha e mbajtjes së saj. Kredisë midis bankave iu vendosën kufij të sipërm dhe nga ana tjetër qeveria shtriu sigurimin e depozitave për bizneset dhe privatët, për të gjitha shumat si dhe zvogëloi kohën e nevojshme për të rimbursuar këto depozita në rast falimentimi. Në kuadrin e sigurimit të likuiditetit u krijuan linja kredie speciale për bankat si dhe u krijua mundësia për ofrim likuiditeti me afat mujor atyre bankave që do të kishin vështirësi me të, por vetëm pasi të kishin përdorur të gjitha mundësitë e tjera që ofron kuadri operacional. Sistemi i administrimit të rrezikut në banka iu nënshtrua ndryshimeve, me qëllim rritjen e masave vlerësuese dhe parandaluese ndaj rreziqeve të sistemit të përcjella nga konteksti i trazuar financiar botëror.

- MAQEDONIA

Republika e Maqedonisë dëshmoi imunitet kundrejt zhvillimeve në konjukturat ndërkombëtare, fakt ky i mbështetur në rritjen e kënaqshme të ekonomisë përgjatë 9 muajve të parë të vitit 2008. Mbështetur në ecurinë pozitive të treguesve kryesorë makroekonomikë dhe në dinamikën e lartë të ekonomisë, qeveria vendase operoi nën suficit buxhetor përgjatë kësaj periudhe. Megjithatë, format prociklike të shpenzimeve buxhetore shoqëruar me rënien e kërkesës së jashtme, rënien e investimeve dhe prodhimit industrial në vend filluan të ushtrojnë presion mbi ekonominë vendase gjatë tremujorit të fundit të vitit. Njëkohësisht, zgjerimi i deficitit të llogarisë korente me përafërsisht 5 për qind gjatë vitit 2008 krahasuar me vitin paraardhës krijoi presione shtesë mbi monedhën vendase, në kushtet e regjimit të fiksuar të kursit të këmbimit. Banka Qendrore e Maqedonisë, gjykoi si të nevojshëm ndikimin e saj në uljen e ritmeve të zgjerimit të kredisë në vend për të ruajtur stabilitetin financiar të vendit. Në këtë kontekst, përveç masave shtrënguese të politikës monetare ajo rriti detyrimet për mjaftueshmërinë e kapitalit për huatë në formë *ovedraft*-i dhe kartë krediti si dhe detyroi bankat, të cilat kapërcejnë pragun prej 40 për qind të rritjes së kredisë për konsumatorët, të depozitojnë fonde me interes të ulët në bankën qendrore. Angazhimi për të ruajtur kursin fiks të këmbimit detyroi Bankën Qendrore të Maqedonisë të ndërhyjë rregullisht në tregun valutor, në mbështetje të monedhës vendase.

- SHQIPËRIA

Në kushtet e sinjaleve të para të ngadalësimit të ritmeve të rritjes ekonomike dhe rritjes së kërkesës për likuiditet në sistemin bankar, si pasojë e lëkundjes së besimit në institucionet financiare në vend, Banka e Shqipërisë ndërmori një paketë të gjerë masash për zbutur pasojat negative të krizës tashmë botërore në ekonominë tonë, për të forcuar më tej stabilitetin e sistemit financiar dhe për të përmbushur kërkesën e tregut për likuiditet. Ndër këto masa mund të

përmendim: ndryshimin e tipit të ankandit kryesor të injektimit të likuiditetit, nga ankand me shumë fikse në ankand me çmim fiks; rritjen e gamës së letrave me vlerë që shërbejnë si kolateral për marrëveshjet e anasjellta të riblerjes; rritjen e hapësirës së përdorimit ditor të rezervës së detyruar, nga 20 për qind në 40 për qind në ditë dhe; uljen e diferencës midis normës bazë të interesit dhe normës së interesit të kredisë njëditore me 100 pikë bazë.

Gjithashtu, me anë të disa akteve rregullatore shtesë u synua kapitalizimi i mëtejshëm i bankave të nivelit të dytë, administrimi më i mirë i rrezikut prej tyre dhe kufizimi më prudencial i treguesve të ekspozimeve të mëdha të bankave të nivelit të dytë në tregjet ndërkombëtare. Qeveria e Republikës së Shqipërisë, në përgjigje të valës së tërheqjes së depozitave në muajin tetor të vitit 2008 dhe në kuadër të përafrimit të legjislacionit të Shqipërisë me atë të Bashkimit Evropian, vendosi të rrisë normën e sigurimit të plotë të depozitave nga 300 mijë lekë, në 2.5 milionë lekë. Këto masa u shoqëruan me një fushatë të gjerë sqaruese dhe sensibilizuese për pozicionin e shëndoshë të ekonomisë shqiptare përkundrejt krizës botërore, duke theksuar kredon e saj se ruajtja e ekuilibrave makrekonomikë është kontributi më i mirë për përballimin me sukses të efekteve të krizës botërore. Të vlerësuara në tërësinë e tyre, këto masa kanë shërbyer për përballimin e problemeve që sjell mungesa e likuiditetit dhe për kufizimin e ndikimeve të tyre në ekonominë reale, gjatë gjysmës së parë të vitit 2009.

SHËNIME

* Eglent Kika, specialist, Departamenti i Politikës Monetare, Erblin Maçi, specialist, Departamenti i Politikës Monetare, Medvin Shehu, specialist, Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë.

Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorëve dhe nuk shprehin domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.

[1] FMN World Economic Outlook Update, nëntor.

[2] FMN, Global Financial Stability Report, tetor.

[3] Norma e sigurimit të depozitave u rrit nga 14000 euro në 56000 euro.

[4] Kështu, niveli tavan u rrit në 2.5 miliardë dollarë amerikanë prej 0.5 miliardë që ishte më parë.

BANKA E SHQIPËRISË NË HARKUN KOHOR PRILL-QERSHOR 2009

Konkursi i Bankës së Shqipërisë "Vlera e Vërtetë e Parasë" midis shkollave të mesme të rrethit Shkodër, 9 prill 2009

Një nga aktivitetet më interesante të programit të edukimit të Bankës së Shqipërisë "Banka Qendrore në jetën e përditshme" është edhe konkursi "Vlera e Vërtetë e Parasë". I realizuar për herë të parë në prill '08 për shkollat e mesme të Tiranës, konkursi sfidon nxënësit e viteve të treta të shkollave të mesme të një rrethi të mësojnë më shumë për Bankën e Shqipërisë, politikën e saj monetare, instrumentet që ajo përdor si dhe ndikimin e vendimeve të bankës qendrore në ekonominë e vendit.

Në datën 9 prill 2009, në teatrin "Migjeni" të qytetit të Shkodrës u zhvillua konkursi "Vlera e Vërtetë e Parasë" për gjimnazistët e shkollave të mesme të këtij rrethi. Me pjesëmarrjen e 16 shkollave, konkursi u ndoq nga nxënës, mësues, përfaqësues të Drejtorisë Arsimore të rrethit si dhe familjarë të pjesëmarrësve. Guvernatori Fullani, në cilësinë e Kryetarit të Jurisë së Konkursit, theksoi rëndësinë e edukimit ekonomiko-financiar në zhvillimin e ekonomisë së një vendi dhe rritjen e mirëqenies së qytetarëve të tij dhe me këtë rast, përgëzoi nxënësit dhe mësuesit e shkollave pjesëmarrëse për paraqitjen e tyre dinjitoze në këtë aktivitet. Në përfundim të konkurrimit, i cili u zhvillua në dy raunde, fituese për rrethin e Shkodrës u shpall shkolla "28 Nëntori".

Konkursi i Bankës së Shqipërisë "Vlera e Vërtetë e Parasë" midis shkollave të mesme të rrethit Korçë, 24 prill 2009

Për vitin shkollor 2008 - 2009, pas Vlorës dhe Shkodrës, ishte Korça qyteti ku u organizua konkursi "Vlera e Vërtetë e Parasë". 11 shkollat e mesme pjesëmarrëse në konkurs për rrethin e Korçës konkurruan në sallën e teatrit "A. Z. Çajupi", në datën 24 prill 2009. Të vënë përballë Jurisë së Bankës së Shqipërisë, ekipet prej 3 nxënësish të vitit të tretë iu përgjigjën pyetjeve rrufe, quiz, me plotësim termash dhe atyre me shtjellim mbi Bankën Qendrore, objektivat, funksionet dhe politikën e saj monetare. Pas një konkurrimi prej disa orësh, ishte shkolla "Themistokli Gërmenji", e cila grumbulloi më shumë pikë dhe u shpall fituese e konkursit "Vlera e Vërtetë e Parasë" për rrethin e Korçës.

Konkursi i Bankës së Shqipërisë "Vlera e Vërtetë e Parasë" midis shkollave të mesme të rrethit Gjirokastër, 8 maj 2009

Në datën 8 maj 2009, në teatrin "Zihni Sako" të qytetit të Gjirokastrës ishte rradha e gjimnazistëve gjirokastritë të merrnin pjesë në konkursin e Bankës së Shqipërisë "Vlera e Vërtetë e Parasë". Për këtë rreth u paraqitën në konkurs 7 shkolla të mesme. Konkursi ngjalli interesin jo vetëm të nxënësve konkurrues, por edhe të publikut të shumtë që kishte mbushur sallën e teatrit dhe mbështeste ngrohtë konkurruesit. Në përgjigje të interesimit të të pranishmëve, z. Fullani, Guvernator i Bankës së Shqipërisë dhe njëkohësisht Kryetar i Jurisë së Konkursit, shpjegoi rëndësinë e programeve të edukimit të publikut, të ideuara dhe të zbatuara nga Banka e Shqipërisë, në 2 vitet

e fundit. Në përfundim të aktivitetit, u shpërndanë trofetë, certifikatat dhe dhuratat për fituesit e çmimeve të ndryshme. Vendin e parë në këtë konkurs e meritoi shkolla e mesme "Siri Shapllo".

Përurimi i mjediseve të reja të Degës së Bankës së Shqipërisë në Gjirokastër

Në datën 7 maj 2009, përkrah organizimit të konkursit "Vlera e Vërtetë e Parasë" midis shkollave të mesme të rrethit Gjirokastër, u zhvillua edhe ceremonia e përurimit të mjediseve të reja të Degës së Bankës së Shqipërisë në Gjirokastër. Pas një pune të madhe për ndërtimin e ambienteve të reja sipas të gjitha standardeve bashkëkohore të bankave më moderne, Dega e Bankës së Shqipërisë në Gjirokastër hapi dyert e saj për publikun në një godinë në hyrje të qytetit. Në përfundim të ceremonisë, Këshilli Mbikëqyrës zhvilloi në këto mjedise mbledhjen e tij të rradhës.

Vizitë e delegacionit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në Bankën e Shqipërisë

Në datat 14 -16 maj 2009, një delegacion nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), i përbërë nga z. Dritan Thaçi, Udhëheqës i Njësisë së Sigurimit Fizik dhe Telekomunikimit në BQK dhe zj. Afërdita Uruqi, Shefe e Prokurimit në BQK, zhvilloi një vizitë pune në Bankën e Shqipërisë. Kjo vizitë u realizua në kuadër të asistencës teknike që Banka e Shqipërisë ofron për BQK dhe u mundësoi bankierëve kosovarë të zhvillonin takime dypalëshe me përfaqësues të Departamentit të Administrimit dhe Departamentit të Sigurimit dhe Mbrojtjes të Bankës së Shqipërisë. Në këto takime, palët u njohën me përvojat e deritanishme të njëri-tjetrit, si dhe diskutuan mbi strukturat organizative me qëllim sigurimin e mbarëvajtjes më të mirë të punës dhe ndarjen efikase të detyrave dhe përgjegjësive.

Konkursi i Bankës së Shqipërisë "Vlera e Vërtetë e Parasë" midis shkollave të mesme të Tiranës, 25-26 maj 2009

Në përfundim të "turit" të tij në rrethet Vlorë, Shkodër, Korçë dhe Gjirokastër, konkursi "Vlera e Vërtetë e Parasë" u kthye në Tiranë, për të sfiduar edhe nxënësit e kryeqytetit me pyetjet mbi bankën qendrore, funksionet e saj, politikën monetare dhe instrumentet me të cilat zbatohet. Kështu, në datat 25–26 maj 2009, në hollin e Bankës së Shqipërisë skuadrat prej 3 nxënësish, të 25 shkollave të mesme të Tiranës garuan me njëra-tjetrën, të ndara në 5 panele të ndryshme. Pas një konkurrimi të gjatë dhe shumë kompetitiv, në fund të ditës së dytë, fituese e konkursit "Vlera e Vërtetë e Parasë" për Tiranën u shpall shkolla "Tirana Jonë".

Nëpërmjet organizimit të këtij konkursi, Banka e Shqipërisë synon të thellojë njohuritë e nxënësve mbi Bankën Qendrore dhe politikën e saj monetare, duke përcjellë në mënyrë argëtuese, një kulturë të vërtetë ekonomike-financiare për këtë grupmoshë. Konkursi i së nxënësit në pozitat e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës Qendrore, i fton ata të njohin nga afër punën e tij për arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve në vend, si dhe nxit interesin e brezit të ri për studime universitare dhe pasuniversitare në lëndët e ekonomisë, biznesit dhe financës.

Vizitë e përfaqësuesve të FMN pranë Bankës së Shqipërisë

Në datat 24 – 31 maj 2009, z. Atilla Arda dhe z. Bossu Wouter, këshilltarë juridikë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar zhvilluan një vizitë pune në Bankën e Shqipërisë. Kjo vizitë u krye në kuadër të asistencës teknike që ofron

Fondi Monetar Ndërkombëtar për hartimin e ligjit "Për Bankën e Shqipërisë". Qëllimi i këtij misioni ishte diskutimi mbi projektligjin për sistemet e pagesave, praktikat më të mira ndërkombëtare në këtë fushë si dhe kuadri rregullativ i Bashkimit Evropian. Diskutimet mes këshilltarëve të FMN dhe punonjësve të departamenteve Juridik, Sistemeve të Pagesave, Operacioneve Monetare të Bankës së Shqipërisë, u zhvilluan në formën e një seminari, ku të pranishmit debatuan kryesisht mbi legjislacionin e sistemeve të pagesave, mbrojtjen dhe mbikëqyrjen e sistemeve, si dhe mbi ligjin për bankën qendrore (kapitulli i parë).

Takim pune për çështje të sistemit të pagesave

Në datën 29 maj 2009, në ambientet e bibliotekës të Bankës së Shqipërisë, Departamenti i Sistemeve të Pagesave zhvilloi një takim pune me koordinatorët e bankave tregtare, në kuadrin e ecurisë dhe zhvillimit të mëtejshëm të sistemit të pagesave në Shqipëri. Argumentet e diskutuara gjatë takimit lidheshin me ecurinë e sistemeve të pagesave për vitin 2008; masat e marra për zbatimin e rregullores "Për strukturën dhe përdorimin e IBAN-it në Shqipëri" dhe problematikat e evidentuara; ristrukturimin e procesit të pagesave të thesarit nga llogaria e Qeverisë pranë Bankës së Shqipërisë, duke i kanalizuar nëpërmjet sistemeve të pagesave; problemet e evidentuara nga raportimet e treguesve statistikorë të instrumenteve të pagesave; si dhe çështje të tjera të ngritura nga vetë koordinatorët e bankave, për përmirësimin e bazës rregullative apo infrastrukturës për sistemet e pagesave.

Vizitë e përfaqësuesve të FMN pranë Departamentit të Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë

Në datat 9-20 qershor 2009, zoti Goran Knezevic, Këshilltar nga FMN, zhvilloi një vizitë pune në Departamentin e Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë. Kjo vizitë u zhvillua në kuadër të Misionit të Asistencës Teknike të Fondit Monetar Ndërkombëtar, me qëllim hartimin e planit të zhvillimit të kapaciteteve mbikëqyrëse të Bankës së Shqipërisë. Gjatë vizitës së tij, zoti Goran Knezevic zhvilloi takime pune me administratorët dhe disa nga drejtuesit e Bankës së Shqipërisë, si dhe me përfaqësues të institucioneve të tjera financiare në vend.

Vizitë e ekspertes së FSVC pranë Departamentit të Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë

Në datat 15 – 19 qershor 2009, zj. Cynthia McNulty, Shefe e Sektorit të Riskut të Tregut pranë Bankës PNC, Pittsbusg, SHBA, zhvilloi një vizitë pune në Departamentin e Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë. Zj. McNultly e kontaktuar nga FSVC, me kërkesë të Bankës së Shqipërisë, është pjesë e një projekti që synon rishikimin dhe përmirësimin e metodologjisë aktuale të stress-test-it. Vizita e saj pranë Bankës së Shqipërisë, si fazë e parë e këtij projekti, kishte për qëllim njohjen me sistemin bankar shqiptar në tërësi dhe me metodologjinë aktuale të stress-test-it. Për këtë qëllim, ekspertja zhvilloi takime me përfaqësues të Departamentit të Mbikëqyrjes, kryesisht të Zyrës së Analizës dhe të Zyrës së Regjistrit të Kredive, si edhe me përfaqësues të Departamentit të Stabilitetit Financiar dhe të Departamentit të Kërkimeve. Në përfundim të vizitës, ajo hartoi një dokument me rekomandimet e veta, të cilat iu paraqitën drejtuesve të Departamentit të Mbikëqyrjes.

Seminari i të premtes

Për të prezantuar dhe diskutuar punimet shkencore teorike dhe empirike, me fokus mbi rastin e Shqipërisë dhe mbi aplikimin e metodave më të reja kërkimore, Departamenti i Kërkimeve në Bankën e Shqipërisë organizon të ashtuquajturin "Seminari i të Premtes". Ky aktivitet me një jetëgjatësi tashmë mëse dyvjeçare, fton të gjithë kërkuesit, si brenda Bankës së Shqipërisë, ashtu edhe jashtë saj për të diskutuar materialet e tyre empirike dhe teorike me një standard të lartë shkencor.

Punimi i parë i diskutuar për tremujorin prill – qershor 2009 ka qenë ai i z. Vasil Zaho, fitues i "Çmimit të Guvernatorit për diplomën më të mirë, 2008", me temë "Eficienca dhe rritja e produktivitetit të bankave shqiptare". Studimi përdor analizën e ecurisë së të dhënave për të dalluar midis eficiencës së kostos, të shpërndarjes, të teknikës dhe asaj të shkallës, si dhe një metodë funksioni në distancë për të llogaritur indekset e produktivitetit Malmquist, për 12 banka shqiptare, gjatë periudhës 1999-2006.

Në muajin maj, prof. Murat Karagoz, nga Universiteti "Epoka", prezantoi studimin "Disa mendime mbi recesionin e fundit të viteve 2000". Megjithëse, janë bërë disa krahasime midis recesionit të fundit të viteve 2000 dhe Depresionit të Madh të vitit 1929, ende mbeten ndryshime të mëdha ndërmjet këtyre dy situatave. Në ndryshim nga Depresioni i Madh, integrimi i sotëm i tregjeve financiare globale solli sinkronizim të recesioneve, duke bërë që faza rënëse e tyre të ishte më e ashpër dhe rigjallërimi më i ngadaltë.

Prezantimi i tretë për këtë tremujor ishte ai i z. Arjan Kadareja, Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, me temë "Variablat financiarë dhe realë për vendet e Eurozonës me lidhje ndërkombëtare. Një metodë VAR globale.". Studimi sjell një vlerësim sasior të efekteve të goditjeve (në nivel vendi ose global) mbi një numër variablash ekonomikë të ShBA, Mbretërisë së Bashkuar dhe vendeve të Eurozonës. Këto të fundit analizohen të veçuara nga njëra-tjetra, për të treguar sjelljen asimetrike të ekonomive të ndryshme ndaj krizës aktuale.

Studimi i rradhës i diskutuar në Seminarin e të Premtes ishte ai i zj. Elona Dushku, Departamenti i Kërkimeve të Bankës së Shqipërisë, me temë "Gap model". Autorja paraqiti punën e deritanishme për ndërtimin e një modeli të ri për politikën monetare në Bankën e Shqipërisë, të quajtur Gap model. Ky model përmban gjithsej katër ekuacione për PBB reale, për normën reale të interesit, për normën reale të kursit të këmbimit dhe për inflacionin. Të gjithë variablat paraqiten si devijime të tyre nga niveli ekuilibër dhe tek modeli gjendet një shkrirje e mirë midis karakteristikave të teorisë neo-keineziane me atë ciklit real të biznesit.

Një tjetër punim i paraqitur ishte ai me temë "Analiza e sistemit bankar shqiptar nën këndvështrimin rrezik - performancë", me autore zj. Irini Kalluci, Departamenti i Kërkimeve të Bankës së Shqipërisë. Materiali trajton si teorikisht ashtu edhe në formën e një analize, tregues të rrezikut dhe të kthimit të sistemit bankar shqiptar. Për herë të parë, paraqitet edhe metodologjia e përllogaritjes së një indeksi rreziku për këtë sistem. Ajo çka synohet të arrihet

nëpërmjet këtij punimi është jo thjesht analiza e treguesve të rrezikut dhe performancës, por mbi të gjitha sugjerimi i disa treguesve dhe i një indeksi që mund të përdoren nga mbikëqyrësit gjatë punës së tyre.

Prezantimi i fundit për këtë tremujor ishte ai i z. Ilir Vika (Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë) mbi temën "Matja e ekuilibrit të kursit të këmbimit të lekut". Studimi synon të masë ekuilibrin e kursit të këmbimit në Shqipëri, duke përdorur metodën e vlerësimit ARDL për kursin real të këmbimit të lekut kundrejt euros. Përcaktuesit e kursit ekuilibër të konsideruar në këtë studim përfshijnë diferencën e produktivitetit, mjetet e huaja neto, shpenzimet e qeverisë, diferencën e normave të interesit dhe shkallën e hapjes së ekonomisë.

KRONOLOGJI E VENDIMEVE TË POLITIKËS MONETARE

12 korrik 2006

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendos të rrisë normën bazë të interesit me 0.25 pikë përqindjeje, në 5.25 për qind.

30 nëntor 2006

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendos të rrisë me 0.25 pikë përqindjeje normën bazë të interesit, në 5.5 për qind.

04 prill, 02 maj dhe 06 qershor 2007

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendos të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në 5.5 për qind.

27 qershor 2007

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendos të rrisë me 0.25 pikë përqindjeje normën bazë të interesit në 5.75 për qind.

19 korrik dhe 29 gusht 2007

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendos të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit në 5.75 për qind.

26 shtator 2007

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendos të rrisë me 0.25 pikë përqindjeje normën bazë të interesit në 6.00 për qind.

31 tetor 2007

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendos të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit në 6.00 për qind.

27 nëntor 2007

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendos të rrisë me 0.25 pikë përqindjeje normën bazë të interesit në 6. 25 për qind.

27 dhjetor 2007

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendos të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit në 6.25 për qind.

30 janar, 27 shkurt, 26 mars, 30prill, 27 maj, 25 qershor, 30 korrik, 29 gusht, 29 shtator, 29 tetor, 26 nëntor dhe 24 dhjetor 2008

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendos të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në 6.25 për qind, gjatë gjithë vitit 2008.

28 janar 2009

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendos të ulë me 0.50 pikë përqindjeje normën bazë të interesit, në 5.75 për qind.

25 shkurt, 25 mars, 29 prill, 17 maj, 24 qershor, 29 korrik dhe 26 gusht 2009

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendos të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit në 5.75 për qind.

NGJARJET JURIDIKE, PRILL - QERSHOR 2009

POLITIKA MONETARE

Në datën 29.04.2009, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 35 "Raportin e Politikës Monetare për tremujorin e parë të vitit 2009". Sipas këtij raporti , aktiviteti ekonomik në vend, u zhvillua në kushtet e një ecurie të qëndrueshme të çmimeve të konsumit. Normat e ulëta të inflacionit bazë dhe atij të mallrave me çmime të patregtueshme dëshmojnë për rënien e presioneve inflacioniste nga ana e kërkesës së brendshme. Importet dhe eksportet janë ulur gjatë kësaj periudhe duke u shoqëruar me një ngushtim prej 4.3 për qind të deficitit tregtar. Zhvillimet fiskale gjatë tremujorit të parë të vitit 2009 kanë qenë përgjithësisht brenda kuadrit buxhetor për vitin 2009 .

MBIKËQYRJA

Në datën 27.05.2009, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 40, rregulloren "Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave, të degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre". Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe parimeve bazë për një drejtim të përgjegjshëm dhe efektiv të bankave dhe degëve të bankave të huaja, detajimi i kritereve që duhet të përmbushin administratorët e tyre si dhe i dokumentacionit të nevojshëm për miratimin e tyre nga Banka e Shqipërisë. Në rregullore parashtrohen gjithashtu, edhe kriteret për lidhjen e marrëveshjeve me të tretë për ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësive për administrimin dhe drejtimin e bankës.

Në datën 10.06.2009, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 44 rregulloren "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit". Përmes miratimit të kësaj rregulloreje synohet parandalimi i përdorimit të subjekteve, të cilat licencohen dhe mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë për pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit. Objekt i rregullores është përcaktimi i procedurave dhe dokumentacionit për identifikimin e klientit, i rregullave për regjistrimin dhe ruajtjen e të dhënave dhe raportimin e tyre tek autoriteti përgjegjës.

Në datën 10.06.2009, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 45, rregulloren "Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë sipas sistemit raportues të unifikuar". Kjo rregullore përcakton rregullat, kushtet dhe afatet e raportimit nga bankat dhe degët e bankave të huaja, subjektet financiare jobanka, shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre,

në Departamentin e Statistikës së Bankës së Shqipërisë, si dhe rregullat për administrimin e këtyre raportimeve. Përmes përdorimit së sistemeve raportuese të unifikuara synohet marrja e informacioneve të standardizuara si dhe përpunimi i tyre për efekt të mbikëqyrjes bankare dhe përgatitjes së statistikave të ndryshme financiare dhe monetare.

Në datën 10.06.2009, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 47 një shtesë në rregulloren "Për administrimin e rrezikut të kredisë". Pas kësaj shtese, "kredimarrës të ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit" do të konsiderohen edhe kredimarrësit që nuk janë të mbrojtur nga një rrezik i tillë, nëpërmjet një produkti derivativ (instrumente derivative), i cili ofron kushte të përshtatshme mbrojtjeje.

Në datën 10.06.2009, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 46, disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave". Përmes ndryshimeve dhe shtesave të bëra në nenet 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, përcaktohen kriteret që duhet të plotësojnë filialet e një banke ose një shoqërie mëmë, në mënyrë që kjo e fundit të përjashtohet nga kufizimet maksimale të lejueshme të ekspozimit të madh. Ndryshimet parashikojnë gjithashtu, mospërfshirjen në ekspozimin e bankës ndaj një personi ose një grupi personash, të garancive të lëshuara nga bankat dhe institucionet financiare që veprojnë në vendet e OECD-së, të cilat garantojnë të drejta apo kredi ndaj klientëve që veprojnë në vend.

Në datën 24.06.2009, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 51, disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren "Për funksionimin e Regjistrit të Kredive në Bankën e Shqipërisë". Pas këtyre ndryshimeve, raportuesit e Regjistrit të Kredive, duhet të raportojnë të dhënat dhe informacionin edhe për çdo "Letër Kredi"ose "Letër Garanci" të miratuar dhe të financuar prej tyre, brenda ditës së nesërme të punës. Raportuesit gjithashtu, fitojnë të drejtën për të kërkuar informacion edhe për personat, të cilët i çmojnë të lidhur me subjektin e interesuar që aplikon për të marrë kredi.

Në datën 24.06.2009, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 52, disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren "Për procedurën e nxjerrjes së raportit mbi kredimarrësin dhe rishikimin e të dhënave që mbahen në Regjistrin e Kredive". Përmes shtesave dhe ndryshimeve të parashtruara në këtë vendim, të cilat prekin nenet 5, 11 dhe 15 të rregullores, synohet të bëhen disa përmirësime në procedurat që duhen ndjekur dhe kushtet që duhen përmbushur, për pranimin e kërkesës së kredimarrësit për nxjerrjen e raportit me të dhënat e tij si dhe për rishikimin e këtyre të dhënave.

Në datën 24.06.2009, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 50 "Strategjinë afatmesme të zhvillimit të Bankës së Shqipërisë për periudhën 2009-2011". Strategjia afatmesme e zhvillimit të Bankës së Shqipërisë ka për qëllim të përcaktojë një program të ngjeshur të punëve, detyrave të të gjitha njësive si dhe rrugëve që duhen ndjekur për përmbushjen e angazhimeve dhe nismave të ndërmarra nga institucioni, për tre vitet në vijim.

POLITIKA EKONOMIKE

Në datën 01.04.2009, Këshilli i Ministrave miratoi udhëzimin nr. 1 "Për formën, mënyrat e procedurat e raportimit të të dhënave të subjekteve, Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit Integrimit të Zonave Ndërtimore dhe Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në kuadër të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit". Udhëzimi synon parandalimin e përdorimit të subjekteve të ndryshme për pastrimin e parave si dhe financimin terrorizmit përmes një sërë raportesh si; "Raporti i transaksionit të parasë fizike", "Raporti i vetëkontrollit", "Raporti i transaksionit të vlerave" etj.. Subjektet raportuese që dyshojnë që transaksioni, prona ose marrëdhëniet e biznesit janë produkte të veprës penale ose kanë për qëllim të përdoren për financimin e terrorizmit, duhet të paraqesin pranë autoritetit përgjegjës, një raport për veprimtarinë, brenda 72 orëve.

Në datën 23.04.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ratifikoi me ligjin nr. 10115 "Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të Republikës Greke e Organizatës së Sigurimit të Kredive të Eksportit (ECIO)". Marrëveshja parashikon shlyerjen e plotë të borxhit që rrjedh nga marrëveshja e nënshkruar në 24 qershor 1991, mes Bankës së Shtetit Shqiptar dhe Konsorciumit të Bankave Greke, brenda një periudhe 10-vjeçare përmes kësteve që do të paguhen çdo gjashtë muaj.

Në datën 23.04.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10117 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632 , datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar". Ligji parashikon, ndër të tjera, ndryshime në nenet 11 dhe 21 të ligjit nr. 9632. Kështu, kufijtë e sipërm, nën të cilët këshillat bashkiakë apo komunalë vendosin për nivelin e taksës vendore për biznesin e vogël (neni 11) dhe të taksës për pasurinë e paluajtshme (neni 21), ndryshojnë nga plus 30 për qind, në plus 10 për qind të nivelit tregues të taksës për kategoritë përkatëse.

Në datën 23.04.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10119 "Për planifikimin e territorit". Ky ligj ka për objekt përcaktimin e parimeve bazë, rregullave dhe procedurave për planifikimin e territorit. Përmes tij synohet të sigurohet zhvillimi i qëndrueshëm i territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe burimeve natyrore; të krijohen kushte të përshtatshme dhe shanse të barabarta për banim, veprimtari ekonomike e sociale për të gjitha kategoritë shoqërore, si dhe bëhet i mundur hartimi dhe përditësimi i rregullt i instrumenteve të planifikimit, nga autoritetet kombëtare dhe vendore, sipas kërkesave të tregut dhe nevojave sociale.

Në datën 23.04.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10116 "Për miratimin e kontratës së shitjes së 76 për qind të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë , Tregtisë dhe Energjitikës së Republikës së Shqipërisë dhe ÇEZ A.S-së ". Me këtë ligj, në kuadër të reformave të rëndësishme të ndërmarra në sektorin e energjitik, që synojnë liberalizimin dhe zhvillimin e tregut të energjisë

elektrike, METE i shet ÇEZ A.S-së 76 për qind të aksioneve të OSSH, për një çmim total blerjeje prej 102000000 eurosh (njëqind e dy milionë).

Në datën 27.04.2009, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 415 "Për rritjen e pensioneve". Ky vendim parashikon rritjen e pensioneve me 8 për qind, 10 për qind dhe 22 për qind, sipas kategorive të ndryshme të përcaktuara në ligjin "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë".

Në datën 06.05.2009, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 487 "Për përcaktimin e rregullave dhe të kritereve për shpërndarjen e fondit të kompensimit të pronarëve, në të holla, për vitin 2009". Vendimi përcakton kategoritë e subjekteve të shpronësuara të cilat do të përfitojnë nga kompensimi, sipërfaqen e truallit për të cilën do të kompensohen sipas çmimit të përcaktuar në hartën e vlerës së miratuar, dokumentacionin që duhet të plotësohet shoqëruar me kërkesën për kompensim, si dhe procedurat që do të ndiqen në shqyrtimin e kërkesave.

Në datën 06.05.2009, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 450 "Për miratimin e kalimit të pronësisë të parcelave ndërtimore të objekteve informale, të veçuara, të shtesave anësore para vitit 1993, si dhe të shtesave anësore pa leje në ndërtime me leje, në favor të poseduesve të tyre". Përmes këtij vendimi miratohet kalimi i pronësisë së parcelave ndërtimore të objekteve informale në favor të poseduesve sipas një liste të bashkëngjitur vendimit dhe planvendosjes përkatëse, për disa qarqe të vendit.

Në datën 08.05.2009, Këshilli i Ministrave miratoi udhëzimin nr. 16 "Për përcaktimin e rregullave për shpërndarjen e rishpërndarjen e fondeve publike për subjektet zgjedhore". Udhëzimi ka për qëllim të përcaktojë rregulla për mënyrën e shpërndarjes së fondeve publike subjekteve zgjedhore, që do të marrin pjesë në zgjedhjet për Kuvendin, 2009 dhe për mënyrat e rishpërndarjes së fondeve publike, subjekteve zgjedhore që do të përfitojnë mandate.

Në datën 11.05.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ratifikoi me ligjin nr. 10123 "Marrëveshjen kuadër të huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës (CEB) për financimin e programit për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale, malore". Ky program synon krijimin dhe ruajtjen e vendeve të mundshme të punës përmes dhënies hua sipërmarrësve të vegjël në zonat rurale, për të lehtësuar blerjen e bagëtisë, mjeteve bujqësore dhe investimet e vogla rurale e shërbimet e vogla. Fondi I prej 5 000 000 (pesë milionë) eurosh i miratuar nga CEB do të përdoret për të dhënë "hua individuale"(më pak se 1200 euro) dhe " hua të ndërmarrjeve të vogla"(më shumë se 1200 euro).

Në datën 11.05.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi me ligjin nr. 10125 ratifikimin e "Marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, që vepron nëpërmjet Ministrit të Financave, Alpha Bank A.E. e Deutsche Bank AG, dega Londër, si rregullues, institucioneve financiare të listuara si huadhënësit fillestarë dhe Alpha Bank A.E., dega Londër si agjent për financimin e shpenzimeve kapitale

për vitin 2009, në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin e Shqipërisë". Huaja e akorduar nga huadhënësit, që parashikohet të mos e kalojë shumën prej 250 000 000 (dyqind e pesëdhjetë milionë) eurosh, do të përdoret për shpenzimet kapitale të planifikuara nga Këshilli i Ministrave për vitin 2009, në përputhje me prioritetet e përcaktuara në "Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim".

Në datën 11.05.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10130 "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit". Ky ligj ka për objekt përcaktimin e formës së organizimit, të rregullave të funksionimit dhe administrimit të Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH). Qëllimi i FSHZH është nxitja e zhvillimit ekonomik dhe social, të qëndrueshëm dhe të balancuar, në nivel rajonal dhe vendor. Për plotësimin e këtij qëllimi, FSHZH parashikohet të punojë për arritjen e objektivave të ndërmjetëm të tillë si; përmirësimi i infrastrukturës social-ekonomike, përmirësimi i shërbimeve publike vendore, forcimi institucional i njësive të qeverisjes vendore dhe nxitja e qeverisjes së mirë në nivel vendor.

Në datën 11.05.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10137 "Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë". Përmes këtij ligji Kuvendi miratoi një sërë ndryshimesh në ligje të ndryshme, sipas fushave të veprimtarisë dhe në përdorimin e të mirave. Disa nga fushat, legjislacioni i të cilave parashikohet të preket nga këto ndryshime janë: fusha e sigurisë kombëtare, fusha e ushqimit dhe e shëndetit, fusha e transportit, ajo e industrisë dhe e shërbimeve të tjera etj..

Në datën 13.05.2009, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 522 "Për përcaktimin e pagës minimale, në shkallë vendi". Sipas këtij vendimi, paga bazë minimale mujore për punonjësit, në shkallë vendi, e detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo person juridik e fizik, do të jetë 18 000 (tetëmbëdhjetëmijë) lekë dhe paga bazë minimale orare, 103 (njëqind e tre) lekë.

Në datën 15.05.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr.10140 "Për financimin nga Buxheti i Shtetit të bashkësive fetare, që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave". Në ligj parashikohet që bashkësitë fetare që kanë lidhur marrëveshje me Këshillin e Ministrave të tilla si; Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, Kisha Katolike në Shqipëri dhe Kryegjyshata Botërore Bektashiane, mund të përfitojnë financim të pjesshëm për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të kultit si dhe deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore, për punonjës të personelit të administratës si dhe arsimtarë të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar të punësuar në institute të krijuara dhe të administruara nga këto bashkësi.

Në datën 25.05.2009, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 581 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2009, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për financimin e shpenzimeve për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të 28 qershorit të vitit 2009". Përmes këtij vendimi, Komisionit Qendror Zgjedhor,i akordohet një fond shtesë prej 165000000

(njëqind e gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekë, për përballimin e shpenzimeve të zgjedhjeve të datës 28 qershor, 2009. Ky fond do të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të këtij viti.

Në datën 28.05.2009, Këshilli i Ministrave miratoi me vendimin nr. 595 "Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Katarit, për bashkëpunim tregtar dhe ekonomik". Me anë të kësaj marrëveshjeje, qeveritë e dy shteteve angazhohen të bashkëpunojnë ngushtësisht në fushat ekonomike, tregtare dhe teknike, si industria, energjia, bujqësia, komunikimet, transporti, puna e turizmi.

Në datën 11.06.2009, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 681 "Për trajtimin e kredive të transferuara nga bankat e nivelit të dytë, me kapital tërësisht shtetëror, në Agjencinë e Trajtimit të Kredive, për kriteret dhe kushtet për ndryshimin e marrëveshjes së kredisë, si dhe procedurat e marrjes në pronësi të pasurive të lëna si garanci ose jo nga huamarrësit, të administrimit, shitjes dhe dhënies me qira apo me enfiteozë të këtyre pasurive". Nëpërmjet këtij vendimi parashikohen kushtet e trajtimit të kredive të transferuara nga bankat e nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror, procedurat e marrjes në pronësi të pasurive të lëna si kolateral dhe administrimit të tyre, si dhe kushtet e kriteret që duhen plotësuar për ndryshimin e marrëveshjes së kredisë, zëvendësimin e debitorit apo të kolateralit.

Në datën 18.06.2009, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 700 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 1117, datë 30.07.2008 të Këshillit të Ministrave "Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nr. 9136, datë 11.09.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe nr. 7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar"". Vendimi parashikon ndër të tjera, ndryshime të pagës minimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, në jo më pak se 16 120 lekë dhe të pagës maksimale në jo më pak se 80 600 lekë. Gjithashtu, kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për të punësuarit, duke filluar nga data 01.05.2009, do të jetë 27,1 për qind e pagës bruto mujore, ku pjesa e punëdhënësit do të jetë 16,7 për qind dhe pjesa e të punësuarit , 11,2 për qind.

DREJTIMI I BANKËS SË SHQIPËRISË, 30 QERSHOR 2009

KËSHILLI MBIKËQYRËS

ARDIAN FULLANI	*Kryetar*
FATOS IBRAHIMI	*Zëvendëskryetar*
TEFTA ÇUÇI	*Anëtare*
LIMOS MALAJ	*Anëtar*
KSENOFON KRISAFI	*Anëtar*
ADRIAN CIVICI	*Anëtar*
ARJAN KADAREJA	*Anëtar*
HALIT XHAFA	*Anëtar*
BENET BECI	*Anëtar*

GUVERNATORI

ARDIAN FULLANI

KABINETI I GUVERNATORIT

GENC MAMANI

ZËVENDËSGUVERNATORËT

FATOS IBRAHIMI	*Zëvendësguvernator i Parë*

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

TEUTA BALETA

DEPARTAMENTET DHE NJËSITË E TJERA

DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE	*Roden Pajaj*
DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE	*Erald Themeli*
DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE	*Altin Tanku*
DEPARTAMENTI I OPERACIONEVE MONETARE	*Marjan Gjermeni*
DEPARTAMENTI I MBIKËQYRJES	*Indrit Banka*
DEPARTAMENTI I STABILITETIT FINANCIAR	*Klodion Shehu*
DEPARTAMENTI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT	*Xhilda Kanini*
DEPARTAMENTI I STATISTIKËS	*Diana Shtylla*
DEPARTAMENTI I EMISIONIT	*Valer Miho*
DEPARTAMENTI I KONTABILITETIT DHE FINANCËS	*Artan Toro*
DEPARTAMENTI I SISTEMEVE TË PAGESAVE	*Dashmir Halilaj*
DEPARTAMENTI JURIDIK	*Toni Gogu*
DEPARTAMENTI I KONTROLLIT	*Teuta Baleta*
DEPARTAMENTI I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË, INTEGRIMIT EVROPIAN DHE I KOMUNIKIMIT	*Ina Kraja*
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT	*Agron Skënderaga*
DEPARTAMENTI I SIGURIMIT DHE MBROJTJES	*Eduard Sinani*

DEGËT

Shkodër	*Ermira Istrefi*
Elbasan	*Valentina Dedja*
Gjirokastër	*Anila Thomaj*
Korçë	*Liljana Zjarri*
Lushnje	*Shpresa Meço*

LISTA E SUBJEKTEVE TË LICENCUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË*

BANKA DHE DEGË TË BANKAVE TË HUAJA

1. BANKA RAIFFEISEN SH.A.
Licenca Nr. 2/1998, datë 11.01.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 163, datë 11.12.1998.
Certifikata nr. 2 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Oliver WHITTLE*
Adresa: *Bulevardi "Bajram Curri", Qendra Tregtare Evropiane, Tiranë.*
Tel.: *2226 699, 2224 540, 2222 669, 2225 416.*
Faks: *2275 599, 2223 587, 2223 695, 2224 051*

2. BANKA E BASHKUAR E SHQIPËRISË SH.A.
Licenca Nr. 3/1998, datë 11.01.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 165, datë 11.12.1998.
Certifikata nr. 3 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Abdul Waheed ALAVI*
Adresa: *Rruga "Durrësit", sheshi tek Zogu i Zi, Godina Teknoprojekt, P.O. BOX 128, Tiranë.*
Tel.: *2240 45 75 / 76 / 77*
Faks: *2240 45 58*

3. BANKA ITALIANE E ZHVILLIMIT SH.A.
Licenca Nr. 5/1998, datë 11.01.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 164, datë 11.12.1998.
Certifikata nr.4 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Libero CATALANO*
Adresa: *Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Ndërtesa Kullat Binjake, Tiranë.*
Tel.: *2280 351 / 2 / 3 / 4 / 5.*
Faks: *2280 356*

4. BANKA KOMBËTARE TREGTARE SH.A.
Licenca Nr. 6/1998, datë 11.01.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 162, datë 11.01.1999.
Certifikata nr.5 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Seyhan PENCAPLIGIL*
Adresa: *Bulevardi "Zhan Dark", Tiranë.*
Tel.: *2250 955*
Faks: *2250 956*

5. BANKA TIRANA SH.A.
Licenca Nr. 07,datë 12.09.1996.
Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 9, datë 12.09.1996.
Certifikata nr.6 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Dimitrios SANTIXIS*
Adresa: *Rruga "Dëshmorët e 4 Shkurtit", PO BOX 2400/1, Tiranë.*

** Deri në 30 qershor 2009.*

Tel. : *2269 616 / 7 / 8, 2233 441, 42, 43, 44, 45, 46, 47*
Faks: *2233 417, 2369 707*

6. DEGA E BANKËS KOMBËTARE TË GREQISË, TIRANË
Licenca Nr. 08, datë 25.11.1996.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 4. datë 14.03.1996.
Certifikata nr.7 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Ioannis KOUGIONAS*
Adresa: *Rruga "Durrësit", Godina Comfort, Tiranë.*
Tel.: *2274 802, 2274 822.*
Faks: *2233 613*

7. BANKA NDËRKOMBËTARE TREGTARE SH.A.
Licenca Nr.09, datë 20.02.1997.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 9, datë 30.04.1996.
Certifikata nr.8 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Mahendra Sing RAWAT*
Adresa: *Qendra e Biznesit, rruga "Murat Toptani", Tiranë.*
Tel.: *2254 372, 2256 254*
Tel./Faks: *2254 368*

8. ALPHA BANK – ALBANIA
Licenca Nr.10, datë 07.01.1998.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë Nr.01/03/96, datë 27.12.1997.
Certifikata nr.9 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Andreas GALATOULAS*
Adresa: *Rruga "Kavajës", G – KAM Business Center, kati II, Tiranë.*
Tel.: *22278 500*
Tel./Faks: *22232 102*

9. INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA SH.A.
Licenca Nr.11, datë 10.08.1998.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 105, datë 10.08.1998.
Certifikata nr.10 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Stefano FARABBI*
Adresa: *Rruga "Ismail Qemali", Nr. 27, P.O. BOX 8319, Tiranë.*
Tel.: *248 753 / 4 / 5 / 6, 2276 000*
Tel./Faks: *248 762*

10. BANKA PROCREDIT SH.A.
Licenca Nr. 12, datë 15.03.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 22, datë 03.03.1999.
Certifikata nr.11 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Borislav KOSTADINOV*
Adresa: *Rruga "Sami Frashëri", Tirana e Re, P.O. BOX 2395, Tiranë.*
Tel.: *2271 272 / 3 / 4 / 5*
Tel./Faks: *2271 276*

11. BANKA EMPORIKI – SHQIPËRI SH.A.
Licenca Nr. 14, datë 28.10.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.105, datë 19.10.1999.
Certifikata nr.13 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *George CARACOSTAS*
Adresa: *Rruga "Kavajës", Nr. 59, "Tirana Tower", Tiranë.*
Tel.: *2258 755, 56, 57, 58, 59, 60*
Tel./Faks: *2258 752*

12. BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRISË SH.A.
Licenca nr. 15, datë 28.08.2002.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 66, datë 28. 08. 2002.
Certifikata nr.14 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Kamal Abdel MONEIM
Adresa: Rruga "Perlat Rexhepi", Al-Kharafi Group Admistration Building, Kati 1&2, Tiranë
Tel.: 2272 168; 2272 162;
Faks: 2272 162.

13. BANKA CREDINS SH.A.
Licenca nr. 16, datë 31.3.2003.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 22, datë 26.03.2003.
Certifikata nr. 15 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Artan SANTO
Adresa: Rruga "Ismail Qemali", Nr. 21, Tiranë.
Tel.: 2234 096, 2233 912; 2258 252
Faks: 2222 916

14. BANKA POPULLORE SH.A.
Licenca nr. 17, datë 16.02.2004.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 06, datë 11.02.2004.
Certifikata nr. 16 " Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Henri Maus de ROLLEY
Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 1, Kati i 9-të, Tiranë.
Tel.: 2280 442 / 3, 2272 788; 2272 789; 2272 790; 2272 791
Faks: 2280 441, 2272 781

15. BANKA UNION SH.A.
Licenca nr. 18, datë 09.01.2006.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 101, datë 28.12.2005.
Certifikata nr. 17 " Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Gazmend KADRIU
Adresa: Bulevardi "Zogu I", pallati 13 katësh, përballë Stacionit të Trenit, Tiranë.
Tel.: 2250 653 / 2258 081
Faks: 2250 654 / 2272 880

16. BANKA E PARË E INVESTIMEVE, ALBANIA SH.A.
Licenca nr. 19, datë 06.07.2007
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 35, datë 27.06.2007
Certifikata nr. 12 " Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Bozhidar TODOROV
Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 2, Kati 14, Tiranë.
Tel: 2256 423 / 4, 2280 210
Faks: 2256 422

Përveç bankave dhe degëve të bankave të huaja, Banka e Shqipërisë ka licencuar deri më 30 qershor 2009 edhe subjektet e mëposhtme:

Nr.	Subjekte
8	SUBJEKTE JOBANKA
201	ZYRA TË KËMBIMIT VALUTOR
2	UNIONE TË SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT
135	SHOQËRI TË KURSIM-KREDITIT
1	ZYRË E PËRFAQËSIMIT TË BANKAVE TË HUAJA

PUBLIKIME TË BOTUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË QË PREJ VITIT 2008

Kjo listë u përpilua për të informuar lexuesit me botimet e Bankës së Shqipërisë që prej vitit 2008. Duke vizituar adresën tonë elektronike (www.bankofalbania.org) mund të plotësoni e dërgoni formularin në public@bankofalbania.org ose në faks (04) 223 558, dhe të regjistroheni për t'u bërë pjesë e listës së shpërndarjes së botimeve të Bankës së Shqipërisë. Gjithashtu, ju mund të përfitoni nga shërbimi i njoftimeve automatike të Bankës së Shqipërisë. Nëpërmjet këtij shërbimi, çdo mesnatë, sistemet e Bankës do t'ju njoftojnë në postën tuaj elektronike rreth ndryshimeve apo të rejave në argumentet që keni përzgjedhur. Më poshtë mund të gjeni të gjithë titujt e publikimeve të Bankës së Shqipërisë të botuara nga viti 2008 deri në gusht të vitit 2009. Kjo listë nuk përfshin vrojtimet e kryera nga Banka e Shqipërisë, të cilat publikohen vetëm në formë elektronike (http://www.bankofalbania.org/web/vrojtime_3405_1.php).

RAPORTI VJETOR:

Raporti Vjetor 2007.
Raporti Vjetor 2008.

RAPORTET PERIODIKE TË POLITIKËS MONETARE:

Vlerësimi tremujor i gjendjes së ekonomisë për tremujorin e parë të vitit 2008.
Vlerësimi tremujor i gjendjes së ekonomisë për tremujorin e tretë të vitit 2008.
Deklarata e politikës monetare për gjashtëmujorin e parë 2008.
Deklarata e politikës monetare për gjashtëmujorin e dytë 2008.
Vlerësimi tremujor i gjendjes së ekonomisë për tremujorin e parë të vitit 2009.
Deklarata e politikës monetare për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009.
Dokumenti i politikës monetare për vitin 2008.
Dokumenti i politikës monetare për periudhën 2009 - 2011.

BOTIME PËR STATISTIKAT:

Raporti Statistikor (Botohet çdo muaj të vitit).
Buletini i Bilancit të Pagesave 2007.
Buletini i Bilancit të Pagesave 2008.

BULETINI ZYRTAR:

Treguesi i Buletinit Zyrtar të Bankës së Shqipërisë (1998-2009).
Buletini Zyrtar - Vëllimi 10, nr.1 Viti 2008
Buletini Zyrtar - Vëllimi 10, nr.2 Viti 2008
Buletini Zyrtar - Vëllimi 10, nr.3 Viti 2008
Buletini Zyrtar - Vëllimi 10, nr.4 Viti 2008
Buletini Zyrtar - Vëllimi 10, nr.5 Viti 2008

Buletini Zyrtar - Vellimi 10, Nr.6 Viti 2008
Buletini Zyrtar - Vëllimi 10, nr.7 Viti 2008
Buletini Zyrtar - Vëllimi 10, nr.8 Viti 2008
Buletini Zyrtar - Vëllimi 10, nr.9 Viti 2008
Buletini Zyrtar - Vëllimi 10, nr.10 Viti 2008
Buletini Zyrtar - Vëllimi 10, nr.11 Viti 2009
Buletini Zyrtar - Vëllimi 11, nr.1 Viti 2009
Buletini Zyrtar - Vëllimi 11, nr.2 Viti 2009
Buletini Zyrtar - Vëllimi 11, nr.3 Viti 2009
Buletini Zyrtar - Vëllimi 11, nr.4 Viti 2009
Buletini Zyrtar - Vëllimi 11, nr.5 Viti 2009
Buletini Zyrtar - Vëllimi 11, nr.6 Viti 2009
Buletini Zyrtar - Vëllimi 11, nr.7 Viti 2009

BULETINI EKONOMIK:

Buletini Ekonomik - Vëllimi 11, nr.1 Viti 2008
Buletini Ekonomik - Vëllimi 11, nr.2 Viti 2008
Buletini Ekonomik - Vëllimi 11, nr.3 Viti 2008
Buletini Ekonomik - Vëllimi 11, nr.4 Viti 2008
Buletini Ekonomik - Vëllimi 12, nr.1 Viti 2009

RAPORTI I STABILITETIT FINANCIAR:

Raporti i Stabilitetit Financiar 2007
Raporti i Stabilitetit Financiar 2008

RAPORTI VJETOR I MBIKËQYRJES:

Raporti Vjetor i Mbikëqyrjes 2007
Raporti Vjetor i Mbikëqyrjes 2008

PUBLIKIME NJOHËSE DHE INFORMATIVE:

Katalogu i publikimeve
Katalogu i publikimeve 2007
Katalogu i publikimeve 2008

MATERIALET E DISKUTIMIT:

Artikuj të botuar në Buletinin Ekonomik të Bankës së Shqipërisë gjatë një dekade - Vëllimi I, Periudha 1998-2000
Artikuj të botuar në Buletinin Ekonomik të Bankës së Shqipërisë gjatë një dekade - Vëllimi II, Periudha 2001-2004
Artikuj të botuar në Buletinin Ekonomik të Bankës së Shqipërisë gjatë një dekade - Vëllimi III, Periudha 2005-2007
Indeksi i çmimeve/vlerave njësi të huaja të importeve shqiptare
Përçimi i kursit të këmbimit në Shqipëri: Evidencë nga vektorët autoregresivë
Matja e funksioneve të import-eksportit në Shqipëri
Matje të reja të inflacionit bazë: Përdorimi i tyre në parashikim dhe analizë
Roli i kursit të këmbimit në shënjestrimin e inflacionit. Si veprohet?
Matja e efektit Balassa-Samuelson: Rasti i Shqipërisë
Roli i bankave në transmetimin e politikës monetare në Shqipëri
A është i qëndrueshëm deficiti i llogarisë korente? Rasti i Shqipërisë
Strategjitë e politikës monetare për ekonomitë e vogla - Ideoi dhe përgatiti, Ardian Fullani

Metoda alternative të matjes së produktit potencial në Shqipëri

TË REJA SHKENCORE NË BANKËN E SHQIPËRISË:

Të reja shkencore në Bankën e Shqipërisë Nr. 1
Të reja shkencore në Bankën e Shqipërisë Nr. 2

PUBLIKIME TË KARAKTERIT JURIDIK:

Ligji nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë"

PUBLIKIME EDUKATIVE -INFORMATIVE:

Guidë rreth llogarisë tuaj të parë bankare
Guida e studentit
Historia e Akullores (ribotim)
Të flasim thjesht për inflacionin (ribotim)
Tërheqja nga qarkullimi i parave (fletëpalosje)
"Vlera e Vërtetë e Parasë"
Banka e Shqipërisë - Banka jonë qendrore (ribotim)
IBAN - Numri Ndërkombëtar i Llogarisë Bankare (fletëpalosje)
Instrumentet e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë dhe procedurat për realizimin e tyre (i ripunuar)
Sistemi i pagesave (i ripunuar)
"Vlera e Vërtetë e Parasë" Vlorë, 2008
Edukimi - sfida e re e Bankës së Shqipërisë